

# ARSIM QYTETAR PËR VITIN E PARË TË ARSIMIT TË MËSËM

• UDHËZUES PËR MËSIMDHËNËS •





**ARSIM  
QYTETAR PËR  
VITIN E PARË  
TË ARSIMIT  
TË MESËM**

•UDHËZUES PËR MËSIMDHËNËS•



Ky publikim është përgatitur nga grupi i punës i përbërë nga:

**Oliver Stanojoski, Ilir Memedi, Ana Poprizova, Nadica Tanevska Janeva, Sunçica Belinska Andov, Valentina Panxharova, Valdete Adili Selimi, Naser Miftari, Marija Mirçevska, Jovana Gjorgjiovska, Ana Mickovska-Raleva, Dejan Rizinski**

Aktivitetet për përgatitjen e përmbajtjes së këtij publikimi u realizuan në kuadër të Projektit të USAID-it për Integrim Ndëretnik të të Rinjve në Arsim i zbatuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Byronë për Zhvillimin e Arsimit

Redaksia profesionale

**Mitko Çeshllarov, Ajshe Ajrullai**

Titulli

**Udhëzues për mësimdhënësit e arsimit qytetar në vitin e parë të arsimit të mesëm profesional**

Botues

**Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ)**

Përktheu

**Enis Misini**

Dizajnoi

**KOMA lab.**

# Hyrje

Të nderuar mësimehdhënës,

Para jush ndodhet *Udhëzuesi për arsim qytetar për vitin e parë të arsimit të mesëm profesional*. Shpresoj se udhëzuesi do t'ju frymëzojë dhe do t'ju nxisë që ta zhvilloni më tej praktikën tuaj mësimore në pajtim me rrjedhat bashkëkohore mësimore.

Në pajtim me programin mësimor, udhëzuesi është ndarë në pesë njësi modulare në të cilat janë futur përmbajtje përkatëse të cilat përfshijnë teorinë dhe aktivitetet praktike për arritjen e rezultateve nga nxënia, të parapara në programin mësimor. Për çdo përmbajtje janë ofruar aktivitete të ndara në dy deri në tre orë mësimore të cilat ju do të mund t'i adaptoni sa i përket formës dhe kohës së realizimit, varësisht vlerësimit tuaj personal dhe përvojës tuaj praktike nga orët.

Orët e propozuara mësimore janë strukturuar në formë të punëtorive, me përfshirjen e: pjesës hyrëse të orës, pjesës kryesore, pjesës përfundimtare dhe një pjese për reflektim dhe vlerësim, me kohë të përlogaritur për realizimin e secilit prej aktiviteteve. Megjithatë, varësisht nga kushtet e realizimit të mësimin, njohurive paraprake dhe shkathtësive të nxënësve, si edhe varësisht nga interesimi i nxënësve për një përmbajtje të caktuar, keni mundësi ta ndryshoni kohën e mësimehdhënies për tema të ndryshme.

Duke e mësuar lëndën e arsimit qytetar pritet nxënësit të jenë qytetarë aktiv dhe të informuar, të cilët kontribuojnë për zhvillimin e bashkësisë së tyre. Ata krahas njohurive për veten, shoqërinë dhe botën duhet të zhvillojnë edhe aftësi të domosdoshme për jetë në një shoqëri demokratike, të fitojnë vlera humanizmi, bashkëpunimi dhe përgjegjësie, si edhe të nxiten në sjellje të cilat çojnë drejt përmirësimit të vetes si person dhe avancimit të kushteve të jetesës në shkollë dhe në bashkësi.



# PËRMBAJTJE

**HYRJE NË  
PËRMBAJTJET  
MËSIMORE  
NGA LËNDA  
ARSIM QYTETAR** ..... **6**

*Moduli*  
**1** **IDENTITETI  
QYTETAR –  
PASQYRË  
PËR VETEN  
SI QYTETAR** ..... **12**

*Moduli*  
**2** **LIDHSHMËRI  
QYTETARE** ..... **78**

*Moduli*  
**3** **QYTETAR  
NË SHOQËRI  
QYTETA** ..... **164**

*Moduli*  
**4** **QYTETARI  
DHE SHTETI** ..... **278**

*Moduli*  
**5** **GLOBALIZIMI  
DHE SHOQËRIA** ..... **370**

**HYRJE NË  
PËRMBAJTJET  
MËSIMORE  
NGA LËNDA  
ARSIM QYTETAR**



## ***Përmbajtja: Hyrje në përmbajtjet mësimore nga lënda arsim qytetar***



### ***Materialet e nevojshme:***

fleta me ngjyrë, fllomasterë, marker, ngjitëse, gërshërë, Fletë pune 1.1



### ***Metoda, teknika, forma:***

punë frontale, punë në grup, punë individuale, stuhi e ideve.



## **Pjesa hyrëse e orës (10 min.)**

Mësimdhënësi i fton nxënësit që të prezantohen duke shqiptuar emrin e tyre dhe një veçori pozitive që ata konsiderojnë se e posedojnë.

*Shënim:* Emri dhe veçoria e nxënësve janë aspekte të identitetit të tyre personal. Mësimdhënësit mund ta përdorin këtë të dhënë në punën e mëtejshme gjatë orës.

## **Pjesa kryesore e orës (25 min.)**

### **Aktivitet:**

#### **Asociacione**

Mësimdhënësi i fton nxënësit që secili prej tyre në mënyrë individuale të shënojë tre asociacione (terme që më së pari u bien ndërmend) kur të dëgjojnë termin – arsim qytetar.

Mësimdhënësi formon grupe të nxënësve (maksimum - 4 nxënës) dhe u jep detyrë që t'i ndajnë asociacionet e tyre në grup. Më pas, secili prej grupeve duhet të merret vesh për 3 asociacione të përbashkëta që do t'i prezantojnë para paraleles.

Mësimdhënësi i shkruan titujt e moduleve që do të mësohen nga lënda arsim qytetar gjatë vitit shkollor (mund t'i përgatisë ato edhe në letër) dhe më pas bën thirrje përfaqësuesve të secilit grup të ngjisin/shënojnë "tullën" e tyre, në afërsi të titujve tashmë të shënuar të moduleve, me çka do të ndërtohet „Muri e përmbajtjeve“ nga lënda arsim qytetar.

Mësimdhënësi bën një përmbledhje se në këtë mënyrë ndërtohet „Muri i përmbajtjeve“ që do të përfshihen në këtë lëndë. Mësimdhënësi i ka vendosur themelet (modulet), ndërsa nxënësit me fletët, të ashtuquajturat- „tulla“.

Mësimdhënësi thekson se përmbajtjet që janë mësuar gjatë arsimit fillor, do të sendërtohen dhe përpunohen më thellësisht gjatë arsimit të mesëm. Në mënyrë që të marrë informacione lidhur me nivelin e të kuptuarit dhe interesin për përmbajtje të caktuara, mësimdhënësi mund të përdorë pyetje për reflektim.

## **Aktivitet:**

### ***Aktiviteti: Cili/a jam unë?***

Mësimdhënësi u jep për detyrë nxënësve që të bëjnë intervistë me nxënësin që rri ulur me ta në bankën e njëjtë, me atë që do ta plotësojnë Fletën e punës 1.1 me qëllim të njoftimit të ndërsjellë të nxënësve, me ç'rast përdoret ushtrimi që është hyrje në përmbajtjet e pranishme në orët e radhës.

Shënim: Në fletën e punës janë përmendur aspekte të identitetit dhe materialet nga ky ushtrim mund të përdoren si përkujtues edhe në orën kur do të përpunohet termi identitet.

## ***Pjesa përfundimtare e orës dhe reflektim*** **(10 min.)**

Mësimdhënësi nxitë diskutim në grup sipas pyetjeve si vijon:

- 1.** Cilat përmbajtje nga kjo lëndë kanë qenë interesante për ju gjatë arsimit fillor?
- 2.** Për cilat nga modulet e prezantuara nga programi mësimor jeni më së shumti të interesuar që të mësoni dhe kuptoni më tepër?
- 3.** Sa konsideroni se ajo që e mësoni nga arsimit qytetar do të jetë e leverdishme gjatë jetës? Sqaroni përmes shembujve.



## **Fletë pune 1.1.** **Cili/a jam unë?**

**Vendbanim**


**Emri**

**Anëtarësi**

**Mosha**

**Ushqim**

**Nacionaliteti**





*Moduli*



**IDENTITETI  
QYTETAR –  
PASQYRË  
PËR VETEN  
SI QYTETAR**

## **Përmbajtja: Vetëdije për identitetin qytetar**



### **Rezultate nga nxënia:**

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:

- ➔ interpretojë termin qytetar dhe t'i sqarojë faktorët që ndikojnë në zhvillimin e identitetit qytetar.



### **Standarde/tregues për arritje:**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ identifikojë lloje të ndryshme të identitet (personal dhe grupor).



### **Materialet e nevojshme:**

tabelë, shkumës, Fletë pune 1.2, materiale për aktivitete (Barometër i qëndrimeve)



### **Metoda, teknika, forma:**

metodë frontale, punë individuale dhe në grup, barometër i qëndrimeve.

## Pjesa hyrëse e orës (15 min.)

Mësimdhënësi u jep për detyrë nxënësve që të plotësojnë *Fletën e punës 1.2*

Më pas fton disa nxënës para paraleles që t'i ndajnë detyrat.

**Konstatimi nga aktiviteti:** Emri është një shprehje e identitet tonë personal. Me të paraqitemi në botën rreth nesh. Përmes këtij ushtrimi mund të vëreni sa kuptime dhe përmbajtje i keni dhënë emrit personal. Kjo ju paraqet dhe prezanton në mjedisin, por njëherësh është edhe prezantim i një pjese të një ose më shumë grupeve të cilëve u takoni (familje, moshatarë, bashkësi, shoqëri, shtet, kontinent).

## Pjesa kryesore e orës (15 min.)

Njëra prej çështjeve më të rëndësishme që janë të pranishme te secili individ është çështja që ka të bëjë me **identitetin e individit**, si njësi, e gjithësi edhe në kontekst të bashkësive, gjegjësisht **shoqërisë qytetare**.

Sfida me të cilën përballlet çdo individ është që nga njëra anë të pranojë vetveten me të gjitha nevojat, veçoritë, vlerat dhe format e tij të sjelljes, e nga ana tjetër nevoja që të përkasë diku dhe të jetë i pranuar në grupin, bashkësinë, shoqërinë.

Në këtë dhe orën e radhës do të përpunohen termet: **identitet, përkatësi, qytetar dhe identitet qytetar**.

**Identiteti** paraqet një konstrukt që përfshin veçoritë, nevojat, vlerat, qëllimet dhe mënyrat e sjelljes që individi i dalloni dhe pranon si të tij.

Në kuptimin psikologjik, me **identitet** nënkuptohet uniteti dhe veçoria e individit, përkundër ndryshimeve që ndodhin në të dhe rreth tij. **Identiteti** fillon të formohet që në moshën më të hershme, përmes vendosjes së lidhjes emotive mes prindërve/kujdestarëve dhe fëmijës. Fëmija fillon të zhvillojë pasqyrë për veten si individ i posaçëm, vëren se është ndryshe nga të tjerët dhe fillon të njohë trupin, emocionet dhe mendimet e tij.

**Zhvillimi i identitetit** është proces dinamik i cili është më së shumti i shprehur në periudhën e adoleshencës. Në këtë periudhë ndodhin ndryshime të mëdha në planin fiziologjik, emocional dhe mental, kështu që është e logjikshme që edhe zhvillimi i identitetit do të jetë i stuhishëm.



Adoleshenti fillon të rishikojë vetveten, nevojat, aftësitë, vlerat, qëllimet, bindjet e tij politike, religjioze dhe shoqërore, etj. Në fakt, **zhvillimi i identitetit të individit** është proces i natyrshëm në të cilin individi "provon" ose eksperimenton me identitete të ndryshme dhe i shijon epilogët, efektet dhe reagimet e ndryshme në dhe nga rrethina.

Kjo bëhet me qëllim që të përcaktohet se cili/a është ai/ajo dhe si dëshiron të jetë i/e perceptuar nga rrethina. Individi mund të reagojë me pranim ose refuzim të rrethinës së njohur ose të afërt, por njëherësh mund të paraqitet ndjenjë e përkatësisë në ndonjë sub-kulturë ose grup të ri. Këto reagime do të mundësojnë që individi të përcaktojë një **aspekt të caktuar të identitetit të tij**. Kjo mund të jetë grup ose bashkësi e përcaktuar nga muzika, hobi, filmi, sporti ose interesa të tjerë. (p.sh Fletë pune 1.1)

Në mënyrë të ngjashme, individi do të eksperimentojë me përvetësimin e shkathtësive dhe strategjive të ndryshme sociale (për shembull, si të jetë i pranuar në shoqërinë e moshatarëve, të arrijë popullaritet dhe të tërheqë vëmendje nga shoqëria). Do të mundohet t'i dallojë të gjitha shkathtësitë dhe strategjitë që i zbaton dikush që është i popullarizuar në shoqëri (për shembull, a tregon shaka, si vishet, si sillet, etj.) dhe t'i zbatojë në rrethinën e tij. Qëllimi i sjelljes së këtyllë është që të sigurojë **përkatësi në bashkësi**.

Gjatë këtij procesi, individi do të shijojë edhe sukses edhe dështim dhe do të tentojë të zbatojë qasje të ndryshme në sjelljet me të tjerët. Në këtë mënyrë e ndërton rrjetin e tij social të mbështetjes, me njerëz me të cilët do të zhvillojë intimitet dhe relacione emocionale. Sa më shumë që të përkufizohen relacionet emocionale të individit, do të zhvillohet edhe **sistemi i vlerave**. Disa të rinj vetëm i marrin përsipër vlerat nga më të afërmit në rrethinë, derisa numri më i madh kanë nevojë që t'i kontrollojnë dhe të ndërtojnë sistem të tyre personal të vlerave. Ky proces mund të jetë jashtëzakonisht i vështirë dhe me stres për adoleshentin, familjen e tij, shkollën dhe bashkësinë. Pikërisht për këtë arsye nevojitet që rrethina ta dallojë këtë dhe të tentojë t'i ofrojë mbështetje adoleshentit në procesin e zhvillimit të identitetit të tij dhe në arritjen e pjekurisë së individit.

Sa më shumë që të jetë zhvilluar identiteti personal, për aq është individi më i sigurt në vetveten, e pranon veten me të gjitha virtytet dhe mangësitë e tij, përballet më lehtë me sfidat e jetës dhe stresin dhe ka inteligjencë më mirë të zhvilluar sociale dhe emocionale. Në një shkallë të caktuar, varet nga identiteti edhe si do të jetë **vetëbesimi i individit** – si e shikon dhe vlerëson vetveten. Nëse identiteti personal nuk është i zhvilluar sa duhet, individi është më i pasigurt në veten dhe pasqyrën për veten më shumë e ndërton në bazë të asaj se si e përjeton rrethina, pra edhe ai vetë përjeton veten ashtu.

Një pjesë e identitetit të individit përcaktohet edhe përmes grupeve në të cilat ai është anëtar. Grupet mund të jenë: familja, klub sportiv, bandë muzikore, bashkësi fetare, status social, etj.

Përkatësia në grupet me të cilat identifikohemi zakonisht është burim i rëndësishëm i krenarisë dhe vetëbesimit për individin. Anëtarët e grupit ndajnë ndjenjën e ndërsjellë të veçantisë dhe dallimit nga të tjerët.

Për shkak të ndikimit të identitetit grupor, gjithnjë e më shumë hulumtohet se si identiteti reflektohet përmes përkatësisë racore dhe etnitetit, gjinisë, seksualitetit, por edhe sistemeve të tjera të ndarjes sociale siç janë përkatësia gjeografike, hapësira sajber. Në mënyrë plotësuese, imponohen edhe çështjet e ndryshimit të identitetit gjatë jetës.

## **Pjesë përfundimtare e orës (10 min.)**

### **Aktivitet:**

#### **Barometër i qëndrimeve – si zhvillohet identiteti?**

Mësimdhënësi përpilon disa pohime që i paraqesin faktorët që ndikojnë në zhvillimin e identitetit të individit (trashëgimia, mjedisi dhe aktiviteti i individit).

(p.sh. 1 - Trashëgimia gjenetike është vendimtare për zhvillimin e identitetit të individit, 2 - Edukata familjare është kyçe për zhvillimin e identitetit të individit, 3 - Aktiviteti i individit është kyç për zhvillimin e identitetit personal, etj.).

Në dy skajet e hapësirës para tabelës, mësimdhënësi vendosë dy përgjigje (nuk pajtohem fare dhe pajtohem tërësisht) dhe i fton nxënësit të pozicionohen në hapësirën mes këtyre dy përgjigjeve (ekstreme) varësisht nga qëndrimet e tyre.

Mësimdhënësi fton disa nxënës të cilët do të sqarojnë qëndrimin e tyre me argumentet e tyre. Më pas, i fton nxënësit që kanë qëndrime ndryshe t'i japin argumentet e tyre.

**Konstatim nga aktiviteti:** Mësimdhënësi bën përmbledhjen e qëndrimeve të nxënësve dhe vendosë theksin në atë se bashkimi në funksionimin e tri grupeve të faktorëve është thelbësor për zhvillimin e identitetit të individit.

1. Trashëgimi (karakteristika gjenetike që janë trashëguese si karakteristika fizike, ngjyra e flokëve, syve, lëkurës, etj.)

2. Mjedisi (ndikimi i familjes, shkollës, moshatarëve, kulturës, artit, mediave, etj.)
3. Vetë-aktivitet i individit (motivim, shprehi, karakter, qëndrime, vlera, etj.)

Ekzistojnë kuptime të ndryshme për dominimin e këtyre faktorëve. Sipas përfaqësuesve të njërës mendim, trashëgimia është faktor vendimtar nga i cili varet dhe përcaktohet zhvillimi i individit. E kundërta e këtij mendimi është ai sipas të cilit zhvillimi i individit thuhet se varet tërësisht nga veprimi i mjedisit. Si rezultat i kësaj, dallimet që paraqiten mes individëve janë rezultat i kushteve të ndryshme në të cilat kanë jetuar individët. Sot, shkencëtarët gjithnjë e më shumë janë të pajtimit se dy faktorët funksionojnë përmes bashkëveprimit të ndërsjellë, dhe se edhe vetë individi mund të ndikojë në zhvillimin e tij përmes aktivitetit të vetëdijshëm personal (vendosje të qëllimeve dhe angazhimit për arritjen e tyre).

Për shembull, Hana e ka trashëguar gjatësinë e saj prej 185 cm nga prindërit e saj, të cilët gjithashtu janë të gjatë (faktor: karakteristika trashëguese). Prindërit e saj konsiderojnë se ajo ka gjatësi të shkëlqyeshme për t'u marrë me manekenizëm dhe ende si adoleshente e kanë regjistruar në orët e manekenizmit (faktor: mjedisi). Hana disa vite merrej me manekenizëm, përkundër faktit që i dukej interesante, dashuria e saj më e madhe ishte basketbolli që e ushtronte në klubin lokal. Vendosi t'i japë fund manekenizmit dhe të përkushtohet tërësisht në arritjen e rezultateve në basketboll. Ushtronte zellshëm dhe vendosi një qëllim që të hyjë në ekipin e kombëtares. Këtë edhe e arriti duke iu falënderuar këmbënguljes dhe motivimit të saj (faktor: vetë-aktivitet).

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)***

1. Çfarë ishte njohuria më e rëndësishme nga aktivitetet e sotme?
2. Si e kuptoni termin identitet personal?
3. Si ndërtohet identiteti personal i individit?
4. Cilët faktorë dhe individë kanë ndikuar në ndërtimin e identitetit tuaj personal?



## Fletë pune 1.2

### Historia e emrit tim

1) Emri im është \_\_\_\_\_

2) Emri im rrjedhë nga \_\_\_\_\_ dhe shënon \_\_\_\_\_

3) Për veten mendoj se \_\_\_\_\_  
(këtu përshkruaj se sa je i lidhur me kuptimin e emrit tënd)

4) Sqaroje historinë se si e ke marrë emrin tënd

(udhëzim: Lindja jote ka paraqitur ngjarje emocionuese në familjen tënde, shëno se çfarë mban mend nga tregimet e më të afërme, kush ta ka dhënë emrin, si është përzgjedhur emri yt, etj.)

---

---

---

---

---

5) Unë e dua emrin tim për shkak se \_\_\_\_\_

6) Nëse do të mund ta ndërroja emrin do të \_\_\_\_\_

7) Nëse ke nofkë përmende \_\_\_\_\_ dhe sqaro se si e ke marrë  
dhe kush të emërton me këtë nofkë.

---

---

---

---

8) Mbimeri im është \_\_\_\_\_ dhe rrjedhë nga \_\_\_\_\_  
Për mua paraqet trashëgimi nga paraardhësit e mi, meqë

---

---

---

---

# Përmbajtja: Vetëdije për identitet qytetar



## Rezultate nga nxënia:

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:

- interpretojë termin qytetar dhe t'i sqarojë faktorët që ndikojnë në zhvillimin e identitetit qytetar.



## Standarde/tregues për arritje:

Nxënësi/nxënësja mund të:

- përshkruajë faktorë të ndryshëm shoqëror që ndikojnë në zhvillimin e identitetit qytetar dhe sjelljen e individit,
- bëjë analizë kritike për ndikime të ndryshme në formimin e identitetit personal qytetar,
- përgatisë prezantime të ndryshme për veten si qytetar.



## Materialet e nevojshme:

tabelë, shkumës, Fletë pune 1.3, Fletë pune 1.4



## Metoda, teknika, forma:

metodë frontale, punë individuale, punë në grup, stuhi e ideve, hartë mendore, diskutim në grup

## Pjesa hyrëse e orës (5 min.)

### Aktivitet:

#### Stuhi e ideve për termin qytetar

Mësimdhënësi i fton nxënësit të përkujtohen në dituritë e tyre paraprake përmes parashtrimit të pyetjeve për diskutim:

- ➔ Çfarë paraqet për ju termi qytetar?
- ➔ Cilat veçori i posedon qytetari?
- ➔ Si duhet të silllet qytetari në shoqëri?

Mësimdhënësi i shënon në tabelë dhe më pas i komenton, përmbledhë dhe e përfundon aktivitetin me përkufizimin e termit qytetar. Përmbledhë se çfarë nënkuptohet me qytetar aktiv, gjegjësisht cilat veçori dhe forma të sjelljes janë të pëlqyeshme: pjesëmarrja, respektimi i obligimeve, njohja e të drejtave dhe lirive, toleranca, përgjegjësia, ndjekja e zhvillimeve shoqërore, angazhimi në zhvillime shoqërore, etj.

**Qytetar** është banori i një shteti të caktuar, i cili me përkatësinë në atë shtet posedon **të drejta dhe liri qytetare** dhe realizon **obligime qytetare**. Qytetarët të cilët jetojnë në një shtet dallohen në bazë të vendit të jetesës (qytet ose fshat). Ata janë pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike, religjioneve, racave, profesioneve, grupeve të ndryshme sociale, arsimore dhe të moshës, etj. Megjithatë, përkundër dallimeve, ata posedojnë të drejta dhe liri të barabarta, si dhe obligime dhe detyra. Qytetarët me sjelljen e tyre dhe praktikimin e të drejtave të tyre, zgjedhin pushtetin që miraton ligje dhe menaxhon bashkësitë. Pikërisht për këtë arsye **roli i qytetarëve** është shumë i rëndësishëm. Prej tyre pritet të jenë aktiv dhe të marrin pjesë në jetën qytetare, gjegjësisht t'i mbrojnë të drejtat e tyre, por edhe të kontrollojnë pushtetin, në interes të parimeve të demokracisë, tolerancës, drejtësisë, përparimit dhe mbrojtjes së bashkësive. Sa më shumë që të respektohen të drejtat dhe liritë e qytetarëve në një shtet, aq më tepër shteti është i hapur, modern dhe demokratik.

## Pjesa kryesore e orës (25 min.)

### Pjesa teorike (10 min.)

Me **ndryshimet** bashkëkohore **shoqërore dhe globale në botë**, siç janë globalizimi, ndryshimet klimatike, migrimet, shpërndarjet e reja të resurseve njerëzore, industriale dhe ekonomike,

diversiteti i pasurive kulturore, **ndryshon dhe zgjerohet kuptimi i termit qytetar**. Çdo individ që **merr pjesë në mënyrë aktive në shoqëri**, kultivon tolerancë të diversiteteve, i respekton të drejtat dhe nuk i cenon liritë e të tjerëve dhe kontribuon në avancimin e ardhmërisë personale, si dhe ardhmërisë së gjeneratave të reja, është qytetar i shekullit njëzet e një.

Identiteti ynë si qytetarë (**identitet qytetar**) e përfshin ndjenjën për veten si pjesë e jetës qytetare, që është pjesë e identitetit personal, por edhe ndjenjën e përkatësisë ndaj grupeve të ndryshme në shoqëri, që është pjesë e identitetit grupor.

**Identiteti qytetar** formohet përmes **shoqërizimit** (socializimit) me institucionet nga rrethina e drejtpërdrejt (familja, moshatarë, etj.) dhe rrethina më e gjerë (institucione arsimore, kulturë, media, organizata qytetare). Individu përvetëson përvojë për mënyrat e funksionimit në shoqërinë përmes pjesëmarrjes në jetën shoqërore ku mëson për norma dhe vlera kulturore, mënyra të sjelljes, përvetëson dituri për funksionimin e shtetit dhe institucioneve. Këto gjëra i përvetëson përmes përfshirjes në aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkësive dhe shtetit dhe përmes marrëdhënieve me qytetarët tjerë.

Identiteti qytetar fillon të formohet që në moshën e hershme përmes raportit të fëmijës me familjen. Përmes mënyrave të plotësimit të nevojave të posaçme për përkujdesje dhe pranim përvetësohen bindjet e para për botën dhe pranohet vlerat që i kultivon familja. Në këtë fazë fëmijët njoftohen edhe me modelet e para të sjelljes. Më tutje, në adoleshencë, ky identitet vazhdon të ndërtohet përmes: përvojave të raporteve të ndërsjella me moshatarët ku zhvillohet ndjenja e përkatësisë dhe vetërespektit; përvetësimi i vlerave për vetë-afirmim; pjesëmarrja në aktivitete të nxënësve dhe mundësia për zhvillimin e interesave personale. Më në fund, në moshën e rritur identiteti qytetar zhvillohet përmes ndjenjës së individit në aktivitete për avancimin e shoqërisë, ndërtimin e besimit ndaj shoqërisë dhe institucioneve të saj dhe plotësimin e nevojave personale përmes institucioneve të shtetit.

Aspekte të rëndësishme të identitetit qytetar janë përfshirja në shoqërinë dhe ndjenja e pranimi nga e njëjta; përvojat e vendosjes së relacioneve me moshatarët, mësimdhënësit, përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme. Nëse individ ka përvoja pozitive të pranimi; mundësi për shprehjen e qëndrimeve dhe interesave personale; përfaqësimin e të drejtave personale; por edhe lirinë për të kritikuar në raport me normat dhe vlerat e vendosura; është mësa e sigurt se do të zhvillojë ndjenjën e përkatësisë ndaj bashkësive, raport pozitiv ndaj shtetit dhe vetvetes si qytetar i tij. Sa më shumë që ndjejmë përkatësi ndaj bashkësisë në të cilën jetojmë, aq më shumë do të angazhohemi në përmirësimin dhe rregullimin e së njëjtës.

Nga ana tjetër, pamundësia për t'i realizuar nevojat e tij në kuadër të bashkësisë dhe shtetit, mund të shpie drejt izolimit ose frustrimit të qytetarit. Ai/ajo formon një pasqyrë negative për shtetin dhe për vetveten si qytetar i tij, ndjen pakënaqësi, dëshpërim dhe pasiguri.

## Aktivitet:

### „Unë si qytetar...“ (15 min.)

Nxënësit duhet të vetëvlerësohen në raport me pohimet si vijon. Listën e pohimeve mund ta marrin në formë të Fletës së punës 1.3, ose ta shikojnë në prozhektor/tabelë. Mund ta plotësojnë nëse konsiderojnë se në listën nuk janë përfshirë disa karakteristika të caktuara të rëndësishme të identitetit të tyre qytetar.

Unë si qytetar....	PO	JO
1 I ndjek zhvillimet politike në shtet		
2 Jam anëtar i organizatave vullnetare/qytetare		
3 Kam marrë pjesë në aksione/nisma qytetare (të nxënësve)		
4 Rishikoj informacione të ndryshme që do t'i lexoj në media/internet		
5 Jam kandiduar në zgjedhjet për parlamentin e nxënësve/kryetar/e të paraleles/klasës		
6 I ndjek zhvillimet politike në botë		
7 Konsideroj se mendimi i secilit duhet të dëgjohet		
8 Kam nënshkruar peticion qytetar		
9 Kam përpiluar/parashtruar peticion qytetar		
10 Besoj se të gjithë njerëzit duhet të jenë të barabartë		
11 Kam votuar në zgjedhjet për parlamentin e nxënësve/ kryetar/e të paraleles/klasës		
12 Sillem me përgjegjësi ndaj anëtarëve të bashkësisë në të cilën jetoj		
13 Besoj se secili duhet të ketë mundësi për të bërë ndryshime në shoqëri		
14 Tjetër (plotëso)		

Pas plotësimit të listës, mësimdhënësi nxitë diskutim përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Cilat përgjigje dominojnë në listat tuaja (PO ose JO)? Si e interpretoni këtë? Sa konsideroni se posedoni karakteristika qytetare (vlera, qëndrime dhe sjellje)?
- ➔ Cilat karakteristika sipas jush janë më shumë apo më pak të rëndësishme? Cilat do të donit t'i zhvillonit/realizonit në mënyrë plotësuese?







Diskutimi vazhdon me pyetje për atë se si nxënësit i kanë zhvilluar te vetja karakteristikat dhe format e përmendura të sjelljes.

- ➔ Si e keni zhvilluar atë veçori/karakteristikë/mënyrë të sjelljes?
- ➔ Si dhe nga kush e mësuat këtë sjellje/vlerë?
- ➔ Çfarë mësuat për identitetin dhe sjelljen qytetare në shtëpi dhe familje?
- ➔ Çfarë mësuat për identitetin qytetar në shkollë?
- ➔ Çfarë mësuat për identitetin qytetar përmes mediave?
- ➔ Prej cilëve njerëz ose grupe të tjera të rëndësishme në jetën tuaj mësuat për qytetarin dhe identitetin qytetar?

Mësimdhënësi i përmbledhë prononcimet e nxënësve në formë të faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e identitetit qytetar të individit.

### ***Faktorë që ndikojnë në formimin e identitetit qytetar janë:***

- ➔
- ➔ Mjedisi i drejtpërdrejt: familja, moshatarët, shkolla dhe bashkëveprimet e ndërsjella të individit me këta faktorë
- ➔ Mjediset lokale së bashku me politikën, bashkësitë, organizatat lokale
- ➔ Shoqëria më e gjerë dhe marrëdhëniet shoqërore

## ***Pjesë përfundimtare e orës (10 min.)***

Mësimdhënësi u jep nxënësve detyrë që të përpilojnë Hartë mendore të identitetit dhe me punë në çifte t'i gjejnë ngjashmëritë e ndërsjella.

### ***Aktivitet për reflektim (5 min.)***

Mësimdhënësi e përfundon orën me diskutim:

- ➔ Cilët qytetarë i frymëzojnë nxënësit? (mësimdhënësi mund të përmendë disa personalitete – politikanë, bamirës, etj. Greta Turnberg, Gandi etj. si shembuj)
- ➔ Cilat veçori i posedojnë ata?
- ➔ Si sillen në shoqëri?
- ➔ Si mund nxënësit të zhvillohen për t'u bërë qytetarë më të përgjegjshëm në shoqëri?




## Fletë pune 1.3

### Unë si qytetar...

Unë si qytetar....	PO	JO
1 I ndjek zhvillimet politike në shtet		
2 Jam anëtar i organizatave vullnetare/qytetare		
3 Kam marrë pjesë në aksione/nisma qytetare (të nxënësve)		
4 Rishikoj informacione të ndryshme që do t'i lexoj në media/internet		
5 Jam kandiduar në zgjedhjet për çarlamentin e nxënësve/kryetar/e të paraleles/klasës		
6 I ndjek zhvillimet politike në botë		
7 Konsideroj se mendimi i secilit duhet të dëgjohet		
8 Kam nënshkruar peticion qytetar		
9 Kam përpiluar/parashtruar peticion qytetar		
10 Besoj se të gjithë njerëzit duhet të jenë të barabartë		
11 Kam votuar në zgjedhje për çarlamentin e nxënësve/ kryetar/e të paraleles/klasës		
12 Sillem me përgjegjësi ndaj anëtarëve të bashkësisë në të cilën jetoj		
13 Besoj se secili duhet të ketë mundësi për të bërë ndryshime në shoqëri		
14 Tjetër (plotëso)		

## Fletë pune 1.4

### Hartë mendore: Identitet



# **Përmbajtja: Dallim dhe zhvillim i veçorive dhe shkathtësive personale**



## **Rezultate nga nxënia:**

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:

- ➔ planifikojë zhvillimin personal,
- ➔ kontrollojë suksesin personal në raport me qëllimet e vendosura për zhvillim personal.



## **Standarde/tregues për arritje:**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ identifikojë anët e veta të dobëta dhe të fuqishme,
- ➔ identifikojë fusha për përmirësimin e shkathtësive të caktuara dhe qëllimeve relevante,
- ➔ vlerësojë përparimin në raport me arritjen e qëllimeve të identifikuara.



## **Materialet e nevojshme:**

Fletë pune 1.5, Fletë pune 1.6



## **Metoda, teknika, forma:**

Metodë frontale, punë individuale dhe në grup, diskutim.

## Pjesa hyrëse e orës (5 min.)

Mësimdhënësi i njofton nxënësit me kuptimin e zhvillimit personal të individit dhe kuptimin e planifikimit të këtij procesi.

**Zhvillimi personal** paraqet proces të vazhdueshëm të zhvillimit personal të individit, gjegjësisht të veçorive, shkathtësive, qëndrimeve, vlerave, interesimeve të tij. Të gjitha këto ndryshime reflektohen në **sjelljen e individit**. Përmes vendimeve që i merr për veten, përmes zgjedhjeve që i bën, individit ka mundësi që të zhvillohet në drejtimin e dëshiruar, gjegjësisht në drejtimin e arritjes së qëllimeve të vendosura të tij.

Në këtë mënyrë individit zhvillohet në personalitet të shëndoshë dhe të realizuar, (qytetar/e), që është aktiv/e dhe produktiv/e për vete dhe jep kontributin e tij/saj në bashkësi.

**Planifikimi i zhvillimit personal** është proces sistematik me të cilin individit përzgjedhë **qëllime** dhe shtigje që do ta çojnë drejt realizimit të këtyre qëllimeve. Planifikimi i zhvillimit personal është proces i strukturuar i identifikimit të qëllimeve të individit, shkathtësi që mund t'i zhvillojë për karrierë, si analizë e anëve të fuqishme dhe të dobëta që mund të ndalen në rrugën e përmbushjes së qëllimeve, etj. Nëse njerëzit kanë pasqyrë për gjendjen e tyre në një moment konkret, mund të bëjnë përpjekje plotësuese për tejkalimin e anëve të dobëta dhe përballje me rreziqet dhe kërcënimet.

## Pjesa kryesore e orës (30 min.)

### Aktivitet:

#### **Vetëvlerësim i veçorive personale**

Mësimdhënësi ua cakton Fletën e punës 1.5 nxënësve (koha për punë të mëvetësishme: 5-7 minuta). Bëhet fjalë për një shkallë të vlerësimit të nxënësve si pikë nismëtare për vlerësimin e veçorive personale dhe fushave në të cilat mund/duan të arrijnë ndryshim.

Pasi që nxënësit do t'i plotësojnë fletët e punës, mësimdhënësi mund të fillojë diskutimin me pyetjet (7-10 minuta):

- ➔ A mësuat diçka të re për veçoritë tuaja, derisa e plotësonit fletën e punës? Nëse po, çfarë ishte ajo?





- ➔ Sa ju ndihmoi shkalla e vlerësimit që t'ï përcaktoni drejtimit e zhvillimit tuaj personal dhe aktiviteteteve që do t'ï kishit ndër marrë?
- ➔ Si do të mund ta përdornit në të ardhmen këtë shkallë të vlerësimit? (Përgjigje të pritura nga nxënësit: për vendimmarrje për hapat e radhës në shkollim, për marrjen e vendimeve për ndryshime më të mëdha në sjelljen personale (p.sh. ndryshime të shprehive), për vlerësimin e zhvillimit personal mes dy pikave kohore, etj.)

Pasi që të nxjerren konstatime nga diskutimi i shkurtër, mësimdhënësi i ndërlidhë me aktivitetin që vijon:

Gjatë formimit dhe zhvillimit të një individi ndikojnë ngjarjet, ndikimet, kushtet, vendimet dhe përjetimet që individi i ka shijuar në të kaluarën e tij. Ato e formësojnë dhe nën ndikimin e tyre ai formohet dhe zhvillohet.

Që një person të dijë se në cilin drejtim dëshiron të zhvillohet, duhet të dijë edhe çfarë ka kaluar, tejkaluar, përjetuar dhe mësuar. Përvoja e tij e kaluar ndikon përmes planeve të ardhshme të tij. Në mënyrë që të mësojë në çfarë drejtimi dëshiron dhe përzgjedh të zhvillohet, duhet të përkujtohet se si ngjarjet dhe përvojat e kaluara kanë ndikuar në atë që është në momentin e tanishëm.

## **Aktivitet:**

### ***Vija ime e përjetimeve***

Mësimdhënësi u jep udhëzim nxënësve për plotësimin e Fletës së punës 1.6. Vija ime e përjetimeve (koha për punë të mëvetësishme: 5-7 minuta). Fleta e punës mund edhe të vizatohet në tabelë ose të prozhektohet, ndërsa nxënësit të plotësojnë në fletore. Pas plotësimit të fletës së punës, mësimdhënësi mund të fillojë diskutim me nxënësit (7-10 minuta), duke i parashtruar pyetjet e mëposhtme:

- ➔ Cilat gjëra të rëndësishme i mësuat për veten për periudhën e dy viteve të fundit, e që janë të ndërlidhura me shkollën?
- ➔ Në cilat fusha konsideroni se jeni zhvilluar në planin personal për dallim prej para dy viteve?
- ➔ Si kanë ndikuar përjetimet nga shkolla, nga dy vitet e kaluara, në qëllimet tuaja në kohën e tanishme?
- ➔ Prej cilave ngjarje, zgjedhje dhe veprime tuaja lidhur me shkollën jeni të kënaqur nga periudha e kaluar?





- ➔ Si kanë ndikuar vendimet, ngjarjet dhe veprimet në të kaluarën në aktivitetet tuaja të tanishme në shkollë dhe jashtë saj?
- ➔ Mendoni se çfarë do të donit të ndryshoni nga vija juaj e përjetimeve? Mendoni për mënyrat e mundshme se si do ta kishit arritur këtë ndryshim? Mendoni për njerëzit që mund t'ju ndihmojnë ose t'ju mbështesin përmes këtij procesi të ndryshimit.

**Shënim:** Gjatë këtij aktiviteti, është më rëndësi që mësimdhënësi të mos insistojë që të gjithë nxënësit t'i ndajnë informacionet që i kanë shënuar në fletët e punës dhe/ose të rrëfejnë detaje rreth ngjarjeve. Ndarja e informacioneve duhet të zhvillohet vetëm në bazë vullnetare.

## ***Pjesë përfundimtare e orës (5 min.)***

Në fund të orës mësimdhënësi bën përmbledhjen e aktivitetit paraprak, si dhe të gjithë orës mësimore duke nxjerrë disa konstatime:

Zhvillimi personal është proces përmes të cilit kalon secili individ. Është me rëndësi ajo se secili mund të ketë rol kryesor në zhvillimin personal, me vendosjen e qëllimeve para vetes dhe aktiviteteve dhe sjelljes në drejtim të përmbushjes së këtyre qëllimeve.

Aktivitetet e sotme mundësuan shqyrtim në fushat për ndryshimin tuaj të mundshëm. Është mirë që të bisedoni për këto njohuri me të afërmit tuaj të cilët ju njohin mirë, në mënyrë që të merrni informacion kthyes prej tyre për atë se si ata i vlerësojnë veçoritë dhe sjelljen tuaj. Në këtë mënyrë mund t'i përcaktoni fushat për përmirësimin e shkathtësive të caktuara dhe arritjen e qëllimeve.

Vija e përjetimeve jep një shqyrtim në procesin e ndryshimit dhe zhvillimit personal, meqë gjërat në disa pjesë kanë mbetur të njëjta, por në disa pjesë janë ndryshuar. Nga aktiviteti mund të shihni edhe në çfarë mase ose në çfarë mënyre disa ngjarje, përvoja dhe përjetime nga e kaluara (prej para dy viteve), mund të ndikojnë në zhvillimin tuaj dhe në atë që jeni sot, si individ, por edhe t'ua tregojnë drejtimet e veprimet për atë që doni të bëheni në të ardhmen.

Aktivitetin mund ta bëni edhe për fusha të tjera nga jeta juaj (p.sh. emocione, komunikim, zhvillim të ndonjë shprehje, marrje të vendimeve dhe zgjedhjeve, etj.) dhe të përsërisni më shumë herë me distanca të njëjta ose të ndryshme kohore (p.sh. në 3 muaj, 6 muaj, 1 vit, 5 vite, nga dita e lindjes tuaj e deri në ditën e sotme, etj.).

## ***Aktivitet për reflektim (5 min.)***

Mësimdhënësi përfundon orën me pyetje të parashtruar për nxënësit:

- ➔ Cili aktivitet ishte më i rëndësishëm për ju në këtë orë? Sqaroni arsyet.
- ➔ Për cilën/cilat veçori personale u bëtë të vetëdijshëm në këtë orë?
- ➔ A keni ide se si mund të ndikohet në zhvillimin dhe avancimin e veçorive, qëndrimeve, përzgjedhjeve, vendimeve të individit?
- ➔ Përmendni shembujt tuaj për përvoja personale gjatë të cilave keni marrë vendim dhe keni bërë ndryshim në jetën tuaj. Si i shikoni këto ngjarje nga perspektiva e sotme?





## Fletë pune 1.5

### Hartë e vetëvlerësimit të veçorive të mia personale<sup>1</sup>

*Udhëzim:* Bën vlerësim personal të veçorive tuaja personale dhe shëno shkronjën që ka të bëjë me vlerën e përgjigjeve. Kjo shkallë e vlerësimit është anonime.

**A- Gjithmonë, B-Më shpesh; C-Ndonjëherë; Ç-Rrallë; D-Asnjëherë**

Pohim	Vlerë
1. Te unë nuk mbisundon sjellja pozitive.	
2. Posedoj aftësinë për t'i shprehur dhe treguar ndjenjat/mendimet e mia para të tjerëve	
3. Posedoj aftësi për të zhvilluar marrëdhënie të mira me të tjerët.	
4. I jap mbështetje vetvetes.	
5. Kujdesem për shëndetin tim trupor.	
6. Kujdesem për shëndetin tim emocional.	
7. Respektoj veten.	
8. Kam aftësi të vendos kufij në marrëdhëniet me njerëz të tjerë (të evitoj „dramatizimin“).	
9. Kam aftësi që të mos u kushtoj rëndësi përgojimeve dhe thashethemeve.	
10. Kam aftësi për t'u përballur me pohime të rrejshme për mua.	

**Rezultate:** *Rezultatet më të ulëta tregojnë për fusha të mundshme të ndryshimit.*

Në cilat mënyra do të mund t'i përmirësoja rezultatet në fushat që kanë vlera të ulëta? Përmend së paku tri ide

---

---

Përpilo një listë personale në të cilën do t'i shkruash mënyrat në të cilat do ta avancosh konceptin tënd për veten. Përmend së paku tri ide.

---

---

<sup>1</sup> Missouri Comprehensive Guidance Programs: Linking School Success to Life Success



## Fletë pune 1.6

### Vija ime e përjetimeve në shkollë

Mendo, kujto dhe në vendet e shënuara me pika, shëno datat e përafërta e të gjitha përjetimeve tuaja të rëndësishme të lidhura me shkollën, para dy viteve kalendarike (ngjarje të rëndësishme, pëvoja, mësimet, arritje, dëshpërim, etj.) që të kanë ndodhur në dy vitet e shkuara. Me këtë rast **përjetimet pozitive shënoji nga ana e djathtë e fletës, ndërsa ato negative nga ana e majtë**. Në secilën dritare pranë përjetimit shkruaj se në çfarë mënyre ka ndikuar kjo te ti dhe zhvillimi yt si individ. Provo të mësosh edhe në cilën/cilat mënyrë/a edhe përjetimet negative kanë pasur ndikim pozitiv.

# Përmbajtja: Dallim dhe zhvillim i veçorive dhe shkathtësive personale



## Rezultate nga nxënia:

Nxënësi/nxënësjë është i/e aftë të:

- planifikojë zhvillimin personal,
- kontrollojë suksesin personal në raport me qëllimet e vendosura për zhvillim personal



## Standarde/tregues për arritje:

Nxënësi/nxënësjë mund të:

- identifikojë anët e tij të dobëta dhe të forta,
- identifikojë fusha për përmirësimin e shkathtësive të caktuara dhe qëllimeve relevante
- vlerësojë përparimin në raport me arritjen e qëllimeve të identifikuara.



## Materialet e nevojshme:

Fletë pune 1.7



## Metoda, teknika, forma:

metodë frontale, metodë individuale, punë në çifte, punë në grup, diskutim me pyetje të strukturuarë paraprakisht, harmonikë.

## ***Pjesa hyrëse e orës (5 min.)***

Mësimdhënësi në pjesën hyrëse të orës bën ndërlidhjen e materialit nga ora e kaluar, duke i parashtruar pyetjet si vijon:

- ➔ Çfarë nënkuptoni me termin „zhvillim personal“?
- ➔ Në çka do të kishit dashur të punoni në zhvillimin personal?
- ➔ Si do të mund ta bëni këtë?

## ***Pjesa kryesore e orës (25 min.)***

Përgjigjet e nxënësve në pjesën hyrëse mësimdhënësi i shfrytëzon për t'i futur në aktivitetet e planifikuara për përkufizimin e qëllimeve personale, vendosjen e prioriteteve dhe planifikimin e aktiviteteve përmes të cilave do të mund të realizohen qëllimet.

Mësimdhënësi ua cakton nxënësve Fletën e punës 1.7 (10 minuta për plotësim të mëvetësishëm). E sqaron udhëzimin për plotësim dhe kuptimin e termeve që duhet t'i plotësojnë në fletën e punës. Aktiviteti përbëhet prej tri pjesëve (A, B, C) që përmes kërkesave të ndryshme i udhëheqin nxënësit nëpër fazat e identifikimit të nevojave, përkufizimit të qëllimeve për zhvillim dhe përzgjedhjes së aktiviteteve përmes realizimit të të cilave do t'i kishin realizuar qëllimet e parashtruara.

### ***Shembull për mësimdhënësin - fletë pune e plotësuar***

#### **A. Vendosni tri qëllime për zhvillimin tuaj personal**

1. Përmirësim i komunikimit
2. Njoftim të shokëve të ri
3. Hobi të ri

#### **B. Shqyrtoni qëllimet e vendosura dhe përzgjidhni një për të cilin do ta plotësoni tabelën më poshtë (në mënyrë të mëvetësishme mund të plotësoni tabela për të gjitha qëllimet):**

1. Njoftim të shokëve të ri





### C. Përpilim të planit të aktiviteteve që do t'i ndërmerni për arritjen e njëres prej qëllimeve të formuluarat paraprakisht:

Aktiviteti	Afati	Resurse të nevojshme	Pengesa	Mbështetje
Shënim i të gjithë shokëve të deritanishëm	2 ditë	Fletë dhe laps kimik	/	Shokë
Caktim i takimit me 2 shokë	10 ditë	Lokalitete dhe caktim përmes rrjeteve sociale	Shokët janë të penguar	Shokë të tjerë Anëtarë të familjes
Listë e mënyrave të njoftimit të shokëve të ri (p.sh. sport, gjuhë, debat, palestër, etj.)	5 ditë	Hulumtim i aktiviteteve që më interesojnë, e në të cilat mund të njoftoj shok të ri	/	Shokë të tjerë Anëtarë të familjes Mësimdhënës OJQ

Plas plotësimin të fletës së punës, mësimdhënësi nxitë diskutim me nxënësit duke i parashtruar pyetjet si vijon (10-15 minuta):

- ➔ Si ndjeheshit derisa e punonit këtë aktivitet?
- ➔ Cili aktivitet (kërkesë) ishte më i lehtë për ju, e cili më i vështirë për ta plotësuar? Si e sqaroni këtë?
- ➔ Për çfarë u bëtë të vetëdijshëm duke e punuar aktivitetin? Për çfarë do të mund t'ju ishin në favor këto njohuri edhe në të ardhmen?

Mësimdhënësi i përdorë konstatimet nga diskutimi për të bërë përmbledhjen e materialit mësimor të përpunuar në orë:

Pasqyra që një individ e ndërton për veten është nën ndikimin dhe në porositë për të që i merr nga rrethina. Informacionet që i merr nga rrethina, nga njerëzit tjerë dhe mënyra në të cilën i interpreton i ndihmon gjatë ndërtimit të **pasqyrës për veten** dhe përkufizimin e drejtimit të **zhvillimit personal**. Së pari ato janë informacionet nga më të afërmit (familja, shokët, mësimdhënësit dhe individë të tjerë), mendimi i të cilëve është më i rëndësishëm. Në mënyrë plotësuese, të tjerët konstatojnë se çfarë individ i është dikush përmes sjelljes, veprimeve dhe mënyrës së tij të komunikimit me rrethinën. Këto informacione ndihmojnë që të **ndërtohet një pasqyrë e qartë për veten dhe identitetin personal**.

Njëherësh, të gjithë **njerëzit kanë veçori, karakteristika dhe sjellje të ndryshme**. Ata posedojnë identitete personale që janë të ndryshme sipas disa karakteristikave, **por njëherësh edhe të ngjashme** sipas disa veçorive. **Çdo individ është tërësi unike e veçorive që e prezantojnë identitetin e tij dhe manifestohen përmes sjelljes**. Bukuria e botës qëndron pikërisht në numrin e pakufizuar të kombinimeve të ndryshme të veçorive dhe karaktereve që ekzistojnë.

## Pjesa përfundimtare e orës (10 min.)

### Aktivitet:

#### Harmonikë

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe (prej 3 deri 6 nxënës). Secili nxënës duhet të bëjë harmonikë nga një fletë e letrës përmes palosjes së letrës (me 4 copë). Në pjesën e parë secili nxënës e shënon emrin e tij dhe ia dorëzon nxënësit që rri ulur në anën e tij të djathtë. Secili nxënës nga grupi merr një fletë dhe në pjesën tjetër të palosur të fletës-harmonik shënon një veçori pozitive që e posedon nxënësi emri i të cilit gjendet në fletën. Kjo procedurë përsëritet për të gjithë nxënësit nga grupi. Nxënësit i shqyrtojnë fletët që i kanë marrë dhe krahasojnë se si është raporti i pasqyrës së tyre për veten dhe pasqyrës nga rrethina. Në grup i diskutojnë pyetjet:

- ➔ A ka dallime të mëdha ose ngjashmëri mes dy pasqyrave/veçorive?
- ➔ Në cilën pjesë janë dallimet më të mëdha?
- ➔ Si i sqarojnë nxënësit dallimet?
- ➔ Në cilën pjesë janë ngjashmëritë më të mëdha?
- ➔ Si i sqarojnë nxënësit ngjashmëritë?

## Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)

Mësimdhënësi e përfundon orën me pyetje të drejtuara nxënësve:

- ➔ Cili aktivitet ishte më i rëndësishëm për ju në këtë orë? Sqaroni arsyet.
- ➔ Përmendi se cilët janë njerëzit nga rrethina juaj mendimi i të cilëve për ju është më i rëndësishëm?
- ➔ Përmendni shembuj tuaj të përvojave personale në të cilat keni marrë vendim dhe keni bërë ndryshim në jetën tuaj nën ndikimin e mendimit të të tjerëve.
- ➔ Si e vlerësoni ndikimin e mendimit të të tjerëve për veçoritë dhe sjelljen tuaj?



## Fletë pune 1.7

### Vendosje e qëllimeve dhe përpilim i planit të aktiviteteve

**A. Vendosni tre qëllime për zhvillimin tuaj personal** (mendoni se çfarë është e rëndësishme për ju në këtë periudhë, me çfarë sfidash përballeni, cilat veçori ose sjellje personale dëshironi t'i ndryshoni, cilat veçori ose shprehi dëshironi t'i zhvilloni te vetja, etj.).

1.

2.

3.

**B. Shqyrtoni qëllimet e vendosura dhe përzgjidhni njërin për të cilin do ta plotësoni tabelën më poshtë** (në mënyrë të mëvetësishme mund t'i plotësoni tabelat për të gjitha qëllimet)

**C. Përpiloni plan të aktiviteteve që do t'i ndërmerri për të arritur njërin prej qëllimeve të formuluar paraqishtë.**

Aktiviteti	Afati	Resurse të nevojshme	Pengesa	Mbështetje

## *Përmbajtja: Kontroll i sjelljes*



### **Rezultate nga nxënia:**

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të analizojë dhe përshtatë sjelljen e tij/saj dhe t'i respektojë qëndrimet dhe nevojat e ndryshme tek njerëzit tjerë.



### **Standarde/tregues për arritje:**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ pranojë se në shoqëri ekzistojnë grupe dhe persona të cilët kanë interesa, qëndrime dhe nevoja të ndryshme,
- ➔ rishikojë karakteristikat dhe sjelljen personale dhe të gjejë mënyra që t'i përmirësojë shkathtësitë e veta sociale.



### **Materialet e nevojshme:**

marker, tabelë, Fletë pune 1.8.



### **Metoda, teknika, forma:**

metodë frontale, punë individuale, punë në çifte, diskutim në grup, pyetësor.



## **Pjesa hyrëse e orës (15 min.)**

Mësimdhënësi e fillon orën me hyrje të shkurtër për përmbajtjen e planifikuar mësimore, me ç'rast i përkujton nxënësit se zhvillimi personal është proces përmes të cilit kalon secili njeri përmes planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve të caktuara në mënyrë që të përmbushen qëllimet që individi i ka përkufizuar për ndryshimin e shkathtësive dhe veçorive personale. Mësimdhënësi thekson se në mesin e karakteristikave personale në të cilat një individ do të mund të punojë dhe t'i zhvillojë, është edhe kontrolli i sjelljes personale. Me këtë rast, veçanërisht e rëndësishme është mënyra e sjelljes dhe komunikimit në shoqërinë qytetare, si shkathtësi sociale që kontribuon individi të silltet me përgjegjësi, duke i pranuar të tjerët dhe dallimet e tyre. Mësimdhënësi paralajmëron se në këtë orë temë kryesore do të jetë mënyra në të cilën një individ mund të kontrollojë dhe përmirësojë sjelljen e tij, ndërsa në orën e radhës kjo do të analizohet në kontekst të marrëdhënieve të një individi me njerëzit tjerë në mjedisin e tij.

Mësimdhënësi ua jep nxënësve *Fletën e punës 1.8* përmes të cilës nxënësit do të mund të bëjnë vetëvlerësim të aftësisë për kontrollin e sjelljes personale. Nxënësit duhet në mënyrë të mëvetëshme të plotësojnë pyetësin për një kohë prej 5 minutave.

Pasi ta plotësojnë pyetësin, mësimdhënësi fillon diskutim në grup me pyetjet si vijon (7-10 minuta):

- ➔ A mësuat diçka të re për aftësinë tuaj për kontroll të sjelljes derisa e plotësonit pyetësin? Nëse po, çfarë ishte ajo?
- ➔ Sa dallojnë përgjigjet që i dhatë në pyetësor nga pasqyra juaj ideale për veten (pasqyra për atë se çfarë do të donit të jeni)? Ku qëndrojnë dallimet kryesore?
- ➔ A keni vërejtur dallime në përgjigjet lidhur me aktivitetet që ju përfshijnë vetëm ju dhe përgjigjet që përfshijnë marrëdhënie me njerëz të tjerë? Nëse po, ku qëndrojnë dallimet?

Pasi që nxënësit do t'i shkëmbejnë përvojat e tyre me plotësimin e pyetësit, mësimdhënësi nxjerr konstatim nga diskutimi i shkurtër:

Në jetën e përditshme shpesh ndodhin ngjarje të papritura që mund të ndikojnë në humorin tonë, gatishmërinë tonë për plotësimin e detyrave të caktuara, sjelljen tonë ndaj njerëzve të tjerë, etj. Për shkak të kësaj, është shumë e rëndësishme që secili individ të punojë në veten dhe të zhvillojë aftësi personale për kontrollin e sjelljes. Praktikisht, aftësia e këtillë ndonjëherë mund të paraqesë bisedë të qetë, në vend se zënkë nervoze me shokun/shoqen më të mirë që na ka ofenduar, tejkallim të pikëllimit të shkakuar nga lajmi i keq për një kohë më të shkurtër se zakonisht, ose, nga ana tjetër, përfundim të obligimeve të tyre shkollore më herët sesa është pritur, për shkak të ndjekjes së planit të hartuar paraprakisht për zbatimin e tyre.

## ***Pjesa kryesore e orës (20 min.)***

Mësimdhënësi e ndan tabelën në katër pjesë dhe në secilën pjesë shënon njërin prej hapave si vijon:

1. planifikim,
2. ndjekje e përparimit,
3. kontroll dhe ndryshim,
4. vlerësim dhe reflektim.

Nxënësve u jep udhëzime që të njëjtën ta bëjnë në një fletë në fletoret e tyre, pas çka ua lexon shembullin si vijon:

„Faiku në pushimin e madh ha ushqim që i pëlqen më së shumti, por e di se nuk është i shëndetshëm (p.sh. hamburger, ëmbëlsira, patate të skuqura, lëngje të gazuara). Prindërit e tij duan që ai të ushqehet më shëndetshëm, prandaj kohë pas kohë i ndihmojnë të bëjë pako me ushqim të shëndetshëm për në shkollë (p.sh. sallatë, copë të pemëve, shishe me ujë). Disa muaj pasi filloi viti shkollor, Faiku vërejti se në ditët kur ha ushqim të pashëndetshëm, së shpejti pas pushimit të madh ndjehet i përgjumur dhe nuk ka përqendrim të mjaftueshëm në mënyrë që ta ndjekë mësimin në mënyrë aktive. Nga ana tjetër, në ditët kur ushqehet më shëndetshëm, Faiku shpesh ka energji edhe për aktivitete plotësuese pas orëve. Për shkak të kësaj, Faiku vendosi se dëshiron të fillojë të ushqehet më shëndetshëm. Çfarë do të mund të bënte Faiku për ta bërë këtë ndryshim në sjelljen e tij dhe të fillojë t’i kontrollojë më mirë shprehitë e tij për ushqim?“

Mësimdhënësi u jep udhëzime nxënësve që në çifte të mendojnë për secilin prej hapave të përmendur paraprakisht (2-3 minuta).

### ***Përgjigje të mundshme të nxënësve:***

1. **Planifikim** – Do të mund të bënte plan javor për ushqim, do të mund të sillte ushqim nga shtëpia, do të mund të bisedonte me prindërit e tij dhe të marrë pjesë në planifikimin dhe blerjen e racioneve familjare, do të mund të merrej vesh me shokët/shoqet që së bashku t’i planifikojnë racionet për pushimet e mëdha, etj.
2. **Ndjekje e përparimit** – do të mund të shënonte se çfarë ha çdo ditë dhe si ndjehet më pas, do të mundte një herë në javë të bëjë krahasim me atë se si është ndier gjatë javës paraprake dhe asaj që vijon, etj.
3. **Kontroll dhe ndryshim** – Do të mund të mbante evidencë rreth asaj se sa i përmbahet planit të tij javor për ushqim dhe nëse vëren se nuk i përmbahet planit për shkak të ndonjë arsyeje të caktuar (p.sh. të martave ka arsim fizik para pushimit të madh, prandaj shpejt e kap uria pas pushimit të madh dhe u vërsulet ëmbëlsirave), të mendojë se si ta ndryshojë këtë.

- 4. Vlerësim dhe reflektim** – Një muaj pasi do të fillojë me mënyrën e re e të ushqyerit, do të mund të bënte krahasim me atë se si është ndier paraprakisht dhe të vendosë qëllime të reja për muajin e ardhshëm, do të mund të bisedoj një herë në muaj me prindërit e tij rreth sfidave me të cilat është përballur në muajin e fundit dhe së bashku të mendojnë për zgjidhje të mundshme, etj.

Pasi që nxënësit në çifte do të mendojnë se çfarë do të mund të bënte Faiku për secilin prej katër hapave për kontroll të sjelljes, mësimitdhënësi fton 2-3 çifte që t'i shkëmbejnë idetë e tyre dhe i shënon në tabelë.

Procedurën e njëjtë (lexim të situatës, punë në çifte dhe prezantim të ideve të 2-3 çifteve) mësimitdhënësi e përsëritë edhe për shembullin si vijon:

„Tara dhe Vesna janë shoqe më të mira të cilat shpesh kalojnë kohën së bashku. Një ditë, Tara mësoi se Vesna u ka treguar vajzave të tjera të klasës njërin prej sekreteve të Tarës. Tara u hidhërua shumë dhe menjëherë e pyeti Vesnën pse e ka bërë këtë. Vesna kërkoi falje dhe sqaroi se nuk e ka ditur se kjo është sekret, pas çka tentoi ta disponojë Tarën në atë mënyrë që i propozoi të shkojnë së bashku në parkun e qytetit pas orëve të mësimit. Tara e pranoi faljen, por ende ishte e hidhëruar me Vesnën. Në disa javët e ardhshme, Vesna vazhdimisht tentonte ta përmirësojë raportin me Tarën dhe ta përtërijë miqësinë që e kishin para se të hidhëroheshin. Nga ana tjetër, Tara ishte vazhdimisht e hidhëruar dhe shqetësohej madje edhe për imtësinë më të vogël të sjelljes së Vesnës. Gradualisht, Vesna filloi të kalojë më shumë kohë me vajzat tjera të klasës, gjë që e shtyri Tarën të kuptojë se i mungon shoqja më e mirë e saj. Çfarë do të mund të bënte Tara për të përtëritur miqësinë me Vesnën dhe të parandalojë ngjarje të ngjashme në të ardhmen?“

## ***Përgjigje të mundshme të nxënësve:***

- 1. Planifikim** – do të mund të mendonte se si do të donte të duket miqësia e saj me Vesnën dhe të bisedojë me të në këtë temë, do të mund të mendonte disa aktivitete të përbashkëta për të cilat do ta ftonte Vesnën, do të mund të mendonte se si do të ishte më së miri të sillet nëse sërisht ndodhë ndonjë konflikt mes saj dhe Vesnës, etj.
- 2. Ndjekje e përparimit** – Tara do të mund t'i propozonte Vesnës që një herë në javë të bisedojnë rreth asaj se çfarë do të donin të bëjnë së bashku gjatë javës së ardhshme, një herë në javë do të mund të bënte vlerësim të sjelljes personale ndaj Vesnës, etj.
- 3. Kontroll dhe ndryshim** – Tara do të mund t'i propozonte Vesnës që pas çdo konflikti të bisedojnë rreth asaj që ka sjellë deri te konflikti dhe si do të mund ta parandalonin në të ardhmen, do të mund të kërkonin së bashku mbështetje nga psikologu i shkollës për përballje me konflikte, etj.
- 4. Vlerësim dhe reflektim** – Tara do të mundte një muaj, pasi që të fillojë me ndryshimet në sjelljen e saj, të bëjë krahasim mes asaj se si është dukur miqësia e saj me Vesnën dhe si duket pas ndryshimeve, do të mund të mendonte për sfidat me të cilat janë përballur si shoqe dhe të propozojë zgjidhje të mundshme, etj.

Pasi që të prezantohen idetë e nxënësve për dy shembujt, mësimdhënësi fillon diskutim në grup me parashtrimin e pyetjeve si vijon (7-10 minuta):

- ➔ Si ndjeheshit derisa mendoni për hapat që Faiku dhe Tara do të mund t'i ndërmarrin për të bërë ndryshim në sjelljen e tyre dhe ta kontrollojnë më mirë?
- ➔ A keni hasur në ndonjë lloj sfidash gjatë mendimit të hapave për Faikun dhe Tarën? Nëse po, përshkruajini.
- ➔ Çfarë mendoni për rezultatet nga aktiviteti? A jeni dakord me idetë e shënuara në tabelë?

Në fund të diskutimit në grup, mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve dhe nxjerr konstatim për rëndësinë e kontrollit të sjelljes personale si pjesë e zhvillimit personal.

## ***Pjesë përfundimtare e orës/Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (10 min.)***

Mësimdhënësi bën përmbledhje të aktiviteteve të orës dhe paralajmëron aktivitete për orën e radhës:

Ideja për heqje dorë nga ajo që e dëshirojmë tani, në mënyrë që të marrim diçka më vonë dhe/ose i japim dikujt tjetër diçka që ai e dëshiron është shkathtësi që mbështetet në njohjen e mirë të qëllimeve dhe interesave personale, por edhe ndjeshmërinë dhe bashkëpunimin me palën tjetër. Në procesin e zhvillimit të shkathtësisë personale për kontrollin e sjelljes, është veçanërisht i rëndësishëm komunikimi me njerëzit tjerë në mjedisin tonë.

Në mënyrë që të jetë i suksesshëm komunikimi i një individi me të tjerët në mjedisin e tij, është shumë e rëndësishme që individi të jetë i aftë për të treguar **tolerancë** ndaj njerëzve në mjedisin e tij të cilët kanë interesa dhe nevoja të ndryshme, por edhe të bëjë **kompromis**. Në orën e radhës, në mënyrë të hollësishme do të bisedojmë për ndërtimin e tolerancës dhe arritjen e kompromisit.

Mësimdhënësi nxitë diskutim me nxënësit, duke i parashtruar pyetjet si vijon:

- ➔ Paramendoni se jeni "në lëkurën" e Faikut dhe Tarës. Cilat prej ideve të propozuara do t'i kishit bërë? Çfarë ju duket e vështirë për t'u realizuar? Si e sqaroni këtë?
- ➔ Si do të kishit vepruar ju nëse jeni "në lëkurën" e shokut/shoqes të/së Faikut dhe Tarës? Si do të mund t'u ndihmonit në mënyrë që t'i realizojnë qëllimet e tyre?
- ➔ Çfarë do të ndodhte nëse keni interesa të ndryshëm (p.sh. doni ushqim të shpejtë, nuk doni të shoqëroheni me Vesnën)? A do të bënit kompromis?
- ➔ A ka situata ose gjëra për të cilat asnjëherë nuk do të hiqnit dorë nga qëndrimi juaj? Nëse po, cilat janë ato? Çfarë do të mund t'ju bindte që të ndryshoni mendimin?
- ➔ Çfarë mësuat nga aktivitetet e deritanishme? Çfarë mund të përdorni dhe të përmirësoni në sjelljen tuaj?



## Fletë pune 1.8

### ***Pjesa përfundimtare e orës/Aktivitet për reflektim dhe vlerësim***

*Udhëzim:* Bëje një vlerësim të sinqertë të aftësisë personale për kontrollin e sjelljes dhe shënoje shkronjën që ka të bëjë me vlerën e përgjigjeve. Kjo shkallë e vlerësimit është anonime.

**A - Gjithmonë, B- Në të shumtën e rasteve; C - Ndonjëherë; Ç - Rrallë; D - Asnjëherë**

Pohim	Vlerë
1 Mund të vlerësoj mirë se sa kohë do të më marrë një detyrë e caktuar.	
2 Kur dikujt do t'i premtoj diçka, mundohem ta mbaj premtimin.	
3 Vendos të punoj në obligimet dhe detyrat e mia, madje edhe kur më duken të mërzitshme.	
4 Mendoj për mënyrën në të cilën i kam përpiluar detyrat e mbaruara.	
5 Kur dikush më hidhëron, mund të bisedoj qetë me të.	
6 Para obligimeve më të rëndësishme shkollore (p.sh. test, detyrë e projektit) bëj plan të detajuar për zbatimin e tyre.	
7 Mund të vlerësoj nëse do t'i përfundoj me kohë obligimet e planifikuara.	
8 Sapo të vërej se plani im për përfundimin e obligimeve nuk funksionon, menjëherë përpiloj opsione të tjera.	
9 Kur diçka nuk do ta bëj mirë, tentoj të mësoj prej gabimeve.	
10 Kur jam i/e pikëlluar, e di si ta përmirësoj humorin tim.	

# Përmbajtja: Kontroll i sjelljes



## Rezultate nga nxënia:

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të analizojë dhe përshtatë sjelljen e tij/saj dhe t'i respektojë qëndrimet dhe nevojat e ndryshme të njerëzve të tjerë.



## Standarde/tregues për arritje:

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ përkufizojë termet tolerancë dhe kompromis,
- ➔ përshkruajë bashkëpunimin mes njerëzve në realizimin e qëllimit të përbashkët,
- ➔ pranojë se në shoqërinë ekzistojnë grupe dhe persona të cilët kanë interesa, qëndrime dhe nevoja të ndryshme,
- ➔ të pranojë se duhet të bëhet kompromis mes interesave personale dhe interesave të njerëzve të tjerë.



## Materialet e nevojshme:

marker, tabelë, disa fleta boshe A4.



## Metoda, teknika, forma:

metodë frontale, punë në grup, luajtje të roleve, stuhi e ideve.

## ***Pjesa hyrëse e orës (2 min.)***

Mësimdhënësi e fillon orën me hyrjen si vijon:

Në jetën bashkëkohore njerëzit shpesh gjenden në mjedis të llojlojshëm në të cilin janë përfshirë individë, etikë punuese, kultura, interesa, dëshira dhe nevoja të ndryshme. Plotësimi i gjithë këtyre dallimeve është thujtë detyrë e pamundshme, por me zhvillimin e tolerancës dhe mënyrat në të cilat mund të arrihet kompromis, pritët që njerëzit të fillojnë t'i kuptojnë dhe t'i pranojnë të tjerët rreth tyre, gjë që do t'i zvogëlonte konfliktet dhe mosmarrëveshjet.

Mësimdhënësi e paralajmëron aktivitetin e radhës si mundësi praktike që nxënësit të shohin rëndësinë e tolerancës dhe kompromisit, në situata kur duhet të gjendet zgjidhje e përbashkët mes më shumë grupeve me qëndrime, interesa dhe nevoja kundërshtuese.

## ***Pjesa kryesore e orës (33 min.)***

### ***Aktivitet:***

#### ***Luajtje e roleve - Ekskursion***

Mësimdhënësi u paralajmëron nxënësve se në orë do të bëjnë aktivitetet me luajtjen e roleve. E tërë paralelja do të ndahet në tri grupe më të vogla të nxënësve (paralelja 1-1, paralelja 1-2 dhe grup më i vogël i vëzhguesve), ndërsa mësimdhënësi përzgjedhë edhe një nxënës që do të jetë përfaqësues i agjencisë turistike dhe merr instruksione të posaçme.

Mësimdhënësi i udhëheqë aktivitetet dhe nxënësve u sqaron se ata janë përfaqësues të dy paraleleve që në fund të vitit shkollor duhet të shkojnë në ekskursion. Paralelet kanë pak kohë për t'u organizuar, por kanë arritur të gjejnë një agjenci turistike që ofron dy aranzhime. Opsioni i parë është shkuarja në Budapest me njoftim të qytetit, vizitë të monumenteve kulturore, diskoteka dhe shopping. Opsioni i dytë është shkuarja në Budvë, Herceg Novi dhe Kotor, me shumë plazhe, aktivitete sportive dhe diskoteka.

Përfaqësuesi i agjencisë turistike i ndan informacionet si vijon: "Çmimi i të dy ekskursioneve është përafërsisht i njëjtë. Ne, si agjenci, kemi dy kërkesa – duhet doemos të vendosni për njërin aranzhim të gjithë, pra duhet doemos të dyja paralelet të shkojnë në një vend dhe keni vetëm 10 min. për ta marrë vendimin, meqë duhet të rezervohen hotelet. Të gjitha paralelet tjera u morën vesh, keni mbetur vetëm edhe ju."



Mësimdhënësi secilit grup të nxënësve u jep instruksione të ndryshme: Përfaqësuesve të 1-1 u thuhet: „Paralelja juaj është e interesuar për të shkuar në Budapest dhe tentoni që t’i bindni nxënësit e 1-2 që ta pranojnë këtë aranzhim”. Nxënësve të 1-2 u thuhet se ata duhet t’i bindin nxënësit e 1-1 se është më mirë të shkohet në Budvë. Vëzhguesve nga agjencia turistike u thuhet se duhet të jenë vëzhgues të kujdesshëm, të ndjekin se çfarë ndodhë gjatë bisedimeve (nëse janë përfshirë të gjithë, a ka pasur nxënës të cilët nuk kanë marrë pjesë, nëse negociatorët janë dëgjuar mes vete dhe kanë biseduar zëshëm, si ka qenë atmosfera, cilët argumente i kanë nxjerrë njëra dhe pala tjetër, etj.). Mësimdhënësi u jep të dy grupeve pak kohë për t’u marrë vesh (5 min.)

Pas kohës së skaduar, mësimdhënësi fillon diskutimin dhe kërkon që secili grup ta shkëmbejë përvojën e tij:

- ➔ A ia dolët që të arrini marrëveshje? Nëse po, çfarë u morët vesh? Nëse nuk ia dolët, sa ju duket e besueshme ajo se do të arrini marrëveshje? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga nxënësit, nga mosarritja e marrëveshjes deri te arritja e kompromisit.)
- ➔ Si ndjeheshit derisa zgjatnin bisedimet, e si tani?
- ➔ Tani pasi që kishit 5 minuta për të bindur, çfarë ju është më e rëndësishme: përmbushja e idesë personale ose arritja e marrëveshjes?

Përfaqësuesit e agjencisë turistike informojnë për rrjedhën e bisedimeve, si kanë rrjedhur, sa nxënës kanë marrë pjesë, si ka qenë atmosfera, etj.



Mësimdhënësi u tregon nxënësve se situata që e kanë luajtur paraqet një shembull të përshkallëzimit të konfliktit. Për shkak të kësaj të dyja palët synojnë t’i zbatojnë idetë e tyre, në një moment pushojnë së dëgjuari përfaqësuesit e palës tjetër, gjë që mund të rezultojë me bërtitje, zemërim, tërbim, hidhërim. Situata e këtillë është shembull i të ashtuquajturës **gërmim në pozicionin personal**, me ç’rast secila palë në konfliktin e humb nga shikimi palën tjetër me të cilën bisedon, gjithnjë e më shumë angazhohet për idenë personale, gjithnjë e më shumë është e bindur se ajo ka të drejtë dhe heqja dorë nga ideja bëhet gjithnjë e më e vështirë.

Mësimdhënësi thekson se në këtë rast konflikti është ndërprerë në fazën e gërmimit në pozicionet, por në jetën reale nëse konflikti do të vazhdonte, arsyeja fillestare për konfliktin do të mbetej e parëndësishme, ndërsa më e rëndësishme është që të arrihet fitore mbi palën tjetër. Në rast ekstrem mund të paraqitet edhe dëshira për t’i shkaktuar lëndim palës tjetër, po madje edhe të ketë humbje edhe për palën e parë.



Në vazhdim mësimdhënësi kërkon nga nxënësit përmes stuhisë së ideve të prononcohen për epilogun e mundshëm nga bisedimet dhe bën një përmbledhje për epilogët e përmendur:

1. Njëra palë humbë, ndërsa tjetra fiton – ky është një nga epilogët më të shpeshtë nga konflikti. Më i forti fiton, ndërsa më i dobëti humb. Por, fitorja nga njëra anë, në të shumtën e rasteve është vetëm epilog i përkohshëm, meqë pala e dobët mund të forcohet, dhe konflikti të shpërthejë përsëri (p.sh. gjatë anulimit të testit, gjatë marrëveshjes për tjetër ekskursion etj.).
3. Asnjëra palë nuk fiton, gjegjësisht humbin të dyja. Ky është epilogu më i shpeshtë nga konfliktet nëse zgjatin një kohë të gjatë. Të dyja palët janë të rraskapitura dhe mund të humbin më shumë, sesa dikush të jetë fitues.
3. Të dyja palët arrijnë kompromis, me ç’rast secili lëshon pe pak, të dyja palët e ndjejnë/ndajnë, edhe fitoren edhe humbjen. Prandaj konsiderohet se kompromisi është zgjidhje e mirë. Të dyja palët fitojnë kur të dyja kanë përjetimin se janë fitimtarë. Deri te kjo mund të vjen kur do të përkufizohen nevojat e të dyja palëve, e meqë nevojat e të dyja palëve mund të plotësohem në më shumë mënyra, me këtë hapen më shumë mundësi për zgjidhjen e konfliktit. Madje në rast të tillë të dyja palët do të jenë të kënaqura.



Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit që të kthehen sërish në grupe të vogla, por në këtë rast t’u përmbahen disa rregullave:

- ➔ Ta dëgjojnë me kujdes palën tjetër,
- ➔ Në një fletë t’i numërojnë nevojat dhe arsyet e tyre për shkak të cilave angazhohen të shkojnë në udhëtim, pikërisht në destinacionin e përzgjedhur.
- ➔ Më pas secili grup para nxënësve të tjerë t’i prezantojë nevojat dhe arsyet e veta, por derisa flasin të parët, të tjerët kanë për detyrë të dëgjojnë me kujdes, pa ndërprerje dhe ndërhyrje.
- ➔ Secili grup ka nga 5 min. për prezantim.
- ➔ Detyra e vëzhguesve është që ta vërejnë atmosferën dhe sjelljen e anëtarëve të dy grupeve dhe të vërejnë dallime në raport me fazën paraprake.



Pas prezantimit mësimdhënësi i komenton ngjashmëritë dhe dallimet e nevojave të palëve kundërshtuese. Mësimdhënësi sqaron se procedura e bërë quhet **skicim i nevojave dhe brengosjeve** dhe mund të jetë shumë e dobishme kur ekziston konflikt, meqë u ndihmon njerëzve që t’i ndajnë nevojat dhe brengosjet e tyre, si dhe nevojat dhe brengosjet e palës tjetër. Në këtë mënyrë mund të perceptohen dhe kuptohen qartë pozicionet personale dhe të huaja, me më pak emocione. **Skicimi** bën të ditur për drejtime të reja në gjetjen e zgjidhjes së konfliktit.



Në fund të aktivitetit, mësimitdhënësi u jep për detyrë nxënësve, në kuadër të secilit grup, të merren vesh dhe ta rrethojnë atë nevojë për të cilën konsiderojnë se është më e rëndësishme dhe prej të cilës nuk do të heqin dorë. Më pas, u bën thirrje që të tentojnë të gjejnë zgjidhje të përbashkët që do të ishte e pranueshme për të dyja palët, gjegjësisht njëherësh do të kënaqte nevojat e njërit dhe grupit tjetër. Si përgjigje e mundshme, përveç arritjes së kompromisit për dy aranzhimet e ofruara, është e mundshme të përmendet edhe kërkimi i opsionit të tretë që do të ishte më adekuat për nevojat e dy grupeve.

Grupet prezantojnë zgjidhjet e tyre dhe sa janë të kënaqur prej tyre. Pas prezantimeve, mësimitdhënësi bën përmbledhjen e aktivitetit të zbatuar përmes përkufizimit të termeve kyçe dhe informacionet themelore të rëndësishme për përmbajtjen mësimore:

**Toleranca** paraqet respektim të dallimeve të tjerëve, në raport me qëndrimet, vlerat, gjuhën, përkatësinë kombëtare ose religjioze, statusin e tyre social, etj. Fëmijët lindin pa paragjykime, por në procesin e rritjes ata i përvetësojnë, mësojnë nga mjedisi, nga moshatarët e tyre, prindërit ose bashkësia. Paragjykimet mund të tejkalohen përmes zhvillimit të tolerancës. Është me rëndësi të theksohet se toleranca nuk është vetëm diçka që është mirë të zhvillohet, por është e domosdoshme për mirëqenien e të gjithë njerëzve në mjedisin tonë. Për shembull, në një klasë, nëse të gjithë nxënësit duhet të arrijnë përparim në përputhje me qëllimet e tyre, është shumë e rëndësishme që të gjithë të ndihmohen dhe të pranojnë njëri-tjetrin, pa marrë parasysh dallimet e tyre.

Ashtu siç rritet dhe zhvillohet një individ, ashtu bëhet gjithnjë e më i vetëdijshëm për të tjerët rreth tij. Është normale dhe e pritur se do të hasë në një individ tjetër me të cilin do të ketë qëndrime, mendime ose interesa të ndryshëm, gjë që mund të rezultojë me mosmarrëveshje, zënka dhe konflikte. Megjithatë, në vend se të hyhet menjëherë në zënka dhe mosmarrëveshje, do të ishte më mirë që individët të bisedojnë për dallimet e tyre, të shprehin se çfarë ndjejnë, çfarë është ajo që për ta paraqet problem. Gjithashtu është me rëndësi që edhe individët e prekur të dinë të dëgjohen mes vete dhe kohë pas kohë të arrijnë **kompromis**, gjegjësisht zgjidhje në të cilën që të dyja palët do të hiqin dorë nga një pjesë e kërkesave të tyre. Kompromisi arrihet përmes komunikimit dhe pranimit të ndërsjellë të kushteve, me ç'rast shumë shpesh hiqet dorë nga pozicionet dhe kërkesat fillestare. Kompromisi është pjesë e rëndësishme e komunikimit të suksesshëm dhe është proces që mësohet.

Përmes shpërndarjes së ndjenjave, nevojave dhe perspektivave personale njerëzit mund të mësojnë të dallojnë çfarë të ndjejnë dhe të dallojnë çfarë ndjejnë njerëzit tjerë. Në këtë mënyrë ata bëhen të vetëdijshëm për nevojat e individit tjetër, ndërsa mund edhe të mësojnë që t'i pranojnë të tjerët dhe pikëpamjet e tyre. Gjithmonë ekziston mundësia që të paraqiten mosmarrëveshje të reja, por ato me kalimin e kohës do të bëheshin më të pakta dhe më të lehta për t'u zgjidhur.

## ***Pjesë përfundimtare e orës/Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (10 min.)***

Mësimdhënësi i nxitë nxënësit për diskutim:

- ➔ Çfarë mendoni për aktivitetin që e zbatuam? A jeni dakord me epilogun final? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga ana e nxënësve, nga pajtimi i plotë me epilogun, e deri te shprehja e nevojës për arritjen e zgjidhjes më të ndryshme dhe mospranim të kompromisit.)
- ➔ Si do të kishte funksionuar një situatë e këtillë në realitetin? (Priten përgjigje të ndryshme nga nxënësit.)
- ➔ Si do të kishit reaguar ju në një situatë të ngjashme? (Nga nxënësit pritet të shkëmbejnë qëndrime dhe përvoja personale me situata të ngjashme nga jeta e përditshme.)
- ➔ Çfarë mësuat nga ky ushtrim? Çfarë mund të përdorni dhe të përmirësoni në sjelljen tuaj?

Mësimdhënësi nxjerrë konstatimin se në jetën e përditshme është më lehtë të vihet deri te konflikti në vend se deri te marrëveshja, veçanërisht kur në komunikim nuk mbahet llogari për nevojat e palës tjetër. Për zgjidhjen më të lehtë të konflikteve, është me rëndësi që të gjitha palët e prekura të jenë të dëgjua dhe nevojat e tyre të merren parasysh. Veçanërisht është e rëndësishme toleranca ndaj të ndryshmëve prej nesh dhe dëshira për arritjen e zgjidhjes së përbashkët që do të kënaqë të dyja palët.

# Përmbajtja: Etikë



## Rezultate nga nxënia:

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:

- analizojë dhe vlerësojë rëndësinë e vlerave dhe normave morale në shoqëri dhe jetën personale të qytetarit.



## Standarde/tregues për arritje:

Nxënësi/nxënësja mund të:

- përkufizojë termet etikë, vlerë, moral dhe norma morale
- identifikojë ndikimin e vlerave dhe normave morale në kontekstin më të gjerë shoqëror



## Materialet e nevojshme:

letër, laps kimik, Fletë pune 1.9, Fletë pune 1.10, Fletë pune 1.11



## Metoda, teknika, forma:

punë në grup, punë individuale, diskutim në grup, analizë e situatave.

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

Mësimdhënësi paralajmëron ushtrimin „Balon”. I ndan nxënësit në grupe dhe të gjitha grupeve u jep një detyrë të njëjtë: Të paramendojnë se disa vlera janë vendosur si thasë të vegjël në një balon të madh që duhet të fluturojë (paraqet Foton 1). Fluturimi shkon mirë deri në një moment, pas çka thasët fillojnë të rëndojnë. Secili grup duhet të përgjigjet se çfarë do të kishin hedhur dhe cilat tri vlera do t'i kishin lënë në shportën e ballonit. Grupet i prezantojnë përgjigjet e tyre dhe mësimdhënësi i fton që të përgjigjen në pyetjet:

1. A e kishit të vështirë vendimin?
2. Pse vendosët ashtu?
3. A keni qenë në situatë në të cilën është dashur të përzgjidhni mes dy gjërave që nënkuptojnë vlera të ndryshme (p.sh. pasuri përballë dashurisë, singëritet përballë miqësisë, etj.)

Mësimdhënësi e udhëheq diskutimin në drejtim që nxënësit të kuptojnë pse është vështirë të përzgjidhet se çfarë të hidhet, e çfarë të lihet në shportën e ballonit, për shkak se nuk është e thjeshtë të përzgjedhim se çfarë ka rëndësi më të madhe për ne.

Në fund të diskutimit, mësimdhënësi bën një përmbledhje se çfarë janë vlerat.

**Vlerat** janë ide të përgjithshme të njerëzve që e udhëheqin sjelljen dhe u ndihmojnë ta kuptojnë dallimin mes asaj që është e drejtë dhe e gabuar. Vlerat përcaktojnë se sa rëndësi u japim disa gjërave ose veprimeve të caktuara, në mënyrë që të përcaktojmë se cila sjellje është më e mirë ose cila është mënyra më e mirë për të jetuar. Për shkak të kësaj, ato paraqesin bazën e mënyrës së përgjithshme të jetës së njerëzve.

## Pjesa kryesore e orës (20 min.)

Mësimdhënësi u jep instruksione nxënësve që secili për vete të plotësojë kërkesën nga *Fleta e punës 1.9 - Vlera kulturologjike*. Më pas, disa nxënës i lexojnë vlerat e shkruara dhe të gjithë së bashku vijjnë deri te sqarimi i termit **vlera kulturologjike**. Ato janë vlera të bartura nga kultura të cilës i takojmë. Secila kulturë kultivon vlerat e saj dhe i bartë te individi përmes familjes dhe mjedisit në të cilin jeton, edhe vetë kultura në esencë është sistem i vlerave rreth të cilave njeriu e organizon jetën.

Në vazhdim, mësimdhënësi të gjithë nxënësve u ndan *Fletë pune 1.10 - Vlera personale* (ose e paraqet listën në prozhektor/hamer) që përmban listë të vlerave, dhe prej tyre kërkon të përzgjedhin 10 vlerat e tyre më të rëndësishme dhe të njëjtat t'i rendisin prej 1 deri 10 me ç'rast 1

është vlera më e rëndësishme. Kur të përfundojnë, mësimdhënësi i fton të gjejnë një çift dhe t'i prezantojnë të njëjtat para të tjerëve dhe të përgjigjen në pyetjet si vijon:

- ➔ Si i përzgjedhët pikërisht këto vlera?
- ➔ Çfarë mendoni, nëse do ta kishit bërë ushtrimin e njëjtë pas 10 vitesh, a do të kishit pasur listë të njëjtë?
- ➔ Nëse gjendeni në situatë të ndryshme jetësore, a do të kishit përzgjedhur vlerat e njëjta?
- ➔ Kur i shikoni dy detyrat (vlera kulturologjike përballë atyre personale), për çka bëheni të vetëdijshëm? A mundet diçka që është vlerë kulturologjike të mos jetë vlerë personale e juaj? Shembull?

Nga përgjigjet që i ka marrë mësimdhënësi bën përmbledhjen se **vlerat e tyre personale** mund të rrjedhin nga kultura të cilës i takojnë, por kjo nuk është e domosdoshme. Ato mund të jenë vlera që i kemi përvetësuar vetë nga përvoja jonë dhe mund të dallohen lirisht nga njëri deri te njeriu tjetër, ndonëse i takojnë kulturës së njëjtë.

Mësimdhënësi e thekson zhvillimin e vlerave, gjegjësisht përcaktimin e prioritetit gjatë jetës, që do të thotë se gjatë jetës, gjëra të tjera mund të bëhen më të rëndësishme ose më të vlefshme për njeriun, varësisht nga përvoja e tij personale. Në mënyrë plotësuese, momentalisht situata ose kushtet në të cilat jeton individi, gjithashtu mund të ndikojnë në dhënien e prioritetit të ndryshëm për vlerat.


## ***Pjesa përfundimtare (10 min.)***

Në fund të orës, mësimdhënësi u paraqet nxënësve listë me fjalë të urta (Tabela 1) u bën thirrje që të prononcohen (të votojnë) lidhur me atë nëse pajtohen me (rëndësinë e) fjalëve të urta. Sqaron se fjalët e urta janë në fakt shprehje e vlerës kulturologjike që i ka kultivuar ose ende i kultivon një shoqëri e caktuar. Nxënësit mund të diskutojnë se sa në një shoqëri bashkëkohore janë ruajtur vlerat nga e kaluara dhe sa dhe cilat janë ndryshuar.

**Tabela 1.** Fjalë të urta

Fjalë e urtë	PAJTOHEM	NUK PAJTOHEM
Kush ngutet, gabon		
Fjalë e mirë hapë dyert e hekurta		
E mira kthehet me të mirë		
Ç'të mbjellësh, do të korrësh		
Puno kot, por mos rri kot		
Dardha bie nën dardhë		
Pa mund nuk ka shkencë		
Tri herë mat, një herë pre.		
Flokë-gjatë, mendje-shkurtër		

**Foto 1.** „Ballon i vlerave“





## ***Fletë pune 1.9***

### ***Vlera kulturologjike***

Shkruani disa vlera që mendoni se i keni marrë nga prindërit, mësuesit dhe shokët tuaj, që mendoni se janë reflektim i kulturës të cilës i përkisni:

---

---

---

---

---

---

---



## ***Fletë pune 1.10***

### ***Vlera personale***

Më poshtë është dhënë një listë e vlerave personale, të renditura sipas rendit alfabetik. Shënoni prej 1 deri 10, sipas asaj se cilat vlera janë më të rëndësishme për ju:

- \_\_\_ Altruizëm
- \_\_\_ Ambicie
- \_\_\_ Autonomi
- \_\_\_ Arritje personale
- \_\_\_ Bujari
- \_\_\_ Dashuri
- \_\_\_ Dituri
- \_\_\_ Estetikë
- \_\_\_ Kënaqësi
- \_\_\_ Kreativitet
- \_\_\_ Lojalitet
- \_\_\_ Miqësi
- \_\_\_ Mirëqenie emocionale
- \_\_\_ Ndjeshmëri
- \_\_\_ Pamje fizike
- \_\_\_ Pasuri
- \_\_\_ Sinqeritet
- \_\_\_ Shëndet
- \_\_\_ Tolerancë
- \_\_\_ Trimëri
- \_\_\_ Urtësi
  
- \_\_\_ \_\_\_\_\_ (përmendni diçka tjetër)!

## Përmbajtja: Etikë



### **Rezultate nga nxënia:**

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:

- ➔ analizojë dhe vlerësojë rëndësinë e vlerave dhe normave morale në shoqëri dhe jetën personale të qytetarit.



### **Standarde/tregues për arritje:**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ përkufizojë termet etikë, vlerë, moral dhe norma morale
- ➔ identifikojë ndikimin e vlerave dhe normave morale në kontekstin më të gjerë shoqëror
- ➔ përshkruajë shembuj të veprimeve etike dhe joetike
- ➔ propozojë mënyra për mbisundimin e etikës në shoqërinë



### **Materialet e nevojshme:**

Fletë pune 1.11, Fletë pune 1.12,



### **Metoda, teknika, forma:**

punë individuale, punë në grup, analizë e situatave, diskutim në grup

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

Nxënësit i marrin pohimet nga Fleta e punës 1.11 „Unë me gjithë dëshirë do të...” dhe kanë 5 minuta që individualisht t’i lexojnë pohimet dhe të vlerësojnë se çfarë është e saktë për ta, duke shënuar njërin prej dy pohimeve sipas kolonës, me shenjën √. Pas plotësimit, mësimitdhënësi kërkon që disa nxënës t’i prezantojnë përgjigjet e tyre dhe të përgjigjen në pyetjet si vijon:

- ➔ Si ndjeheshit derisa përgjidhni mes dy pohimeve? Si morët vendim kë ta përgjidhni? Çfarë ndjenjash ju shkaktonte përgjedhja e njërit përballë pohimit tjetër?
- ➔ Sa jeni pyetur gjatë përgjedhjes – Çfarë do të thonë të tjerët (familja, miqtë, shoqëria) për këtë përgjedhje?

Mësimitdhënësi sqaron se situatat e këtilla zakonisht i quajmë dilema, kur duhet të përgjedhin mes dy ose më shumë situatave prej të cilave që të dyja kanë përparësi dhe mangësi. Dilemat janë dukuri shumë e shpeshtë në jetesën tonë të përditshme dhe shpeshherë i zgjidhim në atë mënyrë që udhëhiqemi nga emocionet tona. Secili prej nesh ka bazë emocionale për të mirën dhe të keqen, për drejtësinë dhe padrejtësinë, për të arsyeshmen dhe të paarsyeshmen. Prandaj gjatë përgjedhjes, te secili prej nesh (siç ishte rasti konkret me pohimet) paraqitet një lloj i “presionit” nëse jemi duke përgjedhur mirë ose keq, nëse paraqitemi në mënyrë të drejtë ose jo kur duhet të ndërmarrin diçka, nëse përgjedhja jonë është në përputhje me vlerat tona, me vlerat e kulturës të cilës i përkasim, etj.

Emocionet/ndjenjat kanë ndikim të madh në zgjidhjen e dilemave morale, ndonëse shumica e njerëzve nuk janë të vetëdijshëm për atë se sa emocionet e tyre i orientojnë procedurat. Emocionet negative të orientuara nga brenda si faji, turpi, etj. shpeshherë i nxisin njerëzit të veprojnë në mënyrë etike. Emocionet negative të orientuara nga jashtë, nga ana tjetër, kanë për qëllim të disiplinonjë dhe dënojnë. Për shembull, njerëzit shpeshherë sillen me hidhërim, neveri ose mospërfillje ndaj atyre që kanë vepruar në mënyrë joetike, dhe në këtë mënyrë e dekurajojnë sjelljen e këtillë në të ardhmen.

Emocionet pozitive si falënderim dhe mahnitje, që i ndiejmë kur shikojmë se dikush silltet ndaj të tjerëve me ndjeshmëri dhe mirësi, mund të na nxisin edhe në drejtë sjelljes së tillë. Ndjeshmëria është ndjenja kryesore morale që motivon drejtë bashkëpunimit, ndihmës dhe mirësjelljesë.

## Pjesa kryesore e orës (25 min.)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe, dhe secili grup merr një situatë nga Fleta e punës 1.12. dhe kanë 10 minuta që ta analizojnë duke u përgjigjur në pyetjet si vijon:

1. Cila është dilema juaj në situatën konkrete?
2. Cilat vlera janë kundërshtuese në këtë situatë?
3. Cilat nga arsyet e përmendura kanë të bëjnë me interesin personal?
4. Cilat nga arsyet e përmendura kanë të bëjnë me kujdesin për njerëzit tjerë, për mirëqenien e gjithë shoqërisë?
5. A janë disa arsye më të mira se tjerat? Pse?
6. A është e arsyeshme që qytetarët t'i shkelin ligjet për "arsye të mira"? Pse po? Pse jo?

Disa vullnetarë i ndajnë përgjigjet e pyetjeve me gjithë klasën dhe lihet hapësirë për komente nga grupet tjera. Përgjigjet e pyetjeve që i ka marrë mësimdhënësi i përdorë për të ardhur deri te përkufizimi i termeve kryesore.

Në esencën e **moralit** janë vlerat tona themelore. Ato vendosin rregulla për atë se si sillemi në situata të caktuara. Meqë sistemi i vlerave është individual dhe varet nga përvojat e individit dhe nga kultura në të cilën jetojmë, njerëz të ndryshëm mund të reagojnë në mënyrë të ndryshme në situata të njëjta. Kështu që, ai që i jep përparësi më të madhe arritjes së suksesit personal, do të vendosë të përshkruajë nga bashkënxënësi dhe ta fshehtë atë, ndërsa ai që e vlerëson më shumë ndershmërinë, do të vendosë që ta tregojë të vërtetën, që të mos e dëmtojë tjetrin (Situata 3).

Shkenca që i hulumton veprimet dhe qëllimet e njeriut nga prizma e **së mirës** ose **së keqes** në mënyrë që e mira të realizohet, ndërsa e keqja të mënjanohet është **etika** ose **shkenca e moralit**. Sjellja e moralshme është diçka që duhet të lëvdohet, sjellja e pamoralshme është diçka që duhet të refuzohet. Mësimdhënësi sqaron se ekziston **moral personal**, e ky është se njeriu ndërton sistemin e parimeve personale etike (morale) në bazë të identitetit personal, dhe **moral social** që paraqet një sistem të tërë të vlerave të përgjithshme morale të pranuar në mënyrën në të cilën funksionon shoqëria. Morali social i përfshin standardet, pritjet dhe rregullat që i ka përcaktuar shoqëria ose një grup shoqëror për atë se çfarë është "jomorale" dhe "përkatesë" të ndjehet, mendohet dhe bëhet. Ndonëse në të shumtën e rasteve janë të shkruara, zakonisht janë të rrënjosura thellë në mënyrën e funksionimit të shoqërisë/grupit.

Morali personal dhe ai social nuk janë gjithmonë të përshtatur. Meqë etika është shpeshherë personale dhe nuk është domosdo e lidhur me ligjet, dikush mund të konsiderojë se një veprim i caktuar është "i mirë" madje edhe nëse me të njëjtin e shkelë ligjin. Për shembull, ndonëse njeriu nga **Situata 4** e di se nuk është në rregull ajo që e shkelë ligjin me prerjen e paligjshme të drunjve,


megjithatë këtë e bën për të siguruar kushte më të mira për jetesë të familjes së tij. Ndonëse, vlerat sociale morale i thonë se kjo nuk është në rregull, moraliteti i tij personal i thotë se duhet ta mbrojë familjen dhe kjo ka prioritet në vendimin e tij. Kështu, ai mund të bëjë veprim të gabuar (të vjedhë drunj) për shkak të arsyes e cila për të personalisht është e arsyeshme.

## ***Pjesë përfundimtare e orës (10 min.)***

Mësimdhënësi e përshkruan në tabelë pyetjen si vijon: ***Çfarë mund të bëjmë për të përmirësuar sundimin e etikës në shoqërinë?*** dhe kërkon nga nxënësit që secili individualisht të shkruajë se çfarë mund të bëjë ai si individ, çfarë mundet familja, moshatarët, shkolla, komuna, shteti. Derisa nxënësit shkruajnë, mësimdhënësi në tabelë vizaton rathë koncentrik (Foto 2) që më pas i plotëson me përgjigjet e nxënësve të cilët prezantojnë.

Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet asaj që secili prej tyre mund ta bëjë, përmes shkrimit të kodeksit personal etik që do të përbëhet prej 3-5 rregullave themelore që secili nxënës dëshiron personalisht t'i respektojë dhe t'i përfshijë në personalitetin e tij (p.sh. Unë do t'i dua dhe respektoj më të afërmit dhe miqtë; Do të sillmë me respekt ndaj të tjerëve ashtu siç dua të sillen me mua, Do t'u ndihmoj të tjerëve, etj.)

**Foto 2.** Rathë të etikës





## Fletë pune 1.11

### **Unë me gjithë dëshirë do të....**

Po kam shumë shokë, por asnjë të ngushtë	Po kam vetëm një ose dy shokë të ngushtë
Të jem lojtari më i mirë në ekipin që gjithmonë humb	Të jem lojtari më i dobët në ekipin që gjithmonë fiton
Të kem mësimdhënës të rreptë, por që më mëson shumë	Të kemi mësimdhënës të mirë nga i cili nuk do të mësoj shumë
Të punoj punë që nuk e dua por përfitoj shumë	Të punoj punë që e dua, ndonëse paga nuk është shumë e lartë
Të kem një shok shumë zbavitës, i cili nuk është njeri shumë i mirë	Të kem shok dikë që është shumë i mirë, por shumë i mërzitshëm
Të jetoj vetë dhe të jem i pasur	Të jetoj me njerëz të dashur dhe të afërt dhe të mos jem shumë i pasur

## Fletë pune 1.12

### Dilema morale

#### Situata 1

Igori çdo ditë udhëton në këmbë prej shumë larg për të mbërritur në punë. Nëse do të kishte biçikletë gjithçka do të ishte më e thjeshtë. Për shkak të kësaj bën plan për të kursyer para nga paga, por për ta blerë biçikletën që e dëshiron, do të duhej të kursejë së paku 18 muaj. Një ditë në rrugë, një njeriu që ecte para tij i ra kuleta me para. Çfarë mendoni, a duhet Igori ta marrë kuletën dhe në këtë mënyrë ta zgjidhë problemin me transportin deri në punë, ose t'ia kthejë kuletën pronarit të saj?

#### Situata 2

Shikoni se si disa nxënës në oborrin e shkollës nënçmojnë dhe përqeshin një nxënës tjetër. Vëreni se këta janë ata fëmijë prej të cilëve kanë frikë të gjithë dhe janë të mëdha gjasat se do t'ju ngacmojnë edhe juve nëse tentoni që t'i ndalni. Si do të reagoni?

#### Situata 3

Keni një test shumë të rëndësishëm nga matematika për provim pranues dhe përshkruani nga ai që rri ulur pranë jush pa vërejtur ai. Merrni po aq pikë sa edhe tjetri nxënës, ndërsa ka vend vetëm për njërin prej jush. Çfarë mendoni, a do të pranoni ose do të heshtni?

#### Situata 4

Policia arreston një njeri të varfër i cili prenë drunj në mënyrë të paligjshme me qëllim që t'i shesë, për të ushqyer familjen. Për këtë vepër penale është parashikuar dënim prej së paku 5 viteve burg. A duhet të merret parasysh statusi i tij social gjatë përcaktimit të dënimit?

#### Situata 5

Lindita është anëtare e grupit që organizon aksion humanitar për një familje shumë të varfër. Disa nga grupi insistojnë që të regjistrojnë intervistë me anëtarët e familjes së rrezikuar dhe të njëjtën ta publikojnë në rrjetet sociale, duke konsideruar se në këtë mënyrë më shumë njerëz do të mësojnë për ta dhe do të mbledhin më shumë mjete. Lindita mendon se anëtarët e familjes nuk duhet të ekspozohen para opinionit. Çfarë mendoni ju?

## Situata 6

Martini për ditëlindje kërkoi nga prindërit t'i blejnë atlete të reja nga kompania më e popullarizuar për pajisje sportive. Megjithatë si dhuratë mori atlete nga një kompani tjetër për pajisje sportive, për arsye se prindërit e tij mësuan se produktet e kompanisë më të popullarizuar për pajisje sportive prodhohen nga ana e fëmijëve të mitur në fabrika me kushte të këqija për punë, për çka marrin paga shumë të ulëta. Prindërit e Martinit konsiderojnë se nuk duhet të mbështesin kompaninë me blerjen e produkteve të tyre. Çfarë mendoni ju?

## Situata 7

Kryetari i një vendbanimi të vogël paralajmëroi hapjen e fabrikës së re dhe moderne nga ana e një investitori të huaj, që do të kishte mundësuar punësimin e së paku 3000 qytetarëve. Megjithatë, për ndërtimin e fabrikës do të ishte e domosdoshme prerja e pyllit që gjendet në afërsi. Aktivistët për ruajtjen e mjedisit jetësor organizojnë protestë kundër hapjes së fabrikës, duke argumentuar se me prerjen e pyllit që gjendet në afërsi do të cenohen vendbanimet natyrore të shumë kafshëve dhe do të ulet cilësia e ajrit në këtë vendbanim. Nga ana tjetër, një pjesë e banorëve të qytetit në fabrikën e re shikojnë mundësinë për përtëritjen e ekonomisë së tyre dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për së paku 3000 qytetarë. Paramendoni se jeni kryetar i këtij vendbanimi. Si do të kishit vepruar në një situatë të këtillë?



## Përmbajtja: Shprehje e emocioneve



### Rezultate nga nxënia:

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:

- analizojë se si në mënyrën e sjelljes ndikojnë dituritë, emocionet dhe vlerat



### Standarde/tregues për arritje:

Nxënësi/nxënësja mund të:

- sqarojë termet emocion, ndjeshmëri, keqardhje
- përmendë shembuj për reagime të ndryshme emocionale, ndjenja të shprehura, ndjeshmëri



### Materialet e nevojshme:

fletë, letër, tabelë, shkumës, Fletë pune 1.13, Fletë pune 1.14, Fletë pune 1.15, Fletë pune 1.16



### Metoda, teknika, forma:

punë individuale dhe në grup, diskutim në grup,

## Pjesa hyrëse e orës (5 min.)

Mësimdhënësi fillon orën në atë mënyrë që i pyet nxënësit:

➔ Si ndjeheni sot?

I pret përgjigjet e tyre dhe vazhdon me pyetjen e radhës:

➔ A është vështirë të flitet për ndjenja? Në cilat situata e keni të vështirë të flitni?

Pas përgjigjeve, mësimdhënësi vazhdon me aktivitetin që ka të bëjë me dallimin e emocioneve.

## Pjesa kryesore e orës (35 min.)

### Aktivitet:

#### **Dallim i emocioneve (15 min.)**

Secili nxënës merr Fletë pune 1.13 me vizatime që tregojnë ndonjë emocion. Detyra e tyre është të dallojnë për cilin emocion bëhet fjalë dhe ta shënojnë nën vizatimin konkret. Mësimdhënësi kërkon nga disa prej tyre që t'i prezantojnë përgjigjet pas çka i paraqet vizatimet e plotësuara me përgjigje (Fletë pune 1.14). Nxënësit i krahasojnë përgjigjet, i diskutojnë dhe i korrigjojnë përgjigjet e gabuara. Mësimdhënësi nxitë diskutim përmes pyetjeve si vijon:

➔ Cilat emocione ishin të vështira për ju për t'u dalluar? Pse?

➔ Tregoni disa situata tipike kur paraqitet ndonjë emocion i caktuar?

Mësimdhënësi e udhëheq diskutimin në drejtim të asaj që nxënësit të kuptojnë se sa janë të aftë të dallojnë emocione, cilat i dallojnë më vështirë dhe pse konsiderojnë se nuk i kanë dalluar, cili emocion është karakteristik për situata të ndryshme.

Në fund të diskutimit mësimdhënësi sqaron se çfarë janë emocionet, thekson se ekzistojnë një varg sqarimesh për atë se çfarë janë emocionet, varësisht nga qasja ndaj kësaj teme. Elementet më të shpeshta janë:

➔ Emocioni është proces psikik që paraet **reagimin** e individit ndaj ndonjë ndodhie. Gjatë reagimit, ndodhia jo vetëm që vërehet/perceptohet, por edhe ndjehet, që i bën emocionet të ndryshme për nga cilësia në krahasim me reagimet tjera të individit (p.sh. perceptim, mendim).

- ➔ „Ndodhi“ në të shumtën e rasteve është **ndryshimi** që e ka prishur balancën e atij individit dhe botës së tij, ndërsa emocioni është pasojë e asaj situatë të sapokrijuar dhe i ndihmon njeriut që të **adaptohet**. Për shembull, emocioni i pikëllimit na ndihmon që të përshtatemi ndaj një humbjeje të caktuar, emocioni i frikës të përshtatemi ndaj një situatë që na frikëson, etj.
- ➔ Individit reagon përmes reagimit emocional ndaj këtyre situatave që i **vlerëson si të rëndësishme**. Në mënyrë që të ndodhë një reagim emocional, një ndodhi e caktuar duhet të regjistrohet (perceptohet), t’i përcaktohet rëndësia, t’i përcaktohet vlera. Ajo që individit e vlerëson si të rëndësishme varet nga sistemi personal i vlerave, për shkak të cilës arsye edhe njerëzit dallojnë në mënyrat se si reagojnë në situatë të njëjtë.
- ➔ E gjithë kjo ndodhë në vetë **organizmin** ku krijohen një varg ndryshimesh fiziologjike (p.sh. skuqje gjatë ndjenjës së turpit, rrahje të fuqishme të zemrës gjatë ndjenjës së frikës, qarje gjatë ndjenjës së pikëllimit, etj.).

Të kuptuarit e emocioneve personale është veçanërisht e rëndësishme që të mund të kuptojmë vetveten, si dhe njerëzit tjerë.

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e elementeve kryesore të disa prej emocioneve themelore, përmes përshkrimeve ose shembujve.

**Frikë:** Përballje me pasiguri ose rrezik ekzistencial. Individit vlerëson se është rrezikuar ndonjë vlerë e tij, ndërsa nuk mund t’i kundërvihet në mënyrë përkatëse objekteve ose situatave që e rrezikojnë.

**Turp:** Dështim në plotësimin e pritjeve personale. Individit ndjen turp në situatë kur vlerëson se me një veprim të caktuar të tij e ka vërtetuar pasqyrën negative për veten para ndonjë individit ose grupit të rëndësishëm.

**Pikëllim:** Shijim i një humbjeje të pazëvendësueshme të një gjëje që vlerësohet si e vlefshme.

**Zemërim:** Sulm ofendues ndaj nesh ose ndonjërit nga të afërmit tanë. Mund të jetë i shkakuar nga hidhërimi ose nga urrejtja.

**Zili:** Dëshirim i asaj që e ka (që është) tjetri. Individit zakonisht konsideron se “tjetri” në mënyrë të pamërituara ka ndonjë përparësi të cilën individit konsideron se ai po aq ose më shumë e meriton.

**Lumturi:** Arritje e përparimit drejt realizimit të një qëllimi të caktuar, ose vërtetim të një përparësie të caktuar.

**Dashuri:** Ndjenjë e këndshme që paraqitet ndaj një objekti që përjetohet si shumë i

**Vlefshëm:** dhe që konsiderohet pjesë përbërëse e jetës së tij intime. Dallon nga rënia në dashuri, që paraqet pasqyrë të idealizuar për “tjetrin”.

**Urrejtje:** Ndjenjë intensive e mosdashjes, të orientuar drejt dikujt për të cilin besohet se rrezikon në mënyrë të paarsyeshme një vlerë të rëndësishme të individit.

## Aktivitet:

### **Emocionet si mënyrë e komunikimit (20 min.)**

Nxënësit nxiten që t'i shikojnë emocionet jo vetëm si përjetime personale, por edhe si mënyrë e komunikimit. Pritet që të kuptojnë se të njëjtat nuk paraqiten në vakuum, por në relacion me diçka ose dikë. Për këtë qëllim mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe më të vogla dhe secili grup merr Fletë pune 1.15. për të cilën kanë 10 minuta që ta plotësojnë. (Mësimdhënësi mund t'i shënojë emocionet në tabelë ose t'i prozhektojë në prozhektor, ndërsa nxënësit të shënojnë në fletore). Pasi që nga një nxënës nga secili grup i prezanton përgjigjet deri te të cilat kanë ardhur, mësimdhënësi i nxitë që t'i krahasojnë përshkrimet, me ç'rast udhëhiqen nga tabela e plotësuar (Tabela 2) me shembuj të paraqitura si lloj i porosisë që e dërgojmë me një emocion të caktuar.

**Tabela 2. Komunikim përmes emocioneve (përgjigje potenciale)**

Emocion	Porosi që dërgojmë duke shprehur emocionin
Zemërim	Ndrysho sjelljen tënde!
Frikë	Më rrezikon diçka më e fuqishme se unë.
Dashuri	Ti je qenie e vlefshme njerëzore dhe unë dua të të kam në jetën time intime.
Pikëllim	Kaloj nëpër humbje të madhe.
Lumturi	Dëshira ime /qëllimi im është plotësuar.
Turp	E di se nuk i plotësoj pritjet tuaja.

Mësimdhënësi thekson se është shumë e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm për emocionet tona, të dimë t'i identifikojmë dhe t'i pranojmë. Të dimë se ato janë shprehje e reagimit tonë në një situatë të caktuar, të jemi të aftë të vlerësojmë fuqinë e tyre dhe të dimë të tregojmë se çfarë saktësisht i shkakton. Në këtë mënyrë, do të dimë se ku dhe si t'i shprehim dhe t'i kontrollojmë. Do të dimë se si emocionet tona ndikojnë te të tjerët dhe do të mund të pranojmë përgjegjësi për veprimin e tyre. Gjithashtu, duhet të dimë t'i identifikojmë emocionet ndaj të tjerëve, t'i respektojmë, ashtu që të mund të reagojmë në mënyrë përkatëse ndaj çdo situatë.

## ***Pjesë përfundimtare e orës dhe reflektim (5 min.)***


Në pjesën e fundit të orës, mësuesi parashtron disa pyetje për reflektim dhe diskutim:

- ➔ Si e shikoni vetveten? Si individ emotiv i vrullshëm ose si emotiv i qetë dhe i qëndrueshëm?
- ➔ Si e vlerësoni aftësinë personale për vlerësimin e emocioneve të tjerëve?
- ➔ Si përbaleni me emocionet e padëshiruara? A jeni drejtuar ndonjëherë për ndihmë të shërbimi profesional i shkollës? Pse po? Pse jo?
- ➔ A keni vërejtur se njerëzit reagojnë ndryshe në situatë konkrete (film, libër, këngë...)? Jepni ndonjë shembull.




## *Fletë pune 1.13*

### *Dallim i emocioneve*



## Fletë pune 1.14

### Dallim i emocioneve (përgjigje)





## **Fletë pune 1.15**

### **Komunikim përmes emocioneve**

Emocion	Porosi që dërgojmë duke shprehur emocionin
Zemërim	
Frikë	
Dashuri	
Pikëllim	
Lumturi	
Turp	



## Përmbajtja: Shprehje e emocioneve



### Rezultate nga nxënia:

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:

- analizojë se si në mënyrën e sjelljes ndikojnë dituritë, emocionet dhe vlerat



### Standarde/tregues për arritje:

Nxënësi/nxënësja mund të:

- sqarojë termet emocion, ndjeshmëri, keqardhje
- përmendë shembuj për reagime të ndryshme emocionale, ndjenja të shprehura, ndjeshmëri
- krahasojë reagime emocionale në situata të ndryshme
- vlerësojë reagime personale në situata të ndryshme



### Materialet e nevojshme:

fletë, laps kimik, tabelë, shkumës, Fletë pune 1.16, Fletë pune 1.17



### Metoda, teknika, forma:

metodë frontale, punë individuale dhe në grup, analizë e situatave, diskutim në grup

## Pjesa hyrëse e orës (5 min.)

### Diskutim në grup: Çfarë është ndjeshmëria?

Наставникот го започнува часот со следните прашања:

- ➔ A keni dëgjuar ndonjëherë për termin ndjeshmëri? Në çfarë konteksti?
- ➔ A keni ndjerë ndonjëherë ndjeshmëri për dikë? Në çfarë situatë është paraqitur kjo?

Me këto pyetje mësimitdhënësi kontrollon se cilat janë njohuritë paraprake të nxënësve për temën e orës rrjedhëse. Pritet që ndonëse shumica e nxënësve kanë përvojë me ndjeshmërinë, jo secili di ta identifikojë në mënyrë përkatëse.

## Pjesa kryesore e orës (30 min.)

### Aktivitet:

#### Në „lëkurën“ e tjetrit

Nxënësit ndahen në pesë grupe dhe secili merr njërin prej situatave nga Fleta e punës 1.16. Prej tyre kërkohet ta analizojnë situatën, përmes diskutimit në grup dhe përgjigjes në pyetjet (si ndjehet personazhi nga situata, pse, çfarë mund të bëjnë për të dhe si ta bëjnë atë). Pasi t'i analizojnë situatat, secili grup, në tabelë e plotëson tabelën vijuese:

Tabela 3. Në „lëkurën“ e tjetrit

Situata	Si ndjehet?	Pse?	Si do të kishit reaguar?
Situata 1			
Situata 2			
Situata 3			
Situata 4			
Situata 5			

Pas plotësimit të tabelës, mësimitdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të ofruara dhe i pyet nxënësit tjerë, nëse do të kishin reaguar ndryshe. Vazhdon me pyetjet në mënyrë që të përcaktojë se sa nxënësit, gjatë leximit të situatës, e kanë përjetuar emocionin e personazhit.

Mësimitdhënësi sqaron se **ndjeshmëria** paraqet aftësi që ta ndjejmë dhe kuptojmë atë që e ndjejnë të tjerët. Kjo do të thotë – jo vetëm që e dimë se dikush vuan ose është i pikëlluar, por jemi të aftë që edhe thellësisht ta kuptojmë ndjenjën e tij dhe e përjetojmë në mënyrë të veçantë, duke e

shikuar botën me sytë e tij. Shkathtësia për të zbuluar se çfarë ndjejnë të tjerët është shkathtësi themelore në komunikimin me njerëzit tjerë dhe paraqet bazën për sjellje të përgjegjshme sociale. Sjellja e tillë është shumë e rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë qytetare dhe respektimin e vlerave demokratike.

Mësimdhënësi sqaron se disa nga reagimet tona ndaj situatave të caktuara i ngjajnë ndjeshmërisë, por nuk janë ndjeshmëri. Në të shumtën e rasteve, ndjeshmërinë e përziejme me **keqardhjen**, që ka të bëjë me ndjenjën dhe tregimin e keqardhjes për të tjerët. Keqardhja i ngjan, por nuk është zëvendësim për ndjeshmërinë, për shkak se njerëzve zakonisht u nevojitet mirëkuptim më i thellë për atë nëpër të cilën janë duke kaluar. Ndjeshmëria është në fakt e ndërlidhur me kujdesin për tjetrin. Morali dhe vlerat tona kanë rrënjë në ndjeshmërinë. Ajo i shtyn njerëzit të reagojnë, të ndihmojnë, po madje edhe të luftojnë kundër ndonjë padrejtësie.

Sipas kësaj, ndjeshmëria është bazë për aktivizëm qytetar. Anëtarët e bashkësive duhet të kuptohen mes vete, të kujdesen për njëri-tjetrin, të dinë të komunikojnë për problemet me të cilat përballen dhe të ndërmarrin aksion për ndryshim pozitiv. Në mënyrë plotësuese, ata duhet të dinë të bashkëpunojnë me njerëz të cilët janë të ndryshën prej tyre, mbi baza të ndryshme (p.sh. moshë, përkatësia etnike, profesioni, etj.). Të gjitha këto kushte varen nga aftësia e individit për ndjeshmëri.

E kundërta e ndjeshmërisë është indiferenca dhe vrazhdësia si mungesë e plotë të ndjeshmërisë.

## ***Zhvillim i sjelljes së ndjeshme***

Sjellja e ndjeshme mund të zhvillohet gjatë jetës. Faktorë të ndryshëm, nga vetë individi, dhe nga mjedisi mund të paraqesiten si rrethana për zhvillimin e ndjeshmërisë:

- ➔ Familja që ofron mbështetje dhe tregon kujdes ndaj anëtarëve, anëtarë të familjes që janë të hapur ndaj mendimeve të ndryshme dhe i pranojnë pa gjykuar.
- ➔ Grupi i moshatarëve që ka pritje dhe vlera pozitive në raport me kujdesin dhe ndihmën për të tjerët.
- ➔ Përfshirja në aktivitete jashtëshkollore, veçanërisht organizata dhe/ose aktivitete vullnetare.
- ➔ Shkolla që kultivon vlera demokratike, duke përfshirë: mbështetje nga dhe ndaj mësimdhënësve, përfshirje të nxënësve në procese të ndryshme në nivel të shkollës, liri e të shprehurit dhe respektim i ndërsjellë i mendimeve.
- ➔ Mediat dhe përmbajtjet mediatike që prezantojnë dhe promovojnë bashkëpunim, respekt, përkujdesje për të tjerët.
- ➔ Vetëbesim të lartë të individit dhe bindje se mund të arrihet ndryshim shoqëror.

## ***Pjesë përfundimtare e orës dhe reflektim (10 min.)***

Mësimdhënësi i nxitë nxënësit që t'i shqyrtojnë në mënyrë të mëvetësishme faktorët për zhvillimin e ndjeshmërisë dhe të vlerësojnë sa, te secili prej tyre, është e pranishme dhe e zhvilluar në jetën e tyre. Ata janë të ftuar të mendojnë se në cilët prej këtyre faktorëve mund të ndikojnë personalisht, dhe në çfarë mënyre, në drejtim të orientimit të tyre drejt zhvillimit të sjelljes emfatike në shoqëri. Përmes diskutimit në grup bëhet përmbledhje e mendimeve të klasës.



## Fletë pune 1.16

### Në “lëkurën” e tjetrit

#### Situata 1

Nxënësit e klasës e injorojnë Petarin dhe nuk shoqërohen me të. Gjatë pushimeve ai mbetet vetë në klasë meqë askush nuk e fton të hanë ose të dalin jashtë së bashku. Ditët kur mësimi përfundon më herët, ai vetë pret në rrugë që të mbërrijë transporti i tij.

- ➔ Si ndjehet Petari?
- ➔ Pse ndjehet ashtu?
- ➔ Si do të reagonit nëse ai mëson në shkollën tuaj?

#### Situata 2

Qeni i Rinës ka ngordhur derisa ajo ishte në pushim. Prindërit nuk kishim guximin që t'i tregojnë derisa ajo të kthehet.

- ➔ Si ndjehet Rina?
- ➔ Pse ndjehet ashtu?
- ➔ Si do të reagonit nëse do ta kishit shoqe?

#### Situata 3

Shoqja e Azrës bleu telefon që Azra e dëshiron tashmë një kohë të gjatë. I vjen mirë që shoqja e saj e ka, por nuk është krejtësisht i njëjtë fakti që ajo nuk mund ta blejë.

- ➔ Si ndjehet Azra?
- ➔ Pse ndjehet ashtu?
- ➔ Si do të reagoje nëse do të ishte shoku/shoqja i/e saj?

#### Situata 4

Disa ditë më parë Manu e kishte ditëlindjen. Ai e ftoi gjithë shoqërinë në aheng. Por, njëherësh mbahej koncert i një ylli të famshëm të muzikës në të cilin shkuan pjesa më e madhe e shoqërisë së Manus. Vetëm dy prej shokëve i erdhën në ahengun e ditëlindjes.

- ➔ Si është ndjerë Manu?
- ➔ Pse është ndjerë kështu?
- ➔ Si do të reagoje ti nëse do të ishte shok/shoqe i/e tij?

## Situata 5

Të premten, ora e shtatë e Norës ishte edukatë fizike. Ajo ishte shumë e lodhur dhe e shpërqendruar dhe mësimdhënësi i edukatës fizike e përjashtoi nga loja. Nora u ul në bankën dhe i shikonte bashkënxënësit se si luajnë.

- ➔ Si është ndier Nora?
- ➔ Pse është ndier ashtu?
- ➔ Si do të reagoje nëse ajo do të mësonte me ty në klasë?



*Moduli*



**LIDHSHMËRI**  
**QYTETARE**



## Përmbajtja: Komunikim



### **Rezultate nga nxënia:**

Nxënësi/nxënësjja i identifikon llojet e ndryshme të komunikimit dhe ndikimin e tyre në mënyrën bashkëkohore të jetesës.



### **Standarde/tregues për arritje:**

Nxënësi mund të:

- ➔ numërojë mënyra të ndryshme të komunikimit dhe kushtet që ndikojnë në komunikimin efektiv,
- ➔ përshkruajë komunikimin si mjet themelor për mirëkuptim mes njerëzve,
- ➔ të hartojë plan për komunikim efektiv (verbal, joverbal, digjital) në mënyrë që të bëhet ndonjë detyrë e ndërlikuar,
- ➔ të përshtatë komunikimin varësisht nga konteksti dhe format e kapshme.



### **Materialet e nevojshme:**

projektor, laptop, markerë, Fletë pune 1.8.



### **Metoda, teknika, forma:**

diskutim, punë individuale, punë në çifte dhe në grup, formë frontale e punës.

## **Pjesa hyrëse e orës (15 min.)**

### **Aktivitet:**

#### **„Telefon i prishur“**

Mësimdhënësi paralajmëron se ora e sotme do të fillojë me një “akullthyes” për të cilin i nevojitet një vullnetar. Mësimdhënësi i jep vullnetarit një fletë të vogël në të cilën është shkruar ndonjë fjali më e gjatë. Nxënësi e lexon fjalinë në vete dhe ia transmeton qetë me pëshpëritje nxënësit të parë nga cilado anë e klasës. Pasi ta dëgjojë fjalinë, nxënësi në mënyrë të njëjtë e transmeton të njëjtën deri te nxënësi pranë tij dhe kështu me radhë deri te nxënësi i fundit i cili pasi do ta dëgjojë fjalinë mësimdhënësi kërkon prej tij që ta thotë me zë. Në të shumtën e rasteve (veçanërisht varet nga numri i nxënësve në klasë) fjalia përfundimtare është e ndryshme dhe dukshëm më e shkurtër nga ajo fillestare. Vullnetari e tregon fjalinë fillestare dhe duke e krahasuar me atë përfundimtare, nxënësit kuptojnë se një pjesë e madhe e informacioneve janë humbur gjatë transmetimit.

Mësimdhënësi i parashtrohet pyetjet si vijon:

- ➔ Pse e bëjmë këtë aktivitet? Çfarë perceptuat/vërejtët në aktivitetin?
- ➔ Çfarë ndodhi me procesin e transmetimit të porosisë?
- ➔ Si e sqaroni atë që u ndryshua përmbajtja e porosisë? Çfarë do të thoshte kjo nëse porosia do të ishte informacion shumë i rëndësishëm për dikë?
- ➔ Pse është i rëndësishëm komunikimi?

Në fund të aktivitetit, mësimdhënësi bashkë me nxënësit konstaton se dërgimi dhe pranimi i porosisë është diçka që e bëjmë për çdo ditë. Ky aktivitet tregon se sa është i rëndësishëm ky proces dhe sa gjëra duhet të merren parasysh gjatë komunikimit.


## Pjesa kryesore e orës (30 min.)

### Aktivitet:

#### Çfarë është komunikimi? (10-15 min.)

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit, secili për vete të përkufizojë se çfarë është **komunikimi**. Kur do ta bëjnë këtë, secili nxënës me nxënësin që gjendet pranë tij, prej dy përkufizimeve duhet të shkruajnë një përkufizim të përbashkët që do t'i përmbajë elementet e dy përkufizimeve paraprake. Më pas, dy çifte bashkohen dhe formojnë grup i cili, gjithashtu, krijon përkufizim të ri prej dy përkufizimeve paraprake sipas parimit të njëjtë. Mësimdhënësi kërkon një përfaqësues nga secili grup që ta lexojë përkufizimin, derisa ai i shënon elementet kryesore në tabelë. Në fund të prezantimeve të të gjitha grupeve, në tabelë tashmë ka një hardhi të madhe të formuar nga të gjitha përkufizimet e nxënësve (Foto 3).

Foto 3. Hardhi për përkufizimin e termit komunikim.



Duke u ndërlidhur në atë që është thënë, mësimdhënësi thekson se termi komunikim është i gjerë dhe varet nga fusha me të cilën ka të bëjë. Megjithatë, përkufizimi i pranuar është se **komunikimi** është proces i shkëmbimit të informacioneve përmes sistemit të përbashkët të sinjaleve mes subjekteve të ndryshme.

Sistemet e komunikimit përdorin dy lloje të sinjaleve: shenja dhe simbole. Shenjat janë sinjale që janë të ndërlidhura me porosinë që e transmetojnë. Për shembull, kur dikush skuqet, kjo për ne është shenjë se është i turpshëm. Simbolet, nga ana tjetër, janë shenjë e marrëveshjes shoqërore mes njerëzve në një grup/bashkësi të caktuar. Për shembull, kur do të dëgjojmë ose lexojmë fjalën "qen", kjo për ne shënon kafshën që ecë në katër këmbë dhe ka gëzof.

Në gjuhë tjetër, kuptimin e njëjtë e ka ndonjë fjalë krejtësisht tjetër. Komunikimi verbal shpesh përfshin edhe shenja dhe simbole. Për shembull, miku na tregon me fjalë se është i shqetësuar (simbol), ndërsa të njëjtën e dallojmë edhe nga zëri i tij i dridhur (shenjë). Shpeshherë, përmbajtja simbolike gjatë komunikimit kontribuon që ajo të jetë më efektive (oratori të transmetojë më mirë një porosi, ndërsa dëgjuesi ta kuptojë të njëjtën në mënyrë përkatëse).

Gjuha është vetvetiu njëri prej sistemeve të simboleve që njerëzit i përdorin për të komunikuar. Ajo shpesh është e shoqëruar me simbole të shumta të tjera që transmetojnë kuptim. Për shembull, grushti i shtrënguar me gishtin e madh të ngritur në disa shoqëri shënon aprovim ose sukses, unaza martesore gjendjen martesore, ndërsa grimasa në fytyrë gjatë pyetjes: "Si të pëlqeu filmi?" e shënon vlerësimin e individit për filmin.

Në mënyrë që komunikimi të jetë i suksesshëm, duhet doemos të ekzistojnë disa kushte themelore: të ketë dërgues të porosisë, pranues të porosisë dhe përmbajtje të porosisë. Megjithatë, këto tri elemente nuk janë të mjaftueshme nëse paraqiten pengesa në komunikimin siç janë: kapacitet i kufizuar i pranuesit, supozim, përmbajtje konfuze, mungesë e kanalit të komunikimit, etj.

Mësimdhënësi i përmendë llojet e komunikimit:

1. Komunikim verbal dhe joverbal,
2. Komunikimi zanor dhe jozanor/i heshtur,
3. Komunikim i tërthortë dhe i drejtpërdrejtë,
4. Komunikim i njëkahshëm dhe i ndërsjellë.

Përmes diskutimit në grup, mësimdhënësi i nxitë nxënësit të mendojnë se në cilat situata përdoret secili lloj i komunikimit, dhe nga kjo i nxjerrë konstatimet si vijon:


Sipas kriterit nëse përdorim fjalë ose jo, kemi komunikim verbal dhe joverbal. Kjo do të thotë se kur e përdorim gjuhën, komunikimi është verbal, derisa, nga ana tjetër, kur përdorim gjeste, mimika, pauza, gjegjësisht kur nuk përdoret të folurit, ky është joverbal.

Sipas asaj nëse përdorim zë ose jo, kemi komunikim zanor dhe jozanor/i heshtur. Edhe njerëzit edhe kafshët komunikojnë me lëshimin e zërave. Kur përdorim shenja të tjera, gjeste, mimika, si dhe alfabetin (tekst të shkruar), atëherë komunikimi është jozanor/i heshtur.

Kriteri i tretë përkufizon nëse komunikojnë drejtpërdrejt me dikë ose përmes mjeteve të tjera ndihmëse. Kur kemi komunikim të drejtpërdrejtë, komunikojmë ballë për ballë, ndërsa të tërthortë përmes aparateve të ndryshme siç janë telefoni ose kompjuteri, letrat, etj.

Sipas asaj se ku është i orientuar komunikimi, vallë drejt vetes ose drejt të tjerëve, kemi komunikim të njëanshëm (drejt vetes) dhe të ndërsjellë (drejt të tjerëve). Të njëanshme janë edhe mjetet për informim publik (mediat): televizioni, radioja, mediat e shtypura, si dhe letrat pa përgjigje.

Foto 4. Lloje të komunikimit



### Aktivitet:

#### **Komunikimi në situata të ndryshme (10-15 min.)**

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të vogla dhe ua jep fletën e punës 2.1, e cila përmban disa situata që duhet të komunikohen. Brenda pesë minutave, secili prej grupeve duhet të të bien dakord dhe të shënojë se si do ta kishin transmetuar informacionin në mënyrë më përkatëse në secilën prej situatave, duke marrë parasysh informacionet paraprake për llojet e komunikimit.

Secili grup prezanton dhe pritët që mësimdhënësi bashkë me nxënësit të konstatojnë se ekzistojnë shumë mënyra të komunikimit, se një informacion i njëjtë mund të transmetohet në mënyrë të ndryshme. Mësimdhënësi thekson se mënyra në të cilën komunikojmë varet shumë nga konteksti në të cilin ndodhë ai, si dhe nga ajo me kë komunikojmë.

#### **Pjesë përfundimtare e orës udhe reflektim (5 min.)**

Në fund të orës mësimdhënësi në tabelë i shënon pohimet si vijon dhe kërkon nga nxënësit përmes përdorimit të emotikonëve (që, gjithashtu, janë simbole për komunikim) ta shënojë qëndrimin e tyre për secilin prej tyre, në fletoren ose tabelën e tyre:

- ➔ Ora ishte interesante.
- ➔ Në orë mësova diçka të re.
- ➔ Në orë e vërtetova atë që tashmë e dija.
- ➔ Dua të mësoj të komunikoj më mirë.
- ➔ Tema për komunikim është e mërzitshme.
- ➔ Nuk është e rëndësishme se si do të komunikoj me të tjerët.

## **Fletë pune 2.1.**

### **Komunikimi në situata të ndryshme**

Plotësoni se çfarë lloji të komunikimit/komunikimeve përdorni gjatë situatave të poshtëpërmendura:

1. Organizojmë garë humanitare dhe duam që për të njëjtën t'i informojmë nxënësit e shkollës sonë.

---

---

2. Mbajmë shfaqje me pantomimë.

---

---

3. Shkruajmë skenar të shkurtër për skeç, si pjesë e programit për patronatin e shkollës.

---

---

4. Pas një dite të gjatë dhe të lodhshme, ulemi dhe meditojmë.

---

---

5. E informojmë kujdestaren e klasës se jemi të sëmurë dhe se do të mungojmë atë ditë.

---

---

6. Konsultohemi me pedagogun e shkollës se cilën lëndë zgjedhore ta përzgjedhim për vitin e ardhshëm.

---

---

## **Përmbajtja: Komunikim**



### **Rezultate nga nxënia:**

Nxënësi/nxënësja i identifikon llojet e ndryshme të komunikimit dhe ndikimin e tyre në mënyrën bashkëkohore të jetesës.



### **Standarde/tregues për arritje:**

Nxënësi mund të:

- ➔ të hartojë plan për komunikim efektiv (verbal, joverbal, digjital) në mënyrë që të realizohet ndonjë detyrë e ndërlikuar,
- ➔ të përshtatë komunikimin varësisht nga konteksti dhe format që janë në dispozicion.



### **Materialet e nevojshme:**

tabelë, shkumës, Fletë pune 2.2.



### **Metoda, teknika, forma:**

punë në çifte, punë individuale, diskutim në grup.

## ***Pjesa hyrëse e orës (10 min.)***

Mësimdhënësi e paralajmëron ushtrimin "Fortesa" dhe kërkon dy vullnetarë që do të dalin nga klasa për shkurt kohë. Nga të gjithë nxënësit tjerë kërkon që të ngrihen dhe të ulen pranë njëri-tjetrit, për të bërë një rreth të ngushtë të mbyllur ku askush nuk do të mund t'i hapë muret, përveç nëse thotë: "Të lutem, a mund të hyjë?" Më pas mësimdhënësi del jashtë dhe u thotë vullnetarëve se pasi të hyjnë brenda një nga një, kanë të njëjtën detyrë, e kjo është që të hyjnë në fortesën. Vullnetarët tentojnë në mënyrë individuale, me shtyrje, me forcë, vendosjen e karriges për të kërcyer, por fortesa nuk hapet, nuk zhvendoset, përderisa njëri nga vullnetarët nuk pyet nëse mund të hyjë.

Ushtrimi bëhet me qëllim që nxënësit të shohin se sa është i rëndësishëm komunikimi dhe sa gjithçka ndryshon dhe varet rrënjësisht nga mënyra në të cilën komunikojmë.

## ***Pjesa kryesore e orës (20 min.)***

Komunikimi efektiv i ndërsjellë është proces në të cilin simbole verbale (p.sh. fjalë, fjali) dhe simbole joverbale (p.sh. pozë e trupit, shprehje në fytyrë) ndahen dhe kuptohen nga njerëzit në mënyrë përkatëse. Komunikimi efektiv i ndërsjellë nënkupton kombinimin e shkathtësive të ndryshme, siç janë: dëgjimi aktiv, komunikimi joverbal, aftësi për të dalluar emocionet personale dhe emocionet e individit me të cilin komunikojmë, të kuptuarit e situatës/kontekstit në të cilin ndodhë komunikimi, etj.

### ***Aktivitet:***

#### ***Dëgjim aktiv (15 min.)***

Nxënësit ndahen në çifte dhe duhet të merren vesh mes vete se kush do të jetë oratori i parë, e kush dëgjuesi. Mësimdhënësi, të dy anëtarëve të çiftit u jep listë me tema për bisedë (Fletë pune 2.2). Njëri anëtar i çiftit duhet të flasë dy minuta për temat që gjenden në listë, derisa, nga ana tjetër, tjetri e dëgjon. Pas përfundimit të dy minutave, dëgjuesi duhet ta përsërisë atë që është thënë, ndërsa oratori mund ta përmirësojë dhe ta plotësojë. Më pas, i ndërrojnë rolet dhe e përsërisin aktivitetin.



Pas përfundimit vijon diskutimi në grup për problemet komunikuese me të cilat janë përballur, si për shembull: mosdëgjim deri në fund, përdorim të fjalorit të ndryshëm, situatë e pakëndshme për të diskutuar për disa gjëra të caktuara, miratim të parakohshëm të konstatimeve, bërje të supozimeve, injorim, etj.

Mësimdhënësi sqaron se nëse analizohet një komunikim i përditshëm verbal, mund të konstatohet se ai rrallë është në formë të dialogut në të cilin në mënyrë të njëpasnjëshme shprehen oratori dhe dëgjuesi. Fjalitë nuk janë gjithmonë të shprehura tërësisht, dëgjuesit ndërpresin dhe parashtrojnë pyetje, plotësojnë komente të tyre dhe i mbarojnë fjalitë e oratorit, temat ndryshohen vazhdimisht, ajo që nuk është shprehur deri në fund mundet, gjithashtu, të transmetojë porosi si ajo që është thënë me fjalë. Megjithatë, këto karakteristika jo gjithmonë do të thonë se komunikimi është joefektiv.

Komunikimi efektiv nënkupton se kuptimi është transmetuar dhe kuptuar në mënyrë përkatëse. Për këtë qëllim, dëgjuesi është mirë të: 1) përdorë shenja joverbale që shprehin interesimin dhe kujdesin për atë që është thënë (p.sh. lëkundje të kokës në formë miratimi, mbajtje të kontaktit me sytë), (2) e parafrazon atë që është thënë në mënyrë që të kontrollojë nëse është kuptuar, (3) përdorë fjalë që bëjnë të ditur për mirëkuptim (p.sh. "Po", "Kuptoj", "Gjithsesi" etj.). Nxënësit nxiten që të mendojnë se sa do t'i kishin përdorur ata vetë mekanizmat e përmendur gjatë komunikimit (dëgjim aktiv) me bashkënxënësit.

## ***Pjesa përfundimtare e orës dhe reflektim (15 min.)***

### **Aktivitet:**

#### ***Plani im për komunikim më të mirë***

Mësimdhënësi e vizaton në tabelë (ose e paraqet me projektor Tabelën 4) dhe kërkon nga nxënësit, secili për vete, të mendojë dhe të shënojë në fletore se cila prej mënyrave të komunikimit (verbal/joverbal/digjital/me shkrim/gojor/të tërthortë/të drejtpërdrejtë, etj.) zakonisht i përdorë gjatë komunikimit me individë të ndryshëm dhe grupe nga rrethina e tij. Secili prej nxënësve duhet edhe ta vlerësojë efektivitetin e komunikimit, në bazë të njohurive për atë se çfarë komunikimi efektiv dhe të planifikojë se si mund ta përmirësojë shkëmbimin e informacioneve dhe mirëkuptimin e ndërsjellë me grupe/individë të ndryshëm.

Tabela 4. Plan për komunikim më të mirë

Si komunikoj zakonisht me:	Mënyra/efektiviteti	Si të përmirësoj komunikimin?
Miqtë		
Anëtarët e familjes		
Mësimdhënësit/kuadrin mësimdhënës		
Përfaqësuesit e institucioneve në nivel lokal dhe kombëtar		
Individ ose grup tjetër të rëndësishëm		



## ***Fletë pune 2.2***

### ***Dëgjim aktiv***

Hidhërohem kur. \_\_\_\_\_

I shmangem \_\_\_\_\_

Do të doja \_\_\_\_\_

Më vjen keq kur \_\_\_\_\_

Dua të mësoj më shumë \_\_\_\_\_

Më së shumti shqetësohem kur \_\_\_\_\_

Brengosempër \_\_\_\_\_

Gëzohem kur \_\_\_\_\_

## ***Përmbajtja: Shqyrtim i pikëpamjeve dhe qëndrimeve të ndryshme***



### ***Rezultate nga nxënia:***

Nxënësi dallon **pikëpamje** të ndryshme për çështje të rëndësishme shoqërore dhe respekton **qëndrimet** që janë të ndryshme nga qëndrimet e tij /saj.



### ***Standarde/tregues për arritje:***

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ argumentojë qëndrime të tij për tema të ndryshme prej fushave të ndryshme,
- ➔ diskutojë pikëpamje të ndryshme për çështje të rëndësishme shoqërore,
- ➔ pranon se ekzistojnë vlera, qëndrime dhe mendime të ndryshme,
- ➔ sqaron se si pikëpamjet e botës i përcaktojnë marrëdhëniet mes njerëzve.



### ***Materialet e nevojshme:***

fleta të letrës, kartela, fleta me pohime, Fletë pune 2.3.



### ***Metoda, teknika, forma:***

diskutim, debat, punë individuale (shprehje e qëndrimeve personale), barometër i qëndrimeve.

## **Pjesa hyrëse e orës (15 min.)**

Mësimdhënësi i paralajmëron nxënësit se orën do ta fillojnë me një aktivitet të shkurtër. Nëse dikush nga nxënësit parashtron pyetje, mësimdhënësi bën të ditur që t'i ndjekin instruksionet ashtu siç secili prej tyre i kupton.

### **Aktivitet:**

#### **Palosje e letrës (10 min.)**

Mësimdhënësi u ndan nxënësve nga një fletë boshe të letrës, më pas i lutë që t'i mbyllin sytë dhe t'i ndjekin instruksionet që ai do t'ua japë.

Instruksione:

hapi 1 – palosni fletën përgjysmë;

hapi 2 – palosni fletën përgjysmë edhe një herë;

hapi 3 – grisni një copë të fletës në këndin e poshtëm të djathtë;

hapi 4 – kthejeni fletën mbrapsht;

hapi 5 – grisni një copë të fletës në këndin e poshtëm të djathtë.

Mësimdhënësi u jep udhëzime nxënësve që t'i çelin sytë, t'i çelin fletët e palosura të letrës dhe t'i ngrej në mënyrë që secili të mund t'i shikojë.

Mësimdhënësi, përmes parashtrimit të pyetjeve si vijon, ofron mundësi që të zhvillohet një diskutim i shkurtër mes nxënësve:

- ➔ Çfarë vëreni? (Pritet që nxënësit të vërejnë se fletët e shumicës së nxënësve janë të ndryshme.)
- ➔ Si u ndjetë kur vërejtët se copa juaj e letrës është më e ndryshme sesa ajo e të tjerëve? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme: disa nga nxënësit është e mundshme të mendojnë se kanë gabuar diçka, disa prej tyre është e mundshme të konstatojnë se përkundër instruksioneve të njëjta ka rezultate të ndryshme, gjë që është në rregull.)
- ➔ A ka menduar dikush nga ju se e ka bërë ushtrimin gabimisht? (Ka mundësi që disa nga nxënësit të përgjigjen në mënyrë pohuese në këtë pyetje. Mësimdhënësi duhet të japë sqarim se nuk ekziston mënyrë e gabuar e ndjekjes së instruksioneve, të gjithë nxënësit kanë kreativitet individual dhe të gjithë kanë rezultat pozitiv nga ndjekja e instruksioneve. Mësimdhënësi duhet të përmbyllë se bukuria është në diversitetet.)
- ➔ Si mund të ketë aq copë të ndryshme të letrës, kur jepja udhëzime të njëjta për të gjithë? (Mësimdhënësi me pyetjet i udhëheqë nxënësit të mendojnë në drejtim të asaj se përkundër udhëzimeve të njëjta nga mësimdhënësi, secili i ka kuptuar ndryshe





instruksionet. Rezultati i kësaj janë fletët e ndryshme, e megjithatë kjo nuk ishte fare gabim ose keq.)

- ➔ Paramendoni se copët e letrave i paraqesin qëndrimet tuaja, çfarë ju flet ushtrimi për qëndrimet e njerëzve? (Mësimdhënësi duhet të theksojë se njerëzit kanë qëndrime të ndryshme për shumë gjëra, por kjo nuk duhet të shikohet si diçka negative. Përkundrazi, qëndrimet e ndryshme na ofrojnë mundësi t'i shikojmë gjërat prej aspekteve të ndryshme.)
- ➔ Pse mund të jetë e dobishme që t'i shikojmë gjërat prej perspektivës së ndryshme? Çfarë mund të mësojmë nga kjo? (Mësimdhënësi duhet t'i nxisë nxënësit që të mendojnë rreth përfitimeve nga perspektivat e ndryshme. P.sh., kur i shikojmë gjëra nga perspektiva e ndryshme kemi mundësi t'i zgjerojmë horizontet, t'i kuptojmë gjërat në mënyrë të ndryshme, të kemi më shumë mirëkuptim për njerëzit që kanë qëndrime më të ndryshe se tonat, etj.).


Në fund të diskutimit, mësimdhënësi, bashkë me nxënësit, bën rezyme se secili ka të drejtë të ketë qëndrim të tij, ndërsa raportet e shëndosha dhe cilësore mes njerëzve nënkuptojnë respektimin e qëndrimeve të huaja, madje edhe atëherë kur ato dallojnë prej tonave..

Pas nxjerrjes së konstatimeve nga aktiviteti dhe diskutimi, mësimdhënësi kalon drejt pjesës së shkurtër teorike:

**Qëndrimi** paraqet raport pozitiv ose negativ ndaj objekteve, situatave dhe personave që përvetësohet përmes përvojës individuale. Njerëzit nuk janë të lindur me qëndrimet e tyre. Ato mësohen dhe përvetësohen në bazë të përvojës, karakteristikave të individit, edukatës, mjedisit dhe shumë faktorëve të tjerë.

**Qëndrimi** mund të manifestohet si prirje për të menduar, ndier dhe vepruar në një mënyrë të caktuar. Struktura psikologjike e qëndrimit përbëhet prej tri komponentëve: kognitiv, emocional dhe veprues. (Foto 5)

**Foto 5. Strukturë psikologjike e qëndrimeve**



Njerëzit në të shumtën e rasteve ndërtojnë qëndrime të tyre për atë që i rrethon dhe për atë që u është e rëndësishme, ndërsa qëndrimet e ndërtuara më tutje ndikojnë në sjelljen e njerëzve dhe e orientojnë atë. Në ndërtimin e qëndrimeve tona ndikojnë shumë faktorë të ndryshëm, p.sh. anëtarët e familjes sonë, shokët tanë, shkollat, mediat, organizatat religjioze, etj. Pikërisht për shkak të kësaj, gjatë ndërtimit të qëndrimeve, duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe t'i kontrollojmë informacionet që i marrim, të tentojmë të arrijmë deri te faktet dhe burimet përkatëse të informacionit. Gjithashtu, gjatë arsyetimit të qëndrimeve dhe pikëpamjeve tona gjithmonë duhet të përdorim argumente dhe fakte.

**Pikëpamjet** i përcaktojmë si mendime, bindje, ide ose mënyra të të menduarit për diçka. Ato janë një mënyrë e caktuar e shqyrtimit ose vlerësimit të gjërave.

## ***Pjesa kryesore e orës (20 min.)***

Para fillimit të aktivitetit, mësimmhënësi përcakton dy pole në klasë ndërmjet të cilave nxënësit mund të lëvizin, me ç'rast në njërin pol vendosë kartelë në të cilën shkruan "Pajtohem", derisa në polin tjetër vendos kartelë në të cilën shkruan "Nuk pajtohem". U jep udhëzime nxënësve për mënyrën në të cilën mund të lëvizin në klasë, në përputhje me **qëndrimet** që do t'u lexohen.

*Shënim:* Si zgjidhje alternative për situata ku hapësira nuk lejon lëvizjen e nxënësve nëpër klasë, mësimmhënësi mund t'u ndajë nxënësve kartela të gjelbra dhe të kuqe. Mësimmhënësi do të jepte udhëzime, sipas të cilave nxënësit, nga vendi ku rrinë, do të duhej të tërheqin njërin prej kartelave. Nëse pajtohen me qëndrimin e përmendur, duhet ta tërheqin kartelën e gjelbër, e nëse nuk pajtohen me qëndrimin, kartelën e kuqe.

### **Aktivitet:**

#### ***Barometër i qëndrimeve***

Mësimmhënësi u jep udhëzim nxënësve që të qëndrojnë në midisin mes dy poleve në të cilat janë vendosur kartelat "Pajtohem" dhe "Nuk pajtohem". Pasi që mësimmhënësi do të lexojë një pohim të caktuar, nxënësit marrin qëndrim dhe pozicionohen në njërin prej dy poleve, me ç'rast formohen dy grupe të nxënësve.

#### **Propozim pohime:**

- ➔ Rrjetet sociale më shumë bëjnë dëm sesa dobi.
- ➔ Nuk do të duhet të ekzistojnë gara sportive "femërore" dhe "mashkullore".





- ➔ Arsimi i mesëm profesional në Republikën e Maqedonisë së Veriut i përgatitë mirë nxënësit për punësim.
- ➔ Kopshtet zoologjike duhet të ndalohen.
- ➔ Mbajtja e uniformës duhet të jetë e detyrueshme..

Pas leximit të disa prej pohimeve, nxënësit duhet të marrin pozicion në barometrin, me ç'rast pritët të formojnë dy grupe që (nuk) pajtohen me pohimin e lexuar. Mësimdhënësi fton vullnetarë nga të dyja anët e barometrit që t'i sqarojnë pozicionet e tyre, me çka nxënësve u mundësohet t'i argumentojnë qëndrimet e tyre dhe t'i dallojnë pikëpamjet e huaja. Gjatë shprehjes së **qëndrimeve**, mësimdhënësi thekson se të gjithë duhet doemos t'i respektojnë **qëndrimet e huaja** dhe t'i dëgjojnë bashkënxënësit pa ndërprerje. Pasi që nxënësit do t'i dëgjojnë argumentet e bashkënxënësit nga grupi i kundërt, kanë edhe mundësi ta ndryshojnë pozicionin e tyre nëse e kanë ndryshuar qëndrimin e tyre.

## ***Pjesë përfundimtare e orës (5 min.)***

Mësimdhënësi bën përmbledhje se është shumë e rëndësishme që nxënësit t'i ndërtojnë me kujdes **qëndrimet e tyre** dhe të jenë të aftë t'i argumentojnë përmes përdorimit të fakteve. Në mënyrë që të formojnë **qëndrime** të qëndrueshme, është e domosdoshme që nxënësit të lexojnë rregullisht, të informohen për zhvillimet në mjedisin e tyre nga burimet përkatëse, t'i "filtrojnë" me kujdes informacionet që janë plasuar në media dhe në rrjetet sociale, dhe, pas një kohe të caktuar, të ndërtojnë **qëndrim** të cilin do të mund ta argumentojnë në mënyrë racionale dhe objektive. Gjithashtu, është me rëndësi që nxënësit t'i dëgjojnë **qëndrimet** dhe **pikëpamjet** e huaja pa i gjykuar dhe me respekt.

Mësimdhënësi thekson se nuk është e gabuar fare që të ndryshohen qëndrimet e individëve nëse argumentet e bashkëbiseduesit janë më të fuqishme dhe e kanë bindur individin në atë. Përkundrazi, është krejtësisht normale dhe e shëndoshë që të ndryshohen qëndrimet kur individit do të marrë informacione të reja.

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)***

Mësimdhënësi u ndan nxënësve listë për vetënotim (Fletë pune 2.3) përmes të cilës do të marrë përshtypje për efektet dhe rezultatet e arritura gjatë orës.





## Fletë pune 2.3

### Shkalla deskriptive për vetënotim

	Pajtohem tërësisht	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem fare
Në orë përvetësova dituri të reja që konsideroj se do të më shërbejnë në jetë.			
Kisha mundësinë që ta shpreh qëndrimin personal në tema të ndryshme.			
Në orë kisha mundësinë që t'i njoftoj më mirë bashkënxënësit e mi përmes shprehjes së qëndrimeve të tyre në tema të caktuara.			
I mësoj më lehtë përmbajtjet mësimore që i përpunojmë me këtë lloj të orëve.			
Në orë ndjehesha këndshëm.			

## **Përmbajtja: Shqyrtim i pikëpamjeve dhe qëndrimeve të ndryshme**



### **Rezultate nga nxënia:**

Nxënësi dallon **pikëpamje** të ndryshme për çështje të rëndësishme shoqërore dhe respekton **qëndrimet** që janë të ndryshme nga qëndrimet e tij /saj.



### **Standarde/tregues për arritje:**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ argumentojë qëndrime të tij për tema të ndryshme nga fusha të ndryshme,
- ➔ diskutojë pikëpamje të ndryshme për çështje të rëndësishme shoqërore,
- ➔ pranojë se ekzistojnë vlera, qëndrime dhe mendime të ndryshme,
- ➔ sqarojë se si pikëpamjet e botës i përcaktojnë raportet mes njerëzve.



### **Materialet e nevojshme:**

fletë, lapsa kimik, *Fletë pune 2.4.*



### **Metoda, teknika, forma:**

diskutim në grup, punë në grup, prezantim

## Pjesa hyrëse e orës (15 min.)

### Aktivitet:

#### Poza

Nxënësit janë ulur në rreth. Në mes të rrethit, dy nxënës vullnetarë pozicionohen në pozë të çuditshme/të pazakonshme (duarkryq, të kthyer me shpinë). Nxënësit kanë për detyrë me një deri dy fjali të shkruajnë se çfarë shohin para vetes. Secili prej nxënësve e ndan **pikëpamjen** e tij për atë që e shikon para vetes.

*Shënim:* Si zgjidhje alternative për situata ku hapësira nuk lejon uljen e nxënësve në rreth, ushtrimi i njëjtë mund të realizohet me pozicionimin e vullnetarëve në pjesën qendrore të klasës, me çka do të ishin mundësuar më shumë këndvështrime të ndryshme të pozës së tyre.

Pasi që nxënësit do t'i shkëmbejnë **pikëpamjet** e tyre të ndryshme, mësimitdhënësi fillon diskutim të shkurtër përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Çfarë mendoni, pse **pikëpamja** juaj është më e ndryshme sesa ajo e të tjerëve? (Pasi që t'i dëgjojë përgjigjet e nxënësve, mësimitdhënësi duhet të theksojë se është shumë normale që individë të ndryshëm të kenë **pikëpamje** dhe **qëndrime** të ndryshme. Kjo nuk duhet t'i largojë dhe tjetërsojë, por përkundrazi, t'i afrojë. **Pikëpamjet** dhe **qëndrimet** e ndryshme janë interesante meqë mundësojnë të zhvillohet diskutim.)
- ➔ A mund të pranoni se edhe **pikëpamjet** e huaja janë të sakta? (Nga nxënësit pritet të përgjigjen se gjërat mund të shikohen nga aspekti dhe perspektiva personale)
- ➔ A është e mundshme **pikëpamjet** e secilit prej jush të jenë të sakta? (Është e mundshme që nxënësit të japin përgjigje të ndryshme. Mësimitdhënësi duhet të nxjerrë konstatimin se secili mund të japë arsyetim për **pikëpamjen** e tij nëse e argumenton mirë, gjithsesi se mund të pranohen **qëndrime** dhe **pikëpamje** të ndryshme si të sakta).
- ➔ Çfarë na tregon ushtrimi? (Nga nxënësit pritet të përgjigjen se ushtrimi vërteton se sa më shumë njerëz, aq më shumë **qëndrime** dhe **pikëpamje** të ndryshme ekzistojnë për një gjë të njëjtë. Njerëzit i shikojnë gjërat prej perspektivave të ndryshme dhe kanë perceptime të ndryshme për të njëjtat. Mësimitdhënësi thekson se nxënësit duhet të jenë të vetëdijshëm për gjithë këtë dhe ta pranojnë faktin se **qëndrimet** që dallohen nga ato të tyre nuk janë **qëndrime të gabuara**).

Në fund të ushtrimit, mësimitdhënësi rrumbullakon se jemi të vetëdijshëm se secili prej nesh ka perceptim dhe interpretim të ndryshëm të gjërave. Nëse pranojmë se të gjitha dukuritë dhe proceset mund të shikohen nga aspekti personal, do të kuptojmë se ekzistojnë shumë **qëndrime** dhe **pikëpamje**. Në këtë mënyrë mund t'i pranojmë dhe kuptojmë **qëndrimet dhe pikëpamjet** e ndryshme të njerëzve, e njëherësh t'i sqarojmë **qëndrimet dhe pikëpamjet** tona, në mënyrë të argumentuar dhe me fakte.

## ***Pjesa kryesore e orës (25 min.)***

### **Aktivitet:**

#### ***Formim i qëndrimit për një temë të caktuar dhe diskutim në grup***

Mësimitdhënësi i ndan nxënësit në katër grupe. Secili grup përcakton një anëtar që do ta lexojë tekstin me zë para anëtarëve të tjerë të grupit. Tekstet kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme shoqërore për të cilat nxënësit do të duhet të diskutojnë në grup dhe të marrin **qëndrim** grupor që do ta prezantojnë para nxënësve të tjerë. Gjatë prezantimit të qëndrimit grupor dhe përgjigjes së pyetjeve dhe komenteve të mundshme nga grupet tjera, nxënësit duhet ta bëjnë këtë në mënyrë të argumentuar dhe me fakte. Koha për diskutim në grup është 7-8 minuta. Mësimitdhënësi i ndan tekstet e secilit prej grupeve (Fletë pune 2.4) dhe jep udhëzime për diskutim në grup.

Pas përfundimit të diskutimit në grup, nga një nxënës nga secili grup e lexon tekstin dhe e prezanton **qëndrimin** që e ka marrë grupi i tij në raport me problemin shoqëror që e përfaqëson. Nxënësit e grupeve të tjera kanë mundësinë ta ndajnë mendimin e tyre, nëse kanë qëndrim të ndryshëm, si dhe të parashtrojnë pyetje deri te grupi që prezanton. Mësimitdhënësi thekson vazhdimisht se nxënësit duhet të dëgjojnë njëri-tjetrin dhe t'i argumentojnë **qëndrimet**.

Në fund të diskutimit, mësimitdhënësi bën përmbledhje se është shumë e rëndësishme që nxënësit të diskutojnë **pikëpamje** të ndryshme për çështje të rëndësishme shoqërore dhe të ndërtojnë **qëndrim** për të njëjtat.

## ***Pjesë përfundimtare e orës (2 min.)***

Në fund të orës, mësuesi nxjerrë konstatim nga aktivitetet e deritanishme:

Qëndrimet e njerëzve formohen nën ndikimin e faktorëve të shumtë: grupet të cilave u takojnë, përvojat personale dhe informacionet të cilat i kanë në dispozicion gjatë krijimit të qëndrimeve, motiveve dhe karakteristikave të individit. Dituria që posedojmë ndikon në atë që do ta pranojmë si pozicionin e yni, çfarë do të jetë e pranueshme për ne, e çfarë jo. Përmes procesit të njëjtë kalojmë të gjithë njerëzit që na mundëson shkëmbim të qëndrimeve, ideve dhe pikëpamjeve të ndryshme. Kjo ka ndikuar në mënyrë plotësuese në zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë, për shkak se shpie drejt mënyrave të reja dhe kreative për zgjidhjen e problemeve ekzistuese. Megjithatë, procesi i krijimit të qëndrimeve është shumë i ndërlikuar, kështu që nuk mund të flasim për "recetë" universale për formimin e qëndrimeve, meqë njerëzit janë shumë të ndërlikuar dhe shumë të ndryshëm.

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (3 min.)***

Mësuesi i udhëzon nxënësit të mendojnë për aktivitetin paraprak ku kishin diskutim në grupe dhe nxitën diskutim rreth pyetjeve si vijon:

- ➔ Si i formuat qëndrimet në nivel të grupit që i prezantuat para gjithë paraleles?
- ➔ A kishte dallime në qëndrimet mes anëtarëve të grupit? Si i tejkaluat?
- ➔ Sa ndikuan argumentet e të tjerëve në qëndrimet tuaj dhe ju bindën që t'i ndryshoni? Në çfarë mënyre kanë ndikuar?
- ➔ Çfarë do t'ju bindte që ta ndryshoni qëndrimin në ndonjë temë për të cilën keni qëndrim shumë më të fortë?



## Fletë pune 2.4

### Tema për diskutim në grup

#### **Pastrehë dhe varfëri**

I/ePastreh dhe varfëria janë probleme shoqërore botërore. Sipas Habitat for Humanity, një e katërta e popullatës botërore jeton në kushte që janë të dëmshme për shëndetin dhe sigurinë e tyre. Shumë prej tyre nuk kanë “kulm mbi kokë” që është e drejta themelore e njeriut për mbijetesë dhe nevojë ekzistenciale. Kjo çështje sociale drejtpërdrejtë prek më shumë se 25 % të popullatës. Për shkak të mungesës së strehimoreve (shtëpive) për këtë popullatë të rrezikuar, nën presion të madh janë qeveritë dhe programet sociale, duke përfshirë edhe sistemet arsimore dhe shëndetësore. Problem plotësues në botë është ajo se në botë ekziston shpërndarje e pabarabartë e pasurisë, që shkon në favor të një grupi të vogël të njerëzve të fuqishëm.

#### Udhëzime për diskutim në grup:

- ➔ Çfarë mendoni, kush ka përgjegjësi më të madhe për varfërinë, individët ose shtetet?
- ➔ Pse janë nën presion qeveritë, sistemet arsimore dhe shëndetësore?
- ➔ Si do të mund të përballëshim me varfërinë dhe mungesën e strehës?

#### **Ndryshime klimatike**

Ndryshimet klimatike janë kërcënim për gjithë botën dhe ndikojnë në gjithë popullatën botërore, për shkak të cilës arsye dallohen si një nga sfidat më serioze për gjithë botën (njerëzit, rrethina njerëzore, dhe ekonomitë). „Bashkësia e shkencëtarëve të brengosur” e quan këtë çështje sociale “njërin prej problemeve më të rrezikshme me të cilat ndonjëherë është përballur njerëzimi”. Tetëqind milionë njerëz të cilët tashmë jetojnë në varfëri të skajshme, më së shumti do të preken nga ndryshimet klimatike në dekadat e ardhshme. Në mbarë botën, njerëzit do të jenë më së shumti të prekur nga ndryshimet klimatike në dekadat e ardhshme. Në mbarë botën, njerëzit tashmë vërejnë dimra më të ngrohtë, vera shumë të ngrohta, reshje të shiut dhe zjarre më të shpeshta. Këto probleme tashmë ndikojnë në qeveritë dhe sistemet në shumë vende, ndërsa humbjet ekonomike të shkaktuar nga fatkeqësitë dhe katastrofat e shkaktuara nga moti janë rritur dukshëm viteve të fundit.

#### Udhëzime për diskutim në grup:

- ➔ Pse ndryshimet klimatike përkufizohen si sfida sociale?
- ➔ Si mund të përballen shtetet me efektet negative nga ndryshimet klimatike?
- ➔ Çfarë do të mund të bënin individët për parandalimin e efekteve negative nga ndryshimet klimatike?

## **Mbipopullim**

Ashtu siç rritet popullata në botë, resurset bëhen gjithnjë e më të rralla. Kombet e Bashkuara raportojnë se popullata e tanishme prej 7,7 miliard njerëzve pritet të rritet në dekadat e ardhshme, me projeksionin prej 8,5 miliardë njerëz deri në vitin 2030. Zonat me rritje më të shpejtë në botë, siç janë Afrika subsahariane, shpesh përballen me resurse tashmë të kufizuara si për shembull, truall për kultivimin e kulturave bujqësore. Meqë numri i popullatës rritet më shumë sesa që mund të përballojë planeti Tokë, njerëzit ndoshta do të duhet të shpërngulen në vend tjetër në mënyrë që t'i shmangen urisë dhe mbetjes të pastrehë.

### **Udhëzime për diskutim në grup:**

- ➔ Çfarë mendoni për tezën se Toka nuk do të mund të përballojë mbipopullimin e njerëzve dhe se ata do të duhet të shpërngulen në ndonjë vend tjetër në mënyrë që t'i shmangen urisë?
- ➔ Çfarë do të mund të bënin shtetet në mënyrë që të përballen me mbipopullimin?
- ➔ Si do të mund të përfshiheshin individët në zgjidhjen e këtij problemi?

## **Të drejta të njeriut dhe pabarazi gjinore**

Në R. e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë dallime të konsiderueshme në aspekt të kohës që burrat dhe gratë e kalojnë në aktivitete shtëpiake (p.sh. mirëmbajtje të shtëpisë, përgatitje të ushqimit, përkujdesje për fëmijët dhe personat më të moshuar, blerje, riparime). Për shembull, në vitin 2014, burrat kanë kaluar rreth 1 orë në ditë në aktivitete të këtilla, gratë nga qyteti – 3 orë, ndërsa gratë nga fshati 4 orë, pa dallim nëse janë të punësuar formalisht ose të papunë. Kjo do të thotë se gratë një pjesë të madhe të kohës brenda një dite e kalojnë në aktivitete (të papaguara) që kanë të bëjnë me shtëpinë, me çka u zvogëlohet koha që do të mund ta përkushtonin për ushtrimin e ndonjë pune të paguar, arsim, aktivitete kulturore dhe sociale. Kjo krijon pabarazi gjinore në shoqëri dhe pamundëson gratë që në mënyrë të barabartë të përfshihen në një pjesë të madhe të aktiviteteve shoqërore.

### **Udhëzime për diskutim në grup:**

- ➔ Sipas jush, si mundet një shtet demokratik të luftojë kundër pabarazisë gjinore?
- ➔ Çfarë do të ndërmerrenit ju në mënyrë që të përballeni me sfida të kësaj natyre?
- ➔ Cilat shtete, sipas jush, janë shembuj të mirë për luftë konstruktive kundër pabarazisë gjinore?

## *Përmbajtja: Përkatësi ndaj bashkësisë*



### *Rezultate nga nxënia:*

Nxënësi/nxënësja e vlerëson rëndësinë e **përkatësisë** ndaj **bashkësisë** dhe përfitimet e **bashkësisë** nga individët në ndërtimin e vlerave të përbashkëta.



### *Standarde/tregues për arritje:*

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ përshkruajë rolet e individëve dhe kontributin e tyre ndaj **bashkësisë**,
- ➔ sqarojë rëndësinë e ndjenjës individuale për **përkatësi** ndaj **bashkësive** të ndryshme,
- ➔ diskutojë ndikimin e të tjerëve mbi ndërtimin e **ndjenjës së përkatësisë** ndaj **bashkësisë** më të gjerë.



### *Materialet e nevojshme:*

*Fletë pune 2.5, Fletë pune 2.6, lëmsh leshi*



### *Metoda, teknika, forma:*

diskutim, punë në grup, prezantim, teknikë-rrjetë, teknikë-pozicionim.



## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

### Aktivitet:

#### Pozicionim (10 min.̄u)

Mësimdhënësi u jep udhëzime nxënësve që të qëndrojnë në rreth (ose vijë). Më pas, mësimdhënësi i lexon shprehjet e poshtëpërmendura dhe jep udhëzime për lëvizje një hap para/mbrapa varësisht nga udhëzimet e përmendura në çdo shprehje.

Propozim deklaratave:

1. Nëse jeni femër, bëni një hap para.
2. Nëse keni flokë të zeza, bëni një hap mbrapa.
3. Nëse jeni nxënës, bëni një hap para.
4. Nëse jeni 15 vjeçar, bëni një hap mbrapa.
5. Nëse keni vëlla, bëni një hap para.
6. Nëse jeni religjioz/e, bëni një hap mbrapa.
7. Nëse jeni patriot, bëni një hap para.
8. Nëse jeni anëtar i seksionit të shkollës, bëni një hap mbrapa.
9. Nëse keni udhëtuar jashtë vendbanimit tuaj muajin e fundit, bëni një hap para.
10. Nëse vitin e kaluar keni kaluar me sukses shumë të mirë, bëni një hap mbrapa.
11. Nëse jetoni në shtëpi, bëni një hap para.
12. Nëse jeni i/e dashuruar, bëni një hap mbrapa.
13. Nëse keni qenë i/e trajtuar në mënyrë të padrejtë nga mësimdhënësi, bëni një hap para.
14. Nëse e konsideron veten i/e lumtur, bëni një hap mbrapa.
15. Nëse të ka dëshpëruar shoku/shoqja më i/e mirë, bëni një hap para.

Pas përfundimit të aktivitetit nxënësit ulen në vendet e tyre. Mësimdhënësi parashton pyetje për diskutim:

- ➔ Çfarë vërejtës gjatë aktivitetit? (Pritet që nxënësit të përgjigjen se përmes aktivitetit i kanë njoftuar më mirë bashkënxënësit e tyre dhe ngjashmëritë dhe dallimet mbi baza të ndryshme që i kanë me ta.)
- ➔ A ju shkaktoi pozicionimi sipas deklaratave të ndryshme ndjenjën e përkatësisë ndaj grupeve të caktuara? Nëse po, cilat janë ato grupe? (Pritet që nxënësit të ndahen në grupe të ndryshme të cilave u takojnë dhe me të cilat identifikohen. Mësimdhënësi





thekson se vetë informacioni se kanë ngjashmëri me dikë pritet të krijojë ndjenjën e bashkësisë, gjegjësisht të përkatësisë ndaj grupit.)

- ➔ Si ndjeheni/do të ishit ndier nëse gjatë ndonjërës prej deklaratave mbetët/mbetni vetë, unik dhe të ndryshëm nga të gjithë të tjerët? (Mësimdhënësi orienton nxënësit që të mendojnë se edhe në situatat kur janë unik, kjo nuk është fare e tmerrshme e as e keqe. Përkundrazi, këtë duhet ta shikojnë si origjinalitet dhe veçanti.)

Në fund të diskutimit, mësimdhënësi, bashkë me nxënësit, bën përmbledhje se është shumë e rëndësishme të kuptojmë se të gjithë njerëzit dallojnë mes vete sipas interesave, nevojave, shprehive, shijeve, etj. Nuk ekzistojnë njerëz të cilët janë tërësisht të njëjtë ose nga ana tjetër tërësisht të ndryshëm. Dallimet mes njerëzve janë pasuri dhe mundësojnë zhvillim të shoqërisë.

## ***Pjesa kryesore e orës (25 min.)***

### ***Pjesa teorike (5 min.)***

Njerëzit gjithmonë janë grupuar dhe organizuar në **bashkësi** në mënyrë që t'u lehtësohet jeta. Termi bashkësi nënkupton një grup njerëzish që grupohen mbi baza të ndryshme si për shembull: karakteristika (gjini, moshë, përkatësi etnike), qëllime ose jetë të përbashkët në vendin e njëjtë gjeografik. Siç rritet dhe zhvillohet njeriu, ashtu bëhet pjesë e numrit gjithnjë e më të madh të grupeve shoqërore.

Pikërisht anëtarësimi në grupe të ndryshme shoqërore është me rëndësi të veçantë në ndërtimin e ndjenjës së identitetit. Identiteti social është veçanërisht i rëndësishëm i asaj që do të thotë të jesh njeri. Grupet më të rëndësishme shoqërore të cilat kanë ndikim të veçantë në ndërtimin e identitetit të individit janë familja dhe grupi i moshatarëve. Këta dy faktorë janë kryesorë në procesin e shoqërizimit (socializimit) primar, kur individi i mëson vlerat dhe normat themelore të sjelljes. Më vonë, gjatë shoqërizimit (socializimit) sekondar, në ndërtimin e identitetit social ndikojnë edhe institucionet arsimore, mediat, organizatat religjioze dhe profesionale, etj. Të gjithë këta faktorë ose të a.q. agensë të shoqërizimit (socializimit) ndikojnë në ndërtimin e identitetit të individëve përmes ndërtimit të qëndrimeve, pikëpamjeve, interesave të tyre – me një fjalë, personalitetin e tyre.

Aspekt i rëndësishëm i identitetit të një individi janë rolet që ai i plotëson, e që kontribuojnë në mbijetesën e bashkësive. Njerëzit në një bashkësi bashkëpunojnë dhe jetojnë në marrëdhënie të përhershme të ndërsjella në mënyrë që të mund t'i realizojnë interesat dhe nevojat e përbashkëta

(p.sh. ndarje të resurseve, organizim të punës, etj.). Çdo individ si anëtar i bashkësive ka rolin e tij shoqëror për të cilin pjesëtarët tjerë të bashkësive kanë pritje të caktuara, ndërsa individët përgjegjësi të caktuara. Në mënyrë që të mund t'i ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, njerëzit bashkohen në bashkësi ose grupe shoqërore. Vetëm përmes bashkëpunimit të përbashkët, mbështetjes së ndërsjellë dhe anëtarëve të bashkësisë mund të kontribuojnë për zhvillimin personal, por edhe për zhvillimin e vetë bashkësisë. Respektimi i normave të vendosura në **bashkësi** e siguron mbijetesën e saj, ndërsa sjellja jokomformiste e të rinjve shpesh kontribuon në zhvillimin e vetë **bashkësisë**. Sjellja që del jashtë normave tashmë të vendosura morale është karakteristike për sub-kulturën e të rinjve dhe shpesh sjellë ndryshime, e shpie shoqërinë përpara.

### Aktivitet:

#### **Rendi shtëpiak në një ndërtesë (20 min)**

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe me nga pesë nxënës dhe secili prej grupeve e merr *Fletën e punës 2.5 „Banues”*. Mësimdhënësi sqaron se në fletën e punës janë përshkruar pesë familje që u takojnë kulturave të ndryshme, ndërsa jetojnë në pesë banesat e një ndërtesë të njëjtë. Detyra e secilit grup është që t'i lexojë përshkrimet e familjeve që jetojnë në ndërtesë, dhe më pas, në bazë të tyre, të vendosë rend shtëpiak për atë ndërtesë. Rendi shtëpiak duhet të përmbajë rregulla të qarta me të cilat do të plotësohen nevojat e të gjithë banuesve në ndërtesë, ashtu që cilido nga banuesit nuk do të ndjehet i rrezikuar në aspektin etnik, kulturor, gjuhësor ose çfarëdo aspekti tjetër.

Pas përfundimit të aktiviteteve në grup, përfaqësuesi i secilit grup e lexon rendin shtëpiak. Mësimdhënësi nxitë diskutim përmes parashtrimit të pyetjeve.

- ➔ Si dukej vendosja e rendit shtëpiak në grupin tuaj? A jeni përballur me ndonjë lloj të vështirësive? (Pritet që nxënësit të kenë pasur vështirësi që të përpilojnë rend shtëpiak me të cilin do t'i plotësojnë nevojat dhe interesat e të gjitha familjeve në ndërtesën, duke marrë parasysh atë se shumica kanë stil të ndryshëm të jetës. Në mënyrë që të bëhet rend shtëpiak, nxënësit do të duhej të theksojnë se është e domosdoshme toleranca, bashkëpunimi dhe fleksibiliteti nga të gjithë banuesit në mënyrë që të mund të funksionojnë në një bashkësi.)
- ➔ A do të kishit vështirësi nëse familjet do t'u përkisnin kulturave të njëjta? (Pritet që nxënësit të përgjigjen në mënyrë pohuese në këtë pyetje. Kur bëhet fjalë për krijimin e rendit shtëpiak, vështirësitë më shumë ndodhin si rezultat i nevojave dhe interesave të ndryshëm të familjes për shkak të stilit të jetës, sesa si pjesëtarë të kulturave të ndryshme.)





Mësimdhënësi e përbyll diskutimin me komentën se për të qenë pjesë e një bashkësie, duhet të respektohen disa rregulla të caktuara të sjelljes. Të gjithë së bashku duhet të japin kontribut për zhvillimin e **bashkësisë**, me mbështetje dhe bashkëpunim të ndërsjellë. Kështu anëtarët e bashkësive do të kontribuojnë në zhvillimin e saj, e njëherësh edhe ata individualisht do të kenë një jetë më cilësore dhe do të jenë më të kënaqur.

## ***Pjesë përfundimtare e orës (5 min.)***

Mësimdhënësi i pyet nxënësit se çfarë do të ndodhte nëse do të ishin vozitur në metro në Japoni (ose në cilindo vend tjetër të largët) dhe diku në afërsi të tyre dëgjojnë se si ndonjë njeri i panjohur flet në telefon në gjuhën e tyre amtare. Çfarë do të bënin nxënësit dhe pse? Nxënësit pritët të përgjigjen se do t'i afrohen njeriut dhe do të fillojnë bisedë meqë do ta ndjejnë si të afërt meqë i përkasin kulturës së njëjtë.

Mësimdhënësi duhet t'i nxisë që të mendojnë nëse do të kishin vepruar në mënyrë të njëjtë në vendin në të cilin jetojnë – njerëzve të panjohur t'u drejtohen vetëm për shkak të asaj se e flasin gjuhën e tyre? Pritët që nxënësit të nxjerrin konstatimin se larg nga rrethina personale e jetesës, kur do të takonin dikë "të vetin" do të zgjohet ndjenja e përkatësisë dhe bashkimit.

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)***

### **Aktivitet:**

#### **Rrjeta**

Mësimdhënësi i fton nxënësit të ndalën në rreth për një aktivitet të shkurtër përfundimtar. Në duar mban një lëmshe leshi. Mësimdhënësi jep udhëzime për aktivitetin. Secili e mban pjesën e lëmshtit që ka mbërritur deri te ai, pasi që të deklarojë se cili rol shoqëror në atë moment për të është më i rëndësishëm (p.sh. nxënës/e, sportist/e, aktivist/e etj.) ia jep lëmshtin nxënësit tjetër. Nxënësit mund të deklarojnë vetëm nga një fjali ose fjalë.





Në fund të ushtrimit, leshi ka formuar një rrjetë të gërshetuar që tregon në mënyrë simbolike se sa të gjithë ne jemi të lidhur.

Mësimdhënësi nxitë diskutim të shkurtër:

- ➔ Përveç rolit shoqëror që konsideroni se në këtë moment se është më i rëndësishëm, cilat role të tjera shoqërore i keni? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme: bir/bijë, nxënës/e, shkrimtar/e, debatues/e, etj.)
- ➔ Si kontribuoni ndaj grupit konkret në të cilin ju vendosin rolet? (Përgjigje të pritura nga nxënësit: sillem me respekt, i kryej obligimet, u ndihmoj anëtarëve të tjerë të ekipit, etj.)
- ➔ Në cilin rol shoqëror e shihni veten në të ardhmen? (Pritet nga nxënësit që të japin përgjigje të ndryshme: p.sh. violiniste e suksesshme, baba i dy fëmijëve, inxhinier/e në kompani të suksesshme, etj.)

Në fund të diskutimit, mësimdhënësi kërkon vullnetarë për orën e radhës, disa nxënës që do të duhej të simulojnë një ngjarje nga jeta e grupit të adoleshentëve. Nxënësit do të duhet të shfaqin një socio-dramë me skenarë të përgatitur paraprakisht (Fletë pune 2.6). Mësimdhënësi ua jep nxënësve *Fletën e punës 2.6* që të përgatiten për orën e radhës.



## Fletë pune 2.5

### Banor

---

**Banesa 1** Familja përbëhet prej tre anëtarëve. Babai punon në sektorin privat, ndërsa nëna nuk punon dhe e ruan bijën e mitur. Flet në gjuhën rome, shqipe dhe maqedonase.

---

**Banesa 2** Në këtë banesë jeton një çift i ri martesor. Tashmë tre vite jetojnë në Shkup, ndërsa janë shpërngulur nga Amerika. Gruaja është aktiviste për të drejtat e kafshëve dhe ka dy kanakarë, ndërsa burri është dixhej. E flasin pak gjuhën maqedonase. Kanë shumë miq në qytetin në të cilin jetojnë e të cilët u vijnë shpesh mysafirë.

---

**Banesa 3** Bëhet fjalë për familje bashkëkohore prej katër anëtarëve. Prindërit kanë biznes privat, ndërsa të birin trevjeçar dhe të bijën pesëvjeçare ua ruan dadoja. Familja është religjioze, ata janë katolikë. Prindërit shumë shpesh mungojnë nga shtëpia për shkak të biznesit familjar. Flasin gjuhën maqedonase.

---

**Banesa 4** Burrë e grua të moshës rreth 70 vjeç jetojnë vetë. Një herë në javë bëjnë drekë familjare për fëmijët dhe nipërit e tyre. Janë të krishterë ortodoks. Flasin gjuhën serbe.

---

**Banesa 5** Në këtë banesë jeton një familje me pesë anëtarë. Prindërit punojnë në administratë shtetërore dhe kanë tre fëmijë (dy janë studentë dhe njëra shkollare). Djali studion në Fakultetin e artit të muzikës dhe interpreton në violinë, vajza më e madhe ka diplomuar dhe merret me kompjuterë dhe IT teknologji, ndërsa vajza më e vogël është në vitin e dytë të shkollës së mesme profesionale. Janë ateistë. Flasin gjuhën shqipe dhe maqedonase.

---

## Fletë pune 2.6

### Socio-Dramë

Socio-drama është shfaqje dramatike në të cilën disa individë aktrojnë sipas skenarit të përgatitur paraprakisht në mënyrë që të prezantojnë një problem ose situatë shoqërore. Socio-drama është teknikë përmes të cilës mësohet dhe ka mundësi që të zgjidhen konflikte të caktuara në marrëdhënie grupore ose kolektive. Ajo është e zhvilluar nga shkencëtari shoqëror Jakob Moreno.

### Skenar

*Socio-drama është simulim i një ngjarjeje nga jeta e përditshme kur një adoleshent është në konflikt me grupin e tij të moshatarëve meqë në Instagram ka publikuar përmbajtje nacionaliste.*

Tino është nxënës në vitin e dytë, gjimnaz. Ka katër shokë më të ngushtë me të cilët çdo ditë e kalon kohën e tij të lirë. Shumë shpesh flet për tema politike që moshatarëve të tij nuk u janë interesante fare. Shpesh shpërndanë edhe qëndrime nacionaliste në Instagram, që nuk është e pranueshme për moshatarët e tij të cilët ndonjëherë e injorojnë, ndonjëherë i kundërvihen, por në të shumtën e rasteve e tolerojnë. Një ditë Tino vëren se të katër shokët e tij kanë ndërprerë ndjekjen e tij në Instagram. Tino është shqetësuar shumë. Ka provuar t'i kërkojë në telefon, askush nuk i është lajmëruar. Kur ka ardhur në shkollë, të gjithë shokët e kanë anashkaluar. Kur ka kërkuar sqarim, ata i kanë thënë se ndjejnë presion dhe nervozë kur janë në praninë e tij meqë vazhdimisht imponon tema që për ta nuk janë interesante, ndërsa edhe shumë shpesh ato komente dinë të jenë ofenduese për disa nga shokët e tij

Tino: Ç'kemi vëllaçko. (I drejtohet Bojanit, njëri prej shokëve të tij të ngushtë)

Bojan: Ç'kemi.

Tino: Të kërkoja, çfarë ka?

Bojan: (E injoron dhe largohet në shoqëri të tre shokëve tjerë.)

Shokët: (Rrinë në grup dhe e injorojnë.)

Tino: (U afrohet shokëve dhe kërkon sqarim për sjelljen e tyre të palogjikshme.) A mund të më sqaroni se çfarë po ndodh? Kam bërë diçka?

Bojan: Tashmë një kohë më të gjatë jemi duke menduar se si të të tregojmë. Mendojmë se ndonjëherë e tepron me qëndrimet tuaja "ultrapatriotike".

Ilir: Më fal që të injoruam këtë periudhë, por disa herë di të ofendosh, ndërsa as që je i vetëdijshëm se çfarë shkakton me qëndrimet tuaja.

Vildan: Po, më fal edhe prej meje që të injoruam. Të gjithë e duam vendin, por kjo nuk do të thotë se do t'i ofendojmë dhe nënçmojmë ata që janë të ndryshëm nga ne. Kjo që je duke e bërë tashmë një kohë të gjatë na vjen rëndë.

Tino: Me siguri keni të drejtë. Ju lutem të më falni për të gjitha ofendimet dhe situatat që ua kam imponuar. Tani e tutje do ta anashkalojë atë temë. Nuk mund ta paramendoj jetën pa ju. Nga ky moment do të ndryshoj. Premtoj.

Të gjithë janë përshëndetur me përshëndetjen e tyre interne dhe kanë shkuar në orë.



## Përmbajtja: Përkatësia ndaj bashkësisë



### Rezultate nga nxënia:

Nxënësi/Nxënësja e vlerëson rëndësinë e përkatësisë ndaj bashkësisë dhe përfitimet e bashkësisë nga individët në ndërtimin e vlerave të përbashkëta.



### Standarde/tregues për arritje:

Nxënësi/nxënësja mund të:

- sqarojë rëndësinë e ndjenjës individuale për **përkatësi** ndaj **bashkësive** të ndryshme,
- diskutojë ndikimin e të tjerëve në ndërtimin e **ndjenjës** së **përkatësisë** ndaj **bashkësisë** më të gjerë,
- promovojë vlerat e **përkatësisë** ndaj shtetit të tij/saj (**patriotizëm**) dhe ndaj botës (**kozmopolitizëm**).



### Materialet e nevojshme:

kuti për „akuarium“, fletë prej letre, lapsa kimikë



### Metoda, teknika, forma:

punë në grupe, socio-dramë (interpretim i roleve), diskutim, teknikë - akuarium.

## **Pjesa hyrëse e orës (10 min.)**

Mësimdhënësi fillon diskutim të orientuar me nxënësit:

- ➔ Cili prej jush nxënës ndjehet **patriot**? (Pritet që një pjesë e nxënësve të prononcohen si patriotë, kështu që varësisht nga vetë paralelja, mësimdhënësi e udhëheqë diskutimin sipas pyetjeve vijuese.)
- ➔ Mendoni se si është zhvilluar kjo ndjenjë e patriotizmit te ju. Cilët faktorë kanë ndikuar më së shumti? Në cilat situata ndjeheni si patriotë? (Pritet që nxënësit të cilët janë prononcuar si patriotë të deklarojnë se dashuria ndaj atdheut më së shumti u është transmetuar përmes familjes dhe vlerat që i kanë përvetësuar që në shoqërizimin (socializmin) primar. Ata japin shembuj të përvojave dhe përjetimeve personale kur ndjekin gara kombëtare me sukses ndërkombëtar, kur e dëgjojnë himnin, etj.)
- ➔ Mendoni se pse nuk ndjeni dashuri të veçantë ndaj atdheut dhe nuk e përkufizoni veten si patriotë? (Nga nxënësit të cilët nuk kanë zhvilluar ndjenjë patriotike pritet të prononcohen se janë indiferentë, se ndjehen sikur i takojnë gjithë botës, e jo vetëm një shteti, etj.)
- ➔ Si do ta kishit përkufizuar termin **nacionalizëm**? Sipas jush, ku qëndron dallimi mes nacionalizmit dhe patriotizmit? (Pritet nga nxënësit që ta përkufizojnë nacionalizmin si vendosje të kombit personal mbi të tjerët dhe në këtë ta bëjnë të ditur dallimin mes termeve).
- ➔ Si do ta kishit përkufizuar termin **kozmpolitizëm**? (Nga nxënësit pritet që këtë term ta ndërlidhin me bashkimin mes popujve në një nivel më të lartë sesa ndarjet kombëtare, etnike, etj.)

Në fund të diskutimit, mësimdhënësi i nxjerrë përkufizimet e tre termeve si konstatime.

## **Pjesa kryesore e orës (25 min.)**

### **Pjesa teorike (5 min.)**

**Patriotizmi** nënkupton dashuri në kuptimin më të gjerë ndaj atdheut, shtetit, bashkësisë tënde. Patriotizmi nënkupton krenarinë me të arriturat dhe kulturën, karakterin dhe identitetin e të gjithë individëve që e përbëjnë bashkësinë. Njerëzit të cilët deklarohen patriotë e duan vendin e tyre, por nuk i mohojnë kulturat e të tjerëve.

**Nacionalizmi** është ideologji e veprimit shoqëror, politik dhe kulturor që interesat dhe vlerat kombëtare të një kombi të vendosen mbi vlerat tjera qytetare dhe mbi interesat e kombeve

tjera. Njerëzit të cilët deklarohen nacionalistë vendin e tyre e vendosin mbi të gjitha vendet tjera.

**Kozmopolitizëm** është ideja sipas të cilës njerëzit vendosin marrëdhënie pavarësisht nga kufijtë kombëtar, rajonal ose shtetërorë dhe i avancojnë marrëdhëniet e përgjithshme njerëzore. Kozmopolitët angazhohen për bashkim dhe pajtim mes popujve në gjithë botën si tejkallim të ndarjeve kombëtare, ndëretnike dhe të tjera. Ky është qëndrim, sipas të cilit, të gjithë njerëzit janë (para së gjithash) "qytetarë të botës", e jo pjesëtarë të kolektiveve të ndryshme si bashkësi lokale, rajonale, kombëtare dhe të tjera.

Kozmopolitizmi nuk është në konflikt me patriotizmin meqë dashuria ndaj vendit të tij nuk e pengon individin që të angazhohet për bashkim dhe pajtim mes popujve në botë. Megjithatë, kozmopolitizmi është e kundërta e nacionalizmit meqë një individ nuk mund ta vendosë vendin/kombin e tij në pozicion superior mbi të gjithë të tjerët për arsye se bie ndesh me parimet e kozmopolitizmit të cilat angazhohen për bashkim mes popujve.

### **Aktivitet:**

#### **Socio-Dramë (20 min.)**

Mësimdhënësi në orën paraprake ka përzgjedhur vullnetarë që do të donin të marrin pjesë në realizimin e socio-dramës së shkurtër dhe u jep skenar. Socio-drama zgjatë 5-6 minuta në mënyrë që të mbetet më shumë kohë për diskutim dhe mundësi që nxënësit t'i shprehin mendimet e tyre. Socio-drama është simulim i një ngjarjeje nga jeta e përditshme kur një adoleshent është në konflikt me shokët e tij për shkak të qëndrimeve të tij nacionaliste.

Mësimdhënësi udhëheq diskutimin me nxënësit me ndihmën e pyetjeve si vijon:

- ➔ Si ndjeheshit derisa po e ndiqnit socio-dramën? (Pritet që nxënësit të deklarohen se janë ndier të tendosur, të habitur, të frymëzuar).
- ➔ Sa ju duket reale situata në socio-dramën? A keni pasur ndonjë përvojë të këtillë ose të ndërlidhur me këtë? (Pritet që nxënësit të ndajnë përvoja të ndryshme që kanë të bëjnë me shprehjen e qëndrimeve nacionaliste.)
- ➔ Si do të vepronit nëse do të ishit në vendin e njeriut të ri që përfaqëson qëndrime nacionaliste? (Pritet që nxënësit të kenë përgjigje të ndryshme: do të kërkoja sqarim, do të doja të bisedojmë dhe të gjejmë zgjidhje të përbashkët për situatën, nuk do të isha mërziur, do të gjeja shokë të ri).
- ➔ Si do të kishit vepruar nëse do të ishit në vendin e shokëve të tij, të cilët janë ofenduar nga qëndrimet e tij nacionaliste? (Janë të mundshme përgjigje të





ndryshme: do të isha hidhëruar, do të ndërprisja shoqërimin me të, do të doja t'i sqaroj se si ndjehem, do të kërkoja sqarim për qëndrimet.)

- ➔ Si do të mund të parandalonin këta njerëz konflikte të këtilla në të ardhmen në shoqërinë e tyre? (Pritet nga nxënësit të propozojnë qasje të ndryshme: bisedë për arsyet e qëndrimeve, marrëveshje për shpërndarje të kujdeseshme të qëndrimeve në rrjetet sociale, etj.)

## *Pjesa përfundimtare e orës dhe aktivitet për reflektim dhe vlerësima (10 min.)*

### **Aktivitet:**

#### **Akuarium**

Mësimdhënësi i lutë nxënësit që në një copë letër me një fjali të shënojnë se si e kanë përjetuar orën, çfarë u ka pëlqyer, e çfarë jo, a kanë mësuar diçka të re, etj.? Më pas fletët i vendosin në kutinë e përgatitur paraprakisht - AKUARIUM. Mësimdhënësi fillon t'i tërheqë fletët anonime dhe i t'i lexojë me zë, pas çka u jep mundësi nxënësve që t'i ndajnë qëndrimet e tyre për atë që është shkruar.

Kjo **teknikë** i mundëson mësimdhënësit që të vlerësojë realisht nëse duhet të vazhdojë të punojë me dinamikë të tillë ose ndoshta duhet të ndryshohen disa gjëra të caktuara dhe ato të adaptohen sipas nevojave të nxënësve.

## ***Përmbajtja: Humanitet***



### ***Rezultate nga nxënia:***

Nxënësi/nxënësja i ndërlidhë humanitetin, të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare me pozitën e kategorive të rrezikuara të njerëzve dhe angazhohet për respektimin e tyre.



### ***Standarde/tregues për arritje:***

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ sqarojë çfarë është humanitet,
- ➔ numërojë kategori të rrezikuara të njerëzve të cilëve u nevojitet ndihmë humanitare,
- ➔ dallojë nevoja specifike të kategorive të rrezikuara në shoqëri,
- ➔ identifikojë institucionet që u ndihmojnë kategorive të rrezikuara,
- ➔ identifikojë organizatat ndërkombëtare (Kryqi i Kuq, Gjysmëhëna e Kuqe) të cilat ushtrojnë veprimtari humanitare.



### ***Materialet e nevojshme:***

CD-projektor, laptop, tabelë, shkumës, fleta, lapsa kimik.



### ***Metoda, teknika, forma:***

formë frontale e punës, analizë e video-regjistrimit, analizë e situatave, diskutim në grup.

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

Mësimdhënësi paraqet një video-insert të kapshëm në YouTube „*Humanity. Change yourself to a better person*” ([link](#)).

**Shënim:** Nëse nuk ekzistojnë kushte teknike për shikimin e përbashkët të videos në klasë, mësimdhënësi mund ta ndajë në mënyrë elektronike videon me nxënësit, që ta shikojnë para realizimit të orës.

Pas shikimit të videos, nxënësit duhet të përgjigjen individualisht në pyetjet:

- ➔ Çfarë mendoja derisa e shikoja videon?
- ➔ Çfarë ndjeja derisa e shikoja videon?
- ➔ A më nxitë videoja për të bërë ndonjë sjellje të caktuar?

Mësimdhënësi i fton nxënësit të prezantojnë shkurtimisht se çfarë kanë shënuar dhe nxitë diskutim në drejtim të sqarimit të termit humanitet.

Humaniteti paraqet besim në vlerën e jetës njerëzore që nënkupton përkujdesje dhe dhënien e ndihmës për njerëzit tjerë, në mënyrë që të përmirësohet njerëzimi dhe të jetë më i moralshëm dhe më jovetjak.

Veprimi i humanistëve dhe organizatave humanitare është i lidhur ngushtë me të drejtat dhe liritë e njeriut. Pikënisja themelore për veprimin e tyre është “Deklarata universale e të drejtave dhe lirive të njeriut”.

## Pjesa kryesore e orës (25 min.)

Mënyrat e veprimit humanitar që janë karakteristike sot, kanë marrë formën e tyre me “Konventën e parë të Gjenevës” dhe formimin e organizatës së Kryqit të Kuq nga mesi i shekullit 19-të. Si përgjigje sistemore e situatave të krizës, veprimi humanitar përfshin adresimin/përgjigjen e nevojave të personave të cilët janë të prekur nga konflikti, katastrofat natyrore, epidemia dhe uria. Në këto gjendje të krizës, fokusi i veprimit humanitar është në përmbushjen e nevojave themelore ose të drejtpërdrejta për ndihmë dhe mbrojtje. Megjithatë, organizatat humanitare nuk veprojnë vetëm në kushte të krizës por edhe për çdo ditë ndihmojnë në sigurimin e jetës më të mirë për kategoritë e rrezikuara dhe marginalizuara të njerëzve që ekzistojnë në secilin shtet. Qëllimi i tyre është trajtimi i barabartë i të gjithë njerëzve dhe parandalimin e vuajtjeve, pa marrë parasysh situatën jetësore në të cilën gjenden disa individë të caktuar. Ata, gjithashtu, promovojnë mirëkuptim të ndërsjellë, bashkëpunim, miqësi dhe paqe mes popujve dhe shteteve.

## Aktivitet:

### Grupe të rrezikuara

„Paramendoni se jeni persona të cilët kanë përjetuar katastrofë natyrore – tërmet. Keni qenë të detyruar t’i braktisni shtëpitë tuaja dhe të vendoseni në strehimore të përkohshme. Ende nuk e dini se kur dhe nëse do të mund të ktheheni në shtëpitë tuaja. Jeni të brengosur dhe frikësuar”.

Secili prej grupeve duhet të mendojë dhe të përgjigjet në pyetjet si vijon (mund të shënohen në tabelë ose të paraqiten me projektor), nga perspektiva e identitetit që u është caktuar:

- ➔ Cilat janë nevojat tuaja në situatën konkrete?
- ➔ Prej çfarë keni frikë? Çfarë ju brengos?
- ➔ Prej kujt pritni ndihmë? Çfarë lloji të ndihmës pritni?

Përgjigje të mundshme për secilin prej grupeve:

**Persona më të moshuar** – dikush t’u dërgojë ushqim dhe ujë, t’u ndihmojë në lëvizje, të kenë qasje deri te mbrojtja shëndetësore);

**Fëmijë** - arsim, kënd për lojëra, kujdes për nevojat themelore (ushqim, siguri), mundësi për ribashkim me familjen (nëse janë të ndarë);

**Gra** – siguri fizike, qasje deri te përkujdesja postnatale, të jenë afër ujit dhe karburantit, mundësi për fitim financiar, të jenë së bashku me fëmijët (nëse i kanë);

**Persona të papunë (joaktiv në aspektin ekonomik)** – qasje deri te të ardhurat, sigurim të produkteve themelore (ushqim, veshje);

**Persona me pengesa fizike** – qasje deri te mbrojtja specifike shëndetësore, aktivitete me bashkësinë për mbështetje të integritit;

**Pakica etnike** – siguri fizike, përfaqësim, informacione të kapshme në gjuhën që e flasin, mundësi përkatëse për praktikimin e religjionit ose aktiviteteve karakteristike për kulturën.

Druajtjet dhe brengat mund të jenë të përbashkëta – frikë nga pasiguria, nga lëndimi i mundshëm i tyre dhe të afërmeve të tyre; brengosje nëse do të kthehen në mënyrën paraprake të jetës, nëse do të marrin ndihmë dhe mbrojtje përkatëse.

Ndihma mund të pritët nga institucionet formale në shtet, në nivel lokal (komunë, qendra komunale për përkujdesje sociale, shtëpi shëndetësore, shkolla) dhe nivel qendror (ministritë e punës dhe politikës sociale, e shëndetësisë, e arsimit, etj.). Përveç kësaj, ndihmë mund të pritët prej organizatave të ndryshme humanitare vendore dhe ndërkombëtare.

Mësimdhënësi tregon se grupet e sipërpërmendura janë vetëm një pjesë e grupeve që zakonisht konsiderohen të rrezikuara. Statusi i këtyre varet nga situata konkrete në të cilën gjenden. Megjithatë, në të shumtën e rasteve këto janë grupet që janë në rrezik më të madh nga varfëria dhe përjashtimi social nga popullata e përgjithshme. Pakicat etnike, emigrantët, personat me aftësi të kufizuara, të pastrehët, personat që luftojnë me keqpërdorimin e substancave, personat e moshuar dhe fëmijët e izoluar, shpeshherë përballen me vështirësi që mund të rezultojnë me përjashtim të mëtejshëm social, siç janë niveli i ulët i arsimit dhe/ose papunësia. Grupeve më të rrezikuara u nevojitet mbrojtje e posaçme e të drejtave të tyre, duke marrë parasysh specifikat e tyre fizike dhe psikologjike, në mënyrë që t'u ndihmohet që të përballen më mirë me katastrofa.

Mbrojtje të posaçme, në disa situata të caktuara, nënkupton edhe kornizë të posaçme ligjore për intervenim humanitar. Për këtë qëllim, si rrethanë lehtësuese, për rregullim dhe ndihmë të palëve të prekura, në nivel ndërkombëtar është miratuar dokument juridik i quajtur "E drejtë ndërkombëtare humanitare". Ky sistem i rregullave ka për qëllim që personat të cilët janë në situata të konfliktit të armatosur/okupimit t'i mbrojtë nga shkelja e të drejtave dhe lirive të tyre njerëzore.

Fushat kryesore që janë nën patronazhin e së „Drejtës ndërkombëtare humanitare“ janë:

- ➔ Mbrojtja e personave që nuk kanë marrë pjesë ose më nuk marrin pjesë në luftime;
- ➔ Kufizimi i mjeteve luftarake;
- ➔ Mbrojtja e punëtorëve humanitarë dhe paqësorë në vendet ku ata veprojnë.



## ***Pjesa përfundimtare e orës dhe reflektim (10 min.)***

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të përkujtohen dhe në bazë të asaj që është diskutuar gjatë orës, të mendohen dhe nëse dëshirojnë të ndajë një situatë në të cilën nxënësi vlerëson se ka vepruar në mënyrë humane. Nxënësit duhet të mendohen dhe arsyetojnë pse kanë vepruar në mënyrë të caktuar dhe si janë ndier për shkak të kësaj.

Përveç kësaj, mësimdhënësi jep listë (Fletë pune 2.7) me përshkrime të shkurtra të organizatave dhe institucioneve që kanë mision të veprojnë në mënyrë humanitare. Nxënësit duhet, për orën e radhës, të lexojnë për organizatat/institucionet dhe të detektojnë së paku një organizatë lokale ose kombëtare që merret me veprimtari humanitare dhe të shkruajnë informacione themelore (150-200 fjalë) për punën e saj. (Nxënësit mund të përmendin organizatë formale ose joformale ose nga ana tjetër një individ që vlen si bamirës në mjedisin e tyre)

Informacionet e shënuara i dërgojnë në mënyrë elektronike deri te mësimdhënësi, i cili i kontrollon para orës së radhës.



## Fletë pune 2.7

# Organizata dhe institucione humanitare që kanë veprimtari humanitare në punën e tyre

### Organizatë e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe

Organizata më të mëdha ndërkombëtare humanitare janë organizata e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe Ndërkombëtare. Kjo është një lëvizje humanitare ndërkombëtare me rreth 97 milionë vullnetarë në mbarë botën. Misioni i tyre është mbrojtja e jetës së njeriut, shëndetit, sigurisë dhe dinjitetit të tij, parandalimit të vuajtjes së njeriut dhe diskriminimit të mbështetur në nacionalitetin, racën, religjionin, përkatësinë klasore, bindjen politike.

Si organizatë e paanshme, neutrale dhe e pavarur, misioni zyrtar i Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe Ndërkombëtare është që angazhohen për mbrojtjen e jetës dhe dinjitetit të viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe të brendshme. Detyrat themelore të organizatës janë si vijon:

- të ndiqet harmonizimi i palëve ndërluftuese me Konventën e Gjenevës,
- të organizojë kujdes mjekësor dhe kujdes për ata që janë lënduar në fushëbetejë,
- të mbikëqyrë trajtimin e robërve të luftës,
- të ndihmojë gjatë kërkimit të personave të zhdukur në konflikt të armatosur (shërbim për gjetje),
- të organizohet mbrojtje dhe përkujdesje për popullatën qytetare,
- të arbitrojnë mes palëve ndërluftuese në një konflikt të armatosur.

Parimet në bazë të të cilave udhëhiqen janë:

**Humanitet** – Promovim i mirëkuptimit të ndërsjellë, miqësisë, bashkëpunimit dhe paqes së përhershme mes të gjithë popujve.

**Paanshmëri** – Mosdiskriminim në raport me nacionalitetin, racën, bindjet fetare, mendimet politike ose klasore. Përpjekje që të lehtësohen vuajtjet e individëve, të udhëhequr vetëm nga nevojat e tyre dhe t'u jepet prioritet rasteve më urgjente të problemit.

**Neutralitet** – Lëvizja nuk merr anë në armiqësitë dhe nuk përfshihet në polemika të natyrës politike, racore, fetare ose ideologjike.

**Pavarësi** – Lëvizja është e pavarur. Ndonëse shoqatat kombëtare janë ndihmëse në shërbime humanitare të qeverive të tyre dhe u nënshtrohen ligjeve të vendeve të tyre përkatëse, gjithmonë duhet ta ruajnë autonominë e tyre në mënyrë që të mund të veprojnë në çdo kohë në përputhje me parimet e lëvizjes.

**Shërbim vullnetar** – Kjo është lëvizje vullnetare, jofitimprurëse dhe e panxitur në çfarëdo mënyre nga dëshira për fitim.

**Unitet** – Mund të ketë vetëm një Kryq të Kuq dhe një Gjysmëhënë e Kuqe në cilëndo vend. Organizatat duhet doemos të jenë të hapura për të gjithë dhe ta ushtrojnë punën e tyre humanitare në gjithë territorin e vendit.

**Universalitet** – Të gjitha shoqëritë kanë status të barabartë dhe kanë përgjegjësi dhe detyra të ndihmojnë njëra-tjetrën.

Më shumë informacione: <https://www.icrc.org/en/who-we-are/movement>

### ***Amnesty International (Amnesti Interneshënëll)***

Organizata është themeluar në mënyrë që të luftojë për mbrojtjen e njerëzve nga tortura dhe anulimin e dënimit me vdekje. Veprimtaria e tyre gjatë viteve është zgjeruar në tema të ndryshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut nëpër botë. Një pjesë e temave në të cilat punojnë janë:

- ➔ Kontrolli i armëve,
- ➔ Dënimi me vdekje,
- ➔ Të drejtat e të burgosurve,
- ➔ Diskriminimi,
- ➔ Personat e zhdukur,
- ➔ Liria e shprehjes,
- ➔ Jetesa dinjitoze,
- ➔ Dhuna policore,
- ➔ Emigrantët, azilkërkuesit, refugjatët.

Më shumë informacione: : <https://www.amnesty.org/en/what-we-do/>

### ***Mjekë pa kufij***

#### ***(Doctors Without Borders/Médecins Sans Frontières (MSF))***

Misioni i organizatës është sigurimi i kujdesit mjekësor për personat të cilëve u nevojitet më së shumti, veçanërisht popullatave që përballen me kriza, viktimat e katastrofave natyrore ose katastrofave të shkaktuara nga njeriu, si dhe viktimat e konflikteve të armatosura. Organizata është themeluar në vitin 1971 dhe ka zyra në 21 vende dhe deri tani ka trajtuar dhjetëra milionë persona në mbarë botën..

Parimet në bazë të të cilave udhëhiqen janë:

- ➔ Të gjithë njerëzit kanë të drejtë për kujdes mjekësor, pa marrë parasysh gjininë, racën, religjionin ose qëndrimet politike, dhe
- ➔ Nevojat e këtyre njerëzve tejkalojnë respektimin e kufijve shtetëror.

Organizata angazhohet për të ofruar kujdesin mjekësor të cilësisë së lartë për të gjithë pacientët në mënyrë të pavarur, neutrale, pa anim.

Më shumë informacione: <https://www.doctorswithoutborders.org/what-we-do>

## **Qendra e Punëve Sociale**

Qendrat e punëve sociale janë në përbërje të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe janë të shpërndara në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Secila prej qendrave i ushtron punët si vijon:

- ➔ zbulon, ndjekë dhe hulumton dukuri dhe probleme sociale,
- ➔ aplikon dhe zbaton forma përkatëse të mbrojtjes sociale dhe drejtpërdrejt ndihmon qytetarët, familjet ose grupet e popullatës,
- ➔ zhvillon punën parandaluese,
- ➔ zhvillon dhe zbaton forma jashtë-institucionale të mbrojtjes sociale,
- ➔ nxitë, organizon aktivitete vullnetare të qytetarëve, shoqatave të tyre, organizatave humanitare, organizatave në zbatimin e programeve për mbrojtje sociale.

Më shumë informacione: [http://www.mtsp.gov.mk/institucii-ns\\_article-centar-za-socijalna-rabota.nsp](http://www.mtsp.gov.mk/institucii-ns_article-centar-za-socijalna-rabota.nsp)

## **Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS)**

MPPS-ja paraqet institucion kryesor që kujdeset për mbrojtjen e kategorive të rrezikuara në shtet. Ofron mbrojtjen e të drejtave të ndryshme, në mesin e të cilave:

- ➔ Ndihma e garantuar minimale,
- ➔ Kompensim për shkak të pengesës/paaftësisë,
- ➔ Kompensim në para për ndihmë dhe kujdes ndaj personave të tjerë,
- ➔ Kompensimi i pagës për orar të shkurtuar të punës (për shkak të kujdesit të fëmijës me pengesa në zhvillim, trupore ose mentale ),
- ➔ Shtesë për strehim,
- ➔ Kompensim i përhershëm,

➔ E drejtë e mbrojtjes shëndetësore.

Krahas kësaj, MPPS-ja i ofron edhe shërbimet si vijon:

- ➔ Shërbime të informimit dhe udhëzimit,
- ➔ Shërbime të ndihmës dhe mbështetjes profesionale,
- ➔ Shërbime të këshillimit,
- ➔ Shërbime në shtëpi,
- ➔ Shërbime në bashkësi,
- ➔ Shërbime për mbrojtje jashtë-familjare.

Më shumë informacione: <http://mtsp.gov.mk/uslugi-i-prava.nsp>

### ***Organizatë lokale ose kombëtare që merret me veprimtari humanitare***

Emri i organizatës: \_\_\_\_\_

Përshkrim i organizatës dhe veprimtarisë: \_\_\_\_\_

## **Përmbajtja: Humanitet**



### **Rezultate nga nxënia:**

Nxënësi/nxënësja i ndërlidhë humanitetin, të drejtat e njeriut dhe të drejtën humanitare ndërkombëtare me pozitën e kategorive të rrezikuara të njerëzve dhe angazhohet për respektimin e tyre.



### **Standarde/tregues për arritje:**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ dallojë nevoja specifike të kategorive të rrezikuara në shoqëri,
- ➔ identifikojë institucionet që u ndihmojnë kategorive të rrezikuara,
- ➔ identifikojë organizatat ndërkombëtare (Kryqi i Kuq, Gjysmëhëna e Kuqe) të cilat ushtrojnë veprimtari humanitare



### **Materialet e nevojshme:**

Fletë pune 2.8, lapsa kimikë (lapsa)



### **Metoda, teknika, forma:**

punë në grupe, stuhi e ideve, prezantim.

## ***Pjesa hyrëse e orës (5 min.)***

Mësimdhënësi bën përmbledhje të detyrave të mbaruara nga nxënësit për organizata humanitare vendore dhe veçon disa që janë më relevante që nxënësit duhet t'i kenë parasysh gjatë përpilimit të aktivitetit të radhës.

## ***Pjesa kryesore e orës (35 min.)***

Gjatë gjithë orës, nxënësit punojnë në grupe në përpilimin e planit operativ për veprimtari humanitare. Secili grup duhet të identifikojë një kategori të caktuar të rrezikuar të qytetarëve në komunë ose në shtetin e tyre, të përshkruajë se ku qëndron ndjeshmëria, të sqarojë se çfarë do të mund të bënin në mënyrë që ta përmirësojnë pozitën e këtij grupi në shoqëri dhe/ose t'i mbrojnë të drejtat e tyre, të përmendë se cilat organizata dhe institucione do të mund të ndihmonin dhe në çfarë mënyre. Grupet duhet ta plotësojnë fletën e punës 2. 8.

Pas plotësimit të fletës së punës, grupet prezantojnë se çfarë kanë bërë dhe cili është plani i tyre i veprimit.

Nëse ka mundësi, rekomandohet që gjatë orës të jetë i ftuar një përfaqësues i një organizate të caktuar humanitare ose institucioni lokal ose shtetëror (MPPS, Sektori për veprimtari sociale në komunë) në mënyrë që t'i udhëzojë nxënësit gjatë realizimit të hapave dhe të ndajë përvoja për mënyrën e veprimit në situata të ndryshme.

## ***Pjesë përfundimtare e orës (5 min.)***

Mësimdhënësi, përmes pyetjeve si vijon kontrollon se çfarë kanë mësuar dhe çfarë shkathtësish kanë përvetësuar:

- ➔ Çfarë ishte më interesante për ju gjatë orës së sotme?
- ➔ Çfarë risie mësuat?
- ➔ Çfarë ishte për ju më e ndërlikuar?
- ➔ Si do t'ju shërbente në jetë ajo që e punuat gjatë orës?



## Fletë pune 2.8

# Plan operativ për veprim humanitar

Përshkrim i kategorisë së rrezikuar të qytetarëve

- ku jetojnë
- shprehi
- vlera
- gjuha

Arsyetim pse i konsideroni kategori të rrezikuara?

---

---

Çfarë mund të bëjmë? (stuhi e ideve)

---

---

Përzgjedhje e aktiviteteve:

---

---

Kush mund të na ndihmojë dhe si?

Organizata humanitare dërkombëtare. \_\_\_\_\_

Organizata (humanitare) lokale.. \_\_\_\_\_

Institucione shtetërore \_\_\_\_\_

Plan për veprim

Detyra sipas ekipeve / personave (Kush/çfarë?)	Korniza kohore (Kur?)	Vlerësim i rreziqeve dhe mënyrave për tejkalim (Çfarë nëse....?)



## *Përmbajtja: Pranim dhe respektim i dallimeve*



### *Rezultate nga nxënia:*

Nxënësi/nxënësja analizon mënyrat e funksionimit të dallimeve në shoqëritë dhe tregon gatishmëri për t'i respektuar ata që janë ndryshe nga vetja.



### *Standarde/tregues për arritje:*

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ rishqyrtojë qëndrimet dhe sjelljet personale në situata konkrete,
- ➔ diskutojë për përfitimet dhe sfidat nga jeta dhe puna në shoqëri me **dallime**,
- ➔ demonstrojë se secili në shoqëri është i rëndësishëm dhe mund t'i **pranojë** njerëzit të cilët janë **ndryshe** nga ai/ajo.



### *Materialet e nevojshme:*

fletë të bardha A4, lapsa kimikë (lapsa)



### *Metoda, teknika, forma:*

punë në çifte, kuis, diskutim, Diagrami i Venit.

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

### Aktivitet:

#### Diagrami i Venit

**Mësimdhënësi** i ndan nxënësit në çifte dhe secilit prej çifteve u jep nga një fletë të bardhë A4. Mësimdhënësi u sqaron nxënësve se detyra e tyre është që në formë të Diagramit të Venit t'i gjejnë ngjashmëritë dhe **dallimet** mes vete. Më pas vullnetarë i lexojnë karakteristikat e Diagramit të Venit para nxënësve të tjerë.

Mësimdhënësi nxitë diskutim të shkurtër me atë që u parashton pyetje nxënësve:

- ➔ Çfarë e kishit më vështirë ta gjeni përmes bisedës, ngjashmëri ose **dallime** mes jush? (Pritet që nxënësit të përgjigjen në mënyrë të ndryshme, varësisht nga përvoja konkrete.)
- ➔ Sa ndikojnë **dallimet** që i detektuat për të ndryshuar mendimin tuaj në raport me atë nxënës/nxënëse? (Nxënësit pritët të shprehen se dallimet që i kanë detektuar e kanë bërë diskutimin më interesant dhe më dinamik dhe se në bazë të karakteristikave që i kanë detektuar përmes diskutimit mund të ndërtohen disa qëndrime të caktuara për nxënësin/nxënësen, por nuk do të thotë se ato qëndrime janë negative, përkundrazi, vetë diskutimi dhe bashkëpunimi zakonisht i bashkon individët.)
- ➔ Sa kontribuojnë ngjashmëritë mes jush që të ndjeheni më të afërt me nxënësin/nxënësen? (Pritet që nxënësit të japin përgjigje pohuese, por edhe të plotësojnë se dallimet nuk ndikojnë fare në largimin, vetë njoftimi i ngjashmërive dhe dallimeve mund të kontribuojnë për afrimin e individëve).

Mësimdhënësi konstaton se të gjithë ne mund të **dallohemi** për shumë gjëra, ashtu siç kemi ngjashmëri. Pikërisht **dallimet** e bëjnë botën më interesante, më dinamike dhe më të bukur.

## Pjesa kryesore e orës (25 min.)

### Aktivitet:

#### **Kuis – Pritjet nga „të tjerët“ (10-15 min.)**

Një nxënës i lexon njëra pas tjetrës historitë për individët A, B dhe C. Pas çdo historie të lexuar, nxënësit tjerë përzgjedhin njëren prej përgjigjeve të ofruara për karakteristikat e personazhit nga historia. Mësimdhënësi në të shumtën e rasteve i shënon përgjigjet e përzgjedhura në tabelë. Në fund, mësimdhënësi i tregon përgjigjet e sakta. Nxënësit duhet të nxiten që të diskutojnë se çfarë i ka shtyrë që t'i përzgjedhin opsionet që i kanë përzgjedhur, si kanë menduar para se t'i përzgjedhin dhe nëse janë të befashuar nga përgjigjet e mirëfillta.

Në fund, nxënësit duhet të përmendin se pse secili prej këtyre individëve është i rëndësishëm për shoqërinë dhe si mund të kontribuojë në zhvillimin e tij. (Për shembull. Individu A të ligjërojë në fakultet në vendin në të cilin është shpërngulur, Individu B të punojë në zhvillimin e sportit dhe frymës sportive, Individu C të bëhet artist përmes nxitjes nga mjedisi.)

#### **Individi A**

**Almira është 35 vjeçe dhe deri para do kohë jetonte në Siri. Por, pasi që në vendin e saj shpërtheu lufta, me familjen e saj vendosën të emigrojnë në Evropën Perëndimore për të gjetur jetë më të mirë.**

Çfarë arsimit ka Almira?

- A. Fillor
- B. Të mesëm
- C. Të lartë
- Ç. Magjistraturë
- D. Doktoraturë

Çfarë ka punuar Almira në Siri?

- A. Ka qenë amvise
- B. Mësuese
- C. Profesoreshë në fakultet
- Ç. Avokate
- D. Fotomodele

**(Përgjigjet e sakta janë D. Doktoraturë dhe C. Profesoreshë në fakultet)**

#### **Individi B**

**Bane është sportist me vite të tëra dhe luan vaterpolo për ekipin e qytetit. Ka shoqërinë e tij me të cilën dëshiron të dalë gjatë fundjavëve, por asnjëherë nuk mbetet pas mesnate për shkak të treningjëve të përditshme.**





Çfarë muzike dëshiron të dëgjojë Bane?

- A. Rep
- B. Turbofolk
- C. Klasike
- Ç. Hevimetal
- D. R'n'B

Cili është ushqimi i preferuar i Banes?

- A. Hamburger
- B. Pastë karabonara
- C. Pica Margaritë
- Ç. Troftë të pjekur në skarë
- D. Doner/Giro

**(Përgjigjet e sakta janë Ç. Hevimetal dhe C. Pica Margarita)**

#### **Individi C**

**Në shkollën fillore në Strugë erdhi një nxënës i ri nga Tajvani. Quhet Vang Vei dhe mban syze.**

Cili është sukcesi i Vang Veit në shkollë?

- A. I pamjaftueshëm
- B. I mjaftueshëm
- C. I mirë
- Ç. Shumë i mirë
- D. I shkëlqyeshëm

Çfarë dëshiron më së shumti të bëjë Vang Vei në kohën e lirë?

- A. Të luajë video-lojëra
- B. Të luajë futboll
- C. Të vizatojë
- Ç. Të notojë
- D. Të lexojë

**(Përgjigjet e sakta janë: C. I mirë dhe C. Të vizatojë)**

Mësimdhënësi konstaton se të gjithë kemi tendencë të miratojmë konstatime për karakteristikat e njerëzve të tjerë, madje edhe kur kemi vetëm pak informacione për ta. Këtë shumë shpesh e bëjmë në mënyrë të pavetëdijshme pa menduar shumë dhe në bazë të përvojave dhe njohjeve tona paraprake të botës dhe njerëzve, roleve të tyre shoqërore, përkatësisë ndaj grupeve, etj. Pritjet tona që i miratojmë për të tjerët në të shumtën e rasteve e përcaktojnë edhe sjelljen tonë ndaj tyre. Nëse i vlerësojmë si më të ngjashëm me ne ose vlerësojmë se i takojnë një grupi të caktuar shoqëror drejt të cilit synojmë, sjellja jonë është më ndryshe, sesa nëse vlerësojmë se janë të ndryshëm prej nesh. Kjo ndodh për shkak se individi, gjatë jetës ka nevojë që ta

thjeshtësojë botën në të cilën jeton në mënyrë që të mund ta kuptojë më lehtë. Për shkak të kësaj, ka tendencë për grupimin e “tjerëve” në kategori, grupe dhe krahasim me ta. Disa kategorive ose grupeve të caktuara u takon edhe vetë individi, derisa në të tjerat nuk bën pjesë.

Për shembull: Mario jeton në Firencë, është tifoz i klubit lokal të futbollit, mëson në shkollën e mesme teknike. Të gjitha këto karakteristika dhe përkatësi e klasifikojnë si anëtar ose pjesëtar të kategorive dhe grupeve të caktuara shoqërore. Me këtë, edhe personat tjerë, të cilët gjithashtu u takojnë grupeve “të tij” i përjeton si më të ngjashëm me veten dhe më të afërt, ndërsa ata që nuk u takojnë (anojnë për ekip tjetër, mësojnë në shkollë tjetër, etj.) si të ndryshëm dhe më të largët.

Kategorizimet e këtylla mes grupeve shoqërore, vetvetiu nuk janë të dëmshme, e as të rrezikshme. Nëse dallimet mes grupeve “tona” dhe “të tjera” bëhen në mënyrë pozitive (për shembull: klasa jonë ka shoqëri më të mirë, klasa tjetër ka sukses më të mirë në shkollë; ne bëjmë filma të mirë, ata bëjnë muzikë të mirë), ata mund të kontribuojnë në formimin e identitetit pozitiv grupor, ndjenjës së sigurisë dhe përkatësisë, si dhe vetëbesimit. Kjo i ndihmon individit që të gjejë vendin e tij në botë, të kuptojë se kush dhe çfarë është (ndërsa kush dhe çfarë nuk është), ku takon dhe si duhet të silllet. Problemet paraqiten kur grupet të cilave u takon një individ i caktuar, i konsideron më të mirë sesa të tjerët dhe i idealizon përderisa të tjerët i nënvlerëson dhe nënçmon. Kjo mund të rezultojë me sjellje të padëshiruar siç janë: thashetheme, ngacmimi, akuzimi, dhuna fizike, etj.

Për shkak të kësaj, ndonëse nuk është e thjeshtë gjithmonë t’i kontrollojmë vlerësimet tona automatike për të tjerët dhe sjelljen tonë, megjithatë duhet të jemi të vetëdijshëm se vlerësimi ynë për personat që i konsiderojmë të ndryshëm prej nesh mund të mos jetë përkatës. Këtë e dallojmë shpesh kur kemi mundësi për t’i njoftuar më mirë të tjerët dhe të realizojmë relacione të ndërsjella në bazë të gjërave që na lidhin. Këto mund të jenë interesa të përbashkët, nevoja për siguri, paqe, mirëqenie, si dhe probleme me të cilat përballemi bashkërisht.

## ***Pjesë përfundimtare e orës (5 min.)***

Mësimdhënësi përmes projektorit (ose shënimit në tabelë/hamer) ua paraqet nxënësve citatin si vijon të Nelson Mandelës dhe i lë që ta lexojnë dhe të mendojnë rreth rëndësisë së tij.

“Askush nuk lind me urrejtje ndaj individit tjetër vetëm për shkak të faktit se ai individ ka ngjyrë **të ndryshme** të lëkurës, prejardhje të ndryshme ose religjion të ndryshëm. Njerëzit mësojnë se si të urrejnë, ata mund të jenë të mësuar edhe si të duan, dashuria është më e natyrshme për zemrën e njeriut, sesa e kundërta”, Nelson Mandela në inaugurimin e tij për president të Afrikës së Jugut në vitin 1994.

Mësimdhënësi u ofron mundësi nxënësve që të shprehin qëndrimin e tyre rreth citatit të përmendur. Zhvillohet një diskutim i shkurtër i cili orientohet drejt përkufizimit për tolerancën e UNESCO-s të vitit 1995 sipas të cilit **toleranca paraqet respektimin, pranimin dhe njohjen e pasurive të dallimeve në kulturat botërore dhe ajo është formë e të shprehurit dhe mënyrë që të jemi njerëz. Toleranca nënkupton vullnetin dhe aftësinë për të pranuar dhe lejuar dallimin, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për dallime në bindjet politike, përkatësinë fetare dhe racore ose, nga ana tjetër, për dallimet mes gjinive.**

Toleranca nënkupton frymën e **respektit** ndaj tjetrit, ndaj atij që është ndryshe prej nesh.

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)***

Diskusim për reflektim përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Përmendni shembuj ose përvoja personale nga jeta e përditshme për pranimin ose respektimin e dallimeve.
- ➔ Mendoni për situata kur keni miratuar konstatime të shpejtuara për disa veçori/karakteristika dhe që ka kontribuar t'i ndryshoni qëndrimet tuaja. Pritet që disa nga nxënësit të ndajnë shembuj të situatave kur u janë zvogëluar disa nga paragjykimet që i kanë ndier ndaj njerëzve të cilët janë të ndryshëm për ta (në aspektin kulturor, etnik, gjinor ose ndonjë kuptim tjetër).
- ➔ Si do të kishit vepruar radhën tjetër kur do të jeni në situatë të vlerësoni se si të veproni me dikë që sipas shumë karakteristikave është i ndryshëm prej jush? (Pritet që të jenë të kujdesshëm në vlerësimin, të jenë të vetëdijshëm për paragjykimet e mundshme që i kanë, t'i kërkojnë mundësitë për bashkëpunim dhe shkëmbim të diturive dhe përvojave.)

## *Përmbajtja: Pranim dhe respektim i dallimeve*



### *Rezultate nga nxënia:*

Nxënësi/nxënësja analizon mënyrat e funksionimit të **dallimeve** në shoqëritë dhe tregon gatishmëri për t'i **respektuar ata që janë ndryshe** nga vetja.



### *Standarde/tregues për arritje:*

Nënësi/nxënësja mund të:

- ➔ përshkruajë se si funksionojnë identitete **të ndryshme** në një shoqëri,
- ➔ rishqyrtojë qëndrimet dhe sjelljet personale në situata konkrete,
- ➔ diskutojë për përfitimet dhe sfidat nga jeta dhe puna në shoqëri me **dallime**,
- ➔ demonstrojë se secili në shoqëri është i rëndësishëm dhe mund t'i **pranojë** njerëzit të cilët janë **ndryshe** nga ai/ajo.



### *Materialet e nevojshme:*

fleta letre, lapsa kimik (lapsa), Fletë pune 2.9.



### *Metoda, teknika, forma:*

punë në grupe, punë individuale, diskutim në grup, prezantim, aktivitet për ngrohje.

## Pjesa hyrëse e orës (5 min.)

### Aktivitet:

#### **Fryn era**

Mësimdhënësi i cili parapakisht i ka renditur karriget në rreth, u jep udhëzime nxënësve se ai që qëndron në mes (meqë vetëm për një nxënës nuk ka karrige) kur do të bërtasë për shembull: "Fryn era për të gjithë që i kanë flokët e shkurtra", ata me flokë të shkurtra ngrihen dhe e ndërrojnë karrigen. Ai që nuk do të gjejë karrige, jep udhëzime me "Fryn era". (Shembuj për udhëzime: "Fryn era për ata që janë të dashuruar, për ata që kanë këpucë/atlete të zeza, për ata që kanë vëlla, etj.)

**Shënim:** Nëse nuk ekzistojnë kushte hapësinore për realizimin e aktivitetit, mësimdhënësi mund t'i ftojë nxënësit që secili prej tyre ta thotë nofkën (emrin) e tij dhe një mbiemër (atribut, veçori), që do të jetë mbiemri i tij (për shembull: "Alek i Drejti", e më pas sqaron shkurtimisht pse pikërisht këtë mbiemër ("... meqë gjithmonë lufton për drejtësi").

Mësimdhënësi i pyet nxënësit nëse dallojnë pse pikërisht ky aktivitet ka qenë i parashikuar për orën në të cilën do të mësojnë për **pranimin dhe respektimin e dallimeve**. Nxënësit udhëzohen që të shprehin se aktiviteti përmes argëtimit na vërteton se për shumë gjëra **dallojmë** dhe se kjo nuk është fare keq ose e gabuar, por, përkundrazi, mund të jetë argëtuese.

## Pjesa kryesore e orës (20 min.)

**Respektimi i dallimeve** nënkupton **pranimin e dallimeve** dhe vetëpërmbajtje nga vlerësimi. Për shembull, mbajtja e shamisë është pjesë e traditës kulturore në disa kultura, në Tibet nxjerrja e gjuhës përdoret për shprehjen e respektit ose si përshëndetje, në Japoni është e pranueshme pirja me zë e gllënjave të supës, etj.



## Aktivitet:

### Treni

Mësimdhënësi ndanë me nxënësit një situatë hipotetike dhe i lutë të imagjinojnë se duhet të nisen në udhë të gjatë me tren, në kupe me katër krevate. U thotë që të imagjinojnë se njëri prej krevateve është për ta, derisa për tri krevatet tjera duhet të përzgjedhin njerëz me të cilët do të donin të udhëtojnë. Më pas mësimdhënësi u jep/paraqet listë të njerëzve me karakteristika të ndryshme në baza të ndryshme. Për shembull:

- Një grua e re me tatuazhe dhe vathë në gjithë trupin,
- Burrë i rritur me pengesa fizike,
- Prift hebre i veshur me veshje zyrtare,
- Burrë emigrant nga një vend tjetër,
- Aktor i famshëm në gjendje të alkoolizuar,
- Nënë me fëmijë me nevoja të posaçme, e cila nuk e flet gjuhën tuaj,
- Grua transgjimore<sup>1</sup>,
- Gjyshe me nip të vogël në duar.

Pasi që nxënësit do të përzgjedhin tre prej personazheve imagjinare me të cilat do të udhëtonin, mësimdhënësi kërkon vullnetarë që ta ndajnë përzgjedhjen e tyre dhe të arsyetojnë pse i kanë përzgjedhur pikërisht këto personazhe, e për shkak të cilës arsye nuk i kanë përzgjedhur të tjerët.

Nxënësit nxiten të mendojnë se çfarë është ajo pozitive që do të mund të mësojnë nga secili prej personazheve, pa dallim nëse të njëjtin e kanë përzgjedhur për udhëtimin, në mënyrë që ta pasurojnë mirëkuptimin dhe pranimin e të "tjerëve".

Zhvillohet diskutim i shkurtër në mënyrë që të bëhet e ditur se secili në shoqëri është i rëndësishëm dhe mund të kontribuojë në zhvillimin e tij. Është e pritshme që anëtarët e shoqërisë të kenë mendime, qëndrime, nevoja, interesa, karakteristika **të ndryshme**. Këto dallime kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë, kështu që secili kontribuon me atë që e di dhe është i aftë për ta bërë më së miri. Për shkak të kësaj, **dallimet** e ndërsjella duhet t'i **pranojmë** dhe **respektojmë** si pjesë përbërëse e jetesës sonë.

Si përgjigje ndaj pyetjes së në çfarë mënyre është e mundshme që individit të nxitet në **respektimin** e dallimeve dhe bashkëpunim me të ndryshmit nga ai, shpesh përmendet edukimi dhe arsimimi i fëmijëve në mënyrë që të zhvillohen shkathtësi të tolerancës dhe respektimit të mirëfilltë të mendimeve dhe sjelljeve të të tjerëve. Kjo do të thotë se fëmijëve duhet t'u ngulitet në sistemin e tyre të vlerave **pranimi** i **dallimeve**, në mënyrë që më vonë t'i respektojnë, e jo vetëm t'i tolerojnë

të ndryshmit prej tyre. Vendi i parë ku mësohet për **pranimin e dallimeve** është familja. Meqë fëmijët mësojnë sipas modelit, ata më së lehti do ta pranojnë sjelljen e anëtarëve të familjes së tyre. Por, familja nuk është mësuesi i vetëm. Të gjitha strukturat shoqërore duhet të përfshihen në ndërtimin e tolerancës. Rol të veçantë në këtë proces kanë shkollat që duhet të tregojnë se secili nxënës është i vlefshëm dhe identiteti dhe dallimi i tij respektohet.

Hulumtimi ka treguar se raporti negativ ndaj “tjerëve” zakonisht lajmërohet kur grupet e ndryshme nuk kanë pasur kontakt të ndërsjellë përkatës ose, nga ana tjetër, kontakti që e kanë pasur ka qenë në bazë të pabarabartë: për shembull, njëri grup nuk e ka kuptuar fare ose jo aq sa duhet gjuhën e tjetrit, njëri grup ka qenë me numër shumë më të madh se tjetri, anëtarët e grupit vazhdimisht janë takuar në “territorin” e njërit grup, anëtarët e grupeve gjatë kontaktit janë nxitur në garë të ndërsjellë, e jo në bashkëpunim, etj..

## ***Pjesë përfundimtare e orës (15 min.)***

Mësimdhënësi thekson se Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet në hapësirën e të cilit qëmoti kohë jetojnë së bashku shumë kultura **të ndryshme**. Shenja e jonë është e dukshme edhe sot në trashëgiminë materiale dhe jomateriale kulturore, në arkitekturën, ushqimin, folklorin, në jetën e përditshme dhe zakonet që i kultivojmë. Në mënyrë që t’i analizojnë përfitimet dhe sfidat e jetesës në shoqëri me dallime, nxënësit e bëjnë aktivitetin e radhës.

Në grupe më të vogla, nxënësit e plotësojnë fletën e punës 2.9. Ata duhet të mendohen dhe të përgjigjen se çfarë dallimesh ekzistojnë në kuadër të shkollës, qytetit/fshatit/komunës dhe shtetit të tyre. Ata nxiten që të mos kufizohen në dallimet tradicionale (etnike, religjioze, etj.), por të mendojnë më gjerësisht. Më pas të mendojnë se cilat janë përfitimet nga dallimi (çfarë përfitojnë prej tij) dhe cilat janë sfidat me të cilat përballen.

Pas përfundimit, grupet tregojnë se çfarë kanë konstatuar dhe i krahasojnë konstatimet e tyre me ato të grupeve të tjera.

Përgjigje të mundshme:

**Dallime** - gjini, moshë, përkatësi etnike, përkatësi religjioze, racë, gjuha në të cilën flitet, subkulturë (muzika, stili i veshjes).

**Përfitime** – mund ta mësojmë gjuhën e “tjetrit”, kemi zgjedhje prej ushqimit të llojllojshëm (tradicional), muzikë, njoftohemi me vlera dhe besime të ndryshme, mund të mësojmë nga përvoja jetësore e më të rriturve, pranojmë mënyra të mira të sjelljes karakteristike për gjininë tjetër, mësojmë të jemi të hapur ndaj dallimeve, përvetësojmë shkathtësi për të përshtatur sjelljen dhe komunikimin tonë me individë dhe grupe të ndryshme në shoqëri, bëhemi më të ndjeshëm.

**Sfida** – mund të mos kuptohemi për shkak të gjuhës së ndryshme, normat kulturore për disa çështje mund të jenë kundërshtuese, kemi vlera të ndryshme për çështje të rëndësishme, ose qëndrimet lidhur me disa tema të caktuara i kemi kundërshtuese.

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim*** **(5 min.)**

Mësimdhënësi u parashtron pyetje nxënësve: „Në çfarë shoqërie dëshironi të jetoni, shoqëri ku kultivohen dallime ose shoqëri që do të promovonte homogjenitet më të madh të qytetarëve, ku sjellja jokonformiste pranohet vështirë nga bashkësia në të cilën jetoni?“

Pritet që nxënësit përmes përgjigjeve të tyre ta mbështesin shoqërinë e dallimeve, në bazë të përfitimeve të diskutuara gjatë aktivitetit paraprak.



## Fletë pune 2.9

### ***Përfitime dhe sfida nga jetesa në shoqëri me dallime***

	Çfarë dallimesh ekzistojnë mes...?	Cilat janë përfitimet nga dallimet?	Cilat janë sfidat për shkak të dallimeve?
Nxënësit në shkollën tonë			
Banorët e qytetit/ fshatit/ komunës tonë			
Qytetarët në shtetin tonë			

# Përmbajtja: Multikulturalizëm dhe jetesë e integruar



## Rezultate nga nxënia:

Nxënësi/nxënësja i dallon përparësitë e shoqërisë **multikulturore** dhe e vlerëson cilësinë e mënyrës së **integruar** të jetesës.



## Standarde/tregues për arritje:

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ numërojë karakteristika themelore të shoqërisë **multikulturore**,
- ➔ të përkufizojë se çfarë është **multikulturalizëm** dhe **integrim**,
- ➔ të dallojë **integrimin** si mënyrë/parakusht për shoqëri **interkulturore**.



## Materialet e nevojshme:

Fletë pune 2.10, Fletë pune 2.11.



## Metoda, teknika, forma:

Punë në çift, diskutim, "Stuhi e ideve", "Akullnajë", hulumtim

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

### Aktivitet:


#### „Akullnajë“

Mësimdhënësi vizaton në tabelë një „Akullnajë“ (Foto 6) me dorë të lirë dhe me vijë horizontale e ndan bregun. Mësimdhënësi u sqaron nxënësve se pjesa e sipërme duhet t'i shënojë të gjitha elementet e kulturës që janë të dukshme dhe lehtë për t'u vërejtur te njerëzit tjerë, derisa pjesa e poshtme, në pjesën më të madhe i shënon ato elemente të kulturës që nuk vërehen, por kanë rëndësi të madhe. Ato janë kryesisht vlera dhe parime për atë se çfarë është mirë, e drejtë, e pëlqyeshme dhe e pranueshme, si edhe çfarë është e keqe, e gabuar, e papëlqyeshme dhe e papranueshme. Në shumë raste, grupe të ndryshme kulturore i ndaj vlerat dhe parimet e ngjashme themelore.

Nxënësit nxiten që lirisht të ndajnë dhe shënojnë në tabelën asociacione për elemente të dukshme dhe të fshehura të kulturës. Në pjesën e sipërme të „Akullnajës“, pritet të numërohen elementet si: racë, gjuhë, veshje, art, zakone, derisa në pjesën e poshtme të akullnajës do të ishin vërejtur: vlera, norma, memorie kolektive, pikëpamje politike, shkathtësi, etj.

Mësimdhënësi i pyet nxënësit, cilat karakteristika kulturore do t'i kishin veçuar për veten edhe si karakteristikë e dukshme (në pjesën e sipërme të akullnajës), por edhe si karakteristikë e pavërejtur (në pjesën e poshtme të akullnajës). Mësimdhënësi bën një përmbledhje se vetëm një pjesë e elementeve të kulturës janë të dukshme, derisa pjesa më e madhe e tyre janë të brendshme/të padukshme nga jashtë, ndërsa shumë të rëndësishme në përcaktimin e identitetit kulturor të individëve.

Foto 6. Akullnaja e kulturës.



## ***Pjesa kryesore e orës (30 min.)***

Pas përfundimit të aktivitetit hyrës, mësuesi mund të ndërlidhet me konstatimet dhe/ose elementet tjera nga përmbajtja: **Pranim dhe respektim i dallimeve**. Përveç kësaj, si ndërlidhje e aktivitetit e përmendë dallimin kulturor në kuadër të klasës. Më pas u bën thirrje nxënësve që të mendojnë nëse ekziston dallim kulturor në nivel të shkollës dhe një hap më tutje – në nivel të bashkësisë lokale. Është e pritshme që nxënësit të tregojnë dallimin kulturor në mjedisin e tyre. Më tutje, mësuesi i fton nxënësit të shprehin të kuptuarit e tyre të fjalës **multikulturalizëm**. Nxënësit shkëmbejnë mendime, ndërsa mësuesi shënon në tabelë termet kryesore që kanë të bëjnë me përcaktimin e termit.

### ***Aktivitet:***

#### ***Bisedë për kulturën tënde (20-25 min.)***

Mësuesi ua shpërndan të gjithë nxënësve fletën e punës 2.10 (në mënyrë alternative, udhëzimet për diskutim mund të paraqiten në projektor/shënohen në tabelë), pas çka u jep udhëzime nxënësve që të gjejnë partnerin e tyre nga bashkënxënësit (më së miri është që ai të jetë dikush që nuk e njohin mjaft mirë).

Në çiftet e formuara, njëri prej nxënësve duhet të ketë rolin e oratorit, derisa tjetri të ketë rolin e dëgjuesit. Oratori duhet të udhëhiqet sipas pohimeve të fletës së punës 2.10 dhe ka 2-3 minuta për të folur për kulturën e tij. Më pas, brenda 1-2 minutave dëgjuesi duhet ta përsërisë atë që e ka thënë, ndier dhe bërë të ditur oratori për kulturën e tij/saj.

Secili prej çifteve ka nga 1-2 minuta për të shkëmbyer mendime mes oratorit dhe dëgjuesit, në mënyrë që të analizohet se sa saktë ka kuptuar dëgjuesi për kulturën e oratorit. Më pas nxënësit i ndërrojnë rolet në çdo çift (oratori nga biseda e parë tani bëhet dëgjues, dhe anasjelltas) dhe procedura e tërë përsëritet (2-3 minuta për oratorin të flasë për kulturën e tij, 1-2 minuta për përsëritjen nga dëgjuesi, 1-2 minuta për shkëmbimin e mendimeve).

Pas përfundimit të aktivitetit, mësuesi inicion diskutim me nxënësit (në kohëzgjatje prej 10 minutave) përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Si e përkufizuat kulturën tuaj?
- ➔ Cilat aspekte të kulturës tuaj për ju ishin më të rëndësishme për t'u ndarë?
- ➔ A ju kuptuan mjaftë qartë ata që ishin në rolin e dëgjuesit?

- ➔ Çfarë ishte më së lehti për ata në rolin e dëgjuesit të mbajnë mend: fakte specifike, ngjarje, ndjenja? Pse?
- ➔ Si ndjeheshit si orator, derisa e prezantoni kulturën tuaj?
- ➔ Si ndjeheshit si dëgjues, derisa i përsëritnit informacionet që ju janë prezantuar?
- ➔ A mundet dhe si mund të zbatohet ky aktivitet në jetën e përditshme?

Nga diskutimi në grup dhe përgjigjet e nxënësve, mësuesi nxjerr konstatim për temat e përpunuara:

Secili individ në mënyrë të ndryshme, personale, e përkufizon kulturën e tij. Ato gjëra që njerëzit vendosin t'i manifestojnë dhe shprehin për kulturën e tyre mund të ndryshohen në masë të konsiderueshme nga njëra deri te kultura tjetër. Për shkak të kësaj, biseda për veçoritë e ndryshme kulturologjike, por edhe perceptimi i ngjashmërive janë hapat e parë për të kuptuar "tjetrin" në aspektin kulturologjik, gjegjësisht atë që është ndryshe prej tij. Kjo paraqet një pjesë të procesit të integritimit dhe vendosjes së bashkëpunimit mes kulturave të ndryshme. Në këtë proces, niveli i mirëkuptimit të veçorive të ndryshme kulturologjike varet nga gatishmëria individuale e secilit individ për t'i dëgjuar, parë, hulumtuar dhe për të mësuar më shumë për këto veçori. Në të kundërtën, shkaktohen mosmarrëveshje dhe/ose keqkuptime për kulturën tjetër. Ndonëse gjithmonë është më lehtë të mbahen mend vetëm ato fakte dhe veçori të dukshme nga kulturat e ndryshme, procesi i integritimit shpie drejt të kuptuarit edhe të veçorive "të padukshme" kulturologjike në sjelljen, ndjenjat, qëndrimet dhe pikëpamjet e dikujt.

## ***Pjesa teorike (5 min.)***

**Multikulturalizmi** është përcaktuar si lëvizje që e pranon diversitetin në një shoqëri si karakteristikë themelore dhe parim themelor. Kjo lëvizje kërkon që të gjitha grupet kulturore të jenë të barabarta, gjegjësisht të rritet dinjiteti, të drejtat dhe njohja e dallimit të këtyre grupeve. Multikulturalizmi e vendosë theksin në diversitetin kulturor në të cilin është primare ruajtja e identitetit personal kulturor dhe pranimi i tjetrit. **Multikulturalizmi** bën të ditur në ekzistimin e më shumë kulturave në një hapësirë gjeografike, që nuk janë në bashkëveprim të detyrueshëm, të përditshëm dhe të natyrshëm. Njëherësh, multikulturalizmi nënkupton edhe mbrojtjen e disa bashkësive të caktuara, veçanërisht në raste të padrejtësive të shkaktuara sistemore ndaj atyre bashkësive përmes diskriminimit, shtypjes dhe përjashtimit të grupeve të caktuara në të kaluarën.

Multikulturalizmi është bazë e domosdoshme, fillestare. Pa koncept të përpunuar dhe miratuar qartë të multikulturalizmit, nuk ka pranim të ngjashmërive, por as respektim të dallimeve. Hapi i radhës, gjegjësisht sendërtimi dhe forcimi i multiulturalizmit, ndodhë në formë të interkulturës: jetesa paralele pranë njëri-tjetrit tejkalohet duke kaluar në referim të ndërsjellë ndaj njëri-tjetrit,




lidhshmëri mes njëri-tjetrit dhe mbështetje të ndërsjellë të njëri-tjetrit në sigurimin e jetesës cilësore në një bashkësi, gjegjësisht shoqëri të njëjtë. Prandaj, **interkulturalizmi** është koncept dinamik dhe ka të bëjë me zhvillimin e marrëdhënieve mes grupeve kulturore. Interkulturalizmi është rezultat i shkëmbimit dhe dialogut ndërkulturor të kulturave të ndryshme të cilat, përmes bashkëpunimit të ndërsjellë, varen prej njëra-tjetrës në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndër-kombëtar (Foto 7).

**Foto 7. Krahasim të termeve multikulturalizëm dhe interkulturalizëm.**


Për sqarimin më të lehtë vizual të konceptit të multikulturalizmit dhe interkulturalizmit, mësimdhënësi mund t'i vizatojë në tabelë dy bashkësitë e mëposhtme.

Bashkësia paraqet shoqëri, derisa përmbajtja e bashkësisë paraqet grupe të ndryshme kulturore në kuadër të shoqërisë.

Propozim – aktivitet i shkurtër: Nxënësve u shpërndahen fleta në ngjyra të ndryshme me të cilat duhet ta paraqesin në aspektin vizual mirëkuptimin e tyre të multikulturalizmit dhe interkulturalizmit. Pas mbarimit, mësimdhënësi mund ta prezantojë paraqitjen vizuale më poshtë, në krahasim me paraqitjet vizuale të nxënësve.



**Multikulturalizëm**



**Interkulturalizëm**

**Integrimi** është më shumë se jetesë e përbashkët e më shumë kulturave në një hapësirë, ai është më shumë edhe se respektim dhe pranim i dallimeve. Kur jetesa e përbashkët nënkupton bashkëpunimin dhe referimin ndaj njëri-tjetrit për shkak të sigurimit të ekzistencës së përbashkët, atëherë flasim për **interkulturë** dhe **integrimit**. Integrimi është proces që duhet të zbatohet në mënyrë aktive dhe të inkurajohet nga të gjithë faktorët në jetën shoqërore, duke filluar nga familja, sistemi arsimor, tregu i punës, jeta e përditshme në bashkësinë lokale dhe ngjashëm.

## ***Pjesë përfundimtare e orës***

Nxënësit ndahen në grupe, e marrin listën me kritere për interkulturalizëm në nivel të shkollës, qytetit/komunës dhe klubit sportiv (Fletë pune 2.11), dhe u bëhet e ditur se deri në orën e radhës secili grup duhet të zbatojë hulumtim në mënyrë që ta përcaktojë përmbushjen e kritereve në tabelë.

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim*** ***(5 min.)***

Наставникот поставува неколку кратки прашања за refleksija:

Mësimdhënësi parashtron disa pyetje të shkurtra për reflektim:

- ➔ Çfarë risie mësuat sot?
- ➔ Përmendni së paku një dallim mes termit multikulturalizëm dhe termit interkulturalizëm?
- ➔ Cilat përfitime mund t'i përmendni nga jeta në bashkësi multikulturore?



## **Fletë pune 2.10**

### ***Bisedë për kulturën tënde***

Ndani 2 minuta për t'i shqyrtuar pohimet dhe udhëzimet më poshtë. Shumë kultura kanë veçori të tyre që ndoshta janë të kuptuara ndryshe nga njerëzit tjerë të cilët nuk u takojnë atyre kulturave. Tentoni të jeni sa është e mundshme më të hapur dhe më të hollësishëm në transmetimin e informacioneve drejt dëgjuesit në çiftin tuaj.

- ➔ Kultura ose etniteti të cilit i takon...
- ➔ Ndonjë veçori e kulturës tënde që në të shumtën e rasteve kuptohet gabimisht nga të tjerët;
- ➔ Ndonjë "informacion i ri" për kulturën tënde që konsideron se bashkëbiseduesi nuk e ka ditur deri tani;
- ➔ Shembull për ndonjë zakon familjar për të cilin konsideron se ka të bëjë me kulturën të cilës i takon;
- ➔ Ndajë ndonjë fjalë të urtë për të cilën konsideron se është e ndërlidhur me kulturën të cilës i takon;
- ➔ Çfarë mendon se është veçanërisht e rëndësishme që ta kuptojnë të tjerët për kulturën tënde?
- ➔ Mendo për ndonjë mësim që për ty është shumë i rëndësishëm, por njëherësh është i rëndësishëm edhe për njerëzit tjerë;
- ➔ Për fund, diçka që konsideron se është mjaft interesante ose e rëndësishme për ta ndarë me dëgjuesin.

## Fletë pune 2.11

### Kritere për interkulturalizmin

Hulumtoni për integrimin ndëretnik dhe interkulturalizmin në shkollën, qytetin ose komunën tuaj, dhe një klub sportiv, sipas zgjedhjes tuaj.

Në bazë të kriterëve të dhëna në tabelën e radhës, vlerësoni se sa praktikohet interkulturalizmi në institucionet e përmendura. Gjatë hulumtimit, mund të përdorni informacione të kapshme në internet, por është e pëlqyeshme që të zbatoni edhe vizitë në terren të institucioneve, të realizoni intervista me përfaqësuesit e të njëjtave, si dhe intervista me nxënës/qytetarë, në mënyrë që të përcaktoni deri në cilin nivel është përmbushur secili prej kriterëve të përmendura. Tentoni që të mblidhni sa është e mundur më shumë informacione për t'i mbështetur vlerësimet tuaja.

	Po, tërësisht	Po, deri diku	Jo
<b>Shkollë</b>			
Informacionet që i publikon shkolla (në ueb-faqen, tabelë të shpalljes) janë në dispozicion në gjuhë të ndryshme të cilat i flasin nxënësit.			
Shkolla ka miratuar dokumente (në kuadër të programit vjetor, planit të veprimit, etj.) për interkulturalizëm ose integrim ndëretnik.			
Në kuadër të shkollës, nxënësit kanë mundësi të takohen dhe të bashkëpunojnë me nxënës të bashkësive të ndryshme etnike:			
→ si pjesë e aktiviteteve jashtëshkollore,			
→ gjatë pushimeve,			
→ si pjesë e mësimin të rregullt.			
Nxënës të bashkësive të ndryshme etnike marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes në shkollë.			
Gjatë mësimdhënies në lëndë të ndryshme bisedohet për mirëkuptim të dallimeve, nxënie nga "të tjerët" dhe shqyrtim të ndonjë dukurie nga perspektiva të ndryshme.			

<b>Qytet / Komunë</b>			
Informacionet që i publikon qytetari/komuna (në ueb-faqen, tabelën e shpalljes) janë të kapshme në gjuhë të ndryshme që i flasin qytetarët.			
Në organet e udhëheqjes (Këshill, institucione lokale) ka përfaqësues të bashkësive të ndryshme etnike të cilët jetojnë në qytetin/komunën.			
Gjatë diskutimit dhe vendimmarrjes u kushtohet kujdes interesave dhe nevojave të të gjitha bashkësive, arritjes së mirëkuptimit të ndërsjellë dhe të mirës së përbashkët.			
Promovohen vende të përbashkëta për jetë kulturore argëtuese, ku mund të takohen dhe shoqërohen përfaqësues të bashkësive të ndryshme etnike/gjuhësore.			
Qyteti/komuna ka miratuar dokumente (strategji, plan të veprimit, etj.) për interkulturalizëm ose integrim ndëretnik.			
<b>Klub sportiv</b>			
Klubi ka publikuar deklaratë se nuk do të tolerojë nacionalizëm dhe racizëm dhe do të ndërmarrë veprim kundër atyre që brohorasin parulla/këngë nacionaliste/raciste.			
Klubi parashikon sanksione(dënime) për lojtarët të cilët promovojnë nacionalizëm dhe/ose racizëm.			
Klubi zbaton politikë të mundësive të barabarta për anëtarësim, avancim dhe pagesë, pa dallim të përkatësisë etnike ose racore.			

## ***Përmbajtja: Multikulturalizëm dhe jetesë e integruar***



### ***Rezultate nga nxënia:***

Nxënësi/nxënësja i dallon përparësitë e shoqërisë **multikulturore** dhe e vlerëson cilësinë e mënyrës së **integruar** të jetesës.



### ***Standarde/tregues për arritje:***

Nxënësi/nxënësja mund të:

- të diskutojë dhe të gjejë zgjidhje për çështje dhe situata të ndërlikuara për të cilat duhet të respektohen dallimet kulturore.



### ***Materialet e nevojshme:***

Fletë pune 2.11; letër, lapsa kimik



### ***Metoda, teknika, forma:***

Punë në grupe, diskutim, prezantim

## ***Pjesa hyrëse e orës (10 min.)***

Mësimdhënësi e fillon orën me parashtrimin e pyetjeve për diskutim:

- ➔ Çfarë shoqërie është shteti ynë? (Pritet që nxënësit të përgjigjen se jetojnë në shoqëri me dallime, gjegjësisht shoqëri multikulturore).
- ➔ A mund të përmendni ndonjë shtet që është homogjen në aspektin kulturor? (Pritet që nxënësit mos të mund të kujtohen për ndonjë shtet ku qytetarët i takojnë vetëm një kulturë).
- ➔ Çfarë paraqet për ju termi **integrim**? (Pritet nga nxënësit të tregojnë se shpesh e dëgjojnë këtë term dhe e dinë se paraqet proces të lidhjes së suksesshme të grupeve të ndryshme të njerëzve.)
- ➔ Cilat janë përparësitë e jetesës në shoqëri **multikulturore**? (Pritet që nxënësit të tregojnë se jeta në bashkësi multikulturore mundëson që të njohohen kultura të ndryshme, gjë që ofron dinamikë më të madhe dhe është më interesante. Nxënësit të cilët kanë qëndrim radikal të kundërt, mësimdhënësi i nxitë të mendojnë me horizonte më të gjera përmes pyetjeve si vijon.)
- ➔ A keni miq ose fqinj të cilët i takojnë ndonjë kulturë të ndryshme nga e juaja? Si do të ishin ndier ata (fqinjët, miqtë) nëse nuk pranohen nga mjedisi në të cilin jetojnë? Si do të ishit ndier ju nëse jeni të refuzuar për shkak të ndonjë karakteristike tuaj kulturore?

Mësimdhënësi plotëson:

Numri më i madh i vendeve në botë janë heterogjene në aspektin kulturor. Për vetëm disa vende në botë mund të thuhet se qytetarët e tyre ndajnë gjuhë të njëjtë dhe se i takojnë bashkësisë së njëjtë etnike.

## ***Pjesa kryesore e orës (25 min.)***

Nxënësit, sipas grupeve i prezantojnë gjetjet nga hulumtimi i tyre i parimeve interkulturore (Fletë pune 2.11). Gjatë prezantimit sqarojnë se në bazë të cilave informacione i kanë bërë vlerësimet dhe të njëjtat i krahasojnë mes grupeve.

Pasi t'i harmonizojnë vlerësimet për secilin kriter, në tri grupe, përgatisin letër me rekomandime deri te secili institucion për avancimin e interkulturalizmit dhe integritit ndëretnik. Letrat i dërgojnë deri te institucionet dhe gjatë vitit ndjekin nëse zbatohen rekomandimet e tyre.

## ***Pjesë përfundimtare e orës (5 min.)***

Ora përfundon me diskutim për përfitimet nga jetesa në shoqëri të integruar:

- ➔ Pse është i rëndësishëm integrimi ndëretnik në një shoqëri? (Përgjigje të pritura: Në mënyrë që të gjitha bashkësitë të kenë mundësi për të qenë të përfaqësuar dhe prezantuar në institucionet, të ndjehen të barabartë, të bashkëpunojnë mes vete në realizimin e qëllimeve të përbashkëta, të mësojnë prej njëri-tjetrit dhe t'i shfrytëzojnë dallimet e ndërsjella në përparimin e shoqërisë, etj.)
- ➔ Si mund ta përmirësojmë integrimin ndëretnik? (Përgjigje të pritura: përmes përfshirjes së parimeve të integritit në dokumentet formale, mundësimin e pjesëmarrjes dhe prezantimit në institucionet formale dhe joformale, mundësim të kushteve për bashkëpunim të ndërsjellë mes bashkësive etnike, theksim të interesave dhe nevojave të përbashkëta, zhvillim të shkathtësive që ta shohim perspektivën e "tjetrit", krijimin e mundësive që dallimi të kuptohet si përfitim, etj.)

Mësimdhënësi bën përmbledhje se në këtë jetesë bashkëkohore është veçanërisht e rëndësishme ta dallojmë multikulturalizmin si koncept të pranimit dhe respektimit të dallimeve, por është shumë më e rëndësishme se si shoqëri duhet të synojmë që përmes integritit të arrijmë nivel të lartë të interkulturalizmit në jetesën tonë, veçanërisht në bashkësitë tona lokale.

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)***

### **Aktivitet:**

#### ***Ndëridhje të termeve***

Mësimdhënësi u jep udhëzim nxënësve të punojnë në çift. U ndan nga një listë me terme për ndërlidhje (Fletë pune 2.12) secilit çift dhe u jep 5-6 minuta të punojnë në aktivitetin. Pas përfundimit të aktivitetit, të gjithë bashkërisht tregojnë se si e kanë përpunuar aktivitetin me ç'rast nxitet diskutim i shkurtër për secilin prej termeve.





## ***Fletë pune 2.12***

### **Terme të ndërlidhura**

Me vija lidhini termet nga ana e majtë me ato nga ana e djathtë, me ç'rast bëni kujdes të jenë kompatibilë.

BASHKËPUNIM

PRANIM

RESPEKTIM

BASHKËVEPRIM

TOLERANCË

BASHKËJETESË

MULTIKULTURALIZËM

INTEGRIM

INTERKULTURALIZËM

## *Përmbajtja: Përballje me konflikte*



### **Rezultate nga nxënia:**

Nxënësi/nxënësja i analizon **konfliktet** në nivel lokal, kombëtar dhe global dhe propozon mënyra të ndryshme për zgjidhjen e tyre.



### **Standarde/tregues për arritje:**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ përkufizojë termin konflikt,
- ➔ identifikojë lloje të ndryshme të konfliktit – arsye, pasoja,
- ➔ vlerësojë arsyet për konfliktin në raport me nevojat e ndryshme të palëve të përfshira.



### **Materialet e nevojshme:**

Fleta të bardha A3 ose flipçart letër, markerë, Fletë pune 2.13.



### **Metoda, teknika, forma:**

Punë në grupe, ilustrim, “Pema e konfliktit”, prezantim, diskutim.

## Pjesa hyrëse e orës (15 min.)

### Aktivitet:

#### Si reagoj ndaj konfliktit? (8 min.)

Mësimdhënësi në mes të klasës vendos një objekt të caktuar (p.sh. shishe, fletore, ombrellë) dhe u thotë nxënësve: "Imagjinoni se ky objekt paraqet **konflikt**. Mendoni se si reagoni zakonisht kur do të përjetoni **konflikt** ose jeni dëshmitarë të **konfliktit** që ndodhë në afërsi". Më pas mësimdhënësi u jep udhëzime nxënësve që të ndalen diku në klasë në raport me objektin, në mënyrën që do të bënte të ditur në reagimin e tyre fillestar gjatë përballjes me **konfliktin**. Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit që t'i marrin parasysh pozitën e tyre të trupit, ndjenjat me të cilat përballen, pozitën dhe largësinë në raport me objektin, që në këtë rast e paraqet konfliktin.

Pasi që nxënësit do të gjejnë pozicion në raport me **konfliktin**, mësimdhënësi fton vullnetarë të tregojnë pse qëndrojnë atje ku gjenden. Mësimdhënësi i nxitë nxënësit të mendojnë: „Nëse kjo paraqet reagimin tuaj fillestar, si do të mund të ishte reagimi juaj pasi që do të mendoni për **konfliktin**?” Mësimdhënësi e rrumbullakëson diskutimin duke komentuar se ky aktivitet është mënyrë e mirë për perceptimin e reagimeve personale dhe reagimeve të bashkënxënësve në situata të konfliktit.

**Shënim:** Nëse lëvizja nëpër klasë është e vështirësuar/e vështirë për ta realizuar, mësimdhënësi mund t'u japë nxënësve udhëzime që të imagjinojnë dhe bëjnë të ditur se ku në klasë do të ishin vendosur në raport me objektin që e paraqet konflikt.

Pas diskutimit të shkurtër për përjetimet dhe reagimet individuale të nxënësve, në raport me disa situata konfliktuoze, mësimdhënësi i udhëzon nxënësit të mendojnë se si do ta kishin përkufizuar termin konflikt, por pa përdorur fjalë me konotacion negativ. Me këtë rast, nxënësit mund të përdorin edhe forma alternative të shprehjes (p.sh. vizatim, tingull, pantomimë, etj.). Pas disa minutave derisa nxënësit mendojnë për përkufizimet, mësimdhënësi fton vullnetarë që t'i tregojnë idetë e tyre. Pasi që do të konstatojë se përkufizimet e ndara kanë pikë të përbashkëta me termin konflikt, mësimdhënësi kalon drejt ndarjes së përkufizimeve teorike dhe i inkurajon nxënësit të bëjnë krahasim me përkufizimet që vetë i kanë përpiluar.

## **Pjesa teorike (5 min.)**

**Konfliktet** janë pjesë e zakonshme dhe e pashmangshme e jetës së përditshme, dhe pjesë përbërëse e marrëdhënieve mes njerëzve. Termi **konflikt** nënkupton konflikt, luftë ose mosmarrëveshje mes dy ose më shumë palëve (individë, grupe, bashkësi, etj.) të cilat nevojat, qëllimet ose interesat e tyre i perceptojnë si jokompatible ose kundërshtuese. Si arsye më të shpeshta për konflikt përmenden resurse të kufizuara, nevoja të pakënaqshme primare, vlera të ndryshme dhe qëllime të ndryshme.

Konflikti mund të përkufizohet edhe si proces dinamik në të cilin struktura, qëndrimet dhe sjellja e palëve kundërshtuese ndryshohen dhe ndikojnë në njëri-tjetrin. Në mënyrë alternative, konflikti mund të shihet edhe si formë e sjelljes konkurrenente mes palëve të ndryshme, që lajmërohet kur dy ose më shumë palë garojnë për perceptime të ndryshme, qëllime jokompatible ose resurse të kufizuara.

Në gjuhën e folur termi **konflikt** shpesh ka konotacion negativ, e kundërt e bashkëpunimit, harmonisë, marrëveshjes ose paqes. Shumë shpesh barazohet me dhunë dhe shumë njerëz **konfliktin** e konsiderojnë destruktiv. Megjithatë, **konflikti** si dukuri sociale është multidimensional dhe nuk mund të përcaktohet në mënyrë kategorike si negativ ose pozitiv. Konfliktet janë shpesh të pranishme në jetën tonë të përditshme, ndërsa kjo nuk shpie gjithmonë drejt dhunës. Ajo që do të mund ta kategorizonte **konfliktin** si dukuri pozitive ose negative është në fakt mënyra në të cilën njerëzit përballen me të. Varësisht nga sjelljet, përzgjedhjet dhe shkathtësitë e individëve, konflikti mund të shihet si diçka pozitive ose negative.

Mendimet dhe kuptimet e ndryshme të gjërave nuk janë vetvetiu negative. Përballja e qëndrimeve kundërshtuese, të ndryshme, shumë shpesh mund t'i transformojë të dyja palët. Me fjalë të tjera, dallimet nuk shprijnë gjithmonë drejt ndarjes dhe konfliktit. Zgjidhja dhe transformimi i **konfliktit** nënkupton gjetjen e mënyrave për krijimin e kushteve që nxisin dhe sigurojnë pajtim të aktorëve kundërshtues, duke marrë parasysh nevojat dhe pikëpamjet e tyre.

**Shënim:** Përkufizimet e dhëna për konfliktin mësimdhënësi mundet edhe t'i shkruajë në tabelë/t'i paraqesë me projektor, në mënyrë që nxënësit të kenë më shumë kohë për krahasime përkufizimet e tij, në mënyrë që të shohin se cilat aspekte të konfliktit i kanë identifikuar, cilat i kanë lëshuar, etj.

## **Pjesa kryesore e orës (25 min.)**

Si transformim i **konfliktit** mund të përkufizohet secili proces i ndryshimit të elementeve të ndryshme që e përbëjnë termin konflikt (p.sh. raportet mes palëve të përfshira, interesave, nevojave dhe modeleve të tyre të sjelljes dhe ose kontestet sociale në të cilat ndodhë konflikti),

me qëllim kryesor – arritje të paqes. Disa nga mënyrat e transformimit të konfliktit janë ndërmjetësimi, arbitrazhi, negociata, etj.

**Ndërmjetësimi** është proces i zgjidhjes së konfliktit, në të cilin një ndërmjetësues neutral u ndihmon palëve të prekura të bisedojnë dhe negociojnë në mënyrë konstruktive për problemet dhe nevojat e tyre. Qëllimi është që të arrihet një zgjidhje që është e pranueshme për të gjitha palët e prekura.

**Arbitrazhi** është formë alternative e zgjidhjes së konflikteve jashtë procesit gjyqësor/juridik. Vendimin e marrin një ose më shumë individë (arbitra), pas çka kjo është e obligueshme në aspektin juridik për të dyja palët e përfshira.

**Negociata** në të shumtën e rasteve është dialog mes dy ose më shumë individëve/palëve të prekura, që mundohen të arrijnë zgjidhje për konfliktin që do të sillte përfitime për të dyja palët.

### **Aktivitet:**

#### ***Pema e konfliktit (20 min.)***

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në disa grupe (varësisht nga numri i nxënësve në paralelen) dhe secili prej grupeve u jep nga një fletë të madhe ose hamer (sipas mundësive). Më pas, secilit prej grupeve u jep nga një situatë konflikti nga ato të propozuara në fletën e punës 2.12.

Pasi ta lexojnë situatën, në fletët e ndara nxënësit duhet të vizatojnë një formë të pemës me rrënjë, trung dhe degë. Në rrënjën nxënësit duhet të shënojnë arsyet për shkak të cilave është paraqitur konflikti, në trungun duhet të shënojnë problemin, ndërsa në degët efektet e konfliktit të krijuar. Pasi të përfundojnë me analizën e arsyeve dhe efekteve të konflikteve, nxënësit duhet të gjejnë zgjidhje përkatëse, gjegjësisht mënyra të transformimit të konflikteve. Zgjidhjet e mundshme i shënojnë në gjethet e pemës. Nxënësit kanë 10 minuta për realizimin e kësaj detyre.

Pas përfundimit të aktiviteteve, secila prej grupeve e prezanton situatën e saj problematike dhe prezanton se çfarë ka punuar gjatë 2-3 minutave. Mësimdhënësi i inkurajon nxënësit tjerë të parashtrojnë pyetje dhe t'i ndajnë lirisht qëndrimet e tyre.

## ***Pjesë përfundimtare e orës (3 min.)***

Pas diskutimit të shkurtër për analizat e prezantuara nga grupet e ndryshme, mësime të bën përmbledhjen e orës mësimore:

Analiza e konflikteve është me rëndësi për identifikimin e zgjidhjeve përkatëse të konfliktit. Ajo ndihmon edhe në forcimin e aftësive lidhur me atë se kur dhe si mundet një individ të reagojë ose intervenojë në rast të konfliktit. Për shkak të kësaj, analiza e konflikteve është vegël kryesore për transformimin e konflikteve. Ajo mundëson shqyrtim më të thellë në sjelljen e palëve të përfshira, ndihmon në zbulimin e arsyeve themelore për konfliktin, nevojat e palëve të përfshira në konflikt, etj. Analiza e konfliktit në të shumtën e rasteve bën të ditur se konflikti është dinamik dhe se ndryshon shumë shpejtë.

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (2 min.)***

Në fund të orës mësime të pyet nxënësit:

- ➔ Çfarë e kishit më vështirë gjatë analizës së konflikteve, situatave problematike? (Nga nxënësit pritët t'i ndajnë sfidat me të cilat janë përballur gjatë orës.)
- ➔ Çfarë risie mësuat? (Pritët që nxënësit të ndajnë informacione dhe shkathtësi të reja konkrete që i kanë përvetësuar në orë.)
- ➔ Nëse në të ardhmen përballeni me situatë konflikti, a do të provoni ndoshta që të realizoni diçka që mësuat në këtë orë? Nëse është ashtu, çfarë do të kishit realizuar? (Pritët nga nxënësit të ndajnë se do të kishin tentuar që t'i gjejnë arsyet konkrete për shkak të cilave është shkaktuar konflikti dhe të gjejnë zgjidhje përkatëse për tejkalimin e tij).

**Shënim:** Mësime të këto pyetje mund t'i japë edhe si pyetje për reflektim të asaj që është mësuar, në të cilat nxënësit do të ishin përgjigjur me shkrim në ditarët e tyre për reflektim.



## **Fletë pune 2.12.**

### **Situata**

#### **Situatë konflikti 1**

Aleni dhe Markoja kanë nga 16 vjet dhe janë shokë më të mirë. Sot merren vesh se ku do të dalin sonte. Aleni dëshiron të shkojnë në një kafene, ku pret ta shohë simpatinë në të cilën shoku i tij e di se është shumë i dashuruar. Markoja insiston të shkojnë në kafenenë ku dalin në të shumtën e rasteve, meqë atje do të jenë shokët tjerë nga shoqëria e tyre. Tashmë gjysmë ore debatojnë dhe diskutimi kalon në **konflikt** verbal i cili duket se mund të ndikojë në miqësinë e tyre të mëtejshme. Aleni i thotë Markos se gjithmonë është egoist dhe kujdeset vetëm për nevojat e tij. Markoja i thotë Alenit se është “burrec” klasik i cili për shkak të një vajze i harron shokët. Lidhur me ofendimin “burrec”, Aleni i thotë Markos se habitet se sa shumë xheloz që është. Markoja buzëqeshë në mënyrë sarkastike dhe largohet.

#### **Situatë konflikti 2**

Nela ka 19 vjet dhe punon në një restorant ku bakshishin e fituar në fund të mbrëmjes e ndajnë të gjithë të punësuarit. Por, meqë ajo tashmë një kohë të gjatë merr përqindjen më të madhe nga bakshishi, insiston që kjo traditë të ndërpritet dhe secili ta marrë bakshishin që e fiton. Nela insiston që të thirret mbledhje në të cilën ajo do ta tregojë qëndrimin e saj. Mbledhja ka kaluar në situatë **konflikti** meqë shumica e të punësuarve nuk janë pajtuar me idenë e Nelës. Udhëheqësi i ndërrimit nuk ka marrë qëndrim dhe u ka dhënë mundësi të punësuarve të tij që të gjejnë zgjidhje për situatën e sapokrijuar. Në fund të takimit nuk është gjetur zgjidhje e përbashkët, të gjithë kanë shkuar në shtëpi të nevrikosur dhe të shqetësuar.

#### **Situatë konflikti 3**

Pas përfundimit të ndeshjes së futbollit, takohen anëtarët e dy grupeve të tifozëve, prej të cilëve të parët janë veçanërisht të kënaqur dhe të lumtur për shkak të fitores së ekipit për të cilin anojnë, derisa të dytët janë dukshëm të shqetësuar për shkak të garës së humbur. Dy grupet fillojnë me provokime të ndërsjella verbale, të cilat kalojnë dhe përshkallëzohen në konfrontim fizik. Njëri nga grupi “fitues” i emocionuar nga gëzimi, ka hedhur një shishe përplot me lëng drejt grupit tjetër, gjë që ka shkaktuar konfrontim të pakontrolluar fizik grupor. Për fat të mirë, në atë moment ka kaluar patrulla policore në afërsi dhe të gjithë anëtarët e grupeve të tifozëve janë shpërndarë në anë të ndryshme.

### ***Situatë konflikti 4***

Damiri dhe Andreji mësojnë në klasë të njëjtë dhe janë shokë më të mirë. Damiri është më i miri në matematikë, ndërsa Andrejit matematika nuk i shkon fare. Andreji dëshiron që të ulen së bashku në testin e matematikës në mënyrë që Damiri të mund t'i ndihmojë, nëse është e mundshme. Damiri është pajtuar. Në testin Andreji dukshëm ka përshkruar dhe shqetësuar Damirin, kështu që mësimitdhënësi e ka vërejtur këtë. I ka dënuar që të dy nxënësit, me atë që ua ka marrë testet. Damiri ka qenë shumë i hidhëruar, ndërsa Andreji tërësisht indiferent ndaj veprimit të mësimitdhënësit. Pas orëve Damiri dhe Andreji kanë pasur debat të ashpër. Damiri i ka thënë Andrejit se nuk dëshiron më të bisedojë me të. Andreji është shqetësuar shumë.



## *Përmbajtja: Përballje me konflikte*



### *Rezultate nga nxënia:*

Nxënësi/nxënësja i analizon **konfliktet** në nivel lokal, kombëtar dhe global dhe propozon mënyra të ndryshme për zgjidhjen e tyre.



### *Standarde/tregues për arritje:*

Nxënësi/nxënësja mund të:

- angazhohet për zgjidhje paqësore të **konflikteve**,
- propozojë mënyra konstruktive për zgjidhje, përballje dhe tejkalimin e **konflikteve**.



### *Materialet e nevojshme:*

Top i butë, fleta, lapsa kimik.



### *Metoda, teknika, forma:*

Punë në çifte, luajtje të roleve, prezantim, diskutim.

## Pjesa hyrëse e orës (5 min.)

### Aktivitet:

#### „Hidhërohem kur...“

Nxënësit dhe mësimdhënësit qëndrojnë drejtë (ose në rreth, nëse lejojnë kushtet) në klasë dhe i kalojnë njëri-tjetrit një top të butë. Me kalimin e topit drejt secilit nxënës, nxënësit ndajnë një situatë **konflikti** duke filluar fjalinë me “Hidhërohem kur...” ose “Jam i/e ofenduar kur...”. Me këtë aktivitet nxënësit bëhen të vetëdijshëm për mendimet dhe ndjenjat e të tjerëve dhe përmes ndarjes kuptojnë se si të mos veprojnë nëse hasen në situatë të njëjtë ose të ngjashme. Mësimdhënësi nxjerrë konstatimin nga aktiviteti për ekzistimin e arsyeve të ndryshme për krijimin e situatave të konfliktit dhe i orienton nxënësit të mendojnë për mënyrat e zgjidhjes së konflikteve që i kanë ndarë.

## Pjesa kryesore e orës (35 min.)

### Pjesa teorike (10 min.)


Në përditshmëri njerëzit mund të përjetojnë **konflikte** me vetveten, me të tjerët, me shoqërinë. Derisa shumica e njerëzve konfliktin e konsiderojnë destruktiv, ai mund të jetë mundësi për pjekuri dhe nxënie. Nëse njerëzit i zhvillojnë shkathtësitë e tyre për përballje me konflikte, ata do të mund t'i analizojnë situatat shoqërore dhe të marrin vendime të mençura për veprim, si dhe për marrje përsipër të përgjegjësisë për pasojat e veprimit të tyre. Aftësitë për përballje konstruktive me konfliktet dhe zgjidhjen e tyre, jo vetëm që kontribuojnë për shëndetin mental të individit, por edhe ndikojnë pozitivisht në shoqërinë si tërësi.

Është me rëndësi të theksohet se termet “përballje me konflikte” dhe “zgjidhje të konflikteve” nuk janë sinonime. Zgjidhja e konflikteve është term më i ngushtë që i përshkruan shkathtësitë dhe strategjitë e dobishme vetëm për zgjidhjen e konflikteve. Përballja me konflikte është term më i gjerë, i cili përfshin shkathtësi dhe strategji të llojllojshme të dobishme për sjelljen konstruktive në situata të konfliktit. Ndonëse disa konflikte të caktuara nuk mund të jenë të zgjidhura, megjithatë të gjitha kanë potencial pozitiv (p.sh. ndryshim në sjellje, dituri të re të përvetësuar për veten/palën tjetër, etj.). Prandaj, dy nxënës të cilët kontestojnë ndoshta nuk do të gjejnë zgjidhje për konfliktin e tyre, por raporti i tyre mund të përmirësohet.

Të gjithë njerëzit kanë mënyrat e tyre për atë se si përballen me konfliktet: disa sillen në mënyrë agresive, bërtasin dhe ofendojnë, të tjerët, nga ana tjetër, heshtin dhe tërhiqen. Për përballje të suksesshme me konfliktet dhe zgjidhjen e tyre mund të përdoret strategjia si vijon e përbërë prej pesë shkallëve (Foto 9). Kjo strategji është mirë të bëhet pjesë e pandarë e sjelljes së zakonshme të të gjithë nxënësve dhe njerëzve, në situata konflikti.

Në fillim, individi duhet doemos të dallojë konfliktin që ndodhë (shkalla e parë). Më tutje, ai duhet t'i marrë parasysh nevojat, ndjenjat dhe qëndrimet e të gjitha palëve të prekura (shkalla e dytë), por edhe të zbulojë se cilët janë interesat e tij dhe interesat e palës tjetër që është e përfshirë në konflikt (shkalla e tretë). Si hap i radhës, individi duhet të mendojë për të gjitha mënyrat e mundshme në të cilat palët e përfshira në konflikt do të mund ta merrnin atë që e duan dhe të propozojë ide për zgjidhje të ndryshme të konfliktit (shkalla e katërt). Në fund, individi duhet ta dallojë zgjidhjen që në mënyrë më të mirë do t'i kënaqë interesat e të gjitha palëve të përfshira në konflikt, e më pas të merret vesh për zbatimin e saj me palët tjera (shkalla e pestë).

**Foto 9. Shkallë për zgjidhjen e konflikteve**



Njëra prej mënyrave të mundshme konstruktive për zgjidhjen e konflikteve është kompromisi. Megjithatë, për shkak të faktit se të gjitha palët e prekura duhet pjesërisht të heqin dorë nga diçka në mënyrë që të gjenden në mes me palën kundërshtuese, kompromisi nuk është gjithmonë mënyra më e mirë për zgjidhjen e një situatë të caktuar të konfliktit.

Mënyra më e mirë e zgjidhjes konstruktive të konflikteve është bashkëpunimi, për arsye se të gjitha palët e prekura janë të përfshira në mënyrë të barabartë në gjetjen e zgjidhjes për konfliktin që do të jetë e pranueshme për të gjithë aktorët e përfshirë.

Pasi që mësimdhënësi në aspektin teorik i arsyeton pesë hapat e shkallës për përballje me **konflikte**, i përfshin nxënësit në aktivitetin kryesor:

„Të gjithë njerëzit e botës kanë interesa të njëjtë kur bëhet fjalë për problemet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor. Kjo ndikon në të gjithë ne, pa dallim nëse jemi president i shtetit ose drejtor i ndonjë fabrike të madhe që shkakton ndotje.

Nëse të gjithë kemi interes që të zgjidhjen problemet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, parashtrohet pyetja, pse atëherë ato nuk janë zgjidhur? Njëra prej arsyeve është ajo se është shumë e vështirë që të arrihet pajtueshmëri. Zgjidhja e konflikteve që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor nënkupton përzierjen e faktorëve ekonomik, social, demografik, kulturor dhe etnik. Meqë në konfliktet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor janë të përziera shumë palë, shpesh formohen aleanca që bisedojnë dhe e rrisin efikasitetin në marrjen e vendimeve. Ka grupe të ndryshme që marrin anë të ndryshme në konfliktet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor. Për shembull, përfaqësuesit e sektorit industrial, autoritetet lokale, institucionet shkencore, ministritë dhe shërbimet qeveritare, organizatat joqeveritare shpesh kanë pikëpamje të ndryshme për atë se si duhet të zgjidhen problemet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor. Meqë problemet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor mund t'i tejkalojnë kufijtë shtetëror dhe ndërkombëtar, çështja e mjedisit jetësor është kujdes i çdo individi. Ky aktivitet merret me vështirësitë që paraqiten gjatë përpjekjeve për zgjidhjen e konflikteve që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor“.

### **Aktivitet:**

#### ***Ngjitje në shkallën e zgjidhjes së konfliktit që ka të bëjë me mjedisin jetësor (20 min.)***

Mësimdhënësi i grupon nxënësit nga dy veta. Njëres gjysmë të dysheve u thotë se tani nuk janë nxënës, por janë përfaqësues të një fabrike të madhe. Fabrika prodhon shumë produkte të dobishme për bashkësinë. Numri i të punësuarve në fabrikë është i madh, dhe nëse rastësisht pushon së punuari, shumë familje do të mbeten pa ekzistencë. Edhe gjysmës tjetër të dysheve mësimdhënësi u thotë se tani nuk janë nxënës, por janë banorë të qytetit ku gjendet fabrika. Ata konsiderojnë se duhet të mbyllet fabrika, meqë e ndotë qytetin. Fabrika i hedhë mbeturinat në lumin nga i cili banorët e qytetit





marrin ujë të freskët për pije. Uji i ndotur ndikon keq në shëndetin e banorëve. Mësimdhënësi u jep udhëzime nxënësve në disa minutat e ardhshëm t'i shënojnë, nevojat, interesat, qëndrimet dhe ndjenjat, e më pas edhe të bisedojnë rreth temës me partnerin e tyre dhe të merren vesh rreth strategjisë dhe qasjes për gjetjen e zgjidhjes për situatën konkrete. Më pas, mësimdhënësi i udhëzon nxënësit që secili prej çifteve të përzgjedhë edhe një çift, dhe banorët e qytetit të fillojnë diskutim me përfaqësuesit e fabrikës, me çka zgjidhjen duhet ta miratojnë për 10 minuta. Mësimdhënësi i përkujton nxënësit në strategjinë „Ngjitje në shkallë” dhe u tregon që të përdorin strategjinë gjatë përbaljes me **konfliktin**.

## ***Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)***

Pas përfundimit të aktivitetit mësimdhënësi fillon një diskutim të shkurtër me nxënësit:

- ➔ Si zhvillohej diskutimi në grupin? (Është e mundshme që disa nga grupet të mos kenë arritur fare deri te ndonjë zgjidhje, ndërsa të tjerët të kenë përpiluar edhe më shumë se një).
- ➔ Me cilat sfida jeni përballur gjatë procesit të përbaljes me konfliktin? (Është e pritshme që sfidat më të mëdha t'i ndajnë nxënësit e grupeve që nuk kanë ardhur deri te zgjidhja, por është mirë që mësimdhënësi t'i nxisë të gjithë nxënësit të mendojnë rreth kësaj çështjeje).
- ➔ Deri në çfarë zgjidhjes keni arritur?
- ➔ A mund të dalloni aspekte pozitive të konfliktit me të cilin përballeni? Nëse po, cilat janë ato?

*Moduli*



**QYTETAR  
NË SHOQËRI  
QYTETARE**

## ***Përmbajtja: Roli i qytetarit në shoqërinë***



### ***Rezultate nga nxënia***

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të dallojë rolin e tij si qytetar dhe t'i identifikojë mundësitë për përfshirje aktive në jetën shoqërore.



### ***Standarde/tregues***

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ përkufizojë qytetar dhe shoqëri qytetare,
- ➔ numërojë karakteristikat e shoqërisë qytetare.



### ***Materiale të nevojshme:***

stikerë në dy ngjyra, letër, lapsa kimik, fletë pune 3.1.



### ***Metoda, teknika, forma:***

formë (ligjërim) frontale (e përbashkët), punë individuale, punë në grupe, metodë demonstruese, diskutim, analizë e situatave.

## ***Pjesa hyrëse e orës (10 min.)***

Mësimdhënësi në fillim të orës u ndan nxënësve stikerë në dy ngjyra (shembull, të gjelbër dhe të verdhë) dhe u jep detyrë atyre që kanë tërhequr stikerë të verdhë (një gjysmë e nxënësve - grupi i verdhë), të shkruajnë dy ose tri fjalë asociacioni për termin qytetar, ndërsa atyre që kanë tërhequr stikerë të gjelbër (gjysma e dytë e nxënësve - grupi i gjelbër), të shkruajnë në stikerët dy ose tri fjalë asociacioni për termin shoqëri qytetare. Stikerët për termin qytetar (grupi i verdhë) ngjiten në njërin anë të klasës, ndërsa stikerët për termin shoqëri qytetare (grupi i gjelbër) ngjiten në murin nga ana tjetër e klasës.

Vijon një shëtitje e shkurtër e galerisë nëpër klasën. Pritet që fjalët e asociacionit të jenë të ngjashme dhe të përsëriten në të dyja anët. Nëse nuk ndodhë kjo, mësimdhënësi duhet të nisë diskutim në mënyrë që t'i orientojë drejt karakteristikave "të përbashkëta" që i përkufizojnë termin qytetar dhe shoqëri qytetare (p.sh. aktivitet, pjesëmarrje, demokraci, të drejta dhe përgjegjësi, mbrojtje e të drejtave, respektim i ligjeve, avancim i të drejtave dhe ligjeve, etj.).

Më pas mësimdhënësi jep detyrë nga fjalët e stikerëve, por edhe nga materiali i mësuar paraprakisht, nxënësit të tentojnë t'i përkufizojnë termin qytetar dhe termin shoqëri qytetare.

Përkufizime të mundshme të termeve:

**Qytetar** është njeriu që ka të drejta, liri dhe përgjegjësi, është i barabartë me qytetarët tjerë dhe ka rol aktiv në jetën shoqërore në bashkësi (shtet).

**Shoqëria qytetare** është bashkësi e qytetarëve të cilët janë bartësit e të drejtave, lirive dhe përgjegjësive të caktuara dhe punojnë në interesin e të gjithë qytetarëve.

## ***Pjesa kryesore e orës (30 min.)***

### ***Pjesa teorike (5 min.)***

Njeriu natyrisht është i parapërcaktuar të jetojë në bashkësi. Ai bashkë me njerëzit tjerë jeton, krijon, i plotëson nevojat e tij jetësore, shpirtërore dhe kulturore. Në mënyrë që njerëzit të jetojnë së bashku dhe të bashkëpunojnë, marrëdhëniet mes tyre në bashkësi duhet doemos të rregullohen me rregulla. Kjo haset në të gjitha shoqëritë në histori. Shteti i përcakton rregullat që njerëzit paraprakisht i vendosin si marrëveshje shoqërore. Ato zakonisht quhen ligje. Për zbatimin e ligjeve kujdesen institucionet e shtetit. Në shoqëritë demokratike me ligjet garantohen edhe të drejtat dhe liritë e njeriut.



Ndonëse shpeshherë qytetari përkufizohet si shtetas i një vendi të caktuar, me çka i takojnë të drejta të caktuara, koncepti ka rëndësi më të gjerë dhe ka të bëjë me ndjenjën personale të përkatësisë ndaj një bashkësie të caktuar, në të cilën qytetari mund të veprojë dhe ndikojë. Bashkësia mund të jetë e përcaktuar gjeografikisht, në bazë të asaj se ku jeton individi (bashkësia lokale), por edhe në bazë të shtetit të cilit i takon. Por, përkatësia përcaktohet edhe në bazë të ndarjes së vlerave të njëjta, si pjesë e identitetit të një individi.

Kur jemi pjesë e një bashkësie të caktuar, mund të ndikojmë në zhvillimin e saj dhe të kontribuojmë drejt mirëqenies. Shikuar në këtë mënyrë, roli i qytetarit përcaktohet si praktikë e pjesëmarrjes aktive në shoqëri. Qytetaria aktive në fakt nënkupton punë në përmirësimin e bashkësisë dhe jetës së të gjithë anëtarëve të saj. Qytetaria demokratike është koncept i përafërt që nënkupton se qytetarët duhet të veprojnë në bazë të parimeve dhe vlerave demokratike, siç janë pluralizmi, respektimi i dinjitetit të njeriut dhe sundimi i së drejtës.

Pritet që qytetarët t'i pranojnë vlerat dhe parimet themelore të demokracisë, të marrim përsipër obligime për funksionimin demokratik të shtetit, por edhe të punojnë drejt përparimit të vazhdueshëm të tyre. Qytetari njëherësh duhet të jetë i pavarur në vendimmarrjen e tij, e me këtë edhe i fuqishëm të ndryshojë shoqërinë në mënyrë që të jetë më mirë për të gjithë. Nga qytetarët pritet të veprojnë për të mirën e të gjithëve, gjegjësisht në emër të së mirës publike.

Mësimdhënësi, gjatë prezantimit të përmbajtjes, mund të nxisë diskutim përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Ndaj cilave bashkësi personalisht ndjejnë përkatësi? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga ana e nxënësve: bashkësisë së shkollës, familjes, komunës, shtetit, etj.).
- ➔ Sa e konsideroni veten qytetarë aktiv? Pse? (Pritet që nxënësit të ndajnë qëndrime dhe përvoja personale).
- ➔ Çfarë mund të bëni nëse nuk jeni dakord me disa rregulla, ligje? (Përgjigje të mundshme: të tentoj t'i ndryshoj, të ngre vetëdijen publike për këtë, të marr pjesë në diskutime rreth tyre, etj.).
- ➔ Si do të vepronit nëse vëreni se dikush nuk i respekton ligjet? (Përgjigje të pritura: do të reagoj, do të tregoj se si janë ligjet, do të hesht, do të shtirem se nuk kam vërejtur, etj.).
- ➔ Si do të reagonit nëse vëreni se dikush vepron vetëm për të siguruar të mira personale, e me këtë rast, nuk kujdeset për të tjerët në bashkësi? (Pres përgjigje: do të reagoj, do të ushtroj presion që të merren parasysh të tjerët në bashkësi, etj.).

## Aktivitet:

### **Analizë e situatës (25 min.)**

Nxënësit ndahen në katër grupe. Secili grup merr nga një situatë të problemit nga fleta e punës 3.1. situatat kanë të bëjnë me problemet hipotetike, por reale në shoqërinë civile. Secili nxënës e lexon situatën në mënyrë të mëvetësishme, e më pas zhvillohet diskutim brenda grupit. Grupi duhet të ofrojë tejkalim të problemeve përmes disa zgjidhjeve të qëndrueshme.

Pasi të përfundojë diskutimi në grupe, diskutimi zgjerohet në nivel të paraleles. Situatat lexohen para të gjithë nxënësve dhe më pas tregohen zgjidhje për situatat në nivel të grupit, ndërsa grupet tjera mund të japin propozime të tyre për zgjidhje të tjera të mundshme të situatës së prezantuar. Nuk ka zgjidhje të sakta dhe të pasakta të situatave të problemit. Qëllimi është që nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike gjatë zgjidhjes së situatave problematike nga jeta e përditshme. Mësimdhënësi mund t'i përdorë pyetjet si vijon në mënyrë që ta udhëheqë diskutimin.

- ➔ Sa e kishit të vështirë që të arrini deri te zgjidhja e situatës? Pse? (Pritet nga nxënësit të ndajnë se situatat nuk janë të thjeshta për t'u zgjidhur, ndërsa marrja në konsideratë e nevojave të të gjitha palëve është komplekse).
- ➔ Çfarë zgjidhje ofruat? A do të jenë të gjitha palët të kënaqura nga zgjidhjet? (Pritet nga nxënësit që t'i analizojnë zgjidhjet e ofruara prej më shumë aspekteve, duke u kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të ndryshme të palëve të prekura).
- ➔ A dalloni situata të ngjashme në mjedisin tuaj të drejtpërdrejt ose keni dëgjuar për situata të ngjashme nga mediat? (Pritet nga nxënësit të ndajnë përvoja dhe shembuj personalë nga jeta e përditshme).
- ➔ Si zhvillohej diskutimi në grupet? Sa mendime të ndryshme janë marrë parasysh? Si vendosët për një zgjidhje? (Pritet nga nxënësit të ndajnë informacione për mënyrën e punës së grupeve, problemet me të cilat janë përballur, mekanizmat me të cilat i kanë zgjidhur, etj.).
- ➔ Sa ka ndikim zhvillimi i përgjegjësisë qytetare në paraqitjen e situatave të këtilla dhe të ngjashme? (Përgjigje të pritura: ndikim i madh – nëse njerëzit janë më të përgjegjshëm, nuk do të ketë situata të këtilla, ndikim të vogël – madje edhe nëse disa njerëz janë më të përgjegjshëm, kjo nuk do të thotë se të gjithë do të punojnë në parandalimin e situatave të këtilla, etj.).
- ➔ Çfarë qasje na nevojitet për zgjidhjen e problemeve? (Pritet nga nxënësit ta potencojnë nevojën për marrjen në konsideratë të nevojave të ndryshme të të gjitha palëve të prekura).





- ➔ Çfarë mund të bëni ju personalisht në mënyrë që t'i zbatoni zgjidhjet që i keni përpiluar në mënyrë që të parandalohen situata të këtilla në të ardhmen? (Pritet nga nxënësit të ndajnë ide të ngjashme rreth zbatimit të mundshëm të zgjidhjeve të ofruara).

Konstatohet se situata të këtilla ka në jetën e përditshme, por sa më e zhvilluar që është shoqëria, për aq është më e madhe përgjegjësia qytetare dhe zgjidhjet që arrihen kanë për qëllim që t'i plotësojnë nevojat e të gjitha palëve. Të gjithë qytetarët kanë për obligim të punojnë në parandalimin në mënyrë që të mos vjen deri te situatat e këtilla të komplikuar problematike, përmes forcimit të institucioneve dhe formimit të qytetarëve të vetëdijshëm dhe të përgjegjshëm. Mësimdhënësi mund t'i nxisë nxënësit që të ndajnë probleme me të cilat përballesh në përditshmërinë e tyre dhe mënyrat e mundshme në të cilat do t'i kishin zgjidhur. Problemet e ndara mund të përdoren edhe gjatë orës së radhës kur përpunohet pjesëmarrja qytetare/rinore.

## ***Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)***

Në pjesën përfundimtare mësimdhënësi i pyet nxënësit që të përmendin disa karakteristika të shoqërisë qytetare.

Përgjigje të mundshme të nxënësve për karakteristika të shoqërisë qytetare:

- ➔ Respektim i të drejtave dhe lirive të njeriut;
- ➔ Respektim dhe pranim i diversiteteve;
- ➔ Humanitet dhe mosdiskriminim;
- ➔ Liri e fjalës (shprehje e mendimit);
- ➔ Liri e grupimit, organizimit dhe tubimit;
- ➔ Aktivitete vullnetare të qytetarëve në funksion të së mirës publike.

Mësimdhënësi çel diskutim për pyetjet si vijon:

- ➔ Si t'i arrijë shoqëria jonë karakteristikat e shoqërisë qytetare?
- ➔ Çfarë mund të bëni ju?

## Fletë pune 3.1.

### **Analizë e situatave problematike**

#### **Situata 1**

Në pjesën periferike të qytetit ndërtohet një lagje urbane. Projekti i lagjes parashikon të ndërtohet shkollë fillore moderne në pjesën qendrore të lagjes. Mirëpo, një pjesë e fshatarëve nga fshati fqinj në atë lokalitet kanë pronë që nuk duan t'ia shesin shtetit. Për shkak të kësaj propozohet që të ndryshohet plani fillestar dhe shkolla të ndërtohet në fund të lagjes menjëherë pranë rrugës kryesore e cila është dykahëshe, automjetet ngasin shpejtë dhe ka trotuar vetëm nga njëra anë. Shumica e prindërve do të duhet t'i sjellin fëmijët e tyre me automjete në shkollë, ndërsa nuk ka vend për parking.

#### **Situata 2**

Në një shkollë të mesme sipas projektit të parlamentit të nxënësve tërësisht po rregullohet oborri i shkollës me më shumë kënde për shoqërimin e nxënësve dhe klasa në të hapur, parking të biçikletave dhe gjelbërim të ri. Rregullimin e bën drejtorja e shkollës me financim nga buxheti i shkollës. Pjesa më e madhe e nxënësve janë vullnetarë gjatë rregullimit. Shkolla gjendet në lagje urbane në të cilën nuk ka park. Qytetarët duan ta përdorin oborrin e shkollës si park, gjë të cilës i kundërvihet parlamenti i nxënësve, por kundër është edhe drejtorja e shkollës. Komuna në mënyrë që t'i kënaqë qytetarët lejon që të përdoret oborri i shkollës. Prandaj, një pjesë e gjelbërimit dhe pajisjes është shkatërruar nga qytetarët e pandërgjegjshëm.

#### **Situata 3**

Në një fshat malor ndërtohen shtëpi për zhvillimin e turizmit rural nga një investitor. Janë ndërtuar 20 shtëpi të bukura me oborre të bukura. Njëherësh, investitori fillon të ndërtojë ndërtesë me 20 banesa në qytet. Banesat ende të pandërtuara i blejnë qytetarë të moshës prej 22 deri 35 vjeç. Ndërkohë investitori bankroton. I dëmshpërblen qytetarët të cilët kanë blerë banesa në ndërtesën e sapondërtuar me shtëpi në fshatin malor që gjendet 55 km larg qytetit. Qytetarët të cilët banesat i kanë blerë me kredi banesore duhet doemos ta pranojnë dëmshpërblimin dhe pjesa më e madhe e tyre shpërngulen në fshat. Nga fshati për në qytet nuk ka transport publik.

#### **Situata 4**

Në Organizatën Rinore (OR) të shkollës, nxënësit zakonisht tubohen për realizimin e aktiviteteve jashtëshkollore që janë në interes të tyre të veçantë. Konkretisht në këtë moment nxënësit në kompjuterët e OR-së përgatisin fjalime për mbrëmjen oratore që është planifikuar të ndodhë për disa muaj. Ndërkohë në shkollë regjistrohet një nxënës i ri me shikim të dëmtuar i cili është i interesuar të marrë pjesë në mbrëmjen oratore. Në OR, ndërsa edhe në shkollë nuk ka tastiere dhe kompjuter përkatës për nxënës me shikim të dëmtuar. OR-ja nuk ka mjete për të blerë një pajisje të tillë. OR-ja nuk e di se çfarë të ndërmarrë për të siguruar kushte në mënyrë që bashkënxënësi me shikim të dëmtuar të përgatisë fjalimin në organizatën rinore të shkollës dhe të përfshihet në mënyrë aktive në mbrëmjen oratore.

## Përmbajtja: Qytetar në shoqëri qytetare



### Rezultate nga nxënia

Nxënësi/nxënësja është i /e aftë të dallojë rolin e tij si qytetar dhe t'i identifikojë mundësitë për përfshirje aktive në jetën shoqërore.



### Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësja mund të:

- identifikojë mundësitë për angazhim në shoqëri qytetare,
- demonstrojë pjesëmarrje aktive në proceset shoqërore.



### Materiale të nevojshme:

letër, lapsa kimik, fletë pune 3.2



### Metoda, teknika, forma:

punë në grup, diskutim, formë frontale (e përbashkët)

## **Pjesa hyrëse e orës (10 min.)**

Mësimdhënësi e fillon orën me parashtrimin e pyetjeve për të gjithë nxënësit që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e nxënësve/rinisë.

- A e dini se çfarë do të thotë pjesëmarrja e nxënësve? (Pritet nga nxënësit të përkujtohen në dituritë e përvetësuara në klasën e tetë dhe të nëntë, nga lënda e arsimit qytetar).
- Çfarë nënkuptoni me pjesëmarrje aktive, e çka me pjesëmarrje rinore? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga nxënësit, varësisht nga përvojat e tyre të deriatëhershme).
- A keni dëgjuar për shkallën e pjesëmarrjes të Roxher Hartit? Çfarë dini për të? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme).
- A keni marrë pjesë në ndonjë nismë të nxënësve ose nismë rinore? Si ka qenë ajo nismë (e organizuar, në formë të stuhishme, etj.)? (Pritet nga nxënësit të ndajnë përvoja personale).

Disa nxënës mund të prezantojnë shkurtimisht ndonjë nismë të nxënësve ose nismë qytetare në të cilën kanë qenë të përfshirë ose për të cilën kanë dëgjuar.

Hapet një diskutim i shkurtër në nivel të paraleles. Mësimdhënësi e thekson rëndësinë e pjesëmarrjes autentike të të rinjve në proceset shoqërore, që është e pranishme si grup i posaçëm i të drejtave në „Konventën për të drejtat e fëmijës”, që nga ana tjetër është dokument obligues i ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## **Pjesa kryesore e orës (30 min.)**

Nxënësve u lëshohet një video klip: <https://www.youtube.com/watch?v=GIPIARPTaqc>

Kjo video shërben si frymëzim për diskutim mes nxënësve, që mësimdhënësi e udhëheq përmes parashtrimin të pyetjeve si për shembull:

- Sa mund të ndryshojë botën pjesëmarrja e të rinjve në shoqëri?
- Cilat janë veçoritë e përbashkëta të të rinjve të cilët janë aktivistë qytetar?

## ***Pjesa teorike (5 min.)***

### ***Pjesëmarrje qytetare***

Qytetarët ndikojnë në vendimet e pushtetit përmes zgjedhjeve demokratike kur e zgjedhin pushtetin, por zgjedhjet mbahem çdo 4 vite, ndërsa qytetarët duhet të ndikojnë vazhdimisht në vendimet e pushtetit. Mënyrë tjetër se si të ndikohet në vendimet e pushtetit është përmes vetorganizimit, nismave qytetare dhe formave të tjera të veprimit.

Qytetarët në bazë të së drejtës qytetare për liri të bashkimit dhe organizimit mundën vetë në bazë të interesave të tyre, të vetorganizohen në shoqata të llojllojshme qytetare. Shoqatat paraqesin organizata joqeveritare, jopartiake dhe jofitimprurëse në të cilat qytetarët bashkohen për shkak të realizimit të interesave dhe bindjeve ekologjike, sociale, kulturore, shkencore, humanitare, arsimore, sportive dhe të tjera.

Gjithashtu një qytetar, grupe ose shoqata të qytetarëve mund të fillojnë nismë qytetare që del nga nevojat dhe interesat e qytetarëve dhe atë ta dorëzojnë deri te pushteti lokal ose qendror.

Qytetarët përmes lidhshmërisë, bashkimit, vetorganizimit, nismave qytetare, peticioneve dhe projekteve të fushave të ndryshme, që kanë rezultuar nga nevojat dhe interesat e qytetarëve, ndikojnë në pushtetin demokratik që të ndërmerë aktivitete për të mirën publike

### ***Pjesëmarrja rinore***

Mësimdhënësi përmendë se është shumë e rëndësishme që nxënësit të aktivizohen në shkollë dhe shoqëri, meqë edhe ata janë qytetarë në shoqëri qytetare dhe tashmë prej moshës 15 vjeçe mund të jenë anëtarë dhe të themelojnë shoqata qytetare me leje nga prindi/kujdestari. Përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit në bashkësi, të rinjtë mësojnë se çfarë do të thotë të jesh qytetar aktiv dhe të njëjtën e praktikojnë. Nxënësit mund të angazhohen në lokalizimin dhe zgjidhjen e problemeve konkrete në bashkësi. Nxitja dhe mbështetja e nxënësve që të zbatojnë nisma të nxënësve konsiderohet si veçanërisht e rëndësishme për zhvillimin e sjelljes qytetare, që nuk do të jetë e kufizuar vetëm në klasë, por do të bartet edhe në kuadër të bashkësisë përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejt për inicimin e ndryshimit të dëshiruar shoqëror, vullnetarizëm, etj. Sipas „Shkallës për pjesëmarrje rinore” të Roxher Hart (Foto 10), është me rëndësi që nxënësit të jenë të informuar për aktivitetet dhe të kenë mundësi që të inicojnë dhe zbatojnë aktivitetet e përpiluara.

Që një nismë e nxënësve të jetë e suksesshme, duhet të jetë e organizuar mirë dhe rekomandohet që të kalojë nëpër disa faza.

### **Aktivitet:**

#### ***Nisma të nxënësve/qytetare (20 min.)***

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup e merr fletën e punës 3.2. Në bazë të diskutimit hyrës gjatë të cilit nxënësit kanë ndarë përvoja personale nga pjesëmarrja në nisma të nxënësve, ata duhet të vlerësojnë suksesin e nismës (procesin dhe rezultatet), përmes përcaktimit se cilat nga karakteristikat /treguesit e përmendur janë plotësuar dhe në çfarë niveli.

Nëse nxënësit nuk kanë pasur përvojë fare në zbatimin e nismave të nxënësve, udhëzohen që të mendojnë për ndonjë nismë që do të donin ta zbatojnë. Në rast të tillë, duhet të fokusohen drejt përmbushjes së tri fazave të para nga formulari (fletë pune 3.2).

Pas përfundimit të punës në grupe, secili prej grupeve e prezanton atë që është punuar.


#### ***Pjesa përfundimtare e orës (5 min.)***

Në pjesën përfundimtare, mësimmshënësi nxitë diskutim për përfitimet nga nismat e nxënësve/të rinjve, dhe nxjerr në pah disa prej tyre:

- ▶ Zhvillim të ndjenjës për të tjerët;
- ▶ Zhvillim të ndjenjës për problemet në vendin ku jetojmë;
- ▶ Nxitje të përgjegjësisë personale dhe shoqërore;
- ▶ Përmirësim të vetëbesimit;
- ▶ Ndjenjë të përkatësisë dhe lojalitetit ndaj shkollës/bashkësisë.



Foto 10. Nivelet e pjesëmarrjes sipas „Shkallës së pjesëmarrjes rinore“ (Roxher Hart).



## *Fletë pune 3.2*

### **Vlerësim i nismës së nxënësve/ qytetare**

---

***Përshkrim i shkurtër i nismës:***

---

#### ***Faza 1:***

##### ***Identifikim i situatave/nevojave/problemeve***

Nxënësit bisedojnë për nevojat e shkollës/bashkësisë së tyre ose analizojnë fusha që duhet të përmirësohen.

Vlerësim:

---

#### ***Faza 2:***

##### ***Zgjedhje e nevojës/problemimit përmes metodës demokratike***

Nga nevojat/problemet e përmendura, në mënyrë demokratike (votim publik ose i fshehtë, kompromis) është përzgjedhur një problem në të cilin të gjithë nxënësit janë dakord që të punojnë.

Vlerësim:

---

---

### **Faza 3.**

#### **Planifikim i mënyrës në të cilën do të zgjidhet problemi**

Nxënësit bëjnë plan të aktiviteteve që duhet të ndërmerren në mënyrë që të zgjidhet problemi. Plani përfshin:

- ➔ Çfarë aktivitete duhet të ndërmerren
- ➔ Sa kohë do të zgjasë aktiviteti (sipas fazave)
- ➔ Ndarja e roleve (kush dhe çfarë do të bëjë secili prej nxënësve, formim të ekipeve)
- ➔ Ndhimë e jashtme (cilët faktorë të jashtëm mund të përfshihen dhe si)

Vlerësim:

---

### **Faza 4.**

#### **Realizim i aktiviteteve në kuadër të nismës**

Nxënësit ndërmarrin aktivitete konkrete në mënyrë që ta zgjidhin problemin e lokalizuar, me ç'rast:

- ➔ Janë të përfshirë në mënyrë aktive në realizimin e aktiviteteve,
- ➔ Janë trajtuar si të barabartë me të rriturit,
- ➔ Bashkëpunojnë, komunikojnë mes vete,
- ➔ Kanë rol të rëndësishëm në marrjen e vendimeve gjatë realizimit të aktivitetit,
- ➔ Dëgjojnë në mënyrë aktive dhe i shprehin lirshëm mendimet dhe qëndrimet e tyre,
- ➔ Aktivitetet realizohen përmes bashkëpunimit të nxënësve të cilët mësojnë në gjuhë të ndryshme mësimore (nëse shkolla ka mësim në më shumë gjuhë).

Vlerësim:

---

---

## **Faza 4A.**

### **Përfshirje e subjekteve të tjera**

Gjithmonë kur ka mundësi, rekomandohet të përfshihet edhe bashkësia, veçanërisht për aktivitetet më afatgjate, që nënkuptojnë zgjidhje të qëndrueshme. Gjatë përfshirjes, ekipet e nxënësve dërgojnë letra, caktojnë takime etj. me ata për të cilët konsiderojnë se mund të ndihmojnë, si për shembull:

- ➔ Faktorët e ndryshëm në shkollë (drejtor, shërbim profesional, mësimdhënës të tjerë, bashkësi e nxënësve);
- ➔ Mbështetje nga këshilli i prindërve dhe prindër të përfshirë në aksionin;
- ➔ Janë përfshirë përfaqësues nga komuna nga Këshilli i Komunës ose administrata e komunës;
- ➔ Janë përfshirë përfaqësues të sektorit afarist;
- ➔ Për realizimin e aktivitetit është marrë mbështetje (financiare, teknike) nga Komuna;
- ➔ Për realizimin e aktivitetit është marrë mbështetje (financiare, teknike) nga sektori afarist.

Vlerësim:

---

## **Faza 5.**

### **Rezultate nga aktivitetet**

Varësisht nga lloji i saj, nisma mund të rezultojë me epilogë të ndryshëm. Një pjesë e tyre janë konkrete dhe menjëherë të dukshme, ndërsa një pjesë kanë të bëjnë me ndryshime në dituritë, qëndrimet, vlerat (ngritje të vetëdijes për një çështje/temë të caktuar):

- ➔ Aktiviteti rezulton me ndryshim fizik të mjedisit,
- ➔ Aktiviteti rezulton me vetëdije të ngritur për një çështje të caktuar,
- ➔ Aktiviteti rezulton me ngritjen e një çështjeje/problemi të caktuar në nivel më të lartë,
- ➔ Aktiviteti rezulton me ndihmë/përmirësim të gjendjes së kategorive të caktuara të rrezikuara të qytetarëve.

Vlerësim:

---

---

## **Faza 6.**

### ***Reflektim për atë që është zbatuar***

Pas përfundimit të nismës, bëhet reflektim me pyetjet si vijon:

- ➔ Çfarë risie mësuat/kuptuat?
- ➔ Çfarë ishte e vështirë/e lehtë/sfidë për ju?
- ➔ Si ndjeheshit?
- ➔ Çfarë do të bënit ndryshe?

Vlerësim:

---

**Niveli i vlerësuar i përfshirjes sipas „Shkallës së pjesëmarrjes” së Roxher Hartit (shiko foto)**

---

# Përmbajtja: Të drejta dhe përgjegjësi



## Rezultate nga nxënia

Nxënësi/nxënësja i identifikon të drejtat e njeriut, të drejtat dhe liritë qytetare që t'i respektojë në situatat e përditshme dhe është i /e aftë t'i ndërlidhë me përgjegjësitë përkatëse



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësja mund të:

- përshkruajë zhvillimin e të drejtave të njeriut,
- debatojnë për respektimin e të drejtave dhe përgjegjësive të qytetarëve në mjedisin e tyre.



## Materiale të nevojshme:

LCD projektor, internet, fleta/hamer, lapsa kimik,



## Metoda, teknika, forma:

formë e përbashkët e punës, punë në grupe, stuhi e ideve, bisedë e udhëzuar (diskutim).

## ***Pjesa hyrëse e orës (5 min.)***

Mësimdhënësi e fillon orën me diskutim të shkurtër sipas pyetjeve si vijon:

- ➔ Si ka qenë në të kaluarën, a kanë pasur njerëzit gjithmonë të drejta? Sqaroi përmes shembullit. (Pritet nga nxënësit të tregojnë se njerëzit jo gjithmonë kanë pasur të drejta; shumë shpesh kishte dukuri si skllavëri, racizëm, antisemitizëm, pabarazi gjinore, etj.).
- ➔ Në cilin dokument janë rregulluar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit në Republikën e Maqedonisë së Veriut? (Pritet që nxënësit të shprehen për Kushtetutën e RMV-së).
- ➔ A dini ndonjë dokument ndërkombëtar që është pjesë e luftës për të drejta të njeriut? (Përgjigje të mundshme: Deklarata universale e të drejtave të njeriut, Konventa evropiane e të drejtave të njeriut, Magna Karta, etj.).
- ➔ A janë gjithmonë të plotësuara të drejtat dhe liritë që janë të garantuara me Kushtetutë dhe ligjet? (Pritet nga nxënësit që të përmendin shembuj për mosrespektimin e të drejtave të njeriut [etnike, gjinore, sociale, kulturore, etj.] të ne ose më gjerë).

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve dhe thekson se të drejtat e njeriut dhe përgjegjësitë janë pjesë shumë e rëndësishme e shoqërive moderne demokratike, për shkak se mundësojnë barazi të garantuar mes qytetarëve dhe mundësi për zhvillim shoqëror.

## ***Pjesa kryesore e orës (30 min.)***

### ***Pjesa teorike***

Ndonëse ideja për rregullimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, në ndonjë formë themelore, mund të thuhet se ekziston thuajse 4000 vite, me miratimin e Kodit të Hamurabit nga ana e mbretit të gjashtë të Babilonit Hamurabi (shek. XVIII p.e.s.), megjithatë si kthesë e madhe dhe tejet e rëndësishme në këtë fushë konsiderohet miratimi i Kartës së madhe të lirisë (Magna Carta Libertatum) në shekullin XIII të epokës tonë në Angli si akt obligues për mbretin Xhon i Pavend (John Lackland). Me këtë kartë mbreti ka qenë i obliguar të respektojë disa procedura ligjore gjatë veprimit me qytetarët e tij dhe liritë e tyre. Me këtë akt për herë të parë formalisht kufizohet fuqia mbretërore e cila deri atëherë ka qenë e pakufizuar.

Themeli bashkëkohor i promovimit ndërkombëtar të të drejtave dhe lirive të njeriut është „Deklarata universale për të drejtat e njeriut“ e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor të vitit 1948, si rezultat i leksionit të mësuar nga Lufta e Dytë Botërore. Për herë të parë në historinë e njerëzimit, ky dokument e garanton dhe mbron karakterin universal e të drejtave të njeriut.

### **Aktivitet:**

#### ***Diskutim për të drejtat e njeriut (15 min.)***

Mësimdhënësi projektton një video klip me titull “HUMAN RIGHTS STORY – HISTORI PËR TË DREJTAT E NJERIUT” që gjendet në YouTube (link). Nëse nuk ka mundësi për projektim gjatë orës, nxënësve u jepet për detyrë që ta shikojnë klipin në shtëpi, para fillimit të orës.

Mësimdhënësi nxitë diskutim për përmbajtjen e videove. Ndahen përshtypjet për zhvillimin e të drejtave të njeriut, nxënësit e komentojnë pjesën me vetëdijen dhe njohjen e njerëzve për të drejtat e njeriut. Mësimdhënësi e udhëheqë diskutimin përmes pyetjeve:

- ➔ Pse duhet t’i di të drejtat e mia? (Përgjigje të pritura: që të jem qytetar i vetëdijshëm dhe aktiv, të mund t’i gëzoj të drejtat e mia duhet të di se cilat janë...).
- ➔ Pse duhet të jem i kujdesshëm për të drejtat e huaja? (Përgjigje të pritura: obligim moral dhe ligjor që të mos shkelen të drejtat e njerëzve të tjerë, për shkak të dënimit nga shoqëria, sanksioneve nga shteti, etj.).

Mësimdhënësi mund të propozojë temë për diskutim sipas zgjedhjes së tij.

Pas përfundimit të diskutimit në raport me videot e propozuara, vazhdohet me aktivitetin e radhës, qëllimi i të cilit është të tregojë se gëzimi i të drejtave të ndryshme nënkupton edhe parakushtet që i mundësojnë të drejtat e njeriut.



## Aktivitet:

### ***Pema e të drejtave të njeriut (15 min.)***

#### **Udhëzime për mësuesin:**

Ndani nxënësit në disa grupe të vogla. Secili grup duhet të vizatojë një pemë të të drejtave të njeriut. Udhëzimet janë si vijon:

- ➔ Në pemën, (në formë të degëve, fletëve, luleve, frutave) vizatoni dhe shënoni ato të drejta të njeriut që mendoni se u nevojiten njerëzve në mënyrë që të jetojnë jetë dinjitoze dhe të drejtë.
- ➔ Mirëpo pema e të drejtave të njeriut, si edhe të gjitha pemët, ka rrënjët e saj, që i nevojiten në mënyrë që të rritet dhe lulëzojë. Prandaj, vizatoni dhe shënoni rrënjët me ato gjëra që i mundësojnë të drejtat e njeriut.
- ➔ **Shembull për të drejta:** E drejta e jetës; Liri nga torturimi; Liri nga robëria; E drejta e lirisë dhe sigurisë; E drejta e gjyqimit të drejtë; E drejta e përmirësimit efektiv nëse ndonjë e drejtë është shkelur; Liri nga diskriminimi, e drejta e barazisë; E drejta për t'u njohur si qenie njerëzore; E drejta e nacionalitetit; E drejta e privatësisë dhe jetës familjare; E drejta e martesës; E drejta e pronësisë; E drejta e lëvizjes së njerëzve; E drejta e azilit; Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit; Liria e shprehjes; Liria e tubimit dhe bashkimit; E drejta e mbrojtjes shëndetësore; E drejta e arsimit; E drejta e punësimit; E drejta e pushimit dhe kohës së lirë; E drejta e mbrojtjes sociale; E drejta e pjesëmarrjes politike; E drejta e pjesëmarrjes në jetën kulturore; Ndalesë për shkeljen e të drejtave të njeriut...
- ➔ **Shembull për faktorë që kontribuojnë në zbatimin e të drejtave të njeriut:** ekonomi e qëndrueshme, sundim i së drejtës, shoqëri e integruar, sistem cilësor arsimor dhe shëndetësor, etj.

Këto vizatime mund të vendosen në klasë.

Në fund të ushtrimit, disa vullnetarë mund të ndajnë se çfarë kanë shkruar në pemën e tyre e të drejtave të njeriut.

## *Pjesa përfundimtare e orës (5 min.)*

Mësimdhënësi nxjerrë konstatim nga përmbajtja:

Zhvillimi i të drejtave të njeriut ka qenë një proces i gjatë historik, i cili ende nuk ka përfunduar. Ky është një proces dinamik që do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Për shkak të kësaj, shtetet duhet të punojnë në zgjerimin e spektrit të të drejtave të njeriut (duke rregulluar të drejtat e bashkësive të ndryshme të marginalizuara, të drejtat që duhet të rezultojnë për shkak të ndryshimeve klimatike, etj.). Njohja e të drejtave të njeriut u mundëson njerëzve që t'i respektojnë, por edhe t'i mbrojnë të drejtat e tyre në raste kur ato do t'u shkelen. Përgjegjësia kryesore e qytetarëve është që të mos i shkelin të drejtat e njerëzve të tjerë.

Si përgatitje për orën e radhës, mësimdhënësi i ndan në mënyrë elektronike me nxënësit versionet digjitale të Kushtetutës së RMV-së dhe „Deklaratën universale të të drejtave të njeriut“:

Kushtetuta e RMV-së: <https://www.sobranie.mk/content/ustav%20al/ustav%20rsm-al-ok.pdf>

DUDNJ: <https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Pages/Language.aspx?LangID=aln>

## *Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)*

Mësimdhënësi nxitë diskutim përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Çfarë risie mësuat në orë?
- ➔ Çfarë nga kjo që e keni mësuar do t'ju shërbejë në përditshmëri?
- ➔ Sa vëreni rreth jush respektim ose mosrespektim të të drejtave të njeriut?
- ➔ Çfarë mund të bëni ju si nxënës në mënyrë që të parandaloni mosrespektimin e të drejtave të njeriut?

# Përmbajtja: Të drejta dhe përgjegjësi



## Rezultate nga nxënia

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:

- identifikojë të drejtat e njeriut, të drejtat dhe liritë qytetare,
- respektojë të drejtat e njeriut në situata të përditshme dhe është i/e aftë t'i ndërlidhë me përgjegjësitë përkatëse.



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësja mund të:

- numërojë llojet e të drejtave dhe përgjegjësive,
- grupojë të drejta dhe përgjegjësitë e qytetarëve në shoqërinë qytetare.



## Materiale të nevojshme:

Kushtetuta e RMV-së, fletë pune 3.3, fletë pune 3.4., fletë pune 3.5, tabelë, marker/shkumës.



## Metoda, teknika, forma:

Punë në grupe, stuhi e ideve, diskutim, bisedë e orientuar, T-lista

## Pjesa hyrëse e orës (5 min.)

Mësimdhënësi e fillon orën me një diskutim të shkurtër përmes stuhisë së ideve:

- ➔ Cila është gjëja e parë që fjala e drejtë u asocion, si e drejtë e njeriut? (Përgjigje të mundshme: liri për të vepruar në njëfarë mënyre, obligim që të mos veproj në mënyrë të caktuar, barazi e njerëzve, etj.).
- ➔ Pse nevojitet që shteti t'i garantojë të drejtat e njeriut? (Përgjigje të mundshme nga nxënësit: që të ndjehemi të mbrojtur dhe të sigurt, të parandalohet mundësia që dikush lirisht dhe pa sanksione të na i shkelë të drejtat, etj.).
- ➔ A janë të drejtat të pakufizuara ose ka ndonjë kufi deri te i cili arrijnë? Pse do të ishin të kufizuara? (Përgjigje të pritura: derisa gëzimi i së drejtës sime nuk cenon të drejtën e huaj; në situata të caktuara shteti mund t'i kufizojë të drejtat tona).
- ➔ A nënkupton e drejta që të sillemi siç duam? Pse? (Pritet nga nxënësit të përgjigjen se sjellja duhet doemos të jetë në përputhje me ligjet dhe mund të sillemi lirisht vetëm deri në atë shkallë në të cilën është e drejta jonë ).

## Pjesa kryesore e orës (20 min.)

Ideja për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor të të gjithë njerëzve është kyç për konceptin e të drejtave të njeriut. Të drejtat dhe liritë e njeriut janë karakteristike për të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh racën, gjininë, përkatësinë kombëtare, etnike, gjuhën, religjionin ose çfarëdo statusi tjetër.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut e vitit 1991, si akti më i rëndësishëm juridik dhe politik në një shtet demokratik, u kushton rëndësi të veçantë të drejtave dhe lirive të njeriut. Kjo është e pritshme, duke marrë parasysh faktin se shteti ynë synon të jetë shtet bashkëkohor demokratik me vlera të vendosura evropiane dhe universale.

Sipas Kushtetutës së RMV-s, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit, të cilat janë të njohura ndërkombëtarisht, janë ndarë në dy grupe më të mëdha:

1. Liri dhe të drejta qytetare dhe politike; dhe
2. Të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore.

Këto të drejta në të shumtën e rasteve quhen edhe gjenerata e parë e të drejtave të njeriut. Të drejtat qytetare paraqesin treguesin për atë se si është pozita e qytetarëve në shoqëri: si është raporti mes qytetarëve dhe shtetit, si është raporti i ndërsjellë i qytetarëve dhe cilat janë mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave, nëse ato eventualisht shkelen. Me të drejta politike, nga ana tjetër, mundësohet që qytetarët të bëhen faktorë aktiv në jetën politike; përcaktohen

kushtet dhe rrethanat në të cilat do të ishte hasur qytetari nëse vendos që të përfshihet në mënyrë aktive në jetën publike.

**Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore** janë drejtpërdrejt të lidhura me cilësinë e standardit jetësor të qytetarëve. Këto të drejta të njeriut kanë të bëjnë me kushtet themelore sociale dhe ekonomike që nevojiten për të jetuar një jetë me dinjitet dhe liri, që kanë të bëjnë me punën dhe të drejtat e punëtorëve, sigurimin social, shëndetësinë, arsimin, ushqimin, ujin, banimin, mjedisin e shëndoshë jetësor dhe kulturën.

Karakteristikat e të drejtave të njeriut janë universalizëm, paprekshmëri, pandashmëri dhe absolutizëm

**Foto 11. Karakteristikat e të drejtave të njeriut**

### **UNIVERSALITETI**

– të drejtat vlejné për të gjithë njerëzit, pa dallim të racës së tyre, bashkësisë etnike, orientimit seksual, seksit, gjinisë, gjuhës, përkatësisë sociale dhe pozitës shoqërore;

### **PATJETËRSUESHMËRI**

– të drejtat nuk mund t'i tjetërsohen tjetrit;

### **PANDASHMËRI**

– të drejtat nuk mund të ndahen (e drejta e punësimit është e pandarë me të drejtën për kompensim të paguar)

### **ABSOLUTITET**

– të drejtat vlejné në tërë territorin e shtetit.

Përgjegjësitë janë pasojë logjike e ekzistimit të të drejtave të njeriut. Nga çdo e drejtë rezultojnë një varg përgjegjësish që ne si qytetarë i kemi – ndaj njerëzve të tjerë, por edhe ndaj vetë shtetit. Ndonëse, barra më e madhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut bie në kurrizin e shtetit, megjithatë secili prej nesh, individualisht, duhet të angazhohet për respektimin dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut përfshijnë: parashtrimin e parashtresave deri te avokati i popullit, „Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi“, si dhe parashtrimin e padive para gjykatave të rregullta ose, nga ana tjetër, parashtrimin e nismave deri te Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## Aktivitet:

### **Çfarë përgjegjësie kanë të drejtat tona? (15 min.)**

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në dy grupe. Njëri grup e merr fletën e punës 3.3. për të drejta qytetare dhe politike. Përveç kësaj, secili prej grupeve merr edhe fleta të prera përkatëse të të drejtave dhe përgjegjësi në përputhje me grupet e të drejtave në të cilat ata punojnë.

Secili grup i lidhë të drejtat dhe përgjegjësitë, që në fund t'i prezantojë publikisht. Mësimdhënësi i krahason lidhjet, në përputhje me shembullin për lidhje të drejtë/saktë. Pas përfundimit të prezantimit, mësimdhënësi i pyet nxënësit nëse dhe çfarë dilemash kanë pasur në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë? Për cilat nga të drejtat ose përgjegjësitë e përmendura dëgjojnë për herë të parë?

Shënim i rëndësishëm: Mësimdhënësi u tregon se shembujt e përmendur nuk janë obligimet e vetme që rezultojnë nga të drejtat e përmendura. Shumë shpesh – të drejtat dhe përgjegjësitë gërshetohen, varësisht nga fusha nga e cila rezultojnë.

## Shembull (për mësimdhënësin)

### **për lidhje të drejtë/të saktë të të drejtave dhe përgjegjësi:**

GRUPI 1: LIRI DHE TË DREJTA QYTETARE DHE POLITIKE	
E drejtë	Përgjegjësi
Integriteti fizik dhe moral i njeriut, janë të paprekshëm	Ndalohet çdo formë e torturimit, sjelljes jonjerëzore ose nënçmuese dhe ndëshkim i njerit ndaj njeriut tjetër
Liria e njeriut është e paprekshme.	Përveç shtetit, askush tjetër nuk guxon të kufizojë lirinë e njeriut.
Garantohet liria e bindjes, vetëdijes, mendimit dhe shprehjes së lirë të mendimit.	Përgjegjësi për mospërdorimin e gjuhës së urrejtjes.
Garantohet siguria dhe fshehtësia e të dhënave personale.	Të mos shpërndahen të dhëna të huaja personale.





Qytetarëve u garantohet liria e bashkimit për shkak të realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të drejtave dhe bindjeve të tjera.	Ndalohet bashkimi me qëllim të rrënimit të dhunshëm të rendit kushtetues të shtetit dhe nxitjes ose thirrjes së agresionit ushtarak, të urrejtjes ose jotolerancës kombëtare, racore ose fetare.
Garantohet pacenueshmëria e shtëpisë.	Ndalohet hyrja e dhunshme në shtëpi të huaj.
Secili qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka të drejtë të lëvizë lirshëm në territorin e shtetit.	Nuk është i lejuar kufizimi ose pamundësimi i lirisë së lëvizjes nga persona të tjerë.
E drejta e barazisë.	Ndalohet sjellja diskriminuese në baza të ndryshme nga persona të tjerë.
E drejta e protestës dhe tubimit publik.	Sjellje e ndërgjegjshme dhe pa dhunë gjatë protestës.
E drejta e zgjedhësve.	Ndalesë për ushtrimin e presionit për mënyrën e votimit të qytetarëve gjatë zgjedhjeve.

#### GRUPI 2: TË DREJTA EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

E drejtë	Përgjegjësi
E drejta e pronësisë.	Marrje e palejueshme e gjërave të huaja.
E drejta e arsimit.	Prani e rregullt në procesin arsimor.
E drejta e mbrojtjes shëndetësore.	Ruajtje dhe avancim të shëndetit personal dhe shëndetit të të tjerëve.
E drejta e njeriut që vetë të vendosë për krijimin e fëmijëve.	Përkujdesje për edukimin dhe mirëmbajtjen e fëmijëve.
E drejta e mjedisit të shëndoshë jetësor.	Ruajtje, avancim dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës.
Garantohet liria e krijimtarisë shkencore, artistike dhe llojet tjera të krijimtarisë.	Të respektohen të drejtat autoriale të autorit të veprës.
Mbrojtja e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të nacionaliteteve.	Respektim i diversiteteve në shoqëri.
E drejta e punës.	Lajmërim i tatimit personal të të ardhurave.
E drejta e grevës.	Përgjegjësi e punëtorëve që ta informojnë punëdhënësin për grevën e planifikuar.
E drejta e pensionit.	Pagesë të kontributeve për sigurim pensional.

## ***Pjesa përfundimtare e orës (5 min.)***

Në fund të orës, mësuesi nxjerr konstatim nga përmbajtja:

Të drejtat dhe përgjegjësitë janë të lidhura ngushtë, ashtu që për të arritur garanci të plotë të të drejtave të njeriut duhet tërësisht t'i zbatojmë dhe respektojmë përgjegjësitë tona. Përgjegjësinë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut e kemi individuale, por edhe kolektive. Shtetet e qëndrueshme demokratike kanë sisteme të zhvilluara dhe mekanizma për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, gjatë shkeljes së tyre.

## ***Aktivitet për vlerësim dhe reflektim (5 min.)***

Mësuesi nxitë diskutim në grup përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ A konsideroni se ka të drejta plotësuese që duhet t'i kenë njerëzit, e që nuk janë përfshirë në Kushtetutë ose „Deklaratën universale të drejtave të njeriut”? Cilat janë ato?
- ➔ Pse respektimi i të drejtave të njeriut nuk është i barabartë kudo në botë?
- ➔ Cilat prej obligimeve për ju janë më të vështira për t'u respektuar?



## Fletë pune 3.3.

### Të drejta qytetare dhe politike

GRUPI 1: LIRI DHE TË DREJTA QYTETARE DHE POLITIKE	
E drejtë	Përgjegjësi

## Fletë pune 3.4.

### Të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore

GRUPI 2: LIRI DHE TË DREJTA QYTETARE DHE POLITIKE	
E drejtë	Përgjegjësi

## Fletë pune 3.5.

### Listë e të drejtave dhe përgjegjësi

#### Grupi 1

Integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të paprekshëm	Ndalohet çdo formë e torturimit, sjelljes jonjerëzore ose nënçmuese dhe ndëshkim i njërit ndaj njeriut tjetër
Liria e njeriut është e paprekshme.	Përveç shtetit, askush tjetër nuk guxon të kufizojë lirinë e njeriut.
Garantohet liria e bindjes, vetëdijes, mendimit dhe shprehjes së lirë të mendimit.	Përgjegjësi për mospërdorimin e gjuhës së urrejtjes.
Garantohet siguria dhe fshehtësia e të dhënave personale.	Të mos shpërndahen të dhëna të huaja personale.
Qytetarëve u garantohet liria e bashkimit për shkak të realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të drejtave dhe bindjeve të tjera.	Ndalohet bashkimi me qëllim të rrënimit të dhunshëm të rendit kushtetues të shtetit dhe nxitjes ose thirrjes së agresionit ushtarak, të urrejtjes ose jotolerancës kombëtare, racore ose fetare.
Garantohet pacenueshmëria e shtëpisë.	Ndalohet hyrja e dhunshme në shtëpi të huaj.
Secili qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka të drejtë të lëvizë lirshëm në territorin e shtetit.	Nuk është i lejuar kufizimi ose pamundësimi i lirisë së lëvizjes nga persona të tjerë.
E drejta e barazisë.	Ndalohet sjellja diskriminuese në baza të ndryshme nga persona të tjerë.
E drejta e protestës dhe tubimit publik.	Sjellje e ndërgjegjshme dhe pa dhunë gjatë protestës.
E drejta e zgjedhësve.	Ndalesë për ushtrimin e presionit për mënyrën e votimit të qytetarëve gjatë zgjedhjeve.

## Grupi 2

E drejta e pronësisë.	Marrje e palejueshme e gjërave të huaja.
E drejta e arsimit.	Prani e rregullt në procesin arsimor.
E drejta e mbrojtjes shëndetësore.	Ruajtje dhe avancim të shëndetit personal dhe shëndetit të të tjerëve.
E drejta e njeriut që vetë të vendosë për krijimin e fëmijëve.	Përkujdesje për edukimin dhe mirëmbajtjen e fëmijëve.
E drejta e mjedisit të shëndoshë jetësor.	Ruajtje, avancim dhe mbrojtje e mjedisit jetësor dhe natyrës.
Garantohet liria e krijimtarisë shkencore, artistike dhe llojet tjera të krijimtarisë.	Të respektohen të drejtat autoriale të autorit të veprës.
Mbrojtja e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të nacionaliteteve.	Respektim i diversiteteve në shoqëri.
E drejta e punës.	Lajmërim i tatimit personal të të ardhurave.
E drejta e grevës.	Përgjegjësi e punëtorëve që ta informojnë punëdhënësin për grevën e planifikuar.
E drejta e pensionit.	Pagesë të kontributeve për sigurim pensional.

# Përmbajtja: Qytetari dhe zhvillimi i qëndrueshëm



## Rezultate nga nxënia

E kupton rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimit racional të resurseve të planetit Tokë



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ përshkruajë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm në segmente individuale të jetesës,
- ➔ përpilojë plan për përdorim racional të resurseve.



## Materiale të nevojshme:

fleta, lapsa kimik



## Metoda, teknika, forma:

Tekst metoda, bisedë e orientuar, ushtrim (zgjidhje të situatës problematike), diskutim.

## Pjesa hyrëse e orës (7 min.)

Mësimdhënësi lexon me kujdes në mënyrë që nxënësit të mund ta imagjinojnë situatën:

„Imagjinoni planetin Tokë si anije kozmike që është në Gjithësi dhe është në lëvizje të vazhdueshme, prandaj i nevojitet karburant që bëhet prej përzierjes së ujit, naftës dhe drurit. Në mënyrë që anija kozmike të vazhdojë lëvizjen me një shpejtësi të caktuar, i nevojitet një sasi e caktuar e karburantit dhe kjo duhet të plotësohet vazhdimisht. Megjithatë, anija kozmike nuk mund të ndalet për ta plotësuar karburantin, duhet vazhdimisht të lëvizë dhe duhet vazhdimisht të ketë karburant. Numri i udhëtarëve në anijen kozmike rritet vazhdimisht dhe për lëvizjen e tij nevojitet gjithnjë e më shumë karburant. Nëse ndalet, kjo do të ishte shkatërruese për udhëtarët e anijes. Por **resurset** prej të cilave bëhet karburanti vazhdimisht zvogëlohen. Ekziston rreziku që rruga e anijes sonë kozmike në Gjithësi të bëhet e pasigurt. Në rrezik janë udhëtarët e saj. Udhëtarët janë të vetëdijshëm për gjendjen dhe tentojnë të gjejnë zgjidhje“.

Mësimdhënësi parashtron pyetje që do të ndihmojnë të zhvillojë diskutim:

- ➔ **Si ndjeheni pas dëgjimit të tekstit të shkurtër?** (Prej nxënësve pritet të japin përgjigje të ndryshme: kureshtarë, të frikësuar, të pasigurt, të shqetësuar, etj.).
- ➔ **Cilat elemente nga teksti në mënyrë simbolike tregojnë gjendjen reale?** (Janë të mundshme më shumë përgjigje: udhëtarët e anijes si simbol për popullatën e planetit Tokë dhe mbipopullimin, shpenzimi i resurseve për shkak të konsumit të madh, mbijetesa e planetit Tokë, vetëdija e njerëzve për gjendjen dhe kërkimi i zgjidhjeve).
- ➔ **Nëse do të ishit udhëtar në këtë anije, çfarë zgjidhje do të kishit ofruar?** (Priten përgjigje të ndryshme: përdorim racional i resurseve, ndryshim i llojit të karburantit që përdoret, etj.).

Në fund të diskutimit, mësimdhënësi nxjerrë një konstatim të shkurtër:

Në jetën e përditshme, secilit prej nesh i nevojitet një sasi e caktuar e resurseve për funksionim optimal. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se secili duhet të shpenzojë sa më shumë që mundet. Përkundrazi, duhet të kemi parasysh se disa resurse të caktuara janë të kufizuara dhe duhet të punojmë drejt zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.

## *Pjesa kryesore e orës (30 min.)*

Mësimdhënësi i sqaron termet kryesore të parashikuara për këtë orë: **resurse, zhvillim i qëndrueshëm, karburante.**

**Zhvillimi i qëndrueshëm** është zhvillim që i plotëson nevojat e së tashmes, pa e vënë në rrezik mundësinë e gjeneratave të ardhshme që t'i plotësojnë nevojat e tyre. Kjo nënkupton se resurset që i shpenzojmë nga toka, duhet t'i përtërijmë, ruajmë, kursejmë dhe/ose të sillemi në mënyrë ekonomike me to, në mënyrë që të ketë edhe për gjeneratat e ardhshme.

**Resurse** janë materialet që i përdorim si ushqim ose për marrjen e **energjisë** ose karburanteve. Ato mund të jenë përtëritëse (erë, ujë, diell) dhe jopërtëritëse (naftë, gaz). Vendet që kanë politika të **zhvillimit të qëndrueshëm** tentojnë të përdorin **resurse përtëritëse**, ndërsa për ato që nuk janë përtëritëse shkenca është duke gjetur zëvendësime ose alternativa.

Konsumi i energjisë dhe **karburanteve** është pjesë përbërëse e përditshmërisë së çdo individi, industrie ose të gjitha segmenteve të tjera të shoqërisë. **Karburantet** përdoren për prodhimin e energjisë, ndërsa energjia është boshti lëvizës i të gjitha aktiviteteve. Prandaj është veçanërisht e rëndësishme **karburantet** që përdoren të jenë ekologjike (diell, erë, gaz, ujë) dhe të mos ndotin.

Njëra prej mënyrave për të ulur ndotjen është përdorimi i sërishëm ose përdorimi i mbeturinave për qëllim të ri. **Riciklimi** është përdorimi i sërishëm i materialeve që i përdorim, por i paraprinë një proces i rëndësishëm i seleksionimit dhe mundësia që ajo që hidhet sërish të përdoret si **karburant**, lëndë e parë, objekt për konsum të gjerë, etj. Pjesë e rëndësishme e politikave të **zhvillimit të qëndrueshëm** është **riciklimi** dhe tendenca që të përdoren materiale që janë përtëritëse ose mund të riciklohen.

**Shënim:** Gjatë diskutimit, mësimdhënësi përkujton nxënësit se çfarë është riciklimi, pse është i rëndësishëm, në çfarë mënyre nxitet kjo mënyrë e mbrojtjes së natyrës në tokë. Përkujtohen për dituritë, përvojat dhe shkathtësitë e përvetësuara tashmë nga vitet paraprake dhe nga lëndët tjera mësimore.

## Aktivitet:

### **Analizë e shprehive jetësore**

**(20 min.)**

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në 5 grupe. Secili grup ka për detyrë brenda 5 minutash të bëjë analizë të shprehive jetësore. Njëherësh bën edhe shqyrtim kritik të ndryshimit të shprehive personale dhe shprehive të bashkësisë në të cilën jeton.

**Shënim:** Në fund të këtij aktiviteti pritët që nxënësit, me ndihmën e mësimdhënësit, të bëjnë një listë të propozimeve që do të mund të zbatoheshin në shkollë, në drejtim të përdorimit të qëndrueshëm të resurseve. Kjo listë e propozimeve duhet të ruhet dhe të përdoret edhe gjatë orës së radhës, ku në fund do të përpilohet plan për përdorim të qëndrueshëm të resurseve në shkollë që nxënësit mund t'ia propozojnë drejtorisë së shkollës.

Secili grup duhet të përfshijë tri segmente në analizën:

- ➔ Gjendja momentale (Cilat janë shprehitë e përditshme, të miat dhe të njerëzve në rrethinën time?)
- ➔ Pasoja nga sjellja (Cilat janë pasojat afatgjate nga shprehitë tona të përditshme?)
- ➔ Propozime (Si do të mund të përmirësohej gjendja?)

### **Propozim tema për analizë:**

#### **Transport**

Përgjigje të pritura të grupit:

- ➔ **Gjendja momentale:** Përdoret transporti publik madje edhe për relacione të shkurtra, familjarët përdorin automjet, në udhëtime mbi 300 km udhëtojnë me aeroplan, etj.
- ➔ **Pasoja:** Ndotja e ajrit, shpenzimi i naftës si resurs jopërtëritës çmimi i të cilit vazhdimisht rritet, etj.
- ➔ **Propozime:** Përdorim të biçikletës, ecje në këmbë në vend të përdorimit të automjetit, transport publik, zëvendësim të transportit ajror me autobus/tren, etj.





## Ujë

Përgjigje të pritura të grupit:

- ➔ **Gjendja momentale:** Uji nga ujësjellësi publik (uji i pijshëm) përdoret për ujitje, shpenzohet në mënyrë joekonomike, çezmat publike janë joekologjike për shkak të konsumit të madh, etj.
- ➔ **Pasoja:** Shtrenjtimi i ujit për shkak të përdorimit joracional, uljes së rezervave të ujit si karburant dhe resurs i rëndësishëm.
- ➔ **Propozime:** Ujë teknik për ujitje, çezma me sensorë, zhvillim të vetëdijes për rëndësinë e ujit.

## Plastikë

Përgjigje të pritura të grupit:

- ➔ **Gjendja momentale:** Përdorim i plastikës në vëllim të madh (p.sh. shishe, qese, pipëza).
- ➔ **Pasoja:** Përdorim i paarsyeshëm i plastikës në aspektin ekologjik (veçanërisht plastika që nuk riciklohet), ndotës i madh.
- ➔ **Propozime:** alternativa për përdorimin e ambalazhit të plastikës (p.sh. xham), qese pëlhure në vend të qeses së plastikës, pipëz prej metali në vend se prej plastike, materiale që riciklohen.

## Letër

Përgjigje të pritura të grupit:

- ➔ **Gjendja momentale:** Shpenzohet shumë resursi i drurit për përpunim, shpesh shpenzohet në mënyrë joekonomike në sasi të mëdha, nuk riciklohet sa duhet ndonëse kjo është e mundshme.
- ➔ **Pasoja:** Ulje e fondit pyjor si resurs i rëndësishëm, humbje të "aleatëve" në luftën kundër ndotjes së ajrit.
- ➔ **Propozime:** Shtypje e dyanshme e përmbajtjeve, përdorim i dy anëve të fletës, qese prej pëlhure në vend se prej letre, seleksionim dhe riciklim të letrës, pyllëzim, zëvendësim i ngrohjes me dru me ndonjë karburant tjetër (rryma e prodhuar nga dielli ose era, gazi).







## Rryma

Përgjigje të pritura të grupit:

- ➔ **Gjendja momentale:** Pa rrymë nuk mund të paramendohet përditshmëria, shpesh përdoret në mënyrë joracionale, prodhimi i rrymës në shkallë të lartë varet nga uji, karburanti më i arsyeshëm ekologjik sesa nafta.
- ➔ **Pasoja:** Çmimi i lartë, uji si resurs mund të mungojë, funksionimi i përditshëm është vështirësuar kur nuk ka rrymë.
- ➔ **Propozime:** Përdorim i teknikës me efikasitet energjetik (konsum më i vogël i rrymës), zëvendësim i naftës në industrinë automobilistike, kursim përmes përdorimit të të ashtuquajturave llamba kursyese, prodhim i rrymës nga dielli, era, etj.

Pasi t'i përpunojnë analizat, në 10-15 minutat e ardhshme nxënësit e prezantojnë atë që e kanë punuar. Nxënësit tjerë dhe mësimmshënësi kanë mundësinë të plotësojnë me pikëpamjet dhe idetë e tyre. Gjatë prezantimeve, mësimmshënësi në tabelë i shënon të gjitha idetë për zhvillim të qëndrueshëm që mund të zbatohen në shkollë (p.sh. ndërrim të çezmave, llambave, kursim të letrës, uljen e përdorimit të plastikës dhe ambalazhit prej plastike, seleksionim, riciklim). Nxënësit në fletoret e tyre i shënojnë idetë për zhvillim të qëndrueshëm në shkollë, në përputhje me informacionet që i shkruan mësimmshënësi në tabelë, si përgatitje për përpilimin e planit për përdorim të qëndrueshëm të resurseve në shkollë.

**Shënim:** Mësimmshënësi mundet sipas zgjedhjes personale të bëjë ndryshime të temave, varësisht nga struktura e nxënësve dhe shprehite të tyre ose varësisht nga profesioni për të cilin arsimohen. P.sh. druri në vendet ku përdoret për ngrohje; industria e tekstilit si ndotëse; menaxhimi i e-mbeturinave dhe mbeturina nga ushqimi; etj.

## Pjesa përfundimtare e orës (5 min.)

Mësimmshënësi bën përmbledhjen se ndryshimet e shprehive të individit mund të kenë rol kryesor në **zhvillimin e qëndrueshëm**. Çel diskutim me nxënësit për pyetjet si vijon:

- ➔ Si e kuptoni mendimin e Albert Ajnshtajnit “Nuk mund t'i zgjidhim problemet në mënyrën e njëjtë në të cilën i kemi shkaktuar” në kontekst të ekologjisë? (Pritet nga nxënësit të tregojnë se problemi me ndotjen nuk mund të zgjidhet me përdorimin e resurseve që ndotin).
- ➔ Si do të kishit përshkruar sjelljen e njerëzve që nuk kujdesen për **zhvillimin e qëndrueshëm**? (Përgjigje të pritura: vetjake, e papërgjegjshme).

- ➔ Me çfarë pengesash do të mund të përballemi nëse tentojmë ta ndryshojmë sjelljen e njerëzve që nuk kujdesen për zhvillimin e qëndrueshëm? (Priten përgjigje të ndryshme nga nxënësit: injorim të temës, hidhërim, pamundësi financiare, etj.).
- ➔ Si do të mund t'i tejkalojmë këto pengesa? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme, por mësimit duhet t'i nxisë nxënësit të mendojnë për zgjidhje konkrete dhe të zbatueshme).

Mësimit jep udhëzime për orën e radhës dhe formohen grupe. Sqaron se do të punohet në krijimin e fushatës onlajn, e sqaron qëllimin, mënyrën e përpunimit, materialet dhe informacionet që nxënësit duhet t'i kenë. Nxënësit dhe mësimit përdorin edhe vegla onlajn për koordinim.

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim***

**(3 min.)**

Mësimit u jep udhëzime që të mendojnë për ndryshimin e parë që do të donin ta bëjnë në raport me sjelljen dhe shprehjet personale, e që do të kontribuonte në zhvillimin e qëndrueshëm. P.sh., blerje të ujit vetëm në shishe të xhamit, seleksionim të mbeturinave për riciklim, përdorim të biçikletës në vend të autobusit, përdorim të kujdeshëm të resurseve, etj.

# Përmbajtja: Qytetari dhe zhvillimi i qëndrueshëm



## Rezultate nga nxënia

E kupton rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimit racional të resurseve të planetit Tokë



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ Numërojnë dhe diskutojnë për shembuj pozitiv nga zhvillimi i qëndrueshëm dhe kursimi i resurseve.
- ➔ Hulumtojnë dhe të propozojë modele të zhvillimit të qëndrueshëm që mund të zbatohen.



## Materiale të nevojshme:

Internet, kompjuter, TIK.



## Metoda, teknika, forma:

formë e përbashkët e punës, hulumtim, kërkim sipas fjalës kyçe, analizë-sintezë e materialit, bisedë e orientuar, diskutim.

## **Pjesa hyrëse e orës (10 min.)**

Mësimdhënësi përmes bisedës së orientuar i përsëritë me nxënësit dituritë e përvetësuara për **resurse, zhvillim të qëndrueshëm, karburante, riciklim** nga ora e kaluar. I kthen nxënësit në tekstin e anijes kozmike, tashmë me një aluzion të qartë të planetit Tokë.

- ➔ Çfarë resurcesh përdorin udhëtarët e anijes kozmike? (Pritet që nxënësit të përgjigjen se në anijen kozmike përdoren resurse jopërtëritëse dhe kjo e rrezikon mbijetesën e saj).
- ➔ Çfarë politike për përdorimin e resurseve ka anija? (Pritet nga nxënësit që të theksojnë se anija momentalisht nuk ka politikë të zhvillimit të qëndrueshëm dhe se ajo duhet të ndryshohet).
- ➔ Çfarë duhet të ndërmerret në mënyrë që udhëtimi i anijes kozmike të mos vihen në rrezik? (Përgjigje të mundshme të nxënësve: ndryshim të karburantit, zbulim të karburantit alternativ që mund të jetë edhe nga karburantet e ricikluara, kontrolli dhe planifikimi i numrit të udhëtarëve, menaxhim të mbeturinave dhe riciklim të tyre, përdorim të resurseve përtëritëse, etj.).
- ➔ Si ndjeheni tani, pasi që gjetët ide për zgjidhjen e problemit të anijes sonë kozmike? (Përgjigje të mundshme: i përgjegjshëm, i qetë, i sigurt, i brengosur).

Mësimdhënësi i përdorë përgjigjet e nxënësve në mënyrë që të nxjerrë konstatime nga biseda hyrëse dhe t'i orientojë drejt aktivitetit kryesor të orës.

## **Pjesa kryesore e orës (30 min.)**

Nxënësit janë tashmë të njoftuar me detyrën për këtë orë dhe i kanë informacionet që u janë të nevojshme me detyrën për këtë orë dhe i kanë informacionet që u janë të nevojshme. Detyra është përpunim i fushatës onlajn për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Para se të fillojnë punën, në mënyrë që t'i frymëzojë, mësimdhënësi çel një diskutim të shkurtër (5-8 minuta):

- ➔ Ku të shkon mendja së pari kur mendon për atë se çfarë duhet "të shpëtohet" në mjedisin tënd? (Përgjigje të mundshme: lumi i afërt, oborri i shkollës, parku i komunës).
- ➔ Pse është kjo kështu? (Nga nxënësit priten përgjigje të ndryshme: probleme me ndotjen e ajrit, vetëdije për sasi të kufizuara të ujit të pijshëm, etj.).
- ➔ Si do të mund të kontribuojë drejt "shpëtimit" të asaj që keni indentifikuar? (Përgjigje të mundshme: apele drejtuar qytetarëve, kërkesë drejtuar bashkësisë lokale për zgjidhjen e problemit, organizim të aksionit ekologjik, etj.).

Mësimdhënësi jep udhëzime konkrete për përpilimin e fushatës, siç janë:

- ➔ Nxënësit ndahen në ekipe sipas afiniteteve që i kanë (p.sh. shkrim të tekstit, kërkim në internet, disajni, promovim, moto e fushatës, etj.). Të gjitha ekipet zgjedhin liderë që do të vazhdojnë punën edhe në fazën e radhës. Është e pëlqyeshme që ndarja e ekipeve të jetë bërë tashmë në orën e kaluar, si do të donin të punojnë nxënësit dhe çfarë pritjet prej tyre.
- ➔ Secili ekip punon në detyrën konkrete që e ka dhe pasi që të jetë mbaruar detyra, ajo bashkohet në një tërësi apo fushatë të përbashkët në nivel të klasës.
- ➔ Të gjitha materialet vizuale domosdoshmërisht ta përmbajnë shenjën për **riciklim** me sqarim, si dhe termet kyçe **zhvillim i qëndrueshëm, resurse dhe karburante**.
- ➔ Nxënësit duhet të përpilojnë moto me të cilën do të emërtohet fushata.
- ➔ Nxënësit mund të përdorin shembuj nga kërkimi në internet (p.sh.. informacione për politikat e shteteve më ekologjike siç janë Finlanda, Islanda, Suedia, Danimarka dhe Sllovenia, shembuj të njerëzve, kompanive dhe organizatave qytetare që merren me zhvillimin e qëndrueshëm, shembuj nga bashkësitë lokale, etj.).

Gjatë orës përpunohet versioni i punës që më pas liderët e ekipeve e përpunojnë deri në fund në fushatën finale, me ç'rast sërish përdoren veglat onlajn për bashkëpunim dhe koordinim. Të gjithë nxënësit duhet të marrin pjesë në punën e ekipit të tyre dhe të japin propozime rreth motos së fushatës, mënyrës së promovimit të saj, grupit qëllimor drejt të cilit është orientuar (fëmijë, të rritur, tinxherë, media, eko-aktivistë, bashkësi lokale, etj.).

Pasi që të jenë përpunuar versionet e punës, disa vullnetarë e prezantojnë versionin e punës para mësimdhënësit dhe ndajnë informacione rreth ideve të tyre, qëllimit të fushatës, mënyrës së hulumtimit dhe grumbullimit të informacioneve, të dhënave interesante deri te të cilat kanë ardhur, shembuj të praktikave pozitive, etj. Idetë që janë të përdorshme dhe relativisht të realizueshme, bashkë me idetë për përdorim të qëndrueshëm të resurseve në shkollë që nxënësit i kanë shkruar orën e kaluar, mund t'ia propozojnë drejtorisë së shkollës në formë të planit për përdorim të qëndrueshëm të resurseve në shkollë.

Shënim: Konsultimet e mësimdhënësit me nxënësit, por edhe mes nxënësve rreth rregullave, materialeve, udhëzimeve, etj. mund të realizohen edhe përmes veglave onlajn që tashmë i përdorë (platformë, bllog, rrjete sociale, kanal YouTube, etj.) për shkak të specifikës dhe vëllimit të aktivitetit, por edhe me qëllim të përdorimit të veglave të përmendura.

## ***Pjesa përfundimtare e orës (5 min.)***

Mësimdhënësi e thekson karakterin global të problemeve ekologjike, por edhe domosdoshmërinë që ndryshimi të nisët nga individi dhe sjellja e tij ndaj natyrës dhe rëndësinë e parimit "Mendo globalisht, vepra lokalisht".

Mësimdhënësi u jep detyrë shtëpie nxënësve që të bëjnë plan individual për ndryshim në sjelljen e tyre në 2 vitet e ardhshme, me aktivitete që janë kyçe dhe në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm. Mund t'i përkujtojë nxënësit në shprehitë për të cilat tashmë kanë biseduar orën e kaluar, e që do të mund t'i zbatonin lehtë. Nxënësit dhe mësimdhënësi i planifikojnë sfidat/shprehitë personale, më shpesh të përmendura, në formë të sfidës së përbashkët 30 ditore në paralele (p.sh. seleksionim dhe riciklim të mbeturinave, përdorim të shisheve prej xhami për ujë, shkuarje në shkollë me biçikletë, etj.).

## **Përmbajtja: Qytetari si novator dhe sipërmarrës**



### **Rezultate nga nxënia**

Nxënësi/nxënësja mund ta dallojë nevojën e inovacionit dhe sipërmarrësisë duke ndjekur dinamikën e zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore.



### **Standarde/tregues**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- Sqarojë termet novator dhe sipërmarrës.



### **Materiale të nevojshme:**

Tabelë, shkumës/marker, fletore, lapsa kimik, fletë pune 3.6.



### **Metoda, teknika, forma:**

formë e përbashkët e punës, stuhi e ideve, tekst metoda, bisedë e orientuar / diskutim, punë në grupe

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

Mësimdhënësi e fillon orën me sqarim të shkurtër:

„Në secilën listë të shpikjeve më të rëndësishme në historinë e qenies njerëzore mund të hasen zjarri dhe rrota, ndërsa në disa dekadat e fundit përmendet edhe çipi i silikonit i cili solli deri tek revolucioni në lidhshmërinë globale dhe zhvillimin teknologjik. Por, këto tri shpikje dallojnë sipas disa karakteristikave. P.sh., zjarri nuk ka pasur nevojë të shpiket (për shkak se ai ka ekzistuar në natyrë), por është dashur të shpiket mënyra që zjarri të mirëmbahet dhe kontrollohet. Nga ana tjetër, rrota ekziston në natyrë në atë formë, kështu që shpikja e saj është shumë e rëndësishme për qenien njerëzore. Ndryshe nga këto dy shpikje, çipi i silikonit është rezultat, mes tjerash, i punës intelektuale të shumë njerëzve të cilët në vitet para vetë përpunimit të çipit të parë të silikonit kanë kontribuar drejt avancimit në teknologjinë dhe shkencën e nevojshme për këtë shpikje. Megjithatë, emrat e shpikësve të rrotës dhe mënyrat e para për kontrollimin dhe mirëmbajtjen e zjarrit asnjëherë nuk do t'i mësojmë, derisa i dimë emrat e Robert Nojsit dhe Xhek Kilbit, të cilët i kanë shpikur çipat e parë të silikonit dhe në këtë mënyrë kanë kontribuar drejt përfitimit financiar të kompanive për të cilat kanë punuar.“

Mësimdhënësi fillon diskutim të shkurtër:

- ➔ Pse pikërisht rrota, zjarri dhe çipi i silikonit konsiderohen si shpikje të rëndësishme? (Pritet prej nxënësve të tregojnë se me shpikjen e tyre lehtësohen/bëhen të mundshme shumë aktivitete të reja dhe deri atëherë të panjohura për njerëzit).
- ➔ Mendoni për produktet që i përdorim çdo ditë (p.sh. lapsa kimik, telefona, atlete, valixhe, veshje, shishe). Si janë krijuar këto produkte dhe pse duken pikërisht kështu? (Përgjigje të pritura: si rezultat i nevojës, përdoren për një qëllim të caktuar, pamja është ndryshuar sipas nevojave të njerëzve, etj.).
- ➔ Sipas jush, si duket procesi në të cilin ndonjë individ shpik produkt të ri në kohën e sotme? Cilët janë faktorët të cilët ndikojnë? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga nxënësit: hulumtim në internet, zgjidhje të ndonjë nevojë, ndikimi i gjendjes ekonomike në të cilën gjendet individi, etj.).
- ➔ Si i quajmë sot njerëzit që zbulojnë ose gjejnë gjëra? (Përgjigje të mundshme: novatorë, hulumtues, shpikës).

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve dhe nxjerr konstatim nga diskutimi: Zbulimi, gjegjësisht shpikja e produkteve të reja në të shumtën e rasteve ndodhë nga ana e njerëzve kreativ të cilët kanë një vizion të caktuar për zgjidhjen e ndonjë problemi ose nevojë. Këtyre njerëzve shpesh u nevojiten edhe mjete dhe materiale me të cilat do të mund të përpunoheshin produktet e shpikura.



## Pjesa kryesore e orës (25 min.)

Mësimdhënësi e shkruan titullin e njësisë mësimore në tabelë „**Qytetari si novator dhe sipërmarrës**”, më pas i ndan nxënësit në 6 grupe dhe secilit grup i jep tekst të shtypur paraprakisht (fletë pune 3.6). Në fletën e punës, janë dhënë dhjetë shembuj të novatorëve dhe/ose sipërmarrësve, me ç’rast qëllimi është që nxënësit praktikisht t’i shqyrtojnë dallimet mes termeve. Mësimdhënësi mund t’i zgjedhë shembujt më përkatës për profesionin që e mësojnë nxënësit ose nga ana tjetër, shembujt e ofruar t’i zëvendësojë me shembuj të ri.

Gjatë leximit të historive, secili prej grupeve duhet të përgjigjet në pyetjet si vijon për njërin prej shembujve në fletën e punës (në kohëzgjatje prej 5-7 minutave):

- ➔ Çfarë kanë shpikur/zbuluar, gjegjësisht çfarë biznesi kanë filluar njerëzit e përmendur në shembujt? (Pritet nga secili prej grupeve të përmend novitetin/biznes idenë kryesore në shembujt).
- ➔ Çfarë ka ndodhur pasi që njerëzit në shembujt i kanë shpikur novitetet e tyre/kanë filluar kompani të tyre, si ka qenë rrugëtimi i tyre jetësor? P.sh. kanë realizuar fitim financiar, kanë marrë mirënjohje shkencore/shoqërore, etj. (Priten përgjigje të ndryshme, në përputhje me shembujt).
- ➔ Cilat veçori të karakterit i kanë njerëzit e përmendur në historitë? (Përgjigje të mundshme: Guxim, këmbëngulje, aftësi novatore, kreativitet, inteligjencë, zell, rrezikim, vetëbesim, përgjegjësi... )

Pasi që të gjitha grupet do të përfundojë me përgjigjen e pyetjeve, secili grup e prezanton atë që e ka punuar (nga 1-2 minuta për grup) dhe vërejtjet kryesore shënohen në tabelë. Pas prezantimeve nga të gjitha grupet, mësimdhënësi i udhëzon nxënësit drejt perceptimit dhe komentimit të veçorive/karakteristikave të përbashkëta të njerëzve të përmendura në shembujt, por edhe dallimet mes termeve novator dhe sipërmarrës.

Mësimdhënësi bën përmbledhje të aktivitetit përmes pjesës së shkurtër teorike (5 min.):

Ndonëse shpesh përmenden së bashku, termet novator dhe sipërmarrës kanë të bëjnë me aktivitete të ndryshme që shpesh, por jo edhe gjithmonë, janë të lidhura.

**Novator** është individi me talent të posaçëm që me zbatimin e qasjes inventive në zgjidhjen e problemeve krijon një ide, produkt, shërbim, etj. Në shoqëritë bashkëkohore veçanërisht vlerësohen dhe respektohen **novatorët** dhe **inovacionet** si resurs që është i domosdoshëm për konkurrencë në ekonominë kombëtare dhe përparimin shoqëror, por edhe për funksionim më të lehtë të shoqërisë për shkak të zgjidhjes së problemeve sociale. Mënyra më e mirë për të ardhur deri te mundësitë e reja për inovacion është që të depërtohet në nevojat ose dëshirat e njerëzve dhe të shikohet në produktin ose shërbimin që ofrohet ose planifikohet të ofrohet, nga perspektiva e blerësve dhe/ose përdoruesve. Thjeshtë, kur bëhet fjalë për inovacion nuk mund

të pyeten njerëzit paraprakisht se çfarë duan që të zbulohet. Për shkak të asaj se në të shumtën e rasteve bëhet fjalë për ide, produkt ose shërbim krejtësisht të ri, njerëzit nuk mund të dinë nëse/sa u nevojitet në jetën e përditshme (p.sh. ndonjë aparat i ri elektrik pa të cilin deri atëherë gjithçka ka funksionuar).

**Sipërmarrës** në të shumtën e rasteve është ndonjë pronar i ndërmarrjes dhe individ që menaxhon resurset të cilat ndërmarrja i ka në dispozicion, shpesh duke marrë përsipër rreziqe për të realizuar fitim. **Sipërmarrësi** zakonisht është pronar i ndërmarrjes, e nëse edhe e menaxhon atë, atëherë është edhe menaxher. Megjithatë, për të qenë **sipërmarrës** nuk mjafton vetëm të fillohet biznes i vogël – këta janë njerëz që kanë talent për të shikuar mundësitë në tregun e punës, dhe aftësitë dhe shkathtësitë për t'i zhvilluar këto mundësi në ndërmarrje që do të realizojnë fitim. Sipërmarrësit kanë talent që t'i dallojnë tendencat që ndodhin rreth tyre dhe i përdorin për të krijuar një produkt/shërbim krejtësisht të ri ose t'i përmirësojnë produktet/shërbimet ekzistuese. Në kuptimin tradicional, sipërmarrësia ndërlidhet me plotësimin e nevojave të konsumatorëve dhe krijimin e nevojave të reja që më pas duhet të kënaqen me konsum më të madh. P.sh. zbulimi i telefonave celularë paraqet shpikje të madhe, ndërsa për njerëzit e sotëm telefoni celular është shndërruar në nevojë. Vetë telefoni celular me vete tërheqë edhe një varg zbulimesh të reja si mbajtës, këllëfë, maska mbrojtëse dhe dekorative, etj. Megjithatë, në dekadën e fundit, **sipërmarrësia** merr dimension të ri social për shkak të orientimit drejt zgjidhjes kreative dhe novatore të problemeve me të cilat njerëzit përballen në jetën e përditshme. Në të dyja rastet, burim kryesor i ideve **sipërmarrëse** është të kuptuarit e qartë të nevojave të njerëzve.

## ***Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (10 min.)***

Mësimdhënësi zhvillon diskutim mes nxënësve:

- ➔ Çfarë keni ditur për sipërmarrësinë dhe inovacionet më parë, e çfarë mësuat në këtë orë? (Priten përgjigje të ndryshme nga nxënësit).
- ➔ Sipas jush, pse janë të nevojshme dhe të rëndësishme inovacionet në shoqërinë e sotme? (Përgjigje të mundshme: përparim shoqëror, ekonomi më e mirë, zgjidhje të problemeve që ekzistojnë një kohë të gjatë, etj.).
- ➔ Çfarë mendoni, pse ardhmëria e shoqërive bashkëkohore është në zhvillimin e sipërmarrësisë (sociale)? (Përgjigje të mundshme: nevojë për gjetjen e zgjidhjeve të problemeve me të cilat përballen njerëzit, marrje përsipër të përgjegjësisë më të madhe, fitim më të madh, etj.).
- ➔ A do të kishit dashur ju të bëheni novator dhe/ose sipërmarrës? Nëse po, cilat kushte do t'ju ishin nevojitur për punë të suksesshme? (Priten përgjigje të ndryshme nga nxënësit).

## Fletë pune 3.6

### Shembuj për novatorë dhe/ose sipërmarrës të suksesshëm

1. Kompania maqedonase “Veda”, në pronësi të Boris Jankovskit, në vitin 2018 për herë të parë përpiloi sistem aerosol për fikjen e shpejtë të zjarreve. Në inovacionin ka punuar një ekip i gjerë multidisiplinar (në mesin e të cilëve edhe 15 doktorë të shkencave në fusha të ndryshme) më shumë se dy dekada. Vetë inovacioni mbështetet në një substancë të fortë kompozite, e cila pas inicimit të saj digjet dhe prodhon sasi të madhe të gazit. Përbërja kimike e gazit të prodhuar e parandalon procesin e djegies dhe për kohë shumë të shkurtër mund ta shuajë zjarrin. Për shkak se shpejtësia është shumë e rëndësishme gjatë fikjes së zjarreve, kjo shpikje ka përparësi të madhe në krahasim me shpikjet ekzistuese. Me ndihmën e Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik, “Veda” filloi me procesin e certifikimit të aparatit, pas çka përgatiten për pjesëmarrje në tregun botëror.
2. **Patricija Bat** është gruaja e parë – dokoreshë me prejardhje afrikane të cilës i është dhënë patenta për inovacion për qëllime mjekësore në SHBA. Inovacioni i Batit quhet „Laserphaco Probe” – aparat mjekësor që shpejtë dhe në mënyrë të padhembshme i shpërbën kataraktet në sytë me ndihmën e laserit, pas çka e “pastron” syrin për vendosjen më të lehtë të thjerrëzave për përmirësimin e shikimit. Pasi që Bati e shpiku aparatin në vitin 1981, ai përdoret në mbarë botën si mënyrë e shpejtë dhe e sigurt për parandalimin e verbërisë për shkak të katarakteve. Bat është edhe themeluese e disiplinës së re shkencore (e quajtur oftalmologji e bashkësisë) që fokusohet në mundësimin e shërbimeve oftalmologjike për gjithë popullatën, pa marrë parasysh të ardhurat financiare të njerëzve.
3. **Henri Ford** është themelues i kompanisë Ford Motor dhe konsiderohet si baba i shiritit modern për montim që përdoret për prodhimtari masive. Modeli i tij T, të cilin ka filluar ta prodhojë në vitin 1908, i ka modernizuar transportin dhe industrinë amerikane. Si pronar i vetëm i kompanisë, ai është bërë njëri prej njerëzve më të pasur dhe më të famshëm në botë. Fordi e ka shpikur edhe fordizmin, gjegjësisht prodhimtarinë masive të një numri të madh të automobilave të lirë me përdorimin e shiritit për montim dhe me paga të larta për punëtorët e tij (pesë dollarë në ditë në vitin 1914). Përkundër faktit që Fordi nuk ka qenë shumë i arsimuar, ai ka pasur një vizion global dhe e ka shikuar konsumin si faktor kyç për paqe. Ai ka qenë njëri prej pacifistëve udhëheqës në Luftën e Parë Botërore, por e ka ridedikuar kompaninë e tij që të prodhojë materiale ushtarake në të dyja luftërat botërore.

4. Derisa kimistja amerikane **Stefani Kvolek** ka punuar në zgjidhje alternative për përdorimin e hekurit në gomat automobilistike, rastësisht e ka zhvilluar materialin për të cilin besohet se ka shpëtuar mijëra jetë për shkak të përdorimit në jelekët antiplumbë që mbrojnë prej plumbave. Në vitin 1964, Kvolek ka zbatuar eksperiment për ndryshimin e gjendjes agregate të materialeve polimere (prej të ngurta në të lëngshme), me ç'rast ka vërejtur se qimet në lëngun e bërë kanë qenë edhe deri pesë herë më të fuqishme se hekuri. Kjo shpikje e Kvolekut përdoret në shumë sfera (prej këpucëve të qëndrueshme për zjarrfikës, deri te pjesët e fluturakeve kozmike), por më i njohur është përdorimi në jelekët antiplumb që mbrojnë nga plumbat.
5. Gjatë vitit 2019, shkollari **Sasho Jandreski** nga Prilepi, me ndihmën e disa profesorëve ekspertë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Fakulteti i Mjekësisë në Shkup, shpiku një shiringë me më shumë oda që i mbron tërësisht pacientët dhe personelin mjekësor nga hepatitet B dhe C dhe virusit hiv. Shpikja është e para e këtij lloji në botë dhe mundëson përdorim të shpejtë, lehtë dhe të saktë në çdo lloj terapie (dermale, epidermale, muskulore dhe intravenoze). Derisa ka qenë vullnetar në ndihmën e shpejtë mjekësore në Prilep, Jandreski ka ardhur deri te ideja të bëjë një shiringë të këtillë që mund të përdoret edhe në automjet të ndihmës së shpejtë mjekësore kur me shpejtësi të madhe barten pacientë të cilët luftojnë për jetë – procedura për dhënien e ilaçit prej një minute e 20 sekonda me shpikjen e re zvogëlohet në 40 sekonda me 100 për qind saktësi. Shiringa e re mjekësore është patentuar, ndërsa interesim për përpunimin e saj kanë treguar edhe kompani të huaja.
6. Francezja **Zhan Vilpre Pouer** qëndron prapa shpikjes që u mundëson shkencëtarëve më lehtë t'i studiojnë organizmat që jetojnë në ujë: akuariumin. Vilpre – Pouer ka hulumtuar një lloj specifik të oktapodit (të quajtur argonaut) për të cilin në atë kohë shumë shkencëtarë kanë menduar se e merr guaskën e tij nga një organizëm tjetër. Në vitin 1832, në mënyrë që të mund të përkufizojë nëse ky supozim është i saktë, Vilpre – Pouer ka vendosur se nevojitet kohë më e gjatë që ta vëzhgojë oktapodin, pas çka e ka bërë akuariumin e parë prej qelqi për vëzhgimin e organizmave ujore në kushte të kontrolluara dhe ka dëshmuar se argonauti e bën vetë guaskën e tij. Më vonë, Vilpre – Pouer ka shpikur edhe dy variante të akuariumit (mjet qelqi që vendoset në kafaz për studimin e organizmave që jetojnë në ujë të cekët dhe akuarium si kafaz që mund të përdoret në thellësi të ndryshme). Si shpërblim për punën e saj, Vilpre-Pouer është bërë gruaja e parë anëtare e Akademisë së Katantias, Itali (ku ka punuar dhe jetuar), si dhe e akademive të tjera shkencore.

7. **Nikolla Tesla** është shkencëtar serb, hulumtues dhe shpikës i fushës së elektroteknikës dhe radioteknikës. Ndonëse është i njohur si baba i rrymës së alternuar dhe shpikjeve të shumta futuriste, më i famshëm është për zbulimet e tij revolucionare në fushën e elektromagnetizmit nga fundi i shekullit 19 dhe fillimi i shekullit 20. Patentat e Tesllës dhe puna e tij teorike mbeten bazë për formimin e sistemit të përgjithshëm të rrymës së alternuar, duke përfshirë edhe konstruktimin e sistemeve trefazëshe, si dhe motorit të induksionit me të cilin bëhet pararendës i Revolucionit të Dytë Industrial. Pas demonstrimit nga ana e tij të radios si media për komunikim celular në vitin 1893, bëhet njëri nga shkencëtarët më të respektuar dhe më të mëdhenj amerikan dhe botëror. Një pjesë e madhe e punës së tij më të hershme do të bëhet bazë për inxhinierinë moderne, ndërsa shumë nga shpikjet e tij janë me rëndësi të paçmuar për zhvillimin e qytetërimit modern. Megjithatë, për shkak të karakterit të tij ekscentrik dhe ndonjëherë pohimeve fantastike për zbulime të mundshme shkencore dhe teknologjike, Tesla shpesh ka qenë i tallur.
8. Studentja **Franka Grazhdani** në vitin 2019 ka diplomuar në Fakultetin e Makinerisë në Shkup me shpikjen – shtroja të mençura për atlete që prodhojnë energji elektrike. Ndonëse shpikje të ngjashme tashmë kanë ekzistuar kur ka hulumtuar për punimin e saj diplomik, inxhinierja e re ka vendosur që të përdorë materiale të lira për të hulumtuar funksionimin e “shndërruesve” (disqeve metalike me kristal pizoelektrik, që kur deformohen gjenerojnë rrymë). Në këtë mënyrë, Grazhdani ka përpunuar një shtrojë që mund të vihet në çfarëdo këpucë, e bërë prej “shndërruesve”. Kur njeriu shkelë derisa ecë, “shndërruesit” deformohen me çka gjenerohet rrymë e cila ruhet në bateri, ndërsa dalja është kablllo e USB-së që hyn në aparatën që mbushet. E vetëdijshme për potencialin komercial të një produkti të këtillë, Grazhdani mendon edhe për zgjerimin e projektit të diplomimit drejt instalimit të “shndërruesve” në automjete dhe makina që gjenerojnë vibracione, ashtu që në këtë mënyrë të fitohet rrymë edhe prej tyre.
9. Në vitin 2009, **Kevin Sistrom** në kohën e tij të lirë ka mësuar të programojë dhe ka bërë një prototip për aplikacion të quajtur Burbn, që shfrytëzuesve të tij u ka mundësuar ta shënojnë lokalitetin e tyre, t’i publikojnë planet e tyre për aktivitetet e radhës dhe të shpërndajnë fotografi. Pasi ka arritur të mbledhë mjete fillestare për zhvillimin e mëtejshëm të aplikacionit, Sistromi ka filluar të punojë me mikun shumëvjeçar **Majk Kriger**. Së bashku e kanë analizuar aplikacionin e bërë Burbn dhe kanë vendosur të fokusohen vetëm në mundësinë e shpërndarjes së fotografive të fotografuara me telefona celularë. Pas analizës së aplikacioneve më të njohura për fotografim në atë kohë, Sistromi dhe Krigeri kanë vendosur të vendosin edhe mundësinë për shpërndarjen e fotografive në rrjetet sociale, si dhe mundësinë për të komentuar dhe “pëlqyer” fotografitë. Kështu kanë arritur deri te forma e sotme e Instagramit. Gjatë ditës së parë të publikimit të aplikacionit të ri, më shumë se 25 000 njerëz kanë filluar të përdorin aplikacionin, pas çka është bërë me famë botërore. .

10. Rugës për në Nju-Jork në vitin 1902 derisa po binte një shi i dendur, **Meri Anderson** ka vërejtur se vozitësi i automjetit shpesh është dashur t'i hapë panelet e dritares së parme në mënyrë që të mund të shikojë se ku e ka drejtuar automobilin. Menjëherë pas kthimit të saj në shtëpi në Alabama, Anderson ka vendosur të gjejë zgjidhje për këtë problem. Ndonëse paraprakisht kanë ekzistuar zgjidhje të ngjashme, shpikja e Andersonit ka qenë modeli i parë efektiv i fshirëseve të xhamave të automobilave, që janë aktivizuar pasi që do të shtypnit një levë të lidhur me vetë fshirëset. Në fillim, prodhuesit e automobilave e kanë refuzuar shpikjen e Andersonit duke thënë se e njëjta nuk ka kurrfarë vlere komerciale. Megjithatë, në vitin 1922 prodhuesit e Kadillakut kanë filluar ta përfshijnë shpikjen e saj në të gjithë automobilat e tyre. Pasi që ka skaduar patenti në emër të Andersonit, fshirëset për automobila janë bërë pajisje standarde në automobilat.

# Përmbajtja: Qytetar në shoqëri qytetare



## Rezultate nga nxënia

Nxënësi/nxënësja mund të dallojë nevojën për inovacion dhe sipërmarrësi për shkak të ndjekjes së dinamikës së zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësja mund të:

- sqarojë faktorë që i mundësojnë qytetarit të jetë novator dhe sipërmarrës,
- përshkruajë dhe diskutojë për mundësitë për shndërrimin e idesë në projekt.



## Materiale të nevojshme:

tabelë, shkumës/ marker, fletore, lapsa kimik, fletë pune 3.7.



## Metoda, teknika, forma:

formë e përbashkët e punës, bisedë e orientuar, punë individuale, diskutim

## ***Pjesa hyrëse e orës (5 min.)***

Mësimdhënësi e fillon orën me diskutim të shkurtër:

- ➔ A e shikonit veten në rolin e novatorit dhe/ose sipërmarrësit? Sa ju tingëllon tërheqëse kjo mundësi? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme).
- ➔ A mund të paramendoni se çfarë do t'ju kishte paraqitur pengesë në rrugën për t'u bërë novator/sipërmarrës? Si do t'i kishim zgjidhur këto probleme? (Pritet prej nxënësve të ndajnë ide të ndryshme: financa, materiale, mjedis që nuk i inkurajon, pasiguri, etj.).
- ➔ Cilat inovacione lënë përshtypje më të madhe te ju? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme).
- ➔ Sa është e mundshme të jesh kreativ dhe novator në një shoqëri bashkëkohore? Pse është kjo e rëndësishme? (Priten përgjigje të ndryshme prej nxënësve: gjithçka është tashmë e përpiluar, ekziston mundësia për kreativitet nëse analizohen nevojat e njerëzve, është me rëndësi për përparimin e shoqërisë, etj.).

Në fund të diskutimit, mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të marra nga nxënësit dhe nxjerrë konstatim:

Që një njeri të bëhet sipërmarrës dhe/ose novator, janë shumë të rëndësishëm faktorët që ndikojnë në të: klima ekonomike, kushtet që i ka për punë dhe jetesë, nxitja nga mjedisi, motivimi personal, etj.

## ***Pjesa kryesore e orës (30 min.)***

Mësimdhënësi sqaron se gjendja e përgjithshme shoqërore ndikon në zhvillimin e sipërmarrësisë dhe frymës novatore te qytetarët. Shteti ka interes të madh që t'i nxisë qytetarët të zhvillojnë frymën e tyre sipërmarrëse dhe novatore, meqë kështu ndërtohet baza për zhvillimin e shoqërisë moderne.

Në mesin e faktorëve që ndikojnë më së shumti në sipërmarrësin dhe inovacionet shpesh përmenden faktorët ekonomik: tregu i lirë dhe konkurrenca, politikat ekonomike të bizneseve të mëdha, format e ndryshme të motivimit të qytetarëve për sipërmarrësi përmes fushatave për vetëpunësim dhe hapjen e bizneseve, (jo)leverdia e kredive të nevojshme për sigurimin e mjeteve të duhura, etj. Gjithashtu, faktorët arsimor kanë pjesëmarrje të rëndësishme në zhvillimin e frymës sipërmarrëse të rinjtë: organizim të panairove dhe konkurseve, gara për inovacione, subvencione dhe ndihmë financiare, arsim plotësues dhe trajnime, etj.



Njëri prej faktorëve më të rëndësishëm që ndikojnë në frymën sipërmarrëse është edhe motivimi personal i qytetarit. Të jesh sipërmarrës do të thotë që të posedosh biznes personal, orar të punës dhe obligime për të cilat vendosë vetë sipërmarrësi, motivim më i madh për sukses dhe me këtë shfrytëzim maksimal i potencialeve personale.

### **Aktivitet:**

#### ***Si të arrihet deri te ideja/inovacioni personal sipërmarrës? (25 minuta)***

Mësimdhënësi i paralajmëron nxënësit se përmes këtij aktiviteti do të kenë mundësinë që të hyjnë “në këpucët” e sipërmarrësve dhe novatorëve, për shkak se do të kenë për detyrë të përpilojnë dhe prezantojnë idenë dhe/ose inovacionin e tyre nga fusha që u intereson. Mësimdhënësi e ndan fletën e punës 3.7 pas çka u jep udhëzime nxënësve që të ndahen në grupe (3-6 nxënës), në të cilat do të kenë 15 minuta për të zhvilluar idenë sipas udhëzimeve nga fleta e punës. Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit të mendojnë për mënyra të mundshme të avancimit të jetës në bashkësinë e tyre, përmirësim të veglave dhe pajisjes që përdoren në mbrojtjen e profesionit, zgjidhjen e problemeve personale me të cilat shpesh takohen në jetën e përditshme, etj. Mësimdhënësi paralajmëron se pas kohës së dhënë për zhvillimin e ideve, vullnetarë do të kenë mundësinë që të bëjnë të ashtuquajturin “prezantim në ashensor” (në ang. Elevator pitch) në kohëzgjatje prej 30-60 sekondave para gjithë klasës me ç’rast do t’i prezantojnë informacionet kyçe për idenë e grupit të tyre.

Pasi të kalojnë 15 minutat e dhëna, grupet fillojnë me prezantimin, ndërsa mësimdhënësi i shënon idetë në tabelë. Nëse ndonjëri prej grupeve nuk ka përpiluar ide/nuk ndihet i përgatitur të prezantojë, mësimdhënësi sqaron se kjo është krejtësisht normale dhe se ofron mundësi për prezantimin e idesë së fillimit të orës së ardhshme mësimore.

## ***Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (10 min.)***

Mësimdhënësi fillon diskutimin në grup përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Cila prej ideve të prezantuara ju ka lënë përshtypjen më të madhe? Sipas cilave kritere? (Priten biseda të ndryshme prej nxënësve).
- ➔ Nëse i merrni parasysh origjinalitetin e ideve, potencialin për zgjidhjen e problemeve shoqërore dhe potencialin për bashkëpunim financiar, cila nga idetë e prezantuara i plotëson të tri kushtet më së miri? A dallon përgjigjja në këtë pyetje nga ideja juaj personale e favorizuar? (Pritet që një pjesë e nxënësve të kenë përdorur kritere nga ato të përmendura gjatë përzgjedhjes së idesë së favorizuar personale).
- ➔ Sipas jush, cilat kushte janë të nevojshme që ideja juaj e favorizuar personal të shndërrohet në realitet? Kurse për idenë që më së miri i plotëson tri kushtet e përmendura paraprakisht? (Përgjigje të mundshme: mjedis nxitës, financa dhe materiale, vetëbesim, arsim plotësues, mbështetje nga shteti, etj.).
- ➔ Cila pjesë e orës për ju personalisht ishte më mbresëlënëse dhe interesante? (Priten përgjigje të ndryshme nga nxënësit).
- ➔ Çfarë do t'ju kishte nxitur që të bëheni novator/sipërmarrës? Çfarë do t'ju kishte penguar? (Përgjigje të mundshme: më shumë orë ku do të ishte punuar në idetë personale, gara dhe konkurse, trajnime dhe shkëmbime plotësuese, mungesa e financave të mjaftueshme, mbështetja e ulët nga mjedisi, etj.).

## Fletë pune 3.7

### Gjashtë kapele e të menduarit

Teknikën "Gjashtë kapele e të menduarit" e ka shpikur Edvard de Bono, ndërsa tani përdoret në shumë fusha të ndryshme. Më poshtë janë dhënë çështje të ndryshme për secilën prej gjashtë kapelave e të menduarit, të përshtatura për procesin e zhvillimit të idesë së re sipërmarrëse dhe/ose inovacionit. Në grupin tuaj, mundohuni që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve në 15 minutat në vijim.

**1. Kapele e gjelbër – Kreativitet:** Cila është ideja sipërmarrëse dhe/ose inovacioni juaj?

Provoni të përshkruani me një fjali.

---

---

**2. Kapele e bardhë - Fakte:** Pse ideja sipërmarrëse dhe/ose inovacioni i juaj është i rëndësishëm / i nevojshëm në shoqërinë e sotme? Mbështetni idenë e përdorimit të fakteve, shembujve, statistikave, etj.

---

---

**3. Kapele e kaltër - Proces:** Si do ta kishit përpunuar idenë tuaj? Mendoni për procesin.

---

---

**4. Kapele e kuqe – Ndjenja:** Çfarë ndjenjash zgjon problemi/nevoja që doni ta zgjidhni me idenë tuaj sipërmarrëse dhe/ose inovacionin te njerëzit? Çfarë ndjenjash do të zgjonte zbatimi i idesë tuaj? Tentoni të hyni "në këpucët e qytetarit të rëndomtë".

---

---

- 5. Kapele e verdhë – Përfitime:** Çfarë përfitimesh do të marrin qytetarët nga ideja dhe/ose inovacioni juaj sipërmarrës? Çfarë do të përmirësoni në shoqërinë moderne dhe jetën e përditshme të qytetarëve? Mendoni në nivele të ndryshme (individ, familje, shkollë, komunë, shtet, gjithë bota) dhe në periudha të ndryshme kohore (ditë, javë, vit, dekadë, shekull).

---

---

- 6. Kapele e zezë – Rreziqe:** Për çfarë rreziqesh duhet të keni kujdes nëse vendosni që të zbatoni idenë dhe/ose inovacionin tuaj sipërmarrës? Çfarë rreziqe do të mund të sillte për qytetarët e rëndomtë? Sërish, është me rëndësi që të mendoni në më shumë nivele dhe për qasje të ndryshme kohore.

---

---

## **Përmbajtja: Qytetar në shoqëri qytetare**



### **Rezultate nga nxënia**

Nxënësi/nxënësja i analizon nevojat personale, i përcakton prioritetet dhe e planifikon financimin e tyre.



### **Standarde/tregues**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ dallojë mënyra dhe forma për sigurimin e parave (p.sh. përfitim, kursim, huazim, investim).



### **Materiale të nevojshme:**

fletore, lapsa kimik, tabelë, shkumës/marker, fletë pune 3.8.



### **Metoda, teknika, forma:**

stuhi e ideve, bisedë e orientuar, punë individuale.

## Pjesa hyrëse e orës (20 min.)

Mësimdhënësi ua shpërndanë nxënësve fletën e punës 3.8 dhe u jep 5-10 minuta për plotësimin e mëvetësishëm të pyetësorit. Si alternativë, mësimdhënësi mund t'i shkruajë pyetjet në tabelë/ t'i projektojë, ndërsa nxënësit t'i shënojnë përgjigjet e tyre në fletoret.

Pasi që nxënësit do të plotësojnë fletën e punës, mësimdhënësi fton disa vullnetarë që t'i ndajnë përgjigjet e tri pyetjeve të hapura. Më pas mësimdhënësi fillon diskutimin në grup (në kohëzgjatje prej 10-15 minutave) përmes pyetjeve si vijon:

- Sa janë të ngjashme nevojat dhe dëshirat tuaja që ishin përmendur me nevojat e prindërve tuaj kur kanë qenë në moshën tuaj, e sa tani? (Pritet nga nxënësit që të tregojnë se nevojat e tyre dallojnë nga nevojat e prindërve të tyre).
- Kush ju mundëson që të jeni konsumatorë, gjegjësisht të shpenzoni para për blerjen e disa produkteve të caktuara? Kur më shpesh vini deri te paratë? (Përgjigje të pritura: para për harxhime nga prindërit, dhurata për ditëlindje dhe ngjarje më të rëndësishme, përfitim, kursim, bursë).
- Si vendosni se do t'i shpenzoni paratë që i keni? A i plotësoni të gjitha dëshirat ose ndonjëherë jeni përballur me përzgjedhje të vështirë? (Përgjigje të mundshme: vendos sipas disponimit momental, mendoj gjatë, konsultohem me prindërit).
- Si ndjeheni kur të gjithë rreth jush shpenzojnë (p.sh. në qendër tregtare ose në shitore), ndërsa ju nuk keni mundësi ose rast që të silleni si të tjerët? (Pritet nga nxënësit që të ndajnë se nuk ndihen rehat dhe dëshirojnë që edhe ata të mund të shpenzojnë).
- A jeni pyetur ndonjëherë se sa është e domosdoshme ajo që e dëshironi dhe sa është vlera e tij reale për ju? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga nxënësit: blerje të telefonit të ri celular do të ma përmirësojë jetën për të mirë, nuk më intereson sa kushton ajo që e dëshiroj, është e rëndësishme që ta kem, etj.).
- Si quhet shoqëria bashkëkohore? Përgjigje të mundshme: kapitaliste, industriale, konsumatore, shoqëri e diturisë, etj.).
- Cili emër më së shumti i përgjigjet shoqërisë bashkëkohore sipas shprehive dhe sjelljes së njerëzve që i përmendët? (Pritet që nxënësit të shprehen me mbiemrin "konsumatore").

Gjatë diskutimit, mësimdhënësi i shënon termet kryesore nga përgjigjet e nxënësve në tabelë (p.sh. kursim, vlerësim i përfitimeve dhe shpenzimeve, përpilim i buxhetit, përpunim, huazim, konsum). Më pas, përmes përmbledhjes së përgjigjeve të nxënësve, mësimdhënësi nxjerrë konstatim nga diskutimi:

Siç tregon edhe vetë termi, shoqëria konsumatore mbështetet në konsumin e të mirave materiale dhe shërbimeve, që bëhen të arritshme për një pjesë gjithnjë e më të madhe të popullatës. Kjo ndonjëherë shpie edhe deri te një situatë shumë befasuese. Përshembull në ditën e lëshimit në shitje të modelit të ri të telefonit celular, njerëzit prisnin me orë që të hapen shitoret, ndërsa ndonjëherë edhe flinin para dyerve të tyre. Gjatë lëshimeve të mëdha siç ndodhë në „Të premtën e zezë”, njerëzit ndonjëherë konfrontohen fizikisht për produktin që duan ta blejnë.

## ***Pjesa kryesore e orës (15 min.)***

### ***Pjesa teorike (5 min.)***

Për dallim nga llojet e mëparshme të shoqërive, **shoqëria konsumatore** nënkupton prodhimtarinë masive të mallrave dhe ofertë të shërbimeve që larg do ta tejkalojnë minimumin konsumatorë, gjegjësisht ofertën e orientuar në kënaqjen e nevojave themelore.

Procesi i “shndërrimit” të punëtorit në **konsumator** ka qenë afatgjatë. Në shoqërinë parakonsumatore punëtori ka qenë i mësuar të punojë për të mirën e të pasurve, atyre për të cilat kanë qenë të dedikuara mallrat dhe shërbimet, ndërsa ai vetë të kënaqet vetëm me sigurimin e nevojave themelore ekzistenciale. Prodhimtaria masive, e me këtë edhe rënia e çmimeve të prodhimeve të dedikuara për tregun e gjerë, rezulton me rritjen e standardit të punëtorëve, e me këtë edhe mundësinë që punëtori të gjendet edhe në anën tjetër, si **konsumator** i mallrave dhe shërbimeve që ofrohen.

Efektet nga shoqëria **konsumatore** mund të jenë edhe pozitive edhe negative mbi individin dhe shoqërinë. Nga njëra anë, dëshira të posedohet diçka dhe mundësia që kjo dëshirë të kënaqet kontribuojnë për ndjenjën e kënaqësisë, ndërsa kontribuojnë edhe për zmadhimin e rritjes ekonomike dhe më shumë punësime. Nga ana tjetër, situata në të cilat shpesh dëshirojmë gjëra që nuk mund t’ia lejojmë vetes, ndërsa në shikim të parë na duken të arritshme dhe i shohim rreth nesh, mund të sjellin deri te frustrimet dhe pakënaqësia, e në disa raste edhe deri te huazimi i panevojshëm.

Gjithsesi, që dikush të jetë konsumator, duhet doemos të përfitojë. Për njerëzit e sotëm përfitimi është shumë i rëndësishëm, ndërsa ekzistojnë më shumë mënyra për të ardhur deri te paratë.

## **Aktivitet:**

### **Stuhi e ideve – Si të sigurohen paratë e nevojshme për konsum? (10 minuta)**

Mësimdhënësi i nxitë nxënësit të mendojnë për mënyrat e mundshme për sigurimin e parave dhe përgjigjet e tyre i shënon në tabelë. Në rastin kur disa prej tyre tashmë kanë qenë të përmendura në fillim të orës nga nxënësit dhe janë regjistruar në tabelë, mësimdhënësi tregon drejt tyre dhe i nxitë nxënësit përmes stuhisë që ideve që t'i sqarojnë termet e përmendura. Nëse është e nevojshme, mësimdhënësi i plotëson përgjigjet e nxënësve me termet që ata nuk i kanë përmendur dhe të njëjtat i sqaron.

Përfitim është shuma që i punësuar i fiton për një punë të caktuar të investuar (fizike ose intelektuale) dhe i mundëson t'i kënaqë nevojat themelore të tij. Ndonëse shoqëria konsumatore përmes reklamave, qendrave tregtare, mënyrës së pasimit të produkteve, e rritë apetitin tonë për shpenzim, ofron edhe mundësi të ndryshme se si të arrihet deri te përfitimi. Orën e kaluar kemi folur për sipërmarrësinë dhe inovacionet që janë mundësi e shkëlqyeshme për përfitim të mirë.

Në mesin e mënyrave të mundshme për sigurimin e parave ekzistojnë edhe: investimi në aksione, prona ose ndërmarrje në mënyrë që të fitohet profit, huazimi nga bankat në formë të kredisë dhe kursimit. Kursimi paraqet ruajtje të parave të përfituara/fituara, në mënyrë që ato të përdoren në të ardhmen. Njëra prej mënyrave më të shpeshta të kursimit është ruajtja e parave në bankë, për çka fitohet interes nga banka.

Në fund të aktivitetit, mësimdhënësi nxjerr konstatim:

Dituria dhe shkathtësitë që secili individ mund t'i përvetësojë gjatë arsimit formal dhe joformal e bëjnë secilin individ konkurrent në tregun e punës, me çka ai mund të përfitojë, huazojë, kursejë dhe investojë para për t'i plotësuar nevojat e tij. Në këtë mënyrë, mbyllet rrethi i shoqërisë konsumatore që varet nga përfitim i qytetarëve dhe standardi i tyre, gjegjësisht fuqia konsumuese që e kanë. Këta dy faktorë së bashku mundësojnë zhvillimin e industrisë dhe prodhimit më të madhe të mallrave dhe shërbimeve.



## *Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitetet për reflektim dhe vlerësim (10 min.)*

Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit që sërish t'i lexojnë përgjigjet e tyre në pyetjet nga fleta e punës 3.5 dhe fillon diskutim në grup:

- ➔ Pasi mësuat më shumë informacione për atë se si funksionon shoqëria konsumatore dhe mënyrat në të cilat sigurohen para, cilat nga dëshirat që juve ju duken më të rëndësishme, do të donit t'i realizoni në periudhën e ardhshme? Pse?
- ➔ Si i vlerësoni shprehjet tuaja konsumatore dhe kursyese?
- ➔ Çfarë prej këtyre shprehjeve do të ndryshonit në jetën e përditshme? Pse?

## Fletë pune 3.8

### Cilat janë shprehjet e mia konsumatore dhe kursimtare?<sup>1</sup>

Udhëzim: Bëj vlerësimin e shprehive tuaja konsumatore dhe kursimtare, e më pas shëno shkronjën që ka të bëjë me vlerën e përgjigjeve. Kjo shkallë e vlerësimit është anonime.

A - Gjithmonë, B - Në të shumtën e rasteve; C - Ndonjëherë; Ç - Rrallë; D – Asnjëherë

Pohim	Vlerë
1. Në kohë të lirë i shikoj vitrinat e dyqaneve.	
2. Kurrë dua të blej diçka të re, në të shumtën e rasteve bëj krahasim të çmimeve të produktit në më shumë shitore.	
3. Informohem çfarë ka të re në shitoret produktet e të cilave më interesojnë (p.sh. veshje, kozmetikë, libra, muzikë, motoçikleta, video lojëra).	
4. Nga paratë që i fitoj/përfitoj, kursej një shumë të caktuar çdo muaj.	
5. Kur të mësoj për ndonjë lëshim të madh të produktit që e dëshiroj, menjëherë e blej.	

Në jetën e përditshme në çka në të shumtën e rasteve shpenzoni dhe çka më së shumti shpenzoni? Mendoni dhe shënoni përgjigjet..

---

---

Çfarë është produkti më i shtrenjtë që e posedoni? Si vendosët se pikërisht këtë produkt doni ta blini? Sa kënaqësi ju solli produkti kur e keni blerë, e sa tani? Sa shpejtë dëshiruat të blini diçka të re? Mendoni dhe shënoni përgjigjet.

---

---

Shënoni pesë dëshira që doni/planifikoni t'i realizoni në periudhën e ardhshme (p.sh. udhëtim jashtë vendit, telefon të ri, video-lojë, etj.) dhe renditini sipas prioritetit/rëndësisë për ju. Mendoni se në çfarë mënyre do të kishit siguruar mjete për realizimin e tyre.

---

---

# Përmbajtja: Qytetari si konsumator dhe kursimtar



## Rezultate nga nxënia

Analizon nevojat personale, përcakton prioritetet dhe planifikon financimin e tyre



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësjë mund të:

- sqarojë rolin e qytetarit si konsumator dhe kursimtar,
- identifikojë situata se si ndryshojnë nevojat financiare të qytetarëve,
- bëjë vlerësimin e përfitimeve dhe rrezikut nga përdorimi i shërbimeve për kursim/huazim në bankë.



## Materiale të nevojshme:

tabelë, shkumës/marker, fleta pune/ fletore, lapsa kimik, fletë pune 3.9.



## Metoda, teknika, forma:

arometër i qëndrimeve, stuhi e ideve, bisedë e orientuar, punë në grupe.

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

### Aktivitet:

#### **Barometër i qëndrimeve**

Mësimdhënësi u jep udhëzim që të qëndrojnë në qendër mes dy poleve në të cilat janë vendosur kartela në të cilat shkruan "Jam dakord" dhe "Nuk jam dakord". Pasi që mësimdhënësi do të lexojë një pohim të caktuar, nxënësit marrin qëndrim dhe pozicionohen në njërin prej dy poleve, me ç'rast formohen dy grupe të nxënësve.

Propozim pohime:

1. Sot kurse, nesër kënaqu.
2. Fito më shumë, shpenzo më pak, pjesën e mbetur investoje.
3. Përdor kartela kreditore, huazo dhe relaksohu, një herë jetohe.

Pas leximit të secilit prej pohimeve, nxënësit duhet të marrin pozicionin në barometr, me ç'rast pritjet që të formojnë dy grupe që (nuk) janë dakord me pohimin e lexuar. Mësimdhënësi fton vullnetarë nga të dyja anët e barometrit që t'i sqarojnë pozicionet e tyre, me çka nxënësve u jepet mundësia që t'i argumentojnë qëndrimet e tyre. Pasi që nxënësit do t'i dëgjojnë argumentet e bashkënxënësve nga grupi i kundërt, kanë edhe mundësi që ta ndryshojnë pozicionin e tyre nëse e kanë ndryshuar qëndrimin e tyre.

Nëse ka nevojë, mësimdhënësi mund ta orientojë diskutimin me parashtrimin e pyetjeve plotësuese:

- ➔ Cili është dallimi themelor mes tri pohimeve?
- ➔ Cili nga pohimet më së shumti u përgjigjet shprehive tuaja momentale konsumatore dhe kursimtare?
- ➔ Cili nga pohimet u përgjigjet më së shumti shprehive që do të donit t'i zhvilloni/arrini?

Në fund të diskutimit, mësimdhënësi bën përmbledhjen e qëndrimeve të nxënësve.

**Shënim:** Si alternativë, mësimdhënësi mund t'u ndajë nxënësve kartela të kuqe/të gjelbra për shprehjen e (mos)pajtimin me pohimet e lexuara.

## ***Pjesa kryesore e orës (20 min.)***

Mësimdhënësi përkujton se në mesin e mënyrave të fitimit që ishin përpunuar në orën e kaluar janë përmendur edhe huazimi dhe kursimi. Në të shumtën e rasteve qytetarët, para se të vendosin për këto mënyra të fitimit, bëjnë analizë të fitimeve dhe shpenzimeve që do t'i kishin nëse zbatojnë ndonjë prej këtyre mënyrave. Kur bëhet fjalë për huazimin (në formë të kredive nga bankat), është me rëndësi që të merren parasysh kushtet për huazim që bankat i ofrojnë (p.sh. përqindje e interesit të parave të huazuara, dallimi mes normës fikse dhe fleksibile të interesit, korniza kohore për shlyerjen e kredisë, dallimi në shumën mes parave të huazuara dhe të kthyer, etj.), si dhe të bëhet plan realist për shlyerjen e kredisë sipas mundësive financiare të qytetarit. Kur bëhet fjalë për kursim (në formë të ruajtjes së parave në bankë, për çka qytetarët marrin interes), kushtet që duhet të merren parasysh dallojnë (p.sh. përqindja e interesit që do ta kishte marrë qytetari, kohëzgjatja e afatizimit të mjeteve, mundësi e përdorimit të mjeteve të afatizuara para skadimit të afatit të parashikuar, etj.).

### ***Aktivitet:***

#### ***Vlerësim i mënyrës së financimit të nevojave të ndryshme (15 minuta)***

Mësimdhënësi u ndan nxënësve fletën e punës 3.6. Si alternativë, mësimdhënësi mund ta projektojë fletën e punës me projektor. Të ndarë në 4-6 grupe (varësisht nga madhësia e klasës), nxënësit e plotësojnë fletën e punës në kohëzgjatje prej 7-10 minuta. Nxënësit kanë për detyrë që në kolonën e dytë t'i detektojnë dhe shkruajnë mënyrat e menaxhimit të mjeteve që janë dhënë në situatat e përmendura, ndërsa në kolonën e tretë të propozojnë zgjidhje që janë të ndryshme nga zgjidhjet e propozuara.

## Fletë pune e plotësuar **Shembull për mësimdhënësin**

	<b>Mënyrë e përzgjedhur e financimit</b>	<b>Propozim për zgjidhje ndryshe</b>
Mia është shkollare dhe këtë verë është mësa e vendosur që krahas pushimit vjetor me prindërit, të shkojë edhe në festivalin e muzikës në Dojran. Prindërit e paralajmëruan se nuk kanë para për të dyja kënaqësitë, kështu që ajo vendosi gjatë pushimit të punësohet në kioskën e afërt dhe të kursejë për festivalin.	Fitim me punësim Kursim	Heqje dorë nga njëri prej udhëtimeve
Lejla i dëshiron xhinset e reja që janë në vitrinë tashmë disa ditë. Nuk ka kohë dhe mundësi që të fitojë shpejtë, por mund të përdorë disa mjete që i ka kursyer nga ditëlindja që e kishte muajin e kaluar. Kështu vendosë që t'i blejë xhinset e reja.	Kursim	Fitim Huazim nga prindërit
Familjes Stoshiq i është prishur automobili i cili u është shumë i nevojshëm, por kjo ngjarje ndodhi në periudhën kur e rinovojnë shtëpinë. Tashmë janë duke i harxhuar rezervat familjare nga buxheti, kështu që vendosin të shfrytëzojnë minusin e lejuar të kartelës kreditore të cilin më pas do ta kthejnë gradualisht.	Kursim Huazim nga banka	Fitim përmes punës plotësuese
Familja Osmani vendosë ta zgjidhë problemin e saj banesor, duke marrë parasysh atë se familja u zgjerua dhe u nevojitet hapësirë më e madhe. Çmimet e banesave janë të larta dhe nuk kanë në dispozicion aq shumë të madhe. Kanë kursyer për pjesëmarrje, por pjesën më të madhe të shumës do ta sigurojnë me kredi banesore. Tani janë në kërkim pas bankës që ofron interes më të ulët për kredinë.	Kursim Kredi Huazim	Fitim përmes punës plotësuese
Marko ëndërron që të ketë motoçikletë tashmë disa vite, veçanërisht pasi që të gjithë shokët nga shoqëria tashmë kanë motoçikleta. Prindërit e tij kanë plan tjetër – kursejnë për studimet e tij të magjistraturës dhe nuk mendojnë se motoçikleta është prioritet. Marko vendosë të punojë gjatë fundjavave dhe pagën ta kursejë për motor. Prindërit janë dakord me vendimin e tij, me kusht që të mos e anashkalojë suksesin në fakultet.	Fitim Kursim	Huazim nga prindërit
Sara e di se vitin e ardhshëm shkollor shkohet në ekskursion shumëditor jashtë vendit dhe është e vetëdijshme se kjo do të jetë problem për familjen e saj për shkak të financave. Vendosë që të ndërmarrë nismë. Gjyshja e saj ka oborr të shkëlqyeshëm me lule që i shet në tregun e afërt. Nga kursimi i vogël që e ka, Sara blen fara të reja për lule, letra të ndryshme për mbështjellje dhe disa shirita me ngjyra të ndryshme. Bashkë me gjyshen e saj, vendosë të rrisë prodhimtarinë e luleve dhe të shesë në treg lule të mbështjella në mënyrë interesante. Sara planifikon që paratë nga shitja e luleve t'i shfrytëzojë për ekskursionin.	Kursim Investim	Fitim përmes punësimit
Familja Ordevski mori trashëgimi prej 50.000 euro. Janë të siguarur në aspektin banesor, kanë vende të mira të punës me paga solide, prandaj këto para në këtë moment nuk u janë të domosdoshme. Gjithmonë kanë planifikuar të bëjnë një fond për arsimimin e tre fëmijëve të tyre të mitur. Çifti bashkëshortor vendosë të blejë banesë që do ta japë me qira dhe paratë nga qiraja do t'i shfrytëzojë për kursim për arsimimin e fëmijëve të tyre.	Investim Kursim	Kursim të parave të trashëguara

Pasi që nxënësit do t'i plotësojnë fletët e punës, disa grupe i ndajnë përgjigjet e tyre. Mësimdhënësi nxitë diskutim (në kohëzgjatje prej 7-10 minutave) në mënyrë që nxënësit t'i dallojnë mënyrat e ndryshme për sigurimin e financave, të identifikojnë situata se si ndryshojnë nevojat financiare të qytetarëve, por edhe t'i vlerësojnë përfitimet dhe rrezikun nga shërbimet e bankave:

- Në çfarë sfidash hasën personazhet nga situatat dhe si i zgjidhnin ato? (Përgjigje të pritura: personazhet duhet të gjejnë zgjidhje për paratë që u nevojiten, i zgjidhën në mënyra të ndryshme).
- Cilat janë përparësitë nga kursimi në bankë, e cilat "rreziqet" nga huazimi? (Pritet nga nxënësit të bëjnë të ditur në situata të ndryshme përmes të cilave do të sqarojnë se, p.sh., paratë e kursyera në bankë nuk mund të shpenzohen lehtë, këstet për huazim mund të jenë shumë të larta, etj.).
- Cilët faktorë ndikojnë në përzgjedhjen e personazheve nga situatat për atë se si do ta zgjidhin situatën në aspektin financiar? (Përgjigje të pritura: situata në të cilën gjenden dallon, nuk është e njëjtë zgjidhja e çështjes banesore dhe blerja e motoçikletës/xhinseve).
- Çfarë ju shtyri që të merrni vendim ndryshe në situatat e paraqitura? (Pritet nga nxënësit që t'i sqarojnë mënyrat e financimit që i propozojnë si grup).
- Sa mund t'i lidhni situatat e dhëna me nevojat tuaja financiare dhe nevojat e familjes tuaj, fqinjëve, familjes më të gjerë, miqve? (Pritet nga nxënësit të komentojnë për atë se sa janë situatat reale).
- Sa dallojnë nevojat tuaja personale financiare nga nevojat e anëtarëve të tjerë të familjes tënde dhe miqve tuaj? (Përgjigje të pritura: dallojnë shumë me prindërit, dallojnë pak me miqtë).
- Cilat ishin prioritetet tuaja për konsumin dhe fitimin para 10 viteve, për çfarë ju nevojiteshin ato para? Cilat janë prioritetet tuaja tani? (Pritet nga nxënësit të ndajnë përvoja personale rreth dallimeve në prioritetet).
- Sipas jush, pse dhe si ndryshohen prioritetet për konsumin dhe mundësitë për fitim gjatë jetës? (Pritet nga nxënësit të komentojnë për faktorët e ndryshëm që ndikojnë te njerëzit: nevojë për arsim sipëror, zgjidhje të çështjes banesore, sigurim të ardhmërisë së sigurt për gjeneratat e ardhshme, etj.).

Në fund të diskutimit, mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të dhëna të nxënësve dhe nxjerr konstatim:

Gjatë jetës së një individi, prioritetet për konsum dhe mundësitë për fitim ndryshojnë vazhdimisht dhe në to ndikojnë shumë faktorë. Për shkak të kësaj, është veçanërisht e rëndësishme që qytetarët të punojnë në përmirësimin e aftësisë së tyre për të manipuluar me paratë (li ashtuquajturë arsimim financiar). Në këtë mënyrë, qytetarët do të mund të marrin vendime të përgjegjshme si konsumatorë dhe kursimtarë në një shoqëri.



## Pjesa përfundimtare e orës (10 min.)

Mësimdhënësi lexon tekst të shkurtër:

„Imagjioni se prej moti ëndërroni në fund të këtij viti shkollor të shkoni në ndonjë udhëtim të largët, për të cilin ju duhet një shumë e madhe e parave. Biseduat me prindërit rreth mundësive tuaja si familje, por fatkeqësisht ata nuk do të jenë në gjendje që t’ju ndihmojnë me financimin e udhëtimit. Ju këshilluan që të mendoni mirë dhe të vendosni se çfarë do të bëni“.

Mësimdhënësi nxitë diskutim në grup përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Çfarë do të bënit ju në situatë të këtillë? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga nxënësit: huazim të parave, punë sezonale, kursim, etj.).
- ➔ Cilët faktorë dhe si do të kishin ndikuar në vendimin tuaj? (Pritet nga nxënësit që të ndajnë përvoja rreth faktorëve që ndikojnë në vendimet e tyre financiare).
- ➔ Imagjioni se mënyra e vetme për të financuar udhëtimin e dëshiruar është huazimi i parave nga banka. Cilat pyetje do t’ia kishit parashtruar vetes para se të vendosni nëse do ta bëni këtë? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme: a do të kisha mundur ta prolongoj udhëtimin për vitin e ardhshëm, sa është me të vërtetë i domosdoshëm/i nevojshëm, a do të mund t’i kthej paratë e huazuara, etj.).
- ➔ Nëse vendosni të huazoni para, në çfarë do të kushtoni vëmendje? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga nxënësit: interesi, afat për shlyerje, vlerësim të mundësive personale për kthimin e parave, etj.).
- ➔ Kur dhe për çfarë keni huazuar para herën e fundit? Si ndjeheni kur keni borxh ose dikush ju ka borxh juve? (Pritet nga nxënësit që të ndajnë situata të ndryshme).

## Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)

Mësimdhënësi i nxitë nxënësit në diskutim përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Çfarë risie mësuat gjatë orës?
- ➔ Si do të jetë e dobishme kjo për ju në jetë? A do të kishit ndryshuar disa nga shprehjet tuaja konsumatore dhe kursimtare?
- ➔ Pse është e rëndësishme që qytetari të jetë i aftë të fitojë, por edhe të kursejë?
- ➔ Pse është me rëndësi që të shpenzohet? Çfarë do të kishte ndodhur nëse do të shpenzonim vetëm për nevojat themelore, ndërsa paratë tjera do t’i kishim ruajtur në shtëpi?

**Shënim:** Mësimdhënësi këto pyetje mund t’i japë edhe si pyetje për reflektim të asaj që është mësuar, të cilave nxënësit do t’u përgjigjeshin me shkrim në ditarët e tyre për reflektim.

## Fletë pune 3.9.

### Vlerësim i mënyrës së financimit të nevojave të ndryshme

Mënyrë e përzgjedhur e financimit

Propozim për zgjidhje ndryshe

Mia është shkollare dhe këtë verë është mësa e vendosur që krahas pushimit vjetor me prindërit, të shkojë edhe në festivalin e muzikës në Dojran. Prindërit e paralajmëruan se nuk kanë para për të dyja kënaqësitë, kështu që ajo vendosi gjatë pushimit të punësohet në kioskën e afërt dhe të kursejë për festivalin.

Lejla i dëshiron xhinset e reja që janë në vitrinë tashmë disa ditë. Nuk ka kohë dhe mundësi që të fitojë shpejtë, por mund të përdorë disa mjete që i ka kursyer nga ditëlindja që e kishte muajin e kaluar. Kështu vendosë që t'i blejë xhinset e reja.

Familjes Stoshij i është prishur automobili i cili u është shumë i nevojshëm, por kjo ngjarje ndodhi në periudhën kur e rinovojnë shtëpinë. Tashmë janë duke i harxhuar rezervat familjare nga buxheti, kështu që vendosin të shfrytëzojnë minusin e lejuar të kartelës kreditore të cilin më pas do ta kthejnë gradualisht.

Familja Osmani vendosë ta zgjidhë problemin e saj banesor, duke marrë parasysh atë se familja u zgjerua dhe u nevojitet hapësirë më e madhe. Çmimet e banesave janë të larta dhe nuk kanë në dispozicion aq shumë të madhe. Kanë kursyer për pjesëmarrje, por pjesën më të madhe të shumës do ta sigurojnë me kredi banesore. Tani janë në kërkim pas bankës që ofron interes më të ulët për kredinë.

Marko ëndërron që të ketë motoçikletë tashmë disa vite, veçanërisht pasi që të gjithë shokët nga shoqëria tashmë kanë motoçikleta. Prindërit e tij kanë plan tjetër – kursejnë për studimet e tij të magjistraturës dhe nuk mendojnë se motoçikleta është prioritet. Marko vendosë të punojë gjatë fundjavave dhe pagën ta kursejë për motor. Prindërit janë dakord me vendimin e tij, me kusht që të mos e anashkalojë suksesin në fakultet.

Sara e di se vitin e ardhshëm shkollor shkohet në ekskursion shumëditor jashtë vendit dhe është e vetëdijshme se kjo do të jetë problem për familjen e saj për shkak të financave. Vendosë që të ndërmarrë nismë. Gjyshja e saj ka oborr të shkëlqyeshëm me lule që i shet në tregun e afërt. Nga kursimi i vogël që e ka, Sara blen fara të reja për lule, letra të ndryshme për mbështjellje dhe disa shirita me ngjyra të ndryshme. Bashkë me gjyshen e saj, vendosë të rrisë prodhimtarinë e luleve dhe të shesë në treg lule të mbështjella në mënyrë interesante. Sara planifikon që paratë nga shitja e luleve t'i shfrytëzojë për ekskursionin.

Familja Ordevski mori trashëgimi prej 50.000 euro. Janë të siguarar në aspektin banesor, kanë vende të mira të punës me paga solide, prandaj këto para në këtë moment nuk u janë të domosdoshme. Gjithmonë kanë planifikuar të bëjnë një fond për arsimimin e tre fëmijëve të tyre të mitur. Çifti bashkëshortor vendosë të blejë banesë që do ta japë me qira dhe paratë nga qiraja do t'i shfrytëzojë për kursim për arsimimin e fëmijëve të tyre.

# Përmbajtja: Organizatat qytetare dhe grupet e përfaqësimit



## Rezultate nga nxënia

Nxënësi/nxënësjë di të vlerësojë rolin e organizatave qytetare dhe grupeve të përfaqësimit në shoqërinë qytetare dhe si qytetar/qytetare di t'i shfrytëzojë përfitimet e tyre.



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësjë mund të:

- identifikojë organizata qytetare dhe grupe të përfaqësimit,
- sqarojë rolin e organizatave qytetare dhe grupeve të përfaqësimit,
- di t'i sqarojë sfidat me të cilat përballen organizatat qytetare gjatë veprimit të tyre.



## Materiale të nevojshme:

tabelë, marker, shkumës, LCD projektor, kompjuter



## Metoda, teknika, forma:

stuhi e ideve, diskutim, frontale

## Pjesa hyrëse e orës (5 min.)

Në fillim të orës mësimit parashtrohet pyetje nëse nxënësit do të mund të përmendin disa organizata qytetare. Nëse nxënësit nuk dinë shembuj, mësimit mund të veçojë disa organizata, sipas mundësisë – lokale, specifike për vendbanimin dhe nevojat e mjedisit lokal. Mësimit jep sqarim të shkurtër për organizatat dhe aktivitetet e tyre.

Nga përshkrimi i mësimit, nxënësit nxiten që t'i përmendin karakteristikat e përbashkëta për **organizatat qytetare**. Përgjigjet e pritura janë: përmirësim i kushteve për jetë në bashkësi, shtet ose botë, mbrojtje të mjedisit, kafshëve, të drejtat e kategorive të ndryshme të rrezikuara të qytetarëve (gra, fëmijë, persona të moshuar, persona me nevoja të posaçme, të pastrehë, etj.). Përgjigjet shënohen në tabelë.

*Nëse ka mundësi, gjatë kësaj ose orës së ardhshme, mësimit mund të ftojë një përfaqësues të organizatës/grupit qytetar për përfaqësim në mënyrë që të ndajnë përvoja me nxënësit dhe japin mundësi për parashtrimin e drejtpërdrejt të pyetjeve.*

## Pjesa kryesore e orës (25 min.)

**Qytetarët bashkohen në organizata** për shkak të realizimit të qëllimeve të tyre, veprimtarive dhe mbrojtjes së të drejtave, interesave dhe bindjeve të grupeve të tyre qëllimore. Ata punojnë në përmirësimin e disa çështjeve të rëndësishme në planin lokal, shtetëror ose botëror (global). Disa nga karakteristikat globale janë ato se: nuk realizojnë profit/fitim, funksionojnë në bazë vullnetare dhe në të shumtën e rasteve financohen prej granteve, donacioneve dhe anëtarësive. Sipas Ligjit për shoqata dhe fondacione, nga organizatat qytetare pritet të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të punojnë në mënyrë transparente, ndërsa nevojitet t'u jepet liri e të shprehurit dhe promovim të qëndrimeve dhe mendimeve të tyre për çështje të ndryshme që u interesojnë, të nisin iniciativa, të marrin pjesë në ndërtimin e mendimit publik dhe krijimin e politikave.

Veprimi i **organizatave qytetare** ofron bazë të mirë për avancimin e sistemit përmes të cilit do të artikulohej parimet themelore të shoqërisë demokratike (p.sh. respektim i të drejtave të njeriut, ulje të përjashtimit social, etj.). Përmes angazhimit të **organizatave qytetare**, shoqëritë në mënyrë të drejtpërdrejt dhe më efikase mund t'u përgjigjen nevojave të qytetarëve dhe t'i përfaqësojnë interesat e tyre.

**Përfaqësim** është ndërmarrja e një veprimi konkret, që ka për qëllim të shkaktojë një ndryshim të caktuar (të ndonjë ligji, politike, vendimi). Qëllimi i grupeve të përfaqësimit është që të "kthehet" vëmendja e opinionit dhe bartësve të vendimeve drejt ndonjë çështjeje të caktuar, të vihet ndonjë

problem në agjendën për zgjidhje, përmes gjetjes së zgjidhjeve për të njëjtin, por edhe ndërtimin e mbështetjes për zgjidhjen dhe për aksionet e nevojshme për implementim. **Megjithatë qëllimi themelor i përfaqësimit mbetet ndryshimi i ndonjë praktike ose politike.**

**Vullnetarizmi** është praktikë e njerëzve që punojnë për të mirën e të tjerëve pa fitim material. Vullnetarizmi konsiderohet si aktivitet altruist i dedikuar për përmirësimin e cilësisë së jetës. Vullnetarët mund t'i bashkëngjiten ndonjë organizate qytetare (p.sh. për bartjen e ushqimit deri te familjet e rrezikuara sociale, strehimin e kafshëve, përkujdesje për mjedisin jetësor), por mund të veprojnë edhe individualisht.

### **Aktivitet:**

#### ***Diskutim pas ndjekjes së video inserteve (20 min.)***

Pas pjesës hyrëse, mësimitdhënësi përdorë LCD projektor dhe kompjuter në mënyrë që nxënësit të mund ta vizualizojnë atë që është thënë paraprakisht. Mësimitdhënësi përdorë video të shkurtra. Përveç videove të propozuara, mësimitdhënësi mund të përzgjedhë edhe video materiale të tjera ose tekste që janë relevante për temën.

Mësimitdhënësi projektton dy video klipe. Nëse nuk ka mundësi për projektim gjatë orës, nxënësit i marrin linkët në mënyrë elektronike dhe duhet t'i shikojnë nga shtëpia.

- „Gra në biçikletë për të drejta më të mëdha në Pakistan”, i arritshëm në Youtube (link)
- „Të të vizatoj: BARTËS TË NDRYSHIMEVE – Masë kritike” i arritshëm në Youtube (link).

Pasi të shikohen dy video përmbajtjet, nxitet diskutim sipas pyetjeve si vijon:

- Cilat janë arsyet për organizim dhe aktivizëm qytetar në të dy shembujt? (Pritet që nxënësit të bëjnë të ditur se në të dyja rastet vërehet rëndësia e organizimit qytetar për arritjen e një ndryshimi të caktuar pozitiv në shoqëri. Në videon e parë aksioni është organizuar nga një organizatë formale qytetare, ndërsa në të dytën nga një grup joformal i përfaqësimit, gjegjësisht lëvizje e organizuar joformale. Ndonëse të dyja rastet kanë të bëjnë me vozitjen e biçikletave nëpër qytete, në njërin rast nevoja rrjedhë nga mobiliteti më i madh i grave dhe përfaqësimi i tyre në sektorin publik, e në rastin e dytë nevoja është ndotje e zvogëluar e ajrit, përmirësim i shëndetit të banorëve të komunës dhe përfaqësim për infrastrukturë më të mirë për biçikleta).





- ➔ Me çfarë vështirësish hasin aktivistët dhe prej kujt? (Përgjigje të pritura: qëndrime dhe paragjykime të anëtarëve të tjerë të bashkësisë, kujdes i pamjaftueshëm i autoriteteve (komunale dhe shtetërore), mungesë e mjeteve financiare etj.).
- ➔ Kush u nevojitet për realizimin e idesë? (Pritet nga nxënësit që të bëjnë të ditur se për realizimin e ideve, nevojitet mbështetja nga sistemi).
- ➔ Sa është vështirë ose lehtë që të realizohet një nismë e caktuar qytetare? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga nxënësit).
- ➔ Mësimdhënësi bën rezume se roli aktiv i qytetarit në shoqëri paraqet mundësi që të veprohet në mënyra të ndryshme dhe përmes formave të ndryshme, në mënyrë që të përmirësohet jeta në bashkësi dhe shoqëri.

## ***Pjesa përfundimtare e orës (5 min.)***

Nxënësit nxiten të mendojnë në drejtim të asaj se në çdo shoqëri ekzistojnë probleme dhe nevojë për organizata qytetare. Me këtë rast, kanë për detyrë për orën e ardhshme të mendojnë për ndonjë problem të caktuar shoqëror në zgjidhjen e të cilit do të donin të përfshihen.

Në mënyrë që t'ua lehtësojë punën, mësimdhënësi u jep disa fusha (i shënon në tabelë):

- ➔ dhunë moshatare,
- ➔ respektim i të drejtave të fëmijëve,
- ➔ ulje të numrit të të pastrehëve,
- ➔ përkujdesje për kafshët e rrugëve,
- ➔ ndihmë për gratë viktime të dhunës familjare,
- ➔ përmirësim i cilësisë së jetës së personave me nevoja të posaçme,
- ➔ përmirësim i arsimit,
- ➔ promovim i kulturës urbane, etj.

Njëherësh, mësimdhënësi i ndan nxënësit në 5 grupe me idenë se në orën e ardhshme ata (nxënësit) do të duhet të bëjnë organizatën e tyre fiktive qytetare të cilës do t'i japin emër, do të përcaktojnë prioritetet e veprimit dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Deri në orën e radhës grupet duhet të mendojnë rreth ideve dhe të përzgjedhin temë. Gjatë vendimmarrjes, mund të udhëhiqen nga aktivitetet e realizuara paraprakisht në kuadër të përmbajtjeve: Humanitet (identifikim i personave të rrezikuar, nevojave dhe mbështetjes) dhe Roli i qytetarit në shoqëri (faza në zbatimin e nismës së nxënësve).

Gjatë punës në grupe, nxënësit komunikojnë në mënyrë elektronike edhe mes vete edhe me mësimdhënësin.

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)***

Mësimdhënësi fillon diskutim në grup:

- ➔ Sipas jush, ku në mjedisin tuaj ka më së shumti nevojë për intervenim qytetar?
- ➔ Sa qytetarët në shtetin tonë organizohen në organizata qytetare dhe grupe të përfaqësimit për zgjidhjen e çështjeve të caktuara që u interesojnë?
- ➔ Cilat janë rezultatet që konsideroni se mund të arrihen me përfaqësimin qytetar?
- ➔ Në çfarë organizate (do të donit) të jeni anëtar?

***Shënim: Mësimdhënësi mund t'i udhëzojë nxënësit që këtyre pyetjeve t'u përgjigjen në ditarët e tyre për reflektim.***

## ***Përmbajtja: Organizatat qytetare dhe grupet e përfaqësimit***



### ***Rezultate nga nxënia***

Nxënësi/nxënësja di të vlerësojë rolin e organizatave qytetare dhe grupeve të përfaqësimit në shoqërinë qytetare dhe si qytetar/qytetare di t'i shfrytëzojë përfitimet e tyre.



### ***Standarde/tregues***

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ analizon mënyra dhe forma të veprimit të organizatave qytetare dhe grupeve të përfaqësimit.



### ***Materiale të nevojshme:***

letër, markerë, ngjyra, tabelë, internet, lapsa kimik, fletë pune 3.10, fletë pune 3.11



### ***Metoda, teknika, forma:***

punë në grup, diskutim



## ***Pjesa hyrëse e orës (5 min.)***

Nxënësit përkujtohen në rolin aktiv të qytetarit në **shoqëri dhe përkujtohen** se për orën e sotme duhet të kenë ide të caktuara për formimin e **organizatës qytetare**. Grupet janë formuar nga ora paraprake, ndërsa mësimdhënësi në një hamer tashmë të përgatitur ua jep udhëzimet për formimin e **organizatës qytetare** fiktive.

## ***Pjesa kryesore e orës (30 min.)***

### **Aktivitet:**

#### ***Forma të veprimit të organizatave qytetare dhe grupeve të përfaqësimit (10 min.)***

Nxënësit e marrin fletën e punës 3.10 dhe duhet t'i shqyrtojnë përshkrimet e organizatave/grupeve që janë prezantuar. Për kursimin e kohës, mësimdhënësi mund ta dërgojë fletën e punës në mënyrë elektronike, në mënyrë që ta lexojnë para orës mësimore.

Pasi t'i shikojnë shembujt, mësimdhënësi nxitë diskutim sipas pyetjeve si vijon:

- Cilët nga shembujt janë organizata formale qytetare, e cilat grupe joformale të përfaqësimit? Si erdhët tek ky konstatim? (Përgjigje të pritura: tri të parat dhe e gjashta janë organizata formale qytetare, ndërsa e katërta dhe e pesta – grupe joformale që veprojnë në fushën më të ngushtë; të parat kanë strukturë të qartë, statut, anëtarë që zakonisht janë formalisht të punësuar në organizatë, derisa të dytat nuk kanë strukturë të qartë dhe zakonisht veprojnë në bazë vullnetare.)
- Cili lloj i organizimit të qytetarëve konsideroni se ka ndikim të madh në arritjen e qëllimeve të tyre? (Mund të priten përgjigje të ndryshme, por do të duhej të konstatohet se ndikimi nuk është e thënë të jetë i lidhur me atë nëse organizata është formale ose joformale, nëse vepron në bazë vullnetare ose jo. Nëse aktivitetet që i zbaton janë të orientuara në mënyrë përkatëse dhe nëse i prezantojnë me sukses interesat e tyre, qytetarët të organizuar në mënyra të ndryshme mund t'i arrijnë qëllimet e tyre. Megjithatë, në mënyrë që të mund të konkurrojnë për mjete nga donacionet/fondacionet e ndryshme, qytetarët duhet të jenë të organizuar formalisht në përputhje me Ligjin për shoqata dhe fondacione.) o организирани во согласност со Законот за здруженија и фон-дации.)

### **Aktivitet:**

#### **Organizata jonë qytetare (20 min.)**

Në kuadër të grupeve të përcaktuara gjatë orës paraprake, nxënësit duhet të punojnë në formimin e organizatave fiktive qytetare, me ç'rast duhet të përcaktojnë emër të organizatës, temë kryesore e interesit nga fushat si vijon – sipas përzgjedhjes (dhunë moshatare, respektim i të drejtave të fëmijëve, ulje të numri të të pastrehëve, përkujdesje për kafshët e rrugëve, ndihmë për gratë viktime të dhunës familjare, përmirësim i cilësisë së jetës së personave me nevoja të posaçme, përmirësim i arsimit, promovim i kulturës urbane ose tjetër), program për punë, etj. përmes ndjekjes së udhëzimeve të përcaktuara nga mësimdhënësi.

Mësimdhënësi u jep udhëzime për punë në hamer (të përpiluara paraprakisht) ose në formë të fletës së punës 3.11.

## ***Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (10 min.)***

Secili grup përmes prezantimit prej 2 minutave duhet ta prezantojë organizatën e tij. Me këtë rast, duhet të përgjigjen në pyetjet:

- Çfarë do të donin të ndryshojnë me angazhimin e tyre?
- Para kujt do të duhej të prezantohen idetë, nga kush të presin ndihmë dhe çfarë pritjesh do të kishin nga aktiviteti i tyre?

## Fletë pune 3.10

### Organizata qytetare dhe grupe të përfaqësimit

#### Shoqata e qytetarëve Sumnall

Shoqata është themeluar në qershor të vitit 2004 në mënyrë që t'u dalë në ndihmë shkollave dhe popullatës në lagjen Topana, të cilët përballen me normë të lartë të largimit nga shkollat, analfabetizëm dhe vetëdije të pamjaftueshme për rëndësinë e arsimit. Për të luftuar me këto probleme, Sumnal organizon dhe realizon aktivitete të ndryshme arsimore dhe shoqërore, si dhe aktivitete që e ndërtojnë karakterin. Përmes bashkëpunimit me bashkësinë, bashkëpunimit me këshillin e prindërve dhe vendosjes së marrëdhënieve të afërta me shkollat lokale, Sumnall është në gjendje t'i identifikojë dhe të fillojë t'u dalë në ndihmë nevojave plotësuese të bashkësisë. Sot, përveç më shumë se 60 orëve në javë aktivitete arsimore që u ofrohen fëmijëve, Sumnalli siguron spektër të gjerë të mundësive arsimore për të gjithë anëtarët e bashkësisë. Këto mundësi përfshijnë: edukim për të drejtat e grave, mësimdhënie, vizitim të ngjarjeve publike, regjistrim të qytetarëve, luftë me varfërinë që është e shpeshtë në atë rrethinë, dhunë në familje, higjienë dhe masa sanitare-shëndetësore, vaksinim, të drejta të fëmijëve, arsimim i të rriturve, pjesëmarrje demokratike.

**Vizion:** Romët janë të integruar në shoqëri dhe japin kontribut të madh në zhvillimin e shtetit.

**Misioni:** Të forcohet bashkësia rome në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes përmirësimit dhe zhvillimit të arsimit, kulturës, zhvillimit kreativ të fëmijëve dhe të rinjve, përfshirje sociale, zhvillim ekonomik, shëndetësi dhe mbrojtje të mjedisit jetësor.

#### HERA – Asociacion për edukim shëndetësor dhe hulumtim

HERA – Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim është shoqatë e formuar në janar të vitit 2000 nga ana e gjashtë vullnetarëve, studentëve të mjekësisë të vendosur që të ndërmarrin diçka rreth edukimit të pamjaftueshëm për HIV dhe SIDA dhe mungesën e ilaçeve dhe kujdesit për njerëzit që jetojnë me HIV në Maqedoni. Pak më vonë, HIV është njëri prej aspektet e shëndetit seksual dhe reprodaktiv, dhe të drejtat seksuale për avancimin e të cilave angazhohet organizata.

Gjatë viteve, HERA angazhohet për politika më të mira me qëllim në lirinë e zgjedhjes dhe në diversitetet. Siguron shërbime falas dhe të besueshme për shëndetin seksual dhe reprodaktiv dhe për dhunë të bazuar në gjini për shkak se qasja, arritja dhe besueshmëria janë të pandara nga shëndeti i qytetarëve. Edukon për të drejtat seksuale me qëllim qytetaria e fuqishme dhe shoqëria e qëndrueshme demokratike janë të paarrtshme pa informim gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrje rinore. Fuqizojnë të marginalizuarit me qëllim për të qenë inkluzive, shoqëria duhet të mbështetet në drejtësinë sociale.

**Mision:** HERA kryeson aksion qytetar dhe nxitë ndryshim shoqëror për realizimin e të drejtave seksuale dhe për mundësimin e arsimit dhe shërbimeve më të mira për shëndet seksual dhe reprodaktiv, veçanërisht për bashkësitë e marginalizuara.

**Vizion:** Të gjithë njerëzit e plotësojnë seksualitetin e tyre lirisht dhe në mirëqenie sociale.

## **Forum Femëror**

FF-ja është organizatë me seli në Tetovë, por aktivitetet e saj i realizon në një rajon më të gjerë të pjesës veriore dhe perëndimore të Maqedonisë. Organizata numëron rreth 40 anëtarë të cilët janë të përfshirë në aktivitete të organizatës. Anëtarët e FF-së kanë përvojë në punën me gra dhe fëmijë. Ata kanë marrë pjesë dhe punuar në një numër të madh të seminareve dhe projekteve për edukim të gruas dhe fëmijëve.

**Qëllimi kryesor:** Promovimi i gruas si partner i barabartë në marrjen e vendimeve dhe kontributin drejt forcimit të gruas në marrjen e roleve të rëndësishme në zhvillimin e shoqërisë civile në Maqedoni.

**Vizion:** Forumi Femëror – Tetovë synon drejt emancipimit të gruas, veçanërisht në mjediset rurale, vetëdijesim të gruas dhe ngritje të vetëdijes për statusin e saj të pabarabartë në shoqërinë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe barazisë në mes gjinive.

**Mision:** Forumi Femëror – Tetovë është organizatë joqeveritare e cila punon në pjesën veriore dhe perëndimore të Maqedonisë në ngritjen e vetëdijes së gruas për mëvetësimin e saj, forcimin e vetëbesimit të saj dhe integritet të papenguar në zhvillimet shoqërore.

## **Tuito racion**

Tuito racion është nismë joformale qytetare e cila gatuan ushqim për të pastrehët dhe të rrezikuarit social. Ideja është që të promovohet solidaritet, riciklim i ushqimit dhe vetëdijesim të secilit njeri në shoqëri që të mos hidhet, por të ndahet me atë që nuk ka.

Në bashkëpunim me shoqatën „Vepra të mirëfillta të mirësisë”, një herë në javë vullnetarët ndajnë racion të ngrohtë të përgatitur paraprakisht për persona të varfër dhe të pastrehë..

## ***Në biçikletë***

Grupi i çiklistëve – entuziastë të cilët angazhohen për infrastrukturë më të mirë të çiklistëve nëpër qytetet dhe kulturë çikliste mes qytetarëve. Aksion karakteristik është e ashtuquajtura „Masë kritike“ që në fakt paraqet vozitje të biçikletës nga ana e një numri të madh të çiklistëve. Krijohet kur një grup i çiklistëve do të tubohen në një vend dhe bashkë voziten nëpër rrugët e qytetit të tyre. „Masa kritike“ nuk ka udhëheqësi. Kjo është vozitje ku askush nuk është kryesori. Secili është përgjegjës për veten dhe për „Masën“.

## ***Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë***

Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë është organizim në të cilin vullnetarisht dhe në bazë demokratike bashkohen sindikatat punëtore për shkak të përfaqësimit të interesave ekonomike dhe sociale të anëtarësisë. LSM-ja është organizatë e mëvetësishme, e pavarur nga pushteti, punëdhënësit, partitë politike dhe organizatat dhe institucionet tjera. LSM-ja organizon numër më të madh të punëtorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe është organizatë reprezentative sindikale.

Qëllimet themelore të LSM-së janë: mbrojtje e të drejtave të punëtorëve, drejtësi sociale, siguri materiale, mbrojtje shëndetësore, sigurim pensional dhe invalidor, mbrojtje juridike, politike solide banesore, rikualifikim dhe përsosje profesionale të punëtorëve.

Metodat për realizimin e qëllimeve janë: forcimi i dialogut social dhe partneritetit social, pjesëmarrje në vendimmarrjen e institucioneve të sistemit, marrëveshje kolektive, mbrojtje të punëtorëve, bashkëpunim ndërkombëtar, arsim të anëtarësisë dhe informim objektiv të opinionit. Mënyrë parësore për realizimin e qëllimeve janë bisedimet dhe marrëveshjet me partnerët socialë. Nëse bisedimet nuk japin rezultat organizohen aksione industriale, në mesin e të cilave janë grevat.

LSM-ja angazhohet për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, për shtet juridik, demokraci dhe treg të lirë. LSM-ja kërkon që të gjithë punëtorët të jenë të lajmëruar rregullisht, të pranojnë pagë të rregullt dhe dinjitoze. Puna jashtë orarit dhe puna e natës duhet të paguhen veçantë, e drejta e pushimit vjetor nuk duhet të zvogëlohet, duhet të paguhen të gjitha kontributet – me një fjalë, të mos keqpërdoret asnjë e drejtë nga marrëdhënia e punës.

## Fletë pune 3.11.

### Organizata jonë qytetare

1. Emri i organizatës qytetare	
2. Përmendni së paku tri arsye për ekzistimin e saj.	
3. Cilat janë palët e prekura me problemin?	
4. Propozoni zgjidhje të mundshme.	
5. Ndryshimi që do të arrihet do të jetë...	
6. Промената што ќе се постигне ќе биде...	
7. Çfarë metodash/veglash do të përdorni për arritjen e ndryshimit?	
8. Slogani i organizatës	

# Përmbajtja: Mediat në shoqërinë demokratike



## Rezultate nga nxënia

Nxënësi/nxënësjë e dallon rolin e mediave në shoqërinë demokratike si kontrollor i pushtetit dhe instrument për pjesëmarrje aktive të qytetarëve në proceset demokratike



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësjë mund të:

- numëron dhe sqaron karakteristikat e mediave,
- vlerëson respektimin e parimeve të punës së medias (pavarësi, përgjegjësi, etikë, vërtetësi),
- analizon dhe vlerëson përmbajtje të ndryshme mediatike,
- vlerëson se si informacionet bartën dhe përjetohen ndryshe.



## Materiale të nevojshme:

letër, lapsa kimik



## Metoda, teknika, forma:

formë frontale, punë në grupe, diskutim

## Mësimdhënësi e fillon orën me pyetje për diskutim:

- Si informoheni në të shumtën e rasteve për atë që ndodhë rreth nesh, në botë?
- Çfarë mendoni, sa lajmet që i dëgjoni ose lexoni janë gjithmonë të sakta dhe objektive?
- Si të kontrollohen informacionet që si qytetarë i marrim nga mediat?

Nëse nxënësit në të shumtën e rasteve e përdorin internetin, mësimdhënësi i udhëheqë përmes pyetjeve që të vlerësojnë nëse kanë pasur mundësi që të lexojnë një lajm të caktuar në ndonjërin prej portaleve, e me këtë rast lajmi të jetë i transmetuar ndryshe. Pse është kjo kështu? Cilës media do t'i besojnë dhe si të dinë se cilat lajme janë të vërteta, e cilat jo?

(Përgjigje të pritura: nxënësit lexojnë lajme të ndryshme që transmetohen ndryshe, ndërsa kjo varet nga ajo se sa kanë qenë objektivë gazetarët, nëse i kanë kontrolluar të gjitha palët relevante, sa janë të pavarura mediat që kanë transmetuar një lajm të caktuar.)

### Aktivitet:

#### **Përhapje e lajmit (zërave)**

Si ushtrim për atë se përhapet një informacion i caktuar, mësimdhënësi propozon lojë "telefon i prishur" me atë që ai/ajo i pëshpëritë një fjali nxënësit të parë që bartet me pëshpëritje deri te nxënësi i fundit në klasë. Më pas nxënësi i fundit duhet ta thotë fjalinë ashtu siç e ka dëgjuar.

Propozim fjali: Në këtë dhomë me katër mure gjithmonë shkonte tezja Vida.

Pritet që versioni fillestar nga fjalitë do të ndryshohet njëjtë si edhe lajme të caktuara që nuk janë nga "dora e parë", ndërsa gjatë transmetimit kanë përjetuar transformim.

## Pjesa kryesore e orës (30 min.)

Mësimdhënësi shkurtimisht i përmendë termet kryesore, që mund t'i marrë edhe përmes diskutimit të orientuar me nxënësit.

**Media masive** (shpesh vetëm media) ose media publike — term që në të shumtën e rasteve përdoret në mënyrë që të shënohet ajo pjesë e mediave që depërtojnë deri te një publikë shumë e madhe. Media është ndërmjetësues ose mjet, kanal përmes të cilit qarkullojnë informacionet. Mediat i përdorim kur duam të komunikojmë në mënyrë indirekte ose direkte me njerëzit. Fjala media përfshin një numër të madh të mjeteve bashkëkohore për komunikim masiv, siç janë televizioni, interneti, kinemaja, filmi, radioja, gazetatat, revista, telefona, lojërat kompjuterike etj.



**Përmbajtja mediatike** shënon simbole, fotografi, muzikë, tekste etj. që transmetohen përmes mediave.

**Gazetarë** janë personat të cilët merren profesionalisht me grumbullimin dhe plasimin e lajmeve. Ata duhet ta paraqesin interesin publik, t'i mbrojnë të drejtat themelore të njeriut të lirisë së gjuhës dhe shprehjes dhe të informojnë opinionin për zhvillimet rrjedhëse. Gazetari krijon lajme në bazë të fakteve dhe informacioneve që janë paraqitje objektive dhe e baraspeshuar e realitetit. Gazetari mund të shprehë mendimet e tyre përmes kolumnës, e cila është zhanër i posaçëm i gazetarëve, gjegjësisht observacion kritik i ndonjë teme me interes publik.

**Burim i informimit** në gazetari mund të jetë një dokument, individ, institucion që përmban, gjegjësisht ka ndonjë lloj të informacionit. Ndarja themelore e burimeve të informimit është në primare dhe sekondare. Primaret posedojnë informacione të dorës së parë: dëshmitarë, pjesëmarrës në ngjarje, viktima, etj. Informacionet sekondare merren dhe mësohen në mënyrë indirekte: arkiv, bazë e të dhënave, ekspertë, etj.

**Lajmet** duhet të jenë me kohë dhe të sakta. Lajmi është i transmetuar tërësisht kur janë përgjigjur pesë pyetje: "Kush?", "Çka?", "Kur?", "Ku?" dhe "Si?". (P.sh. Kryetari i KSHZ-së, sonte në orën 12 në konferencë për media në komisionin, deklaroi se zgjedhjet parlamentare kanë kaluar në atmosferë korrekte dhe demokratike.)

**Parime themelore** të punës së secilit medium janë pavarësia, përgjegjësia, etika, **vërtetësia**.

**Pavarësia** ka të bëjë me informimin pa ndikim dhe presion nga pushteti, partitë politike, qendrat ekonomike të fuqisë, pa ndikim nga qendrat etnike, religjioze ose të tjera, si dhe pa presione nga redaktorët gjatë përzgjedhjes së temave ose gjatë nxjerrjes së fakteve.

**Vërtetësia** nënkupton se **gazetari** në informimin i respekton të gjitha standardet profesionale të gazetarisë dhe informon për fakte që i ka marrë prej burimeve relevante.

Përgjegjësi është kur **gazetari** informon me vërtetësi, nxjerr fakte që i ka marrë prej më shumë burimeve dhe u referohet atyre. Me këtë rast, **etika** nënkupton se e respekton kodeksin e gazetarëve, përdorë gjuhë me të cilën nuk etiketon, nuk ofendon, nuk akuzon, nuk përdor gjuhë të urrejtjes, nuk diskriminon.

(Mësimdhënësi bën të ditur se nxënësit mund ta shqyrtojnë „Kodeksin e gazetarëve“, i arritshëm në ueb-faqen e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (link).

**Redaktor** është personi që e rregullon programin dhe përmbajtjen e disa mediave të caktuara, e njëherësh është edhe përgjegjës për vërtetësinë dhe mënyrën e transmetimit të lajmeve.

## Aktivitet:

### **Përpilim i gazetës së shkollës (pjesa e parë)**

Mësimdhënësi jep detyrë që të përpilohet gazetë muri ose elektronike dhe i ndan nxënësit në 4 grupe, prej të cilave secila paraqet një media elektronike ose të shtypur, ndërsa nxënësit janë gazetarë. Nxënësit mund të përpilojnë emër të medias. Secila media ka detyrë që është marrë nga mësimdhënësi (kryeredaktor) të shkruajë një raport objektiv – tekst (prej 150 deri 200 fjalë) në formë elektronike ose të shtypur në temat si vijon:

- ➔ **Grupi 1.** Me cilat probleme hasen nxënësit në shkollën (tonë)?
- ➔ **Grupi 2.** Çfarë mësimdhënësish duan (preferojnë) nxënësit?
- ➔ **Grupi 3.** Pse disa mësimdhënës nuk janë të dashur në mesin e nxënësve (të mos përmenden emra të mësimdhënësve)?
- ➔ **Grupi 4.** Çfarë e bën shkollën tonë më të mirë se të tjerat?

Gazeta e murit mund të publikohet në hyrjen e shkollës, derisa ajo elektronike mund të shpërndahet në rrjetet sociale.

Gjatë orës, nxënësit duhet të vendosin (1) si do të mbledhin informacione për tekstin (realizim të intervistave, anketave, diskutimeve në grup me nxënës/mësimdhënës, shqyrtim të dokumenteve), (2) çfarë burimesh të informacioneve do të përdorin (primare, sekondare), (3) si do të sigurohen se informimi është i vërtetë, i përgjegjshëm dhe etik, (4) si do t'i prezantojnë informacionet. Gjatë aktivitetit duhet ta simulojnë procesin e grumbullimit të informacioneve, përmes intervistimit, anketimit të ndërsjellë, etj. Nxënësit duhet të përgatisin raportin gjatë orës, ndërsa mësimdhënësi paralajmëron se tekstet do të lexohen gjatë orës së radhës.

Nxënësve u jepet mundësia që t'i mbarojnë tekstet dhe para fillimit të orës së radhës, t'ia dërgojnë mësimdhënësit në mënyrë elektronike.

## *Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)*

Mësimdhënësi nxitë diskutim për punën gjatë aktivitetit paraprak:

- ➔ Si ndjeheni në rolin e gazetarëve? (Përgjigje të pritura: këndshëm/pakëndshëm, përgjegjshëm/papërgjegjshëm, me ndikim/pa ndikim.)
- ➔ A do të ndjeheni më këndshëm nëse do të duhej të shkruani për ndonjë temë tjetër (nga grupet tjera)? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme.)
- ➔ Sa konsideroni se ishit objektiv gjatë shkrimit të teksteve?
- ➔ A ndjenit "frena" gjatë përpunimit të teksteve (në kuptim të asaj nëse dikush ndoshta do të ndjehet i ofenduar për shkak të tekstit)?
- ➔ Kur ju është lajmëruar se në orën e ardhshme do të lexohen publikisht tekstet tuaja, a dëshiruat që të ndryshoni diçka në përmbajtjen? Nëse po, çfarë? Pse?

# Përmbajtja: Mediat në shoqërinë demokratike



## Rezultate nga nxënia

Nxënësi/nxënësja dallon rolin e mediave në shoqërinë demokratike si kontrollues të pushtetit dhe instrument për pjesëmarrje aktive të qytetarëve në proceset demokratike



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ vlerëson se si informacionet transmetohen dhe përjetojnë ndryshe,
- ➔ vlerëson respektimin e parimeve të punës së medias (pavarësi, përgjegjësi, etikë, vërtetësi),
- ➔ analizon dhe vlerëson përmbajtje të ndryshme mediatike.



## Materiale të nevojshme:

Fletë pune 3.12, letër, lapsa kimik, stikerë.



## Metoda, teknika, forma:

Metodë frontale, punë në grupe, punë individuale, diskutim,

## ***Pjesa hyrëse e orës (10 min.)***

Në fillim të orës, mësimitdhënësi kërkon prej nxënësve përsëritje të shkurtër për parimet themelore në gazetarinë, i orienton dhe u ndihmon që të përkujtohen. Për këtë qëllim, nxënësit marrin fletën e punës 3.12 në të cilën duhet ta rrumbullakojnë titullin/lajmin që përshtatet me parimin e ofruar.

Më pas, shkurtimisht diskutohet për përgjigjet e sakta.

## ***Pjesa kryesore e orës (30 min.)***

### ***Pjesa teorike (10 min.)***

Në fillim të pjesës kryesore të orës mësimitdhënësi pyet nëse nxënësit do të mund të sqarojnë termet **censurë dhe autocensurë**. Nëse termet nuk janë të qarta, mësimitdhënësi i sqaron.

**Censurë** është shtypja e fjalës ose llojit tjetër të komunikimit që mund të konsiderohet si i pakëndshëm, i dëmshëm, i ndjeshëm ose joadekuat për opinionin. Me një fjalë, censura është ndalesë për publikimin e informacioneve që janë të interesit publik.

**Autocensurë** është nëse gazetari (ose redaktori) vendosë në mënyrë të mëvetësishme të mos transmetojë ndonjë informacion opinionit meqë konsideron se do të mund të kishte pasoja nga transmetimi.

Mësimitdhënësi vazhdon me sqarimin e rëndësisë dhe parimeve të arsimit mediatic.

Mediat janë pjesë e pazëvendësueshme e jetës së njeriut bashkëkohor dhe ndikojnë në formimin e mendimeve, qëndrimeve dhe sjelljeve të publikut. Për këtë duhet të pranohet fakti se në procesin e shoqërizimit, përveç familjes, moshatarëve, arsimit, rol të rëndësishëm kanë edhe mediat. Për shkak të kësaj, është shumë e rëndësishme që të formohet publik që është i arsimuar në aspektin mediatic.

**Arsimimi mediatic** është aftësi për të kapur, analizuar dhe vlerësuar fuqinë e porosive që i dërgojnë mediat, si dhe për të komunikuar në mënyrë kompetente me mediat. Konkretisht, arsimimi mediatic ka për qëllim t'u ndihmoj qytetarëve të dallojnë se në çfarë mënyre mediat i "filtrojnë" perceptimet dhe bindjet e tyre, e formojnë kulturën e popullarizuar dhe ndikojnë në zgjedhjen personale. Njëherësh, nga qytetarët e arsimuar në aspektin mediatic pritet të jenë të aftësuar për mendim kritik dhe krijim të mëvetësishëm të informacioneve.

Kur ndjekim përmbajtje mediatike, është veçanërisht e rëndësishme të kemi raport kritik ndaj asaj që e shikojmë. Konkretisht, për të analizuar dhe vlerësuar përmbajtje të ndryshme mediatike duhet t'i parashtrojmë pyetjet si vijon<sup>1</sup>:

## **1. Kush e ka krijuar këtë porosi dhe pse është dërguar?**

Së pari duhet të fokusohemi pse ndonjë përmbajtje mediatike është krijuar. Vallë për të argëtuar, për të informuar ose për të bindur për diçka? Nëse e mësojmë arsyen pse është krijuar porosia, do ta kemi shumë më lehtë të kuptojmë efektin e saj. Është me rëndësi të dimë se kush e dërgon porosinë dhe cili është qëllimi. A është ky informacion ose propagandë e fshehtë, a është lajm gazetar ose mendim dhe qëndrim personal, a është film që është krijuar për të argëtuar ose ka ndonjë porosi të fshehur? Ndonjëherë dërguesi i porosisë dhe qëllimet e tij/ saj janë të qarta dhe të sinqerta, por jo gjithmonë është ashtu. Ka raste kur gazetari i tejkalon rregullat profesionale dhe standardet etike dhe në vend se objektivisht të transmetojë informacionin, tenton që me qëndrimin e tij të ndikojë në mendimin tonë.

## **2. Cilat teknika janë përdorur për të tërhequr vëmendjen time?**

Mediat shërbejnë me strategji më të ndryshme për të tërhequr vëmendjen tonë dhe të na interesojnë për porosinë që e transmetojnë. Kjo është veçanërisht e evidente në industrinë e marketingut, ku agjencitë reklamuese përdorin teknika më të ndryshme që të jenë më të suksesshme në qëllimin e tyre përfundimtar. Disa nga këto teknika janë: angazhim i individëve të famshëm për të reklamuar një produkt ose shërbim të caktuar, përdorim të muzikës dhe fotografive që shkaktojnë disa emocione të caktuara, etj. Teknikat varen nga publiku drejt të cilit janë orientuar reklamat.

Gjithashtu, edhe në emisionet dhe artikujt informative hasim teknika të ndryshme të tërheqjes së vëmendjes, mënyra të prezantimit të informacionit, tekstit, videos, fotografisë, të gjitha kanë rol tejet të rëndësishëm në këtë proces. Ndonjëherë teknikat me të cilat shërbejnë njerëzit që i krijojnë dhe transmetojnë përmbajtjet mediatike nuk janë etike, as profesionale. Ndonjëherë ato teknika përmbajnë manipulim, të vërteta të pjesshme ose të pavërteta, tituj që manipulojnë emocionet tona ose tituj që na bindin se duhet doemos të klikojmë dhe të lexojmë lajme: "Shokuese!", "Ekskluzive", "Nuk do t'ju besohet!!!"

### ***3. Cilat pikëpamje dhe vlera janë prezantuar përmes porosisë?***

Është me rëndësi të kuptojmë se ekzistojnë media që nuk kanë vlera dhe qëndrime të caktuara. Të gjitha mediat transmetojnë porosi të caktuara subtile për atë se kush ose çfarë është me rëndësi. Porositë domosdoshmërisht i përmbajnë edhe qëndrimet, mendimet dhe vlerat e atyre që i krijojnë. Për shembull, në vendimin për karakterin e personazheve në një seri, në vendimin për skenën, vendin, kohën e historisë, janë përfshirë qëndrimet dhe mendimet e atyre që e bëjnë këtë seri. Po madje edhe lajmet përmbajnë ide dhe vlera të përfshira, në përzgjedhjen e asaj që është e rëndësishme, në përzgjedhjen e temave, cilat lajmet do të shkojnë të parat, në përzgjedhjen e fokusit, përzgjedhjen e fotografive, etj. Prandaj, duhet të zhvillojmë shkathtësi që do të na ndihmojnë t'i dallojmë vlerat dhe idetë në përmbajtjet mediatike, në lajmet, në produksionin argëtues, në internet, veçanërisht kur ato janë të fshehura dhe të transmetuara në mënyrë subtile. Në këtë mënyrë do të mund të miratojmë vendime të drejta dhe të argumentuara, cilat porosi do t'i pranojmë, e cilat do t'i hedhim poshtë.

### ***4. Si interpretohet ndryshe kjo porosi nga njerëz të ndryshëm?***

Efekti nga porositë mediatike jo gjithmonë korrespondon me qëllimin e atij që ka krijuar porosinë dhe nuk është gjithmonë i njëjtë të të gjithë njerëzit. Disa do ta kuptojnë porosinë në një mënyrë, derisa të tjerët në mënyrë tjetër. Të kuptuarit e porosive do të varet nga njohuritë tona në fushat e ndryshme, nga përvojat tona dhe nga konteksti në të cilin e njëjta është transmetuar.

### ***5. Çfarë është lëshuar në këtë porosi?***

Porositë që i marrim përmes mediave nuk përmbajnë gjithçka. Shumë shpesh, qëllimisht ose pa qëllim, janë lëshuar disa pjesë të rëndësishme që mund të ndikojnë në atë se si do ta kuptojmë porosinë ose si do ta "dekodojmë". P.sh. reklamat për pije të gazuara gjithmonë fokusohen në elementin freskues të pijes, por asnjëherë në përbërjen (p.sh. sasia e sheqerit në produktin). Kjo është ashtu për shkak se ai që e krijon porosinë e ka privilegjin të vendosë se çfarë do të vendosë në reklamë, e çfarë do të përjashtojë. Nëse një gazetar e paraqet edhe anën tjetër, nëse përjashton informacione të rëndësishme që lajmit do t'i jepnin kuptim më ndryshe, atëherë themi se informimi është joprofesional dhe joobjektiv.

## **Aktivitet:**

### **Përpilim i gazetës së shkollës (pjesa e dytë) (20 min.)**

Mësimdhënësi u ndan grupeve tekstet e shkruara paraprakisht prej katër grupeve dhe lutë nga një përfaqësues nga secili grup që ta lexojë raportin e tyre që ka të bëjë me problematika në shkollën e tyre. Secili grup ka nga 2 minuta për prezantim. Pas përfundimit të prezantimeve, opinioni, gjegjësisht në rastin konkret nxënësit, duhet të diskutojnë se sa tekstet e kanë paraqitur gjendjen, kanë përdorur burime relevante, kanë qenë objektiv në prezantim, kanë raportuar në mënyrë etike. Njëherësh, duhet të tentojnë t'i analizojnë tekstet nga aspekti i pesë pyetjeve të arsyetuara paraprakisht.

Më pas, redaktori (mësimdhënësi/mësimdhënësja) simulon dy situata. Në të parën, vendosë një pjesë të teksteve (veçanërisht nëse ekzistojnë përmbajtje që nuk janë në favor të dikujt nga shkolla) që të mos publikohen ose të publikohen në formë të ndryshuar. Pas vendimit të këtillë, mësimdhënësi i nxitë nxënësit që të bisedojnë për censurën mediatike dhe ndikimin e së njëjtës mbi informimin përkatës të opinionit.

Në situatën e dytë, mësimdhënësi-redaktor nuk i censuron tekstet që përmbajnë kritikë objektive ndaj shkollës dhe/ose mësimdhënësve gjë që nxitë diskutim për integritetin dhe përgjegjësinë gjatë informimit. Nxitet diskutim në drejtim të përgjegjësisë së gazetarit (redaktorit) që duhet të jetë kryesisht ndaj opinionit, ndërsa qëllimet e objektivitetit të gazetarisë nuk duhet të jenë të orientuara për të nënçmuar ose poshtëruar dikë, por për të bërë të ditur për situatat që janë të pavolitshme për zhvillimin e shoqërisë qytetare, me qëllim të tejkalimit të tyre.

## **Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)**

Mësimdhënësi i nxitë nxënësit të mendojnë dhe bisedojnë për pyetjet si vijon:

- Çfarë risie mësuat gjatë orës?
- Si do t'ju shërbej kjo në jetë?
- Cilat parime të gazetarisë konsideroni se është më vështirë të respektohen?
- Si duhet të jetë roli i mediave në shoqëri?



## Fletë pune 3.12.

### Parime të gazetarisë

<b>Objektivitet</b>	Deri te aksidenti ka ardhur, kur një vozitës i dehur ka qëlluar një këmbësor, pohojnë dëshmitarë	Një i mitur i lënduar në aksident rrugor duke vrapuar në vend të pashënuar, deklaruan nga policia që kreu ekspertizë në vendin e ngjarjes
<b>Vërtetësi</b>	teknologjia 5G shërben për internet më të shpejtë	Teknologjia 5G vret shpendë
<b>Etikë</b>	Policia sekuestroi 2 kg. marihuanë në një banesë në Aerodrom	Në banesën e të miturit Pere Delev janë sekuestruar 2 kilogramë marihuanë
<b>Pavarësi</b>	Prokuroria Publike parashtroi aktakuzë kundër liderit të partisë P.P. pasi që ai javën e kaluar ishte kapur në kufi me një milionë euro të palajmëruara, për këtë ishte publikuar edhe video regjistrim nga arrestimi. Nga partia P.P. shprehen se bëhet fjalë për rast të montuar politik para zgjedhjeve	Në banesën e të miturit Pere Delev janë sekuestruar 2 kilogramë marihuanë

# Përmbajtja: Religjioni në shoqëri



## Rezultate nga nxënia

Nxënësit/Nxënësja e vlerëson në mënyrë kritike ndikimin e religjionit në shoqërinë bashkëkohore dhe sillet në mënyrë tolerante ndaj diversiteteve religjioze.



## Standarde/tregues

Ученикот/ученичката:

- përkufizon termet agnosticizëm, sekte, ateizëm,
- sqaron rolin e organizatave religjioze dhe fetare në shoqëri,
- argumenton të drejtën e njerëzve të përkatësisë së ndryshme (jo) religjioze,
- hulumton dhe prezanton veprimin e grupeve dhe organizatave të ndryshme religjioze.



## Materiale të nevojshme:

ompjuter, LCD projektor, letër, lapska kimik, CD-plejer, fletë pune 3.14



## Metoda, teknika, forma:

diskutim, metodë frontale, punë në çifte, punë individuale, punë në grup, pyetësor

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

Mësimdhënësi i fton nxënësit që në qetësi dhe me kujdes të dëgjojnë tekstin e këngës Imagine (Imagjino) të Xhon Lenon-it (e arritshme në linkun si vijon). Mësimdhënësi mund t'ua japë tekstin e këngës në formë të shtypur dhe me përkthim:

Imagine there's no heaven	Imagjinoni se nuk ekziston parajsja
It's easy if you try	Është lehtë nëse e provoni
No hell below us	Nuk ka ferr nën ne
Above us only sky	Mbi ne vetë qiell
Imagine all the people living for today	Imagjinoni të gjithë njerëzit që jetojnë për sot
Imagine there's no countries	Imagjinoni se nuk ekzistojnë shtetet
It isn't hard to do	Nuk është vështirë të bëhet
Nothing to kill or die for	Nuk ka arsye për vrasje ose vdekje
And no religion too	Dhe nuk ekziston religjion gjithashtu
Imagine all the people living life in peace ...	Imagjinoni të gjithë njerëzit që jetojnë në paqe...

Mësimdhënësi nxitë diskutim përmes pyetjes:

➔ Çfarë mendoni, si do të ishte bota në të cilën nuk ka religjion?

(Priten përgjigje më të ndryshme, prej të tillave se bota do të ishte vend ideal me mirëqenie, meqë nuk do të ketë ndarje, diskriminim; deri te qëndrimet se bota do të ishte vend më i keq meqë religjioni ekziston për ta bërë njeriun më të mirë).

## Pjesa kryesore e orës (25 min.)

### Pjesa teorike (10 min.)

Religjioni paraqet një sistem të besimeve dhe riteve në të cilin edhe fuqitë natyrore dhe shoqërore paraqiten si mbinatyrore, të pavarura nga njeriu, natyra ose historia.

Megjithatë, religjioni, në formë të ndryshme paraqitet vazhdimisht në njëfarë forme meqë ka funksione të tij siç janë:

1. **Shikim ndaj botës.** Secili religjion ofron një shikim të caktuar ndaj botës dhe mënyrë të të kuptuarit të dukurive të ndryshme. Në këtë mënyrë u ndihmon njerëzve që t'i sqarojnë dukuritë natyrore dhe shoqërore dhe ta përcaktojnë kuptimin e tyre.

2. **Psikologjik – emocional.** Ky funksion ka të bëjë me ofrimin e përgjigjeve për çështjet ekzistenciale siç janë vdekja, sëmundja, vuajtja, ligësia, fatkeqësia, etj. Dhe me këtë – ndihmon besimtarin që në aspektin psikologjik ta mbisundojë ndjenjën e frikës nga vdekja dhe dukurive të lidhura me të.
3. **Etik.** Përbëhet nga formimi i rregullave themelore morale të sjelljes që duhet të respektohen dhe praktikohen nga besimtarët.
4. **Shoqëror integrues.** Ideja themelore është se religjioni luan rol thelbësor në lidhjen, integrimin dhe bashkimin shpirtëror të shtresave të ndryshme në një bashkësi më të gjerë shoqërore. Përmes besimit të përbashkët, besimtarët lidhen me njerëzit tjerë me bindje të njëjta religjioze.

Ekzistojnë më shumë se 10 000 religjione në botë, por ndarja kryesore sot bëhet në bazë të asaj në çka dhe sa perëndi besohen. Sipas kësaj, dallojmë religjione monoteiste, karakteristika e të cilave është besimi në një Zot (p.sh. të tilla janë krishterimi që është në numër më të madh, Islami që është religjioni më i ri monoteist dhe i dyti për nga numri, dhe Judaizmi, i cili është religjioni më i vjetër monoteist).

Përveç religjioneve monoteiste, ekzistojnë edhe religjione pa paraqitje të perendisë si krijues të botës (religjione joteiste/religjione etike). Këto janë Budizmi, Taoizmi, Konfuçianizmi, ndërsa baza e tyre është përmirësimi i raportit të besimtarit me universin.

Religjionet politeiste karakterizohen me besimin në më shumë perëndi, ndërsa në numër më të madh është ai Hinduist.

Rreth 5% e popullatës botërore deklarohet si ateistë. Në kuptimin më të ngushtë, ateizmi është qëndrim se nuk ekzistojnë perëndi. Ekzistojnë lëvizje të ndryshme shekulare që në esencën e saj janë ateiste dhe konsiderojnë se parimet morale dhe sjellja nuk kanë të bëjnë me religjionin. Megjithatë, edhe individët të cilët nuk janë religjioz kanë nevojë për të kuptuar botën, por pikëpamjet e tyre dhe moralin në të shumtën e rasteve i ndërtojnë në bazë të informacioneve që i kanë marrë përmes studimit të filozofisë dhe shkencës.

**Agnosticizëm** është qëndrimi se ekzistimi i perëndive nuk mund të përcaktohet e as të dëshmohet. Fjala agnostik përdoret për ata që nuk janë të bindur në ekzistimin e perëndive ose dukurive të tjera shpirtërore.

**Sikti** është organizatë fetare e cila ka shikim personal ndaj botës, që rezulton nga ndonjë religjion dominues, por nuk është identike me të. Fjala sekt ka kuptimin e mësimi që është veçuar nga religjioni dominues nga i cili ka dalë.

P.sh. në fillim kur është paraqitur krishterimi ka qenë sekt – mësim i shkëputur nga judaizmi. Sot ka sekte të ndryshme, ndërsa shpesh të pranishëm në rrethinën tonë janë Dëshmitarët e

Jehovës, Dervishët, etj. Në terminologjinë moderne, shpesh shprehja sekt në fakt barazohet me termin kult që ka të bëjë me grup shoqëror me besime dhe praktika devijuese sociale ose të reja.

### **Aktivitet:**

#### **Çfarë jam unë? Në çfarë besoj?**

Mësimdhënësi i shënon në tabelë termet (ose i ngjet në pjesë të ndryshme të klasës): monoteist, politeist, pjesëtar i religjionit etik, ateist, agnostik, tjetër, nuk di /nuk dua të prononcohem.

I fton nxënësit të qëndrojnë para termit që konsiderojnë se i përshkruan më së miri bindjet e tyre personale. Nxënësit që duan mund të prononcohen për bindjet e tyre dhe të sqarojnë se si i kanë formuar të njëjtat (u janë bartur përmes familjes, i kanë përvetësuar me studimin e bindjeve të ndryshme religjioze dhe përzgjedhje të asaj që më së shumti përkon me vlerat e tyre, etj.). Mësimdhënësi nxitë diskutim për të drejtën e secilit individ për të zgjedhur sistem të caktuar të besimeve, që mund të jetë, e mund edhe të mos jetë i lidhur me ndonjë religjion të caktuar. Thekson se në një shoqëri demokratike është shumë e rëndësishme që secili të mund të zgjedhë lirisht pikëpamjen e tij ndaj botës (të përzgjedhë religjionin në të cilin do të besojë ose të mos jetë religjioz) dhe të respektohet e drejta e tjetrit, nëse të njëjtën nuk e shkelë e drejta jonë e përcaktimit religjioz. Kjo nënkupton se përcaktimi religjioz nuk është diçka me çka individ i lind, por të njëjtin e mëson dhe përvetëson përmes shoqërizimit në shoqëri, dhe mund ta ndryshojë nëse dëshiron.

### **Aktivitet:**

#### **Kush si mendon.**

Mësimdhënësi u jep individualisht nxënësve një pyetësor të shkurtër (fletë pune 3.14) në mënyrë që të detektohet se sa termet e sapomësuarat u janë të qarta dhe të kuptueshme, ndërsa qëllimi është që të dallojnë se si do të reagojnë personat religjiozë dhe joreligjiozë.

## Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (10 min.)

Mësimdhënësi e paraqet nenin 18 të „Deklaratës universale për të drejtat e njeriut“, sipas të cilës:

*Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit ose bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht, besimin ose bindjen e vet me anë të dhënes së mësimëve, kryerjes së kultit dhe ceremonive fetare.*

Në nivel të klasës fillohet diskutimi për tolerancën mes religjioneve dhe respektimin e qëndrimit të atyre që nuk janë religjioz, përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Çfarë duhet të bëjmë që të mos ketë paragjykime dhe diskriminim ndaj (jo)pjesëtarëve të (jo) përkatësisë tjetër religjioze? (Përgjigje të pritura: Të njohem me religjionet e ndryshme ose me ateistët, besimet themelore, vlerat që i përfaqësojnë, të tentojmë të kuptojmë pse kanë përzgjedhur një religjion të caktuar / pse kanë përzgjedhur të jenë joreligjiozë).
- ➔ Cilët janë stereotipat më të shpeshtë për religjionet e ndryshme/joreligjiozët? (Përgjigje të mundshme: Të krishterët nuk besojnë në shkencë, ateistët nuk veprojnë në mënyrë morale, myslimanët i nënçmojnë gratë, të gjithë budistët janë vegjetarianë, etj.). Në kontekst të kësaj pyetje, mësimdhënësi duhet të bëjë të ditur se me njohimin e pjesëtarëve të ndryshëm të këtyre grupeve, stereotipat ulen, ndërsa vijnë në shprehje karakteristikat e përbashkëta.
- ➔ Sa konsideroni se i njihni besimet e njerëzve të mjedisit tuaj dhe si reflektohen ato në mënyrën e tyre të jetës? Çfarë do të mund të bëni në mënyrë që t'i njohni dhe kuptoni më mirë? (Priten përgjigje të ndryshme, prej mendimeve se i njohin dhe kuptojnë mirë deri te mendimet se nuk i njohin dhe mund t'i njohin dhe kuptojnë më mirë përmes: komunikimit të ndërsjellë; bisedimeve rreth çështjeve që u interesojnë; leximit dhe studimit të teksteve, riteve religjioze; vizitës në objekte religjioze, etj.).

## Fletë pune 3.14.

### Kush si mendon.

Pyetje	Ateist /Agnostik	Pjesëtar i ndonjë religjioni monoteist ose sekte (të përcaktohet cilit)
1.Si është krijuar njeriu?		
2. Çfarë ndodhë pas vdekjes?		
3. Kush do të më ndihmojë kur e kam më së vështiri?		
4. Sjellja ime morale ka të bëjë me ...		
5. Kam bërë shumë gjëra të këqija. Para kujt do të përgjigjem për këtë?		

## *Përmbajtja: Religjioni në shoqëri*



### **Rezultate nga nxënia**

Nxënësi/nxënësja e vlerëson në mënyrë kritike ndikimin e religjionit në shoqërinë bashkëkohore dhe të sillet në mënyrë tolerante ndaj diversiteteve religjioze.



### **Standarde/tregues**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ përkufizon termet fundamentalizëm dhe ekstremizëm radikal,
- ➔ dallon dhe diskuton për format e fundamentalizmit dhe ekstremizmit radikal fetar.



### **Materiale të nevojshme:**

letër, lapsa kimikë



### **Metoda, teknika, forma:**

diskutim, metodë frontale, punë individuale, stuhi e ideve, asociacione



## *Pjesa hyrëse e orës (5 min.)*

Mësimdhënësi në tabelë i shkruan termet "radikale" dhe "ekstreme" dhe kërkon nga nxënësit të japin asociacione se çfarë mendojnë kur do të dëgjojnë njërin, e çfarë kur dëgjojnë termin tjetër.

Asociacione të mundshme për "radikale" janë: revolucionare, progresive, mënyrë e re e këndvështrimit, ultra, militante, drastike, etj.

Asociacione të mundshme për "ekstreme" janë: e tepruar, fanatike, e skajshme, e dhunshme, larg mesit, maksimale, jostandarde, etj.

Asociacionet shënohen në tabelë rreth termeve. Janë të mundshme përputhje të asociacioneve..

## *Pjesa kryesore e orës (25 min.)*

### *Pjesa teorike (10 min.)*

Mësimdhënësi e vazhdon orën me sqarimin se gjatë orës do të ndalen në disa dukuri të caktuara negative që mund të shkaktohen nga interpretimet e ndryshme ekstreme të religjionit. Thekson se toleranca religjioze në histori ka luajtur rol të madh në uljen e dhunës, promovimin e pajtimit dhe mirëkuptimit mes grupeve kundërshtuese. Por, historia na mëson edhe atë se religjioni në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mund të jetë edhe arsye për luftëra, terrorizëm dhe forma të tjera të dhunës. Një pjesë e dukurive për shkak të cilave paraqitet kjo, janë përshkruar më poshtë.

**Fundamentalizëm** është mënyrë e të menduarit me të cilën disa parime të caktuara konsiderohen si të vërteta themelore, të cilat pa marrë parasysh se si janë, duhet të bëhen të pandryshueshme. **Fundamentalizmi** fetar, si term ka filluar të përmendet në fillim të shekullit 20 dhe me të janë shënuar besime të disa sekteve protestante nga SHBA-ja që i hedhin poshtë qëndrimet shkencore për evolucionin përmes seleksionimit natyror, i vendosin mësimet biblike mbi gjithçka, ndërsa Biblën si fjalë të paprekshme të Zotit. Religjione të ndryshme (Krishterimi, Judaizmi, Islami, Hinduizmi, etj.) kanë lëvizje që konsiderohen për fundamentaliste. E përbashkët për këto lëvizje është ajo se angazhohen për kthim drejt librave themelore të shenjta dhe drejt leximit më të thjeshtë të tyre, që shpeshherë është tekstuale dhe jokritike (Siç është e shkruar, ashtu edhe duhet vepruar). **Fundamentalizmi** në të shumtën e rasteve është reagim i globalizimit, kundërshton shekullarizimin (veçimin e bashkësive fetare nga shteti), parimet e demokracisë, barazinë dhe të drejtat e njeriut. **Fundamentalizmi** te çdo religjion e vendosë religjionin e tij mbi të tjerat, për shkak të cilës arsye është kërcënim për barazinë në shoqëri dhe shpeshherë

ndërlidhet me nacionalizmin dhe fashizmin. **Fundamentalizmi fetar** shpeshherë ndërlidhet me ekstremizëm, ndonëse të dyja termet janë të ndryshme.

**Ekstremizmi** paraqet besimin ose mbështetjen e ideve që janë shumë të ndryshme nga ajo që shumica e njerëzve mendojnë se është korrekte ose e arsyeshme. Për shkak të kësaj, ekstremizmi ka të bëjë me qëndrime ose sjellje për të cilën konsiderohet se janë jashtë normave. **Ekstremizmi i dhunshëm** ka të bëjë me besime dhe veprimet të personave që mbështesin ose përdorin dhunën për të arritur qëllime ideologjike, fetare ose politike. Shembuj të organizatave që zbatojnë ekstremizëm të dhunshëm janë: Neo-nazistët, Kju Kluks Klan, ISIL, Boko Haram, eko-terrorizëm, etj.<sup>1</sup> Një pjesë e tyre e arsyetojnë nevojën e dhunës përmes përdorimit të interpretimit jokritik të teksteve të caktuara religjioze.

**Radikalizimi** është proces përmes të cilit individit ose grupit pranon qëndrime dhe sjellje ekstreme sociale, politike ose religjioze, dukshëm të ndryshme nga shumica e anëtarëve të grupit/bashkësisë së tyre. Sjellja shpeshherë është e orientuar drejt synimit që të bëhet ndryshim i konsiderueshëm në shoqëri. Nëse individit i cili është i radikalizuar mendon për përdorimin e dhunës si mjet legjitim dhe i dëshiruar për veprim, atëherë bëhet fjalë për radikalizim që shpie drejt **ekstremizmit të dhunshëm**. **Ekstremistët** kanë qëndrime shumë të shprehura mbrojtëse ndaj grupit personal, ndërsa urrejtje, mosdurim dhe agresivitet ndaj ndonjë grupi tjetër. Qëllimi i tyre është ruajtja e vlerave, identitetit dhe pikëpamjeve të grupit personal, me mënyra që mund të jenë kufiri i skajshëm i së lejuarës ose mënyrë e paligjshme, siç është terrorizmi.

### **Aktivitet:**

#### ***Pse dikush do të shkonte drejt ekstremizmit (të dhunshëm)? (15 min.)***

Përmes stuhisë së ideve mësimdhënësi i nxitë nxënësit të përmendin arsye pse konsiderojnë se disa persona të caktuar (me fokus në të rinjtë) do të kishin pranuar qëndrime ekstremiste të përcjella me sjellje të dhunshme për mbrojtjen dhe/ose promovimin e tyre.

Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë. Më pas mësimdhënësi bën përmbledhjen dhe plotëson nëse është e nevojshme. Thekson se arsyet mund të kategorizohen në të ashtuquajturit:



<sup>1</sup> Mësimdhënësi mund t'u tregojë nxënësve, nëse kanë interes, të hulumtojnë për këto organizata dhe t'i veçojnë aspektet e veprimit të dhunshëm



A. „**Faktorë të shtyrjes**” (karakteristikat negative sociale, kulturore dhe politike të mjedisit shoqëror të dikujt, që ndihmojnë në “shtyrjen” e individëve më të rrezikuar në rrugën e ekstremizmit të dhunshëm), që mund të jenë:

- ➔ **personale:** ndjenja të padrejtësisë dhe diskriminimit; krizë dhe tragjedi personale; frustrim; tjetërsim; fascinim me dhunë; kërkim pas përgjigjeve për kuptimin e jetës; kureshtje; krizë e identitetit; përjashtim social; mohim i të drejtave dhe lirive qytetare; dëshpërim nga proceset demokratike, etj. dhe
- ➔ **faktorë strukturorë** që veprojnë si arsye për rritjen e përshtatshmërisë për zhvillimin e ekstremizmit të dhunshëm: rregullim i dobët shtetëror, mungesë e sundimit të së drejtës, korrupsion dhe krim, veçanërisht kur kombinohen me disa elemente të tjera.

B. „**Faktorë të tërheqjes**” (karakteristika dhe përfitime të ndryshme nga pjesëmarrja ose anëtarësimi në organizatë ekstremiste [të dhunshme] që i “tërheqë” individët e rrezikuar që të bashkëngjiten), e mund të përfshijnë: ndjenjë të përkatësisë ndaj ndonjë grupi anëtarësimi i të cilit mundëson lloje të ndryshme të leverdisë: punësim, para ose ndonjë leverdi tjetër materiale; premtim të idealeve më të mëdha krahas atyre materiale - liri, aventurë, ideologji; ndjenjë lojaliteti dhe përkushtimi; ndjenjë emocionimi dhe aventure; mundësi për “heroizëm”, ofrim të shikimit të thjeshtë të botës në të cilën gjërat janë bardh e zi (ne kundrejt atyre) etj.

Popullata e re konsiderohet si një ndër grupet më të rrezikuara të personave që lehtë mund të bien pre e ndikimit të grupeve të caktuara radikale që praktikojnë dhunë dhe ekstremizëm. Dëshira për përkatësi në një grup të caktuar, kërkimi pas identitetit, dëshpërimi nga institucionet, statusi social dhe familjar, kërkimi pas emocionit dhe aventurës është ajo që të rinjtë i bën shumë të ndjeshëm për të rënë pre e ndikimeve të ndryshme ose të pranojnë madje edhe aktivitete të dhunshme në mënyrë që t’i përmbushin pritjet dhe idealet e tyre. Në të shumtën e rasteve, manipulimi i të rinjve është në bazë individuale emocionale, ku personat e ashtuquajtur rekrutues i përzgjedhin të rinjtë të cilët në atë moment janë veçanërisht të ndjeshëm, gjegjësisht ndjejnë brengë për diçka të humbur, kanë marrëdhënie të këqija ose mosmarrëveshje me prindërit dhe në shkollë, ndjenjë se nuk janë të dashur, nuk kanë financa të mjaftueshme, shoqëri, ndjejnë se nuk i përkasin bashkësisë, konsiderojnë se nuk ka ardhmëri për ta, ndjejnë padrejtësi personale, etj.

Shenja të radikalizmit, ndonjëherë te të rinjtë manifestohen në mënyrë shumë të qartë dhe paralajmëruese, por ka edhe raste kur radikalizmi te të rinjtë është pak i dukshëm, po madje edhe nuk vërehet fare.

## ***Pjesa përfundimtare e orës (15 min.)***

Nxënësve u paraqiten aktivitetet si vijon që mund të ndërmerren në nivel të shkollës në mënyrë që të parandalohet bashkimi i të rinjve drejt lëvizjeve ekstremiste dhe shfaqje të sjelljes së dhunshme si rezultat i bindjeve. Ata duhet të vlerësojnë në shkallën prej 1 – nuk është fare efektive deri 5 – është shumë efektive, sa secila prej aktiviteteve mund të kontribuojë drejt përballjes me problemin e përmendur. Varësisht nga mundësitë e orës, nxënësit mund të votojnë me ngritjen e kartelës me numra prej 1 deri 5, ose nga ana tjetër, të punojnë në grup ku do të duhet të marrin vendim të përbashkët. Vlerësimet për një pjesë të aktiviteteve diskutohen në nivel të gjithë klasës (veçanërisht nëse ka dallime të mëdha në vlerësimin e efektivitetit të tyre).

### **Aktivite në nivel të shkollës për parandalimin e të rinjve që të bashkohen drejt lëvizjeve ekstremiste dhe shfaqjes së sjelljes së dhunshme**

---

Nxënësit i përcaktojnë në mënyrë të mëvetësishme rregullat dhe përgjegjësitë në shkollë;

---

Mësimdhënësit dhe shërbimi profesional bisedojnë haptazi me nxënësit për dhunën, radikalizmin, ekstremizmin dhe terrorizmin, si dhe pasojat prej tyre;

---

Shkolla rregullisht komunikon me prindërit/kujdestarët e nxënësve dhe siguron edukimin e tyre për parandalim nga radikalizmi dhe dhuna;

---

Me nxënësit bisedohet haptazi për diversitetet në religjionet dhe besimet;

---

Nxënësit nxiten për organizimin e fushatës për mjedis të sigurt shkollor për të gjithë;

---

Shkolla vendosë mekanizma për lajmërim (shërbim profesional ose online) që do t'i nxisin nxënësit të bisedojnë kundër shenjave të radikalizmit dhe dhunës;

---

Shkolla krijon platformë onlajn për edukim dhe parandalimin nga radikalizimi dhe dhuna e dedikuar për nxënësit;

---

Thirren prindërit/kujdestarët e nxënësit/nxënëses nëse ai/ajo tregon sjellje devijuese, të pazakonshme dhe të çuditshme që nuk është në përputhje me kodeksin e sjelljes në shkollë;

---

Mësimdhënësi e informon pedagogun, psikologun, drejtorin, si dhe këshillin e mësimdhënësve nëse vëren sjellje devijuese, të pazakonshme dhe të çuditshme te disa nxënësve të caktuar në mënyrë që të ndërmerren masa përkatëse.

---

# Përmbajtja: Kultura, institucionet kulturore dhe identiteti kulturor



## Rezultate nga nxënia

Identifikon rolin e kulturës, institucioneve kulturore në formimin dhe zhvillimin e identitetit kulturor.



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësja mund të:

- numërojë vlera kulturore të përgjithshme qytetëruese,
- sqarojë faktorët në zhvillimin e identitetit kulturor,
- përshkruajë kuptimin e të drejtave kulturore në zhvillimin e individit.



## Materiale të nevojshme:

letër, hamer, lapsa kimik, ngjyra, fletë pune 3.15



## Metoda, teknika, forma:

frontale, individuale, diskutim, stuhi e ideve, shprehje në formë të esesë.

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

Mësimdhënësi e shënon në tabelë citatin si vijon të Goce Dellçevit: „Unë e kuptoj botën si fushë për garë kulturore mes popujve“. Më pas nxitë diskutim në grup përmes pyetjeve si vijon:

- Çfarë mendoni se ka dashur të thotë Dellçevi me “garë kulturore mes popujve”? Si e interpretoni ju citatin? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme: garë konstruktive në arritjen e përparimit shoqëror, garë mes artistëve dhe punëtorëve kulturorë, etj.).
- Si, ju, si nxënës, do të mund të merrni pjesë në atë “garë kulturore”? (Priten përgjigje të ndryshme: përmes pjesëmarrjes në aktivitete shkencore dhe kulturore, përpunim të artit, bashkëpunim me përfaqësues të kulturave të tjera, etj.).
- Duke i marrë parasysh përmbajtjet mësimore të përpunuara paraprakisht, si do ta përkufizonit termin **kulturë**? (Pritet nga nxënësit që të përkujtohen se kultura përbëhet prej ideve, zakoneve dhe normave sociale të sjelljes në një shoqëri).
- Si është kultura në shoqërinë në të cilën jetojmë, krahasuar me kulturat tjera me të cilat jeni njoftuar? (Pritet nga nxënësit që të ndajnë karakteristika konkrete kulturologjike – gjuhë, racë, veshje, art, zakone, memorie kolektive, shkathtësi, etj.).
- A ekzistojnë vlera që janë universale dhe të pranishme në më shumë kultura të ndryshme? Cilat janë ato? (Pritet nga nxënësit të përmendin vlera që janë të përgjithshme qytetëruese, siç janë: liria, drejtësia, dinjiteti, e vërteta, barazia, paqja, ndershmëria, etj.).

Pas diskutimit të shkurtër, mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve dhe nxjerrë konstatim:

Ndonëse ekzistojnë një numër i madh i kulturave të ndryshme në botë, një pjesë e madhe e tyre ndajnë vlera që janë universale. Vlerat e tilla i quajmë vlera të përgjithshme qytetëruese dhe duhet t’i keni në mend gjithmonë kur flasim për rëndësinë e kulturës në një shoqëri, por edhe në nivel botëror.

## Pjesa kryesore e orës (25 min.)

### Pjesa teorike (10 min.)

Fjala **kulturë** vjen nga fjala latine „cultura” që fillimisht kishte kuptimin e pastrimit të truallit, gjegjësisht krijimit të sipërfaqeve të përpunueshme të tokës për nevojat e njerëzve. Në sociologji e ka thuar kuptimin e njëjtë – pastrim në kuptimin e përkujdesjes, ruajtjes dhe kultivimit të shpirtit të njeriut, kultivimin e sjelljes së tij në përputhje me disa norma të caktuara që vlej në bashkësinë.

**Kultura** paraqet një lloj të “programit mendor” meqë secili njeri mëson se si të sillet në mjedisin në të cilin funksionon. Përmes procesit të shoqërizimit që fillon në familje, e më vonë edhe përmes lojërave të fëmijëve, institucioneve arsimore, religjionit dhe mediave, individi i pranon dhe aprovon përmbajtjet kulturore siç janë gjuha, zakonet, ndjenjat, reagimet, vlerat, simbolet, ritet, etj. Në këtë mënyrë gjatë jetës e **ndërton identitetin e tij kulturor**.

Nga momenti i lindjes së tij e tutje, jeta e njeriut është e përcaktuar me **kulturën**. Pjesa më e madhe e njerëzve, pasi të lindin, tërë jetën e tyre e kalojnë në kulturën të cilës i takojnë. Duke jetuar në kulturën e tij, njeriu i pranon vlerat, idetë, rregullat dhe elementet tjera të saj. Në këtë mënyrë, kultura e formon botëkuptimin e tij dhe mënyrën e reagimit ndaj ndikimeve të jashtme. Kultura përkatëse i mundëson që të ndihet më ndryshe nga pjesëtarët e kulturave të tjera, kështu që në këtë mënyrë individi e krijon **identitetin kulturor** të tij.

Përkundër faktit që ekzistojnë elemente universale kulturore që janë karakteristikë e çdo shoqërie, ekzistojnë edhe elemente kulturore që praktikohen ndryshe në mjedise të ndryshme shoqërore. Për shkak të kësaj, thuhet se ekzistojnë dallime mes kulturave. Meqë shpeshherë **kultura** barazohet edhe me religjionin, prejardhjen etnike të njerëzve dhe ndarjen e shumicës dhe pakicës, është me rëndësi të përmendet se koncepti për shoqëri në të cilat ekziston vetëm një kulturë është mit. Në çdo shoqëri ka edhe shumicë të kulturave që dallohen mes vete, por kanë edhe ngjashmëri. Të thuhet se ndonjë shoqëri është **multikulturore**, në fakt do të thotë që të bëhet e ditur në diversitetin kulturor të kësaj shoqërie. Shembull tipik për një shoqëri multikulturore është ajo e Maqedonisë.

Në shoqëritë demokratike, multikulturalizmi mbrohet edhe me të drejta kulturore dhe privilegje, të garantuara me Kushtetutë. Kjo nënkupton të drejtën e arsimit në gjuhën amtare, lirisë së krijimit shkencor dhe artistik, lirisë së bashkimit për shkak të realizimit të të drejtave kulturore, sociale dhe të drejtave të tjera. Çdo e drejtë duhet t’i plotësojë katër karakteristikat themelore si vijon:

- **Disponueshmëri:** Qasja deri te kultura përfshin katër elemente: mosdiskriminim, disponueshmërinë fizike, disponueshmërinë ekonomike dhe disponueshmërinë deri te informacionet. Kjo do të thotë se shtetet duhet të sigurojnë që secili qytetar të mund të gëzojë të drejtat kulturore pa diskriminim (në mënyrë të barabartë edhe në zonat rurale edhe në ato urbane, pa marrë parasysh moshën, gjuhën që e flet, nivelin e të ardhurave, dhe nevojat e posaçme). P.sh., nëse një nxënës nga një bashkësi të caktuar joshumicë në bibliotekën e shkollës nuk mund të gjejë libra në gjuhën që e flet në shtëpi, kjo do të thotë se kultura (në këtë rast librat) nuk i janë të disponueshme për nxënësit.
- **Pranueshmëri:** Kur përpilohen masa për realizimin e të drejtave kulturore, shtetet detyrimisht duhet të konsultohen me individë dhe grupe nga të gjitha kulturat, në mënyrë që të sigurohen se masat e planifikuara për mbrojtjen e diversitetit kulturor janë të pranueshme për ta. P.sh., gjatë planifikimit të çmimeve të biletave për të hyrë në një institucion kulturor, duhet të merren parasysh grupet e rrezikuara sociale. Biletat e shtrenjta janë të papranueshme për qytetarët me të ardhura të ulëta dhe e shkelin të drejtën e tyre të qasjes deri te kultura.
- **Përshtatshmëria:** Shtetet duhet të pranojnë qasje fleksibile ndaj të drejtave kulturore dhe të respektojnë diversitetin kulturor të individëve dhe bashkësive. P.sh. nëse një shkollë në të cilën mësimi zhvillohet në më shumë gjuhë mësimore bën kremtim vetëm në njërën prej atyre gjuhëve, kjo qasje nuk është e përshtatur me nevojat e të gjithë nxënësve dhe mësimdhënësve.
- **Realizimi përkatës:** Realizimi i të drejtave kulturore duhet të jetë përkatës me nevojat e qytetarëve dhe vlerat e tyre kulturore, me ç'rast duhet të merren parasysh edhe konsumi i ushqimit, përdorimi i ujit, dhënia e shërbimeve shëndetësore dhe arsimore, si dhe dizajni dhe ndërtimi i ndërtesave dhe institucioneve. P.sh. nëse gjatë ndërtimit të institucioneve kulturore nuk janë planifikuar rampa për qasje më të lehtë deri te vetë ndërtesat, ato nuk janë përkatëse për të gjitha grupet e qytetarëve për shkak se është shkelur e drejta e qasjes deri te kultura për qytetarët me invaliditet trupor.

### Aktivitet:

#### **Identitet kulturor (15 min.)**

Mësimdhënësi u ndan nxënësve fletën e punës 3.15, që nxënësit e plotësojnë individualisht në kohëzgjatje prej pesë minutave. Si alternativë, mësimdhënësi mund t'i shkruajë pyetjet në tabelë/t'i projektojë, ndërsa nxënësit t'i shënojnë përgjigjet në fletoret e tyre.

Pasi që nxënësit do të plotësojnë fletën e punës, mësimdhënësi fillon diskutimin në grup (10 min.):







- Si ndjeheshit derisa përgjigjeshit në pyetjet? A e kishit vështirë ose lehtë që të vendosni për përgjigjet? A ju befaso i diçka? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga nxënësit).
- Si vendosët se cili përcaktim kulturor ju përshkruan më së miri? Pse e zgjodhët pikërisht atë? (Pritet që nxënësit të përzgjedhin përcaktim kulturor me të cilin ndjehen më komod, si u përputhet më së miri me karakterin).
- Çfarë mendoni, pse disa nga stereotipat për kulturën të cilës i takoni nuk janë të sakta për ju? (Pritet nga nxënësit që të ndajnë komente dhe përvojat e tyre për temën, si dhe të bëjnë të ditur se ekzistojnë dallime mes njerëzve).
- Si do të ishit ndier nëse dikush sillet ndaj jush sikur të gjitha stereotipat për kulturën të cilës i takoheni janë të sakta për ju? (Përgjigje të pritura: pakëndshëm, i shqetësuar, i hutuar, me dëshirë që të sqarohet identiteti personal).
- Në situata në të cilat njoftoni individë të rinj, sa mbështeteni në përcaktimet kulturore në ndërtimin e raportit? A supozoni se disa gjëra janë të tilla siç paraqesin stereotipat ose nga ana tjetër, bisedoni haptazi për to me ata që i njihni? (Priten përgjigje të ndryshme nga nxënësit).

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve dhe nxjerrë konstatim:

Ndonëse ekzistojnë një numër i madh i dallimeve në identitetin kulturor të njerëzve rreth nesh, është me rëndësi që ta respektojnë dallimin kulturor dhe të punojmë drejt shoqërisë së integruar multikulturore.

## ***Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitetet për reflektim dhe vlerësim (10 min.)***

Mësimdhënësi u jep detyrë nxënësve që të ndahen në grupe të vogla (2-4 nxënës) në të cilat do të bisedojnë për veprat kulturore-artistike që u kanë lënë përshtypje të madhe dhe kanë ndikuar në zhvillimin e identitetit të tyre kulturor (p.sh. film, shfaqje, balet, operë, poemë, roman, etj.). Gjatë bisedës, nxënësit duhet t'i kushtojnë vëmendje edhe asaj që veprat e përzgjedhura kulturore-artistike flasin për identitetin kulturor të kulturës të cilës i takojnë nxënësit.

Në fund të orës, mësimdhënësi i ndan nxënësit në katër grupe dhe u jep detyrë që nxënësit duhet ta përgatisin deri në orën e radhës, kur është parashikuar prezantimi i asaj që është punuar. Nxënësit, me përdorimin e veglave onlajn, duhet t'i hulumtojnë temat e dhëna dhe të

bëjnë prezantimin e të dhënave të mbledhura (varësisht nga mundësitë, prezantimi mund të jetë Power Point/në hamer).

Secili prej grupeve duhet të hulumtojë një të një prej temave të përmendura:

Секоја од групите треба да истражи една од наведените теми:

- 1.** Të hulumtohen dhe prezantohen tri subkultura sipas përzgjedhjes (p.sh. reperë, biznesmenë, pankerë, hakerë, etj.).
- 2.** Të hulumtohen dhe prezantohen zakonet tradicionale të dasmave të tri bashkësive etnike në shtet.
- 3.** Të gjenden dhe të prezantohen nga tri barçoleta në gjuhën e folur të disa bashkësive etnike në shtet dhe të analizohet përmbajtja e tyre (p.sh. stereotipat në të cilat mbështeten).
- 4.** Të hulumtohen dhe të prezantohen vlerat kulturore dhe mënyrat e formësimit të tyre në stereotipa pozitive në tri shtete sipas zgjedhjes (p.sh. japonezët janë të zellshëm dhe të pastër, gjermanët punëtorë, anglezët të përmbajtur).

## **Fletë pune 3.15.**

### **Identitet kulturor**

- 1.** HShkruaj tri përcaktime kulturore me të cilat identifikohesh më së shumti. P.sh. nxënës/e, bir/bijë, femër/mashkull, sportist/e, muzikant/e, besimtar/e, pjesëtar/e e bashkësisë etnike \_\_\_\_\_, etj.

---

---

- 2.** Prej tri përcaktimeve kulturore që i shkrove, cila të përshkruan më së miri?

---

---

- 3.** Çfarë të pëlqen më së shumti te përcaktimi kulturor që e përzgjedhe?

---

---

- 4.** Shkruaj disa stereotipa për kulturën të cilës i takon, që për ty personalisht nuk janë të vërteta.

---

---

# Përmbajtja: Kultura, institucionet kulturore dhe identiteti kulturor



## Rezultate nga nxënia

Identifikon rolin e kulturës, institucioneve kulturore në formimin dhe zhvillimin e identitetit kulturor.



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësja mund të:

- sqarojë faktorët në zhvillimin e identitetit kulturor,
- analizojë dukuritë pozitive dhe negative në kulturë,
- hulumtojë dhe prezantojë simbolet e ndryshme kulturore dhe monumentet në grupet e ndryshme kulturore.



## Materiale të nevojshme:

letër, lapsa kimik, kompjuter, LCD



## Metoda, teknika, forma:

frontale, përpilim të projektit, diskutim

## ***Pjesa hyrëse e orës (10 min.)***

Mësimdhënësi e fillon orën me diskutim të shkurtër:

- ➔ Cilat vlera e bëjnë identitetin kulturor të shtetit tonë? (Priten përgjigje të ndryshme nga nxënësit - traditë, humanitet, drejtësi, bashkëjetesë, vlera familjare, etj.).
- ➔ Vallë, ju si nxënës, i takoni ndonjë subkulturë? Nëse po, cilës? Në çfarë dalloni nga kultura dominuese? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme: nxënës, të rinj, stili i veshjes, muzika që e dëgjojnë, vende në të cilat dalin për argëtim, shprehi, etj.).
- ➔ Si e përjetoni veten (p.sh. etnocentrist, relativizues kulturor, kosmpolit, nacionalist, patriot)? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga nxënësit.).
- ➔ A ndjeheni dhe silleni njëjtë në të gjitha situatat? Nëse ekzistojnë dallime, në cilat situata ndodhë kjo? Pse? (Pritet nga nxënësit të ndajnë se në situata të ndryshme sillen ndryshe.).

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve dhe nxjerrë konstatim:

Secili prej nesh u takon më shumë kulturave njëherësh. Përveç asaj që i përkasin kulturës dominuese në të cilën jetojmë, njerëzit shpesh u takojnë edhe subkulturave më të vogla dhe dallojnë në botëkuptimet dhe interesat e tyre. Për shkak të kësaj, është shumë e rëndësishme të bisedohet rreth dukurive pozitive dhe negative në kulturën. Kështu, derisa integrimi kulturor është dukuri drejt së cilës synojnë shoqëritë moderne demokratike, etnocentrizmi ka efekte të mëdha negative.

## ***Pjesa kryesore e orës (25 min.)***

### ***Pjesa teorike (5 min.)***

Njëra prej karakteristikave themelore të njeriut është nevoja e tij për të ndërtuar identitet kulturor. Gjatë jetës së tij, njeriu kryesisht e zhvillon dhe përforcon identitetin e tij kulturor. Pjesëtarët e një grupi të caktuar i lidhë kultura, historia, prejardhja e përbashkët, etj. që i bën të jenë të lidhur ngushtë mes vete. Në kuadër të një kulture të përbashkët që vlen si dominuese, shpesh paraqiten edhe subkultura (nënkultura) që zakonisht nuk e rrezikojnë kulturën dominuese, ndërsa krijohen si shprehje p.sh. e stilit të përbashkët të veshjes, shprehjes muzikore dhe afiniteteve, stilit të jetesës, profesionit, etj.

Kur njeriu bëhet i ngarkuar me kulturën e tij dhe ka numër të madh të stereotipave negativ në raport me kulturat tjera, thuhet se është bërë etnocentrik. Entocentrizmi në të shumtën e rasteve

shihet në dhënien e vlerësimeve negative për kulturat tjera, me ç'rast kultura e vetë shihet si më e mira dhe mbi të gjitha të tjerat. P.sh. në Gjermani gjatë Luftës së Dytë Botërore, nazistët e kanë shikuar racën ariane si më të mirë, ndërsa të gjitha kulturat tjera i kanë konsideruar më pak të vlefshme ose të pavlefshme. Etnocentrizmi pengon çfarëdo zhvillimi të marrëdhënieve mes kulturave të ndryshme, për shkak se niset nga dallimet e tyre të ndërsjella. Për shkak të kësaj, mund të vjen deri te izolimi i kulturave të caktuara, kështu që përfaqësuesit e tyre jetojnë në geto ose enklava të izoluara.

Në mënyrë që të evitohen pasojat negative nga etnocentrizmi, kundërpeshë e rëndësishme është relativizmi kulturor sipas të cilit të gjitha kulturat janë të ndryshme, por po aq të vlefshme. Ngjashëm me këtë, fenomen i kundërt i etnocentrizmit është kozmopolitizmi – filozofia e jetës sipas të cilës secili individ mund të gjejë vendin e tij në botë, pa marrë parasysh se cilës kulturë i takon (qytetar i botës).

Është me rëndësi të theksohet se formimi i një kulture është proces i përhershëm dhe dinamik, në të cilin ndikojnë të gjithë anëtarët e shoqërisë. Zakonet popullore, shprehjet e të folurit që përdoren, si dhe veprat artistike që i krijojnë punëtorët kulturorë, janë mënyrat më evidente në të cilat ndryshohet kultura në kohë të sotme, me çka ndikohet edhe në formimin e identitetit kulturor të një shteti.

### **Aktivitet:**

#### ***Prezantim i hulumtimeve (20 min.)***

Mësimdhënësi u bën thirrje grupeve që ishin formuar në orën paraprake që t'i prezantojnë hulumtimet e tyre të përpiluara si detyrë shtëpie. Secili prej grupeve ka tre minuta për prezantim. Në fund të prezantimeve, mësimdhënësi nxitë diskutim për informacionet e prezantuara dhe si janë ato të ndërlidhura me formimin e identitetit kulturor të një grupi të caktuar të njerëzve.

## ***Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitetet për reflektim dhe vlerësim (10 min.)***

Mësimdhënësi nxitë diskutim me nxënësit:

- ➔ A mësuat diçka të re nga hulumtimet dhe prezantimet? Nëse po, ndani se çfarë është ajo?
- ➔ Sipas jush, cilat janë elementet më të rëndësishme të identitetit kulturor të një njeriu? Cilët janë faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë?
- ➔ Cilat janë dukuritë pozitive, e cilat negative në kulturë?
- ➔ Pse është me rëndësi t'i njoftojmë dhe respektojmë kulturat tjera?
- ➔ Si do të mund të kontribuonit drejt integritit më të mirë multikulturor në shoqërinë tonë? Çfarë do të mund të bënit?

**Shënim:** Mësimdhënësi mund t'u japë udhëzime nxënësve që këtyre pyetjeve t'u përgjigjen në ditarët e tyre për reflektim.

*Moduli*



# **QYTETARI DHE SHTETI**



## Përmbajtja: Vlera demokratike



### **Rezultate nga nxënia**

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të dallojë dhe të vlerësojë vlerat demokratike në shoqëri.



### **Standarde/tregues për arritje**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ numërojë vlerat e demokracisë,
- ➔ përfaqësojë në mënyrë të argumentuar formën demokratike të udhëheqjes.



### **Materiale të nevojshme:**

letër, lapsa kimik, tabelë, fletë pune 4.1, fletë pune 4.2



### **Metoda, teknika, forma:**

metodë demonstruese, ligjërime, punë në çifte, diskutim në grup.

## Pjesa hyrëse e orës (15 min.)

### Aktivitet:

#### **Anije kozmike<sup>5</sup>**

Mësimdhënësi në fillim të orës i ndan nxënësit në grupe prej 6-8 nxënës, e ndan fletën e punës 4.1 dhe i jep instruksionet e nevojshme për përdorimin e fletës së punës. Më pas me zë e lexon tekstin si vijon:

„Paramendoni se grupi juaj është ekuipazhi i një anije kozmike që duhet të aterojë në anën e ndritshme të Hënës, në mënyrë që të takohet me astronautët të cilët ateruan atje një muaj më parë dhe së bashku të hulumtojnë atë anë. Megjithatë, për shkak të problemit me pajisjen, keni qenë të detyruar të ateroni në një lokacion 100 kilometra larg vendit të planifikuar për takim. Gjatë uljes, anija kozmike ishte dëmtuar dhe prandaj do të duhet të niseni në këmbë drejt vendit për takim. Për shkak të kësaj, nga lista e dhënë në fletën e punës 4.1, duhet t’i përzgjidhni gjërat më të rëndësishme që do t’ju ndihmojnë në udhëtimin tuaj të gjatë. Detyra juaj është që t’i renditni sipas rëndësisë gjërat e dhëna, me ç’rast 1 = më i rëndësishëm/me ndihmë më të madhe gjatë udhëtimit, ndërsa 14 = më së paku i rëndësishëm/ndihmë më e vogël gjatë udhëtimit. Është me rëndësi të dini se 1) duhet të lëvizni bashkë si grup drejt vendit të planifikuar për takim dhe se 2) të gjitha gjërat në listë janë në gjendje të mirë. Keni dy minuta për të plotësuar kolonën e dytë (renditje personale) në tabelën dhe 5 minuta për të marrë vendim në nivel të grupit dhe të plotësoni kolonën e tretë (renditje grupore).”

Pasi të skadojë koha për marrjen e vendimeve, mësimdhënësi në tabelë e shënon/projekton renditjen e sendeve të bërë nga ana e ekspertëve (shkencëtarë dhe inxhinierë), të paraqitur në tabelën 5.

Tabela 5. Rënditje eksperte e sendeve.

Gjëra	Rënditje	Gjëra	Rënditje
Oksigjen	1	Parashutë	8
Ujë	2	Trap (mjet i thjeshtë lundrimi)	9
Hartë	3	Raketë	10
Ushqim	4	Çumësht	11
Pranues për radio frekuenca	5	Ngrohëse	12
Litar	6	Busull	13
Kuti për ndihmë të parë	7	Shkrepës	14

5 Përshtatur nga: <http://civix.ca/resources/wp-content/uploads/2018/05/0N-Secondary-Lesson-3.pdf>



Mësimdhënësi u jep udhëzime nxënësve që t'i krahasojnë vendimet e tyre individuale dhe vendimet si grup me renditjen eksperte, pas çka nxitë diskutim (në kohëzgjatje prej 7-10 minutave) me pyetjet si vijon:

- ➔ Çfarë dallimesh ekzistojnë mes renditjes së grupit tonë dhe përgjigjeve eksperte? Çfarë mendoni, pse ekzistojnë dallime të tilla? (Përgjigje të mundshme: nivele të ndryshme të njohjes së materies, vështirësi për t'u përshtatur në grup, etj.).
- ➔ Çfarë dallimesh ekzistojnë mes përgjigjeve tuaja personale në kolonën e dytë dhe përgjigjet e grupit tuaj në kolonën e tretë? (Përgjigje të mundshme: dhënie të rëndësisë për gjëra të ndryshme, marrje parasysh të faktorëve të ndryshëm; etj.).
- ➔ Në kuadër të grupit tuaj, si vendosët për renditjen e gjërave? (Përgjigje të mundshme: konsensus, votë e shumicës, dominim të disa anëtarëve të caktuar, etj.).
- ➔ Gjatë vendimmarrjes a kishte anëtarë të grupit tuaj që e kryesonin diskutimin dhe/ose anëtarë që nuk janë përfshirë fare në diskutim? (Janë të mundshëm skenarë të ndryshëm, varësisht nga karakteristikat personale të nxënësve).
- ➔ Cilat janë përparësitë dhe dobësitë e marrjes së vendimeve si individë dhe si grup? (Përgjigje të mundshme: përgjegjësi e plotë personale, mbështetje në të tjerë, vështirësi për arritjen e marrëveshjes, etj.).

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve dhe nxjerr konstatim:

Ngjashëm si në aktivitetin që jemi duke e bërë tani, jeta në një shtet nënkupton marrjen e vazhdueshme të vendimeve – edhe në nivel individual edhe në atë grupor. Si kategori e veçantë e vendimmarrjes veçohet obligimi i disa qytetarëve të caktuar në shoqëri të cilët ushtrojnë funksione publike, t'i prezantojnë interesat e të gjithë qytetarëve dhe të marrin vendime për punë të ndryshme që më pas ndikojnë në gjithë shoqërinë. Ky proces i marrjes së vendimeve që ndikojnë te të gjithë qytetarët mund të dallojë nga shteti në shtet, varësisht nga mënyra në të cilën pushteti është rregulluar atje. Njëjtë sikurse procesi i vendimmarrjes që dallonte mes grupeve që i formuam për këtë aktivitet, ashtu edhe mes shteteve ka dallime – në një shtet është e mundshme që vendimet të merren sipas vullnetit të shumicës, në një tjetër një njeri të ketë fuqi mbi të gjithë, e në të tretin të ketë kaos të madh dhe të mos ketë role të përkufizuara saktësisht. Për shkak të kësaj, veçanërisht janë të rëndësishme vlerat dhe parimet themelore në të cilat mbështeten qytetarët, për shkak se ata më pas ndikojnë në rregullimin shtetëror.

## Pjesa kryesore e orës (25 min.)

### Aktivitet:

#### Përpilim i T-tabelës (10 min.)

Mësimdhënësi në tabelë vizaton T-tabela me ç'rast në një të anë e shënon titullin "Shtete demokratike", ndërsa në anën tjetër "Rregullime të tjera shtetërore". Më pas, mësimdhënësi i nxitë nxënësit të shkëmbejnë ide për karakteristika të demokracisë përballë rregullimeve të tjera shtetërore për të cilat kanë mësuar deri tani. Në fund të aktivitetit, mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve dhe e thekson rëndësinë e vlerave demokratike si bazë e shoqërisë bashkëkohore demokratike.

Tabela 6. Shembull për mësimdhënësin - T-tabelë e plotësuar

Shtete demokratike	Rregullime të tjera shtetërore
Vendimet merren në mënyrë demokratike	Vendimet i marrin një numër i vogël i njerëzve të cilët jo gjithmonë janë zgjedhur prej qytetarëve
Në zgjedhje qytetarët votojnë për përfaqësuesit e tyre	Pushteti i urdhëron qytetarët se si të sillen
Qytetarët kanë të drejtën e lirisë së fjalës	Mediat nuk punojnë lirshëm
Të gjithë janë të barabartë para ligjit	Ekzistojnë më shumë parti politike (pluralizëm politik)
Media të lira	Pushteti nuk është i ndarë në më shumë institucione

## Pjesa teorike (5 min.)

Mes shteteve demokratike shpesh ekzistojnë dallime në nivelin e zhvillimit, kështu që për disa shtete thuhet se janë më demokratike sesa të tjerat. Ajo që është e përbashkët për një numër të madh të shteteve bashkëkohore demokratike, pa marrë parasysh nivelin e zhvillimit, është përmbushja e vlerave të caktuara demokratike që janë kriter i rëndësishëm në mënyrë që një shtet të mund të quhet demokratik. Në vlerat themelore demokratike bëjnë pjesë:

- ➔ Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut;
- ➔ Mbrojtja e barabartë para ligjit e të gjithë qytetarëve;
- ➔ Pushteti demokratik që është zgjedhur nga populli në zgjedhje;
- ➔ Ekzistimi i më shumë partive politike (pluralizëm politik);
- ➔ Pjesëmarrje aktive e qytetarëve;
- ➔ Tolerancë, respektim i diversiteteve dhe vlerave të tjera demokratike.

Megjithatë, në botë ekzistojnë edhe shtete që nuk i përmbushin vlerat themelore demokratike. Në ato shtete mund të ketë diktaturë të një njeriu – të sunduesit të vetëm i cili ka një pushtet të madh në duart e tij, ose nga ana tjetër familje sunduese, një parti politike ose diktaturë të një grupi të njerëzve siç është aristokracia ose oligarkia. Ndonjëherë ndodhë që edhe vendi – demokraci në zhvillim të bëhet shtet autoritar (me ç’rast njerëzit në pushtet presin që qytetarët t’i ndjekin dhe respektojnë tërësisht vendimet e tyre) ose shtet totalitar (ku të gjitha aktivitetet e qytetarëve janë orientuar dhe kontrolluar nga pushteti).

**Shënim:** Një pjesë e të dhënave/informacioneve të ndara me nxënësit përmes përmbajtjes mësimore mund t’u jenë tashmë të njohura nxënësve, kështu që mësimdhënësi mund ta realizojë këtë pjesë të orës me parashtrimin e pyetjeve të shkurtra në mënyrë që të arrihet bashkëveprim më i madh.

### **Aktivitet:**

#### **Vlera demokratike<sup>6</sup> (10 min.)**

Nxënësit ndahen në çifte. Secili çift e merr fletën e punës 4.2 ku duhet t’i lidhin termet me përshkrimet e tyre. Për ndërlidhjen e fushave kanë 5 minuta. Pasi që nxënësit do t’i lidhin fushat, mësimdhënësi i nxitë nxënësit t’i ndajnë përgjigjet e tyre. Nëse ka nevojë, mësimdhënësi i sqaron në mënyrë plotësuese termet e dhëna dhe i ndan përgjigjet e sakta.

2 Përshtatur nga: [https://www.parliament.vic.gov.au/images/Education/Level\\_56\\_Democratic\\_Values.pdf](https://www.parliament.vic.gov.au/images/Education/Level_56_Democratic_Values.pdf)

## Shembull për mësimdhënësin - Fletë pune e plotësuar

Termi	Përshkrimi
Vendimmarrje demokratike	Proces i drejtë në të cilin vendimmarrja bëhet me mundësi të barabarta për përfshirjen e të gjitha palëve të prekura.
Demokraci përfaqësuese	Rregullim shtetëror në të cilin përfaqësues të zgjedhur të popullit marrin vendim për gjëra të ndryshme.
Qeveri transparente dhe llogaridhënëse	Secili qytetar mund ta kritikojë Qeverinë dhe/ose të kërkojë sqarim për vendimet që janë marrë. Qeveria përgjigjet në pyetjet dhe kërkesat e qytetarëve.
Liri e fjalës	Të gjithë qytetarët mund t'i shprehin lirshëm mendimet e tyre, përderisa nuk i shkelin kufizimet ligjore.
Barazi para ligjit	Të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit dhe nuk ka dallime në mënyrën e trajtimit për shkak të përkatësisë së tyre etnike, moshës, gjinisë, invaliditetit, etj.
Drejtësi sociale	Të gjithë qytetarët kanë mundësi të barabarta për jetë cilësore. Shpërndarja e burimeve është e drejtë. Qytetarët respektohen dhe tolerohen mes vete.
Barazi gjinore	Burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta, si dhe mundësi të barabarta për qasje deri te të gjitha profesionet.

## Aktivitet përfundimtar / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)

Mësimdhënësi e lexon tekstin e shkurtër:

„Paramendoni se jeni takuar me sukses me astronautët në vendin e planifikuar nga aktiviteti hyrës i kësaj ore. Shumë shpejt pas kësaj, njëri prej astronautëve dëshiron të vendosë pushtet në koloninë e re në Hënë me atë që do të shpallet mbret. Astronautët tjerë duhet t'i bindni se mënyra e këtillë e rregullimit mund të jetë e dëmshme dhe se përparësitë e rregullimit demokratik mundësojnë funksionim më të mirë të kolonisë. Çfarë do të shkruani në fjalimin tuaj para astronautëve të tjerë?”

**Shënim:** Nëse është e mundshme, mësimdhënësi mund të ftojë vullnetarë që t'i prezantojnë argumentet e tyre.

## *Fletë pune 4.1.*

### **Anije kozmike**

Gjëra	Renditje personale	Renditje grupore
Shkrepës		
Ujë		
Busull		
Hartë		
Ngrohëse		
Oksigjen		
Qumësht		
Pranues për radio frekuenca		
Trap (mjet i thjeshtë lundrimi)		
Litar		
Parashutë		
Ushqim		
Raketa		
Kuti për ndihmë të parë		

## Fletë pune 4.2.

### Vlera demokratike

Termi	Përshkrimi
Vendimmarrje demokratike	Burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta, si dhe të drejtë të barabartë të qasjes deri te të gjitha profesionet.
Demokraci përfaqësuese	Të gjithë qytetarët mund t'i shprehin lirshëm mendimet e tyre, përderisa nuk i shkelin kufizimet ligjore.
Qeveri transparente dhe llogaridhënëse	Të gjithë qytetarët kanë mundësi të barabarta për jetë cilësore. Shpërndarja e burimeve është e drejtë. Qytetarët respektohen dhe tolerohen mes vete.
Liri e fjalës	Secili qytetar mund ta kritikojë Qeverinë dhe/ose të kërkojë sqarim për vendimet që janë marrë. Qeveria përgjigjet në pyetjet dhe kërkesat e qytetarëve.
Barazi para ligjit	Rregullim shtetëror në të cilin përfaqësues të zgjedhur të popullit marrin vendime për çështje të ndryshme.
Drejtësi sociale	Proces të drejtë në të cilin marrja e vendimeve bëhet me mundësi të barabarta për përfshirjen e të gjitha palëve të prekura.
Barazi gjinore	Të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit dhe nuk ka dallime në mënyrën e trajtimit për shkak të përkatësisë së tyre etnike, moshës, gjinisë, invaliditetit, etj.



## Përmbajtja: Qytetari dhe shteti



### Rezultate nga nxënia

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të dallojë dhe të vlerësojë vlerat demokratike në shoqëri.



### Kritere për notim:

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ numërojnë vlerat e demokracisë,
- ➔ analizojë institucionet e rendit demokratik politik



### Materiale të nevojshme:

letër, lapsa kimik, fletë pune 4.3



### Metoda, teknika, forma:

formë frontale (e përbashkët), punë në grupe, hulumtim, prezantim, diskutim, teknika e rushit.

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

Mësimdhënësi në fillim të orës në tabelë e shkruan termin *demokraci*. Më pas i udhëzon nxënësit që lirshëm të ndajnë shprehje dhe aktivitete që janë të lidhura me termin qendror, ndërsa ai i shënon në tabelë dhe e shfrytëzon teknikën e rrushit. Nëse ka nevojë, mësimdhënësi mund t'i udhëzojë nxënësit të përkujtohen në aktivitetet e realizuara dhe përmbajtjet e përpunuara nga ora paraprake. Në fund të 10 minutave të parashikuara, në tabelën tashmë ka një rrush të madh me asociacione të nxënësve për termin *demokraci*.

## Pjesa kryesore e orës (20 min.)

### Aktivitet:

#### **Tregues global për demokraci**

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në pesë grupe. Më pas e ndan fletën e punës 4.3 në të cilën janë dhënë „Treguesiglobal për demokraci“ që përdoren për hulumtim dhe analizë të tendencave demokratike në 163 shtete në mbarë botën, nga viti 1975 e këndej. Secili grup merr njërin prej treguesve të dhënë në fletën e punës. Grupet marrin për detyrë të hulumtojnë në internet se cilat nga institucionet dhe organizatat që ekzistojnë në RMV janë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve lidhur me treguesin konkret që e kanë marrë si temë.

*Gjatë hulumtimit të institucioneve dhe organizatave, grupet duhet të përgjigjen në pyetjet si vijon:*

- ➔ *Cilat janë kompetencat e institucionit/organizatës, në çfarë fushe vepron?*
- ➔ *Si është i lidhur veprimi i institucionit/organizatës me përmbushjen e treguesit global për demokraci?*
- ➔ *Si do të mund të përmirësohej veprimi i institucionit/organizatës?*

Nxënësit kanë 10 minuta për hulumtim, dhe më pas secili prej grupeve i prezanton gjetjet e tyre (2 minuta për grup).

## Shembull për mësimdhënësin

### Tregues global për demokraci“ dhe institucione relevante në RMV

Tregues global për demokraci	Institucione dhe organizata relevante
<b>1. Qeveri përfaqësuese:</b>	
Zgjedhje të lira dhe korrekte	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Ministria e Punëve të Brendshme, organizatat qytetare
Mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët për votim	Kuvendi, Qeveria, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, ministrinë dikastere, organizatat qytetare
Parti të lira politike	Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, partitë politike
Përfaqësues të zgjedhur të qytetarëve	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Kuvendi, Qeveria, qytetarë dhe organizata qytetare
<b>2. Të drejta themelore të njeriut:</b>	
Qasje deri te drejtësia dhe sistemi juridik	Ministria e Drejtësisë, gjykatat, Avokati i Popullit, Kuvendi, organizatat qytetare
Të drejta dhe liri qytetare	Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, Kuvendi, organizatat qytetare
Të drejta sociale dhe barazi	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Avokati i Popullit, Kuvendi, organizatat qytetare
<b>3. Kontroll mbi pushtetin:</b>	
Integritet mediatic	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale, Ministria e Punëve të Brendshme, gazetarë dhe punëtorë mediatic, Këshilli i Etikës në Media
Gjyqësor i pavarur	Gjykatat, Ministria e Drejtësisë
Parlament efektiv	Kuvendi, Qeveria





<b>4. Administratë profesionale:</b>	
Zbatim i parashikueshëm i politikave publike	Administrata shtetërore dhe publike
Mungesë e korrupsionit	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Ministria e Punëve të Brendshme, organizatat qytetare
<b>5. Pjesëmarrje qytetare:</b>	
Demokraci lokale	Pushteti lokal, administrata lokale, organizatat qytetare
Demokraci e drejtpërdrejtë	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, qytetarët dhe organizatat qytetare
Pjesëmarrje në zgjedhje	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, qytetarë me të drejtë vote
Pjesëmarrje në shoqëri qytetare	Organizatat qytetare dhe grupe të përfaqësimit, ministri dhe institucione dikastere

**Shënim:** Nëse nuk ekzistojnë kushte për hulumtim në internet gjatë orës, mësuesi mund të japë fletën e punës si detyrë shtëpie në fund të orës paraprake ose të shtypë informacione për disa nga institucionet e RMV që janë relevante për treguesit global për demokraci.

Në fund të prezantimeve, mësuesi nxjerr konstatim:

Forma demokratike e udhëheqjes paraqet një përmbledhje të institucioneve në një shtet, me ç'rast pushteti shtetëror merr vendime për tema të ndryshme që i prekin të gjithë qytetarët, me ndihmën e institucioneve të ndryshme. Pushteti shtetëror është i ndërlikuar dhe i degëzuar në më shumë institucione në mënyrë që të mund të sigurojë efikasitet, demokraci dhe profesionalizëm. Me fjalë të tjera, institucionet janë pjesë e domosdoshme e rendit shtetëror demokratik. Për shkak të kësaj, në një demokraci të gjitha institucionet e formuara duhet të jenë funksionale në mënyrë që të mundësohet zhvillim në shoqëri.

## ***Pjesa përfundimtare e orës (10 min.)***

Në pjesën përfundimtare mësuesi i udhëzon nxënësit që ta shqyrtojnë sërish fletën e punës 4.3 dhe të mendojnë për përvojat e tyre nga jeta e përditshme në RMV. Më pas nxitë diskutim për vlerësimin e nxënësve rreth asaj se sa i përmbush RMV-ja treguesit individual.

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)***

Mësuesi u jep për detyrë nxënësve që të mendojnë për pyetjet e dhëna dhe përgjigjet t'i shënojnë në ditarët e tyre reflektues:

1. Përmes aktiviteteve në këto dy orë, mësova se...
2. Përmembajtjet për vlera demokratike më detyruan të mendoj për ...
3. Nga vlerat demokratike që i përpunuam, për mua personalisht më e rëndësishme është...
4. Për shkak të përmbajtjeve për vlera demokratike, u bëra i/e vetëdijshëm/me për ...
5. Në të ardhmen, atë që e kam mësuar nga kjo orë do ta zbatoj në atë mënyrë që ...

## **Fletë pune 4.3.**

### **Tregues global për demokraci<sup>7</sup>**

#### **1. Qeveri përfaqësuese:**

- Zgjedhje të lira dhe korrekte
- Mundësi të barabarta për votim për të gjithë qytetarët
- Parti të lira politike
- Përfaqësues të zgjedhur të qytetarëve

#### **2. Të drejta themelore të njeriut:**

- Qasje deri te drejtësia dhe sistemi juridik
- Të drejta dhe liri qytetare
- Të drejta dhe barazi sociale

#### **3. Kontroll i pushtetit:**

- Integritet mediatik
- Gjyqësor i pavarur
- Parlament efektiv

#### **4. Administratë profesionale:**

- Zbatim i parashikueshëm i politikave publike
- Mungesë e korrupsionit

#### **5. Pjesëmarrje qytetare:**

- Demokraci lokale
- Demokraci e drejtpërdrejtë
- Pjesëmarrje në zgjedhje
- Pjesëmarrje e shoqërisë qytetare

7 Përshtatur nga: <https://www.idea.int/data-tools/tools/global-state-democracy-indices>

## **Përmbajtja: Pushteti në funksion të qytetarëve**



### **Rezultate nga nxënia**

Nxënësi/nxënësja është i /e aftë të identifikojë pushtetin që është në funksion të qytetarëve.



### **Standarde/tregues për arritje**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ numërojnë karakteristika të pushtetit në funksion të qytetarëve,
- ➔ përshkruajnë kushtetutën dhe ligjet si bazë për konstituimin e pushtetit në shtet,
- ➔ polemizojë për përdorimin dhe keqpërdorimin e kompetencave që rezultojnë nga pozicionet e ndryshme në pushtet.



### **Materiale të nevojshme:**

propozim pohime për diskutim.



### **Metoda, teknika, forma:**

formë frontale (e përbashkët), formë e punës në grup, diskutim

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

Mësimdhënësi u jep udhëzime nxënësve që të imagjinojnë një situatë në të cilën të gjithë njerëzit janë absolutisht të lirë dhe nuk ekzistojnë kurrfarë rregullash morale ose ligje që e kufizojnë sjelljen e tyre. Kjo do të thotë se ka të drejtë në gjithçka, secili mund të bëjë çfarë të dojë, të lëvizë ku të dojë, të flasë çfarë të dojë. Mësimdhënësi nxitë diskutim mes nxënësve (në kohëzgjatje prej 10 minutave) me pyetjet si vijon:

- ➔ Në një situatë të këtillë, në të cilën të gjithë njerëzit janë absolutisht të lirë, si mendoni se sillen njerëzit mes vete? (Pritet nga nxënësit të përgjigjen se cilido që do të mund t'i përvetësonte (merrte) burimet si ushqim dhe ujë të tjetrit, të lëvizë ose të jetojë në token e tij/në shtëpinë e tij, ta sulmojë fizikisht ose dënojë).
- ➔ Pse prisni një sjellje të tillë nga njerëzit? (Pritet nga nxënësit të tregojnë arsyet për sjelljen e këtillë të njerëzve në mungesë të rregullave dhe ligjeve).
- ➔ Paramendoni se ju jeni njëri prej njerëzve që jeton në situatë ku nuk ka rregulla. Rreth jush shpesh ndodhin shembujt që i përmendët, ndaj jetoni në frikë, mosbesim dhe dhunë. Çfarë do të bënit ju në mënyrë që të jetoni në paqe dhe qetësi? (Pritet nga nxënësit të bëjnë të ditur për kontraktimin e parimeve themelore të sjelljes si zgjidhje e mundshme e problemit).
- ➔ Prej cilave liri dhe të drejta absolute duhet të heqin dorë qytetarët në emër të marrëveshjes shoqërore, në mënyrë që të marrin mbrojtje nga shteti? (Përgjigje të mundshme: liria absolute e lëvizjes - nuk guxon pa leje të hysh në shtëpi të huaj të dikujt tjetër; liria absolute e fjalës - nuk guxon të përdorësh gjuhën e urrejtjes; e drejta absolute e pronës - nuk guxon të përvetësosh gjëra përmes dhunës; e drejta absolute e privatësisë - shteti duhet doemos të ketë të dhënat tuaja, në mënyrë që të mund të të mbrojë, etj.).

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve dhe nxjerrë konstatim:

Gjendja në të cilën nuk ka kurrfarë rregullash dhe të gjithë njerëzit janë absolutisht të lirë quhet "gjendja natyrore" dhe konsiderohet se shpejtë do të kishte kaluar në gjendje të trazirave ku secili do të ishte në luftë kundër secilit dhe ku do të sundonte frika, mosbesimi dhe dhuna. Duke dashur që të evitohet jetesën në këtë mënyrë, njerëzit kanë vendosur të lidhin të ashtuquajturën "marrëveshje shoqërore" - janë marrë vesh se nevojitet të heqin dorë nga liritë absolute, e si zëvendësim të krijojnë rregulla morale dhe ligje që kanë për qëllim mbrojtjen e tyre. Prandaj njerëzit janë marrë vesh që të formojnë shtet, dhe i kanë dhënë fuqinë ose monopolin mbi të drejtën që t'i dënojë ata që nuk u përmbahen rregullave dhe ligjeve. Pra, njerëzit kanë hequr dorë nga liritë e tyre absolute në mënyrë që të marrin mbrojtjen e të drejtave të tyre, ndërsa këtë mbrojtje tani e mundëson shteti.<sup>8</sup> Kjo quhet *teori e marrëveshjes shoqërore* dhe përdoret për

8 The Enlightenment: Social Contract. E arritshme në: <https://www.youtube.com/watch?v=Av6R8QfgZ48>



të sqaruar pse është paraqitur nevoja për formimin e shteteve. Megjithatë, është me rëndësi të përmendet se kjo teori është hipotetike dhe nuk ilustron një ngjarje/periudhë konkrete historike.

## ***Pjesa kryesore e orës (20 min.)***

Shteti paraqet formë të bashkimit që dallon nga grupet tjera shoqërore sipas qëllimit të tij – të vendosë rend dhe siguri; sipas metodave të tij – ligje dhe zbatim të tyre; territorin e tij – korniza gjeografike në të cilat ka të drejtë të vepron; dhe përfundimisht, sipas sovranitetit<sup>9</sup>

Nga marrëveshja shoqërore mes njerëzve rrjedhë ideja për sovranitet. **Sovraniteti** në esencë paraqet një vullnet unik të qytetarëve. Kushtetuta jonë e dallon pikërisht këtë dhe thotë se “sovraniteti rezulton nga qytetarët dhe u takon qytetarëve”. Meqë qytetarët janë marrë vesh që të formojnë shtet, shteti është reflektim i vullnetit të tyre unik. Duke marrë parasysh se sovraniteti rezulton nga dhe u takon qytetarëve, është me rëndësi që ata të mund të marrin pjesë dhe të vendosin se në çfarë mënyre shteti do të jetë i organizuar dhe menaxhuar. Me atë që sovraniteti rezulton nga dhe u takon qytetarëve, ndërsa shtetin e formojnë qytetarët, sovraniteti bartet te shteti. Sovraniteti i një shteti është mbrojtur nga Kushtetuta e atij shteti, ndërsa realizohet përmes ndarjes së pushteteve (pushtet ligdhënës, ekzekutiv, gjyqësor) që nga ana tjetër kanë autoritet suprem politik të miratojnë ligje, të zbatojnë vendime ose mundësojnë respektim të Kushtetutës, e me këtë edhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Kjo do të thotë se ajo që e vendosë pushteti sovran, vlen për të gjithë qytetarët në territorin e tij, prej politikanëve, kompanive, pushtetit lokal, deri te secili qytetar individual<sup>10</sup>

Një shtet ka tri karakteristika kyçe: territor, popullatë dhe pushtet sovran. Shteti është bashkësi territoriale, gjegjësisht pushteti është i kufizuar në një popullatë të caktuar, që jeton në një territor të caktuar. Prandaj, gjithë territori në botë është i ndarë në 193 shtete të ndryshme që dallojnë për nga madhësia e popullatës, gjegjësisht numrit të qytetarëve të cilët jetojnë në territorin e një shteti, gjegjësisht shtetas.

Shteti ka të drejtë t’i imponojë rregullat dhe ligjet mbi shtetasit e tij, “por nga ana tjetër është i obliguar të garantojë siguri juridike, të sigurojë kushte të domosdoshme për jetë dhe punë, të sigurojë të drejta qytetare dhe politike, ta mbrojtë qytetarin”. Pushteti sovran shtetëror në esencë do të thotë se ai është autoriteti më i lartë politik në një shtet që merr vendime në mënyrë të mëvetësishme. Në një shtet nuk mund të ketë më shumë autoritete sovrane, për shembull

9 Britanika, Shteti si entitet sovran politik. E arritshme në: <https://www.britannica.com/topic/state-sovereign-political-entity>

10 The Political Theory of Thomas Hobbes: The Sovereign and the State. E arritshme në: <https://www.youtube.com/watch?v=BsN3f1-DFbA>

dy parlamente, dy qeveri, dy gjyqësor, që kanë të drejtë të vendosin për të gjithë shtetasit<sup>11</sup>. Shtetet sovrane nuk guxojnë të përzihen në punët e brendshme të shteteve të tjera sovrane.

## **Udhëheqje/sundim i mirë**

Në mënyrë që të themi se një pushtet i caktuar është në funksion të qytetarëve, në fakt duhet të pyetemi se sa u përmbahet pushteti parimeve të udhëheqjes/sundimit të mirë: transparencë, llogaridhënie, dalje në ndihmë të nevojave të qytetarëve, inkluzivitet dhe pjesëmarrje, dhe efikasitet. Udhëheqja në fakt ka të bëjë me mënyrën në të cilën fitohet, bartet dhe praktikohet fuqia për të marrë vendime në kuadër të një shoqërie. Udhëheqja e mirë nënkupton se marrja e vendimeve është e ndarë, ashtu që fuqia dhe resurset nuk do të akumulohen në duart e një individi ose grupi, por edhe se kanë mundësi të barabartë për t'i shfrytëzuar shërbimet publike dhe të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes. Kjo nënkupton konsultim të rregullt mes organeve qeveritare dhe qytetarëve, ashtu që pushtetet përgjigjen para qytetarëve për besimin e tyre dhe garantojnë se u shërbejnë interesave të tyre.

### **Aktivitet:**

#### ***Pushteti në funksion të qytetarëve (10-15 min.)***

Mësimdhënësi i paralajmëron nxënësit se do të lexojë veprime dhe mënyra të ndryshme të udhëheqjes nga ana e pushtetit dhe institucioneve shtetërore. Nxënësit do të duhet të diskutojnë në grup, dhe më pas do të grupohen në dy grupe (1) veprime të pushtetit që është në funksion të qytetarëve (F) dhe (2) veprime të pushtetit që nuk është në funksion të qytetarëve (N). Varësisht nga koha që kanë në dispozicion dhe interesimi i nxënësve, mësimdhënësi mund të bëjë edhe përzgjedhjen e disa nga propozim-pohimeve të dhëna për diskutim më të thellësishëm.



11 Vini re, p.sh. në shtetet federale, ka një pushtet federal, por edhe më shumë pushtete në nivel të njësive federale. Këto të dytat kanë mundësi vetëm në nivel të njësisë së tyre territoriale, por vetëm pushteti federal ka kompetencë në nivel të gjithë territorit. Ngjashëm është edhe me vetëqeverisjen lokale.



Propozim-pohime:

- ➔ Të gjitha nismat e parashtruara nga qytetarët refuzohen. (N)
- ➔ Qytetarët kanë mundësi të marrin pjesë në seancat e Këshillit të Komunës. (F)
- ➔ Komuna publikon rregullisht raporte vjetore për buxhetin e harxhuar, në mënyrën që është e kuptueshme për qytetarët. (F)
- ➔ Shërbimi për marrëdhënie me opinionin i Qeverisë përgjigjet me kohë në të gjitha pyetjet e gazetarëve. (F)
- ➔ Ministria e Shëndetësisë publikon rregullisht në ueb faqen e saj informacione në interes të qytetarëve. (F)
- ➔ Shkollat nga sistemi i arsimit publik nuk regjistrojnë fëmijë të cilët nuk kanë dokumente personale. (N)
- ➔ Hapësirat e Agjencisë për Punësim janë të arritshme për personat me nevoja të veçanta. (F)
- ➔ Shoqata e mësimdhënësve dhe nxënësve konsultohen rregullisht në procesin e përpilimit dhe zbatimit të reformave arsimore. (F)
- ➔ Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit rregullisht reagon kundër rasteve të konfliktit të interesave në institucione. (F)
- ➔ Qytetarët presin nga disa muaj për të marrë informacion nga ana e një Ministrie të caktuar. (N)

## ***Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)***

Mësimdhënësi fillon diskutimin me nxënësit sipas pyetjeve të parashtruara:

- ➔ Pse është i rëndësishëm ky leksion sipas teje?
- ➔ Sa nga përmbajtja e përpunuar në këtë orë ishte tashmë e njohur për ty, e me sa u njoftove për herë të parë?
- ➔ Si do të mund ta zbatosh në përditshmëri diturinë e fituar në këtë orë?

## **Përmbajtja: Pushteti në funksion të qytetarëve**



### **Rezultate nga nxënia:**

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të sqarojë funksionimin e shtetit dhe të identifikojë mënyrat e pjesëmarrjes në pushtet dhe jetën publike.



### **Standarde/indikatorë për arritje**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- debatojë në mënyrë të argumentuar se pushteti i zgjedhur duhet t'i përfaqësojë interesat e të gjithë qytetarëve.
- polemizojë për përdorimin dhe keqpërdorimin e kompetencave që rezultojnë nga pozicionet e ndryshme të pushtetit.



### **Materiale të nevojshme:**

kuvertë letrash\*, resurse për ndarje (bonbone, zhetonë, etj.)\* \*\*



### **Metoda, teknika, forma:**

punë në grupe, simulim, diskutim

## Pjesa hyrëse e orës (2 min.)

Mësimdhënësi u paralajmëron nxënësve se për këtë orë është parashikuar lojë për rishpërndarjen e resurseve, me ç'rast do të përdorin kuvertë të letrave dhe "resurs" që do të shpërndahet.

\* Nëse klasa ka më shumë se 20 nxënës, nga kuverta e letrave merren aq letra sa ka nxënës, me atë që kushtohet kujdes që të gjithë mbretërit, mbretëreshat dhe xhandarët të jenë të shpërndarë. Për shembull, nëse klasa ka 20 nxënës, nga kuverta e letrave detyrimisht merren mbret, mbretëreshë dhe xhandar në të gjithë ngjyrat (12 letra) dhe 8 letra me numra prej 1 deri 10. Nëse klasa ka më pak se 20 nxënës, merren mbret, mbretëreshë dhe xhandar në 2 ngjyra (për shembull zemër dhe gjeth – gjithsej 6 letra), ndërsa letrat tjera merren nga letrat me numra prej 1 deri 10.

\*\* Nevojiten resurse, që përlogariten në mënyrën si vijon  $n \times 2 + 10$ , ku n është numri i nxënësve në klasë. Për shembull, klasa ka 20 nxënës, pra  $20 \times 2 + 10 = 50$  resurse.

## Pjesa kryesore e orës (28 min.)

### Aktivitet:

#### **Loja për rishpërndarjen e resurseve<sup>12</sup>**

Mësimdhënësi paralajmëron se do të luhen dy versionet e lojës, "autokratik" dhe "demokratik" sipas rregullave që do t'i sqarojë ai. Së pari luhet versioni "autokratik", e më pas ai "demokratik", pas çka vijon diskutimi.

Radhitja e hapave në këtë lojë është si vijon:

1. Sundimtarët dhe qeveria marrin vendim për mënyrën e shpërndarjes së resurseve,
2. Elitat dhe Kuvendi vendosin nëse do ta mbështetin ose jo vendimin e Qeverisë,
3. Qytetarët e kanë fjalën përfundimtare dhe resurset ndahen kur qytetarët do ta marrin vendimin.

**Shënim:** Mësimdhënësi duhet të jetë i njoftuar paraprakisht me rregullat e lojës, me qëllim që të përgatitet në mënyrë përkatëse. Rregullat e lojës nuk lexohen para nxënësve paraprakisht, por mësimdhënësi i fut nxënësit hap pas hapi, varësisht nga zgjedhja që nxënësit do ta bëjnë gjatë lojës.

<sup>12</sup> Active Learning in Political Science, Democracy vs. Autocracy: The Resource Distribution Game. E arritshme në: <https://activelearnings.com/2016/10/14/democracy-vs-autocracy-the-resource-distribution-game/>

## VERSIONI AUTOKRATIK


Ndarje e roleve:

**Nëse klasa ka mbi 20 nxënës,** kuverta e letrave duhet të përmbajë aq letra sa ka edhe nxënës, siç është sqaruar më sipër. Secili nxënës tërheqë nga një letër. Ata nxënës që do të marrin mbret, mbretëreshë ose xhandar gjeth e marrin rolin e **sundimtarëve (pushtet, atyre që vendosin)** – gjithsej 3 nxënës; mbret, mbretëreshë dhe xhandar në zemër, bakllava dhe tërfil janë **elitat (partia në pushtet, ushtria, familjet e sundimtarëve)** – gjithsej 9 nxënës. Letrat tjera prej 1 deri 10, në cilëndo ngjyrë i përfaqësojnë **qytetarët.**

**Nëse klasa ka nën 20 nxënës,** kuverta duhet të përmbajë aq letra sa ka edhe nxënës, siç është sqaruar më sipër. Secili nxënës tërheqë nga një letër. Ata nxënës që do të marrin mbret dhe mbretëreshë gjeth e marrin rolin e **sundimtarëve (pushtet, atyre që vendosin)** gjithsej 2 nxënës; xhandarët, mbreti dhe mbretëreshë në zemër janë **elitat (partia në pushtet, ushtria, familjet e sundimtarëve)** – gjithsej 6 nxënës. Letrat tjera prej 1 deri 10, në cilëndo ngjyrë i përfaqësojnë **qytetarët.**

Versioni autokratik i lojës zhvillohet sipas radhitjes si vijon (hapat janë paraqitur në foton 12):

**Foto 12. Hapat në versionin autokratik të lojës.**



1. Sundimtarët duhet t'i shpërndajnë resurset (p.sh. 50 bonbone) mes tri grupeve: sundimtarë, elita dhe qytetarë. Sundimtarët e diskutojnë vendimin jashtë klasës (më së shumti 2 min.) para se t'ia njoftojnë klasës. Është me rëndësi që të merret parasysh se pasi që sundimtarët do t'i shpërndajnë resurset mes sundimtarëve, elitave dhe qytetarëve, brenda në kategoritë, shpërndarja është e barabartë mes të gjithëve që i takojnë këtij grupi. (Për shembull, të gjithë përfaqësuesit e elitave marrin numër të barabartë të resurseve).
2. Pasi që sundimtarët do ta marrin vendimin, kthehen në klasë dhe njoftojnë ndarjen e resurseve para të gjithëve.
3. Tani e kanë radhën elitat që të diskutojnë jashtë klasës (më së shumti 2 min.) dhe të vendosin nëse do ta pranojnë ose hedhin poshtë vendimin me votim. Vendimi merret me shumicë votash nga elitat.
  - 3.1. Nëse elitat e pranojnë vendimin e sundimtarëve, resurset shpërndahen në atë mënyrë në të cilën kanë vendosur sundimtarët, ndërsa janë pajtuar elitat.
  - 3.2. Nëse elitat e hedhin poshtë vendimin, konsiderohet se i kanë përmbysur sundimtarët nga pushteti dhe për shkak të kësaj, sundimtarët nuk marrin nga resurset. Elitat vendosin për shpërndarje të re të resurseve mes elitave dhe qytetarëve. Mirëpo, për shkak se ndryshimi i pushtetit ndikon në masë të konsiderueshme në ekonominë, 1/3 e resurseve janë shkatërruar (mësimdhënësi i merr nga grumbulli), kështu që tani shpërndahen vetëm 2/3 e resurseve nga fillimi i lojës.
4. Pasi që elitat do ta njoftojnë vendimin, qytetarët duhet të vendosin nëse do ta pranojnë ose hedhin poshtë me rebelim. Qytetarët e marrin vendimin jashtë klasës (më së shumti 2 min.).
  - 4.1. Nëse qytetarët zgjedhin ta pranojnë vendimin, bonbonet ndahen në atë mënyrë në të cilën kanë vendosur sundimtarët dhe/ose elitat.
  - 4.2. Nëse qytetarët vendosin të rebelohen për shkak të shpërndarjes, në mënyrë që rebelimi të jetë i suksesshëm duhet të marrin pjesë shumica e qytetarëve – nevojitet pajtueshmëri nga ¾ e qytetarëve në mënyrë që të zbatohet rebelim i suksesshëm.
5. Nëse qytetarët vendosin me sukses që të rebelohen, vjen deri te trazirat në të cilat pësojnë sundimtarët dhe elitat. Për shkak të trazirave, një pjesë e qytetarëve largohen nga shteti (të gjithë qytetarët që kanë letër me zemër). Por, meqë trazirat e shkatërrojnë ekonominë, ata që do të mbijetojnë dhe nuk do të largohen, marrin vetëm nga një copë të resurseve.

Konstatime që duhet t'i ketë parasysh mësimdhënësi në versionin "autokratik":

- ➔ Për shkak se vendimet merren në mënyrë të fshehtë, pa konsultime mes sundimtarëve, elitave dhe qytetarëve, ka shumë gjasa që në fund qytetarët të mos jenë të kënaqur nga shpërndarja e resurseve.
- ➔ Për shkak se qytetarët nuk kanë mënyrë tjetër për të treguar se nuk janë dakord me vendimin dhe t'i detyrojnë sundimtarët dhe elitat të ndryshojnë shpërndarjen e parashikuar të resurseve, ata duhet doemos të rebelohen.
- ➔ Për shkak të trazirave të shkaktuara, resurset zvogëlohen në masë të konsiderueshme.

### VERSIONI DEMOKRATIK


Ndarje e roleve:

**Nëse klasa ka mbi 20 nxënës**, kuverta e letrave duhet të përmbajë aq letra sa ka nxënës, siç është sqaruar më sipër. Secili nxënës tërheqë nga një letër. Ata nxënës që do të marrin mbret, mbretëreshë ose xhandar gjith e marrin rolin e **pushtetit ekzekutiv (qeveria si trup që merr vendime)** – gjithsej 3 nxënës; mbret, mbretëreshë dhe xhandar zemër, bakllava dhe tërfil janë **deputetët në Kuvend** – gjithsej 9 nxënës. Letrat tjera prej 1 deri 10, në cilëndo ngjyrë i përfaqësojnë **qytetarët**.

**Nëse klasa ka nën 20 nxënës**, kuverta duhet të përmbajë aq letra sa ka edhe nxënës, siç është sqaruar më sipër. Secili nxënës tërheqë nga një letër. Ata nxënës që do të marrin mbret, ose mbretëreshë gjith e marrin rolin e **pushtetit ekzekutiv (qeveria si trup që merr vendime)** – gjithsej 2 nxënës; xhandar, mbret ose mbretëreshë dhe zemër janë **deputetët në Kuvend** – gjithsej 4 nxënës. Letrat tjera prej 1 deri 10, në cilëndo ngjyrë i përfaqësojnë **qytetarët**.

Versioni demokratik i lojës zhvillohet sipas radhitjes si vijon (hapat janë paraqitur në foton 12):

**Foto 13. Hapa në versionin demokratik të lojës.**





1. Përfaqësuesit e Qeverisë duhet t'i shpërndajnë resurset mes qeverisë, deputetëve dhe qytetarëve. Anëtarët e Qeverisë e diskutojnë vendimin për shpërndarjen e resurseve në klasë para gjithë klasës. Ata mund të konsultohen me deputetët dhe qytetarët rreth vendimit. Pasi që t'i shpërndajnë resurset mes qeverisë, deputetëve dhe qytetarëve, brenda në grupet, shpërndarja duhet të jetë e barabartë mes të gjithëve që i takojnë këtij grupi.
2. Pasi që Qeveria do ta njoftojë vendimin për shpërndarje, përfaqësuesit e Kuvendit diskutojnë para klasës. Ata mund edhe të konsultohen me qytetarët, pas çka vendosin nëse do ta pranojnë ose hedhin poshtë vendimin me votim. Vendimi merret me shumicë votash nga anëtarët e Kuvendit.
  - 3.1. Nëse Kuvendi e pranon vendimin e Qeverisë, resurset ndahen në atë mënyrë në të cilën ka vendosur Qeveria.
  - 3.1. Nëse Kuvendi vendosë që ta hedhë poshtë vendimin, konsiderohet se Qeverisë i është votuar mosbesim. Deputetët tani vendosin për ndarje të re të resurseve mes deputetëve dhe qytetarëve, sërish me shumicë të votave nga deputetët. Meqë bëhet fjalë për procedurë kushtetuese, nuk humben resurse, kështu që deputetët vendosin se si t'i shpërndajnë resurset mes deputetëve dhe qytetarëve.
4. Qytetarët vendosin nëse do ta pranojnë vendimin për shpërndarjen e resurseve ose do ta hedhin poshtë me shumicë të votave.
  - 4.1. Nëse qytetarët e pranojnë vendimin e Kuvendit, shpërndarja e resurseve do të zhvillohet në mënyrën në të cilën ka vendosur Kuvendi.
  - 4.1. Nëse shumica e qytetarëve nuk e pranojnë vendimin, Qeveria dhe Kuvendi shpërndahen dhe nuk marrin kurrfarë resurset, derisa secili qytetar merr nga dy copë të resursit.

Konstatime që duhet t'i marrë parasysh mësimdhënësi në versionin "demokratik":

- ➔ Për arsye se vendimet merren publikisht edhe Qeveria edhe Kuvendi mund të vendosin që t'i konsultojnë qytetarët, ka shumë gjasa që vendimi në fund do të jetë i pranuar nga qytetarët.
- ➔ Qytetarët mund të zgjedhin që ta shprehin pakënaqësinë derisa merret vendimi, të kontestojnë vendimin përmes përfaqësuesve të tyre në Kuvend, ose në fund të kërkojnë shpërndarje të Kuvendit dhe zgjedhje të reja.
- ➔ Prej të gjithave, me siguri epilogu më i pavoritshëm do të jetë i fundit meqë humbin të gjithë nëse Qeveria dhe Kuvendi nuk miratojnë me kohë vendime në interesin e të gjithëve, por sërish qytetarët e kanë të garantuar një minimum të resurseve që shpërndahen (në vend të humbjes së plotë të resurseve), për shkak se ndërrimi i pushtetit përmes zgjedhjeve është procedurë korrekte dhe demokratike.

## ***Pjesë përfundimtare e orës (10 min.)***

Mësimdhënësi nxitë diskutim mes nxënësve:

- ➔ Si sundimtarët dhe Qeveria e morën vendimin për shpërndarje të resurseve në rastin e parë dhe të dytë? Pse vendosën për një lloj të tillë të ndarjes? Çfarë dallimesh në përkufizimin për shpërndarje “korrekte” ka mes sundimtarëve dhe Qeverisë?
- ➔ Pse elitat dhe Kuvendi vendosën ta mbështesin/hedhin poshtë vendimin në rastin e parë dhe të dytë? Çfarë lloji i vendimit do t’i detyronte të votojnë kundër?
- ➔ Pse qytetarët vendosën të mbështesin/hedhin poshtë vendimin në rastin e parë dhe të dytë? Sa janë të kënaqur nga shpërndarja përfundimtare e resurseve?
- ➔ Interesat e kujt i përfaqësonin sundimtarët, e të kujt Qeveria?
- ➔ Cilat janë përparësitë e votimit përballë veprimeve të tjera (p.sh. mospjesëmarrje në zgjedhje, dhunë) gjatë ndërrimit të pushtetit?
- ➔ Cilat rregulla, autokratike ose demokratike, sipas jush ishin më korrekte (u ishin në dobi të gjithëve në mënyrë të barabartë, u diskutuan dhe prezantuan publikisht)?

Mësimdhënësi nxjerr konstatim nga diskutimi në grup:

Qëllimi i kësaj loje është të theksojë disa poenta. Së pari, autoritetet demokratike janë përgjegjëse para shumicës së qytetarëve (në mënyrë që t’i votohet mosbesim Qeverisë ose Kuvendit nevojitej vetëm shumicë), derisa qeveritë autokratike i përgjigjen një grupi të vogël të bashkëpunëtorëve të afërt (në mënyrë që qytetarët të mund të rebelohen u nevojitej një shumicë e madhe prej 3/4).

Më tutje, në shtetet me pushtet demokratik, pushteti duhet doemos të kujdeset për interesat e të gjithë qytetarëve. Në të kundërtën ai mund të zëvendësohet lehtë me votimin e mosbesimit nga Kuvendi ose me votimin për parti tjetër në zgjedhje. Në sistemet autoritare, kontrolli i tillë i rregullt nga deputetët ose në zgjedhje të qytetarëve nuk ekziston. Prandaj, ndryshimet janë shpesh të dhunshme, gjë që nga ana tjetër, është në dëm të gjithë shoqërisë meqë me këtë rast humben jetë njerëzish dhe shteti dobësohet ekonomikisht (në lojën, në versionin autokratik, ndonëse rebelimi është i suksesshëm, të gjithë të mbijetuarit morën vetëm nga një copë të resursit).

Përfundimisht, vendimet në sistemet demokratike merren para opinionit (edhe Qeveria edhe Kuvendi në skenarin e dytë diskutojnë para klasës se si do ta zbatojnë shpërndarjen). Te sistemet autokratike, vendimet shpesh merren nga një rreth i vogël i njerëzve, në fshehtësi, pa prani të opinionit dhe pa pjesëmarrjen e tij në vendimmarrjen (në skenarin e parë sundimtarët dhe elitat diskutojnë jashtë klasës për atë se si do ta zbatojnë shpërndarjen).

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim*** **(5 min.)**

Mësimdhënësi nxitë diskutim:

- ➔ Çfarë mësuat nga ky aktivitet?
- ➔ Çfarë ju pëlqeu te ky aktivitet, e çfarë jo?
- ➔ Nëse mund t'i ndryshoni rregullat e këtij ushtrimi në mënyrë që të jetë më interesant, çfarë do të ndryshonit?
- ➔ Në çfarë mënyre mund ta shfrytëzoni në përditshmërinë tuaj atë që e mësuat nga ushtrimi?

# **Përmbajtja: Si është organizuar pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut**



## **Rezultate nga nxënia**

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të sqarojë funksionimin e shtetit dhe t'i identifikojë mënyrat e pjesëmarrjes në pushtetin dhe jetën publike.



## **Standarde/tregues për arritjen:**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ dallojë pushtetin ligdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor,
- ➔ numërojë kompetencat e llojeve të pushtetit,
- ➔ përshkruajë ndarjen e pushtetit si kusht për kontroll të ndërsjellë dhe kufizim të fuqisë së pushtetit.



## **Materiale të nevojshme:**

letër, lapsa kimik, fotografi të institucioneve, ueb faqe



## **Metoda, teknika, forma:**

formë frontale (e përbashkët), punë në grupe, hulumtim, prezantim, stuhi e ideve, diskutim, kuis

## ***Pjesa hyrëse e orës (5 min.)***

Mësimdhënësi në fillim të orës përmes pyetjeve të shkurtra i pyet nxënësit për ndarjen e pushtetit demokratik:

- ➔ Cila është njëra prej karakteristikave më të rëndësishme të sistemeve demokratike?  
Përgjigje të mundshme: ndarje e pushtetit, barazi para ligjit, të drejta themelore të njeriut, etj.).
- ➔ Si është ndarë pushteti demokratik në shtetin tonë? (Përgjigje e pritur: pushteti demokratik është i ndarë në pushtet ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor).
- ➔ Kush janë bartësit e pushtetit ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor në shtetin tonë? (Përgjigje e pritur: bartës i pushtetit ligjdhënës është Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, bartës i pushtetit ekzekutiv është Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe bartës i pushtetit gjyqësor janë gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut).

## ***Pjesa kryesore e orës (33 min.)***

### ***Pjesa teorike (5 min.)***

Ndarja e pushtetit paraqet vlerën kryesore demokratike. Historia ka treguar se kur ndonjë njeri ose grup i vogël i njerëzve kanë pushtet dhe fuqi të pakufizuar, shumë shpesh mund ta keqpërdorin pozitën dhe fuqinë e tyre, ashtu që njerëzit tjerë në shtet të mos kenë të drejta dhe liri të njëjta, të mos marrin vendime të përbashkëta, të mos marrin pjesë në pushtet. Në teoritë bashkëkohore konsiderohet se sa më shumë që pushteti është i ndarë në institucione të ndryshme, demokracia është në nivel më të lartë. Në sisteme demokratike, sundimi i vetëm i një institucioni ose një individi është tërësisht i papranueshëm. Prandaj, bazë e demokracisë është ndarja e pushtetit në më shumë institucione dhe individë. Secili prej tyre ka detyrat dhe të drejtat e tyre dhe asnjëra prej tyre nuk guxon të heqë dorë nga to ose t'i tejkalojë në kundërshtim me ligjin dhe parimin e përcaktuar.

Ndarja e pushtetit garantohet me Kushtetutën dhe ligjet. Fuqia e udhëheqjes dhe vendimmarrjes ndahet, ajo nuk është e përqendruar në një vend, ndërsa pjesët e pushtetit demokratik përmes institucioneve shtetërore kontrollojnë njëra-tjetrën.

Në rregullimet demokratike në të shumtën e rasteve pushteti ndahet në tri pjesë: pushtet ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kjo ndarje është në përputhje me funksionet themelore që duhet t'i realizojë një pushtet demokratik (funksion ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor). Ashtu është i ndarë edhe pushteti demokratik në shtetin tonë.

**Shënim:** Meqë materiali nga kjo pjesë teorike duhet t'u jetë i njohur nxënësve nga përmbajtjet mësimore të miratuara paraprakisht, mësimdhënësi mund ta ligjërojë në mënyrë bashkëvepruese me parashtrimin e shpeshtë të pyetjeve. Me pyetje mund të nxitet diskutim për ndarjen e pushtetit. Për shembull, pse pushteti është i ndarë në më shumë pjesë? Çfarë do të ndodhte nëse vetëm njëra prej tyre e ka fuqinë?... të kërkohet që nxënësit të japin shembull, etj.

Mësimdhënësi siguron fotografi nga Parlamenti, Qeveria dhe disa nga gjykatat në shtetin tonë.

### **Aktivitet:**

Nxënësit ndahen në tri grupe që kanë nga 10 minuta për hulumtimin e temave të dhëna dhe përgatitjen e prezantimeve të shkurtra. Tri grupet e nxënësve marrin detyra të ndryshme që mund të jepen paraprakisht për detyrë shtëpie ose të zhvillohen tërësisht gjatë orës. Si burime për hulumtim përdoren Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, informacione nga interneti, njohuritë paraprake të nxënësve dhe letërsi tjetër. Nëse ndonjë nxënës në shtëpi nuk ka internet ose në shkollë nuk ka internet, mësimdhënësi siguron materiale të shtypura.

Linqe (vegza) të dobishme për kërkim:

<https://www.sobranie.mk/content/ustav%20al/ustav%20rsm-al-ok.pdf>

Pushtet ligjdhënës: <https://www.sobranie.mk/home-al.nspix>

Pushtet ekzekutiv: <https://vlada.mk/?ln=sq> , <https://pretsedatel.mk/al/fillimi/>

Pushtet gjyqësor: [http://www.sud.mk/wps/portal/central/sud/!ut/p/z1/04\\_Sj9CPykssy0xPLMnMz0vMAfljo8zizdxNTAwsvA183ANCzQ0cfV0MPElsvYzczc30wwkpiAJKG-AAjgZA\\_VGEIBTKRhik0yoqAgARg\\_TJ/dz/d5/LOlDUmlTUSEhL3dHa0FKRnNBLzROV3FpQSEhL3Nx/](http://www.sud.mk/wps/portal/central/sud/!ut/p/z1/04_Sj9CPykssy0xPLMnMz0vMAfljo8zizdxNTAwsvA183ANCzQ0cfV0MPElsvYzczc30wwkpiAJKG-AAjgZA_VGEIBTKRhik0yoqAgARg_TJ/dz/d5/LOlDUmlTUSEhL3dHa0FKRnNBLzROV3FpQSEhL3Nx/), <http://ombudsman.mk/SQ/default.aspx> , <http://jorm.gov.mk/sq/>

**Grupi i parë** merr detyrë të hulumtojë dhe prezantojë për **pushtetin ligjdhënës**. Grupi mund të ndahet në dy nëngrupe (I-A dhe I-B). Nëngrupi i parë të punojë në hulumtimin e përgjithshëm për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Parlamentin). Në çfarë mënyre zgjidhet, çfarë përfaqëson zgjedhja, sa deputetë ka, si duhet të sillen deputetët, si duhet të jetë autoriteti i tyre dhe integriteti i tyre. Nëngrupi i dytë duhet të punojë në kompetencat dhe rolin e Kuvendit, gjegjësisht çfarë vendime merr, cili është roli i tij në pushtetin ekzekutiv dhe gjyqësor, cilat fusha të jetesës shoqërore i rregullon dhe ngjashëm.

**Grupi i dytë** merr detyrë të hulumtojë dhe prezantojë për **pushtetin ekzekutiv**. Edhe grupi i dytë mund të ndahet në dy nëngrupe (II-A dhe II-B). I pari të punojë dhe

hulumtojë për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përbërjen e saj dhe rolin dhe kompetencat e saj. Ndërsa nëngrupi i dytë të punojë dhe hulumtojë për funksionin dhe institucionin President i Republikës së Maqedonisë së Veriut, meqë shumica e kompetencave të Presidentit janë pjesë e pushtetit ekzekutiv.

**Grupi i tretë** merr detyrë të hulumtojë dhe prezantojë për **pushtetin gjyqësor**. Formohen tri nëngrupe (III-A, III-B dhe III-C). Nëngrupi i parë punon për rolin themelor të pushtetit gjyqësor dhe gjykatat themelore dhe të apelit. Nëngrupi i dytë punon dhe hulumton për Gjykatën Administrative, Gjykatën e Lartë Administrative, Gjykatën Supreme dhe Gjykatën Kushtetuese. Nëngrupi i tretë punon dhe hulumton për Prokurorinë Publike dhe Avokatin e Popullit, gjegjësisht cilat janë qëllimet dhe parimet e punës së këtyre institucioneve.

Në fund të hulumtimit, secili nëngrup përgatitë nga pesë pyetje të shkurtra të lidhura me përmbajtjet që do t'i prezantojnë, që sjellin nga dy pikë. Nëngrupet i bashkojnë prezantimet dhe pyetjet, dhe më pas i prezantojnë detyrat që i kanë bërë para të gjithë nxënësve (secili grup merr nga 5 minuta për prezantim).

## ***Pjesa përfundimtare e orës Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (7 min.)***

Pas përfundimit të prezantimit të tre grupeve, përfaqësuesi nga secili grup zbaton një kuis të shpejtë për nxënësit tjerë që nuk kanë qenë pjesë e grupit, për kontrollimin e informatave të përvetësuara nga tema sipas pyetjeve që secili grup i ka ndarë. Mësimdhënësi i shënon pikët e fituara të grupeve, ndërsa pas përfundimit të kuisit nga grupi i tretë – e shpallë grupin fitues që ka marrë më së shumti pikë.

### **Propozim pyetje për kuis:**

- ➔ Si është organizuar pushteti në shtetin tonë?
- ➔ Sqaroje pushtetin ligjdhënës (bartës, përbërje, kompetenca).
- ➔ Sqaroje rolin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (përbërje, kompetenca).
- ➔ Kush e ushtron dhe si funksionon pushteti gjyqësor në shtetin tonë?
- ➔ Çfarë gjykata ka dhe cili është funksioni i tyre? (për secilën ndaras)
- ➔ Cili është roli i Prokurorisë Publike?
- ➔ Cili është roli i Avokatit të Popullit?

# **Përmbajtja: Si është i organizuar pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut**



## **Rezultate nga nxënia**

Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të sqarojë funksionimin e shtetit dhe t'i identifikojë mënyrat e pjesëmarrjes në pushtet dhe jetën publike.



## **Standarde/tregues për arritje të rezultateve**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ dallojë pushtetin qendror dhe lokal,
- ➔ përshkruajë rëndësinë e decentralizimit të pushtetit.



## **Materiale të nevojshme:**

letër, lapsa kimik, markerë, letër hamerë ose flipçart, fletë pune 4.4



## **Metoda, teknika, forma:**

diskutim, demonstrim, stuhi e ideve, punë individuale



## *Pjesa hyrëse e orës (7 min.)*

Mësimdhënësi e fillon orën me „Stuhi të ideve“. Në tabelë shkruan 2 terme që do të përpunohen në orë (decentralizim dhe vetëqeverisje lokale). I nxitë nxënësit të mendojnë për ide dhe mendime ose njohuri paraprake për secilin prej termeve. Nxënësit i shënojnë në fletoren e tyre të punës ose në fletë (të letrës). Më pas nxënësit me ftesë të mësimdhënësit i tregojnë idetë, mendimet ose njohuritë paraprake. Një pjesë e tyre regjistrohen në tabelë. Të gjitha idetë, mendimet dhe njohuritë e dhëna paraprake merren parasysh pa mbajtur llogari për saktësinë e tyre. U theksohet nxënësve se nuk duhet të marrin qëndrim kritik ndaj asaj që është thënë, ndërsa informacionet e fituara i plotëson mësimdhënësi në pjesën kryesore të orës. ното, а добиените информации ги надолпува наставникот во главниот дел на часот.

## *Pjesa kryesore e orës (30 min.)*

### *Pjesa teorike (5 min.)*

#### **Decentralizim**

Krahas ndarjes së pushtetit ligdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor ekziston edhe mënyrë tjetër e ndarjes së pushtetit sipas organizimit të pushtetit dhe shpërndarjes së funksioneve në nivel qendror dhe lokal, gjegjësisht shkenca njeh pushtet të centralizuar dhe pushtet të decentralizuar ose pushtet qendror dhe lokal. Në të kaluarën sundimtarët dhe autoritetet e shteteve kanë tentuar që shtetet e tyre të jenë sa më shumë të centralizuara. Gjegjësisht gjithë pushteti të udhëhiqet nga një qendër nga një individ ose grup i vogël i njerëzve. Në botën bashkëkohore shumë shtete janë të decentralizuara. Gjegjësisht transferohen një pjesë e kompetencave nga pushteti qendror në pushtetin rajonal ose lokal. Ky proces është shembull për shtetet e përparuara demokratike dhe quhet proces i **decentralizimit**. Decentralizimi paraqet shpërndarje të funksioneve nga pushteti qendror gjegjësisht nga pushtet ekzekutiv (Qeveria) dhe ai ligdhënës (Kuvendi) në pushtetin lokal. Me fjalë të tjera, decentralizimi paraqet zgjerim të autonomisë lokale, gjegjësisht pushteti qendror i jep vetëqeverisjes lokale një pavarësi të caktuar në vendimmarrje.

Decentralizimi ka për qëllim të sigurojë forcimin e cilësisë së jetës së qytetarëve në nivel lokal, shërbime publike efektive dhe cilësore, si dhe zhvillim ekonomik.

## **Vetëqeverisje lokale**

Qytetarëve të shtetit tonë me Kushtetutë u është garantuar e drejta e **vetëqeverisjes lokale dhe** paraqet vlerë demokratike. Vetëqeverisja lokale është organizim i pushtetit në nivel lokal. Disa e quajnë “pushteti i katërt” krahas atij ligdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Në vetëqeverisje lokale qytetarët marrin pjesë drejtpërdrejt dhe përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur për çështjet me rëndësi lokale. Vetëqeverisja lokale të ne është e organizuar në komuna dhe Qytetin e Shkupit që janë njësi të vetëqeverisjes lokale. **Komuna** është bashkësi e banorëve të një zone të caktuar territoriale. Nga ana tjetër, në komunat mund të themelohen forma më të ulëta të vetëqeverisjes lokale: bashkësi lokale – në mjediset rurale, dhe bashkësi urbane – në qytetet. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, vetëqeverisja lokale është e organizuar në aspektin territorial në 81 komuna, prej të cilave 10 në Qytetin e Shkupit si njësi të veçantë të vetëqeverisjes lokale. Të gjitha komunat kanë kompetenca të barabarta.

Përfaqësues të zgjedhur janë **kryetari** i njësisë së vetëqeverisjes lokale (i cili ka funksion ekzekutiv) dhe këshilltarët në **Këshillin** e njësisë së vetëqeverisjes lokale (që ka funksion ligdhënës). Këshilli i komunës është organ përfaqësues i qytetarëve. Anëtarët e Këshillit janë përfaqësues të qytetarëve dhe zgjidhen me votim të fshehtë në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira, më të njohura si “zgjedhje lokale”. Numri i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit, varet nga madhësia dhe numri i banorëve të komunës dhe arrin prej 9 deri 33 këshilltarë.

Këshilli punon në seanca që janë publike, që do të thotë se në të mund të jetë i pranishëm secili qytetar. Kryetari i komunës është organ që i zbaton vendimet e Këshillit. Kryetari i komunës zgjidhet po ashtu drejtpërdrejt, në zgjedhjet e njëjta lokale, si edhe Këshilli.

Komunat kanë kompetenca të kufizuara për ushtrimin e punëve që janë me interes të gjithë bashkësisë lokale. Këto janë gjërat me rëndësi lokale si vijon:

- planifikim urban dhe rural;
- mbrojtje e mjedisit jetësor dhe natyrës;
- zhvillim lokal ekonomik;
- veprimtari komunale;
- kulturë;
- sport dhe rekreacion;
- mbrojtje sociale dhe mbrojtje e fëmijëve;
- arsim;
- mbrojtje shëndetësore;
- zbatim i përgatitjeve dhe ndërmarrje e masave për mbrojtje dhe shpëtim nga shkatërrimet ushtarake, fatkeqësitë natyrore dhe aksidente të tjera, si dhe nga pasojat e shkaktuara prej tyre.

## Aktivitet:

### Për çfarë kompetence bëhet fjalë? (15 min.)

Mësimdhënësi ua ndan fletën e punës 4.4 nxënësve dhe sqaron se fleta e punës përbëhet prej dy kolonave, prej të cilave njëra përmban shembuj specifik nga kompetencat e komunave, ndërsa e dyta përmban llojin e kompetencës. Nxënësit duhet t'i lexojnë individualisht pohimet, të mendojnë rreth llojit të kompetencës dhe t'i lidhin shembujt me kategorinë përkatëse të kompetencës.

### Shembull për mësimdhënësin – fletë pune e plotësuar

Shembull	Kompetencë
Në fshatin Kalishtë, në Ambulancën e fshatit është punësuar doktor i mjekësisë së përgjithshme	Mbrojtje shëndetësore
Komuna e Dibrës miratoi masa për pyllëzimin e brigjeve të lumit Drin dhe Radikë për shkak të mbrojtjes nga erozioni.	Mbrojtje e mjedisit jetësor dhe natyrës
Në bul. Xhon Kenedi është vendosur ndriçim i ri rrugor.	Veprimtari komunale
Në planin e detajuar urbanistik për Muaxhir Mëhallën është planifikuar ndërtim i hotelit.	Planifikim urban dhe rural
Këshilli i Komunës së Gostivarit me vendim ndau mjete financiare nga buxheti i komunës së Gostivarit për ndërtimin e sallës sportive në SHMK "Gostivar".	Arsim
Komuna e Shtipit në përputhje me planin dhe programin për menaxhimin e mbeturinave parashikon ndërtimin e qendrave për riciklim.	Veprimtari komunale
Komuna e Manastirit e organizon verën e sivjetme kulturore "Bit-fest".	Kulturë
Komuna e Resnjës në programin për punë parashikoi edukimin e qytetarëve për prodhimin e mollëve ekologjike.	Mbrojtje e mjedisit jetësor dhe natyrës
Këshilli i Komunës aprovoi fond të të hollave për mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.	Zhvillim lokal ekonomik
Komuna siguroi mjete për ndërtimin e shtëpisë për fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror.	Mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve

Pasi që nxënësit të mbarojnë me ndërlidhjen e kompetencave, mësimitdhënësi fton disa nxënës që ta prezantojnë mënyrën e tyre të ndërlidhjes. Nxënësit tjerë i krahasojnë përgjigjet e tyre. Nëse ekziston ndërlidhje e ndryshme e termeve mes nxënësve, mësimitdhënësi mund të nxisë diskutim për qasjen e ndryshme të nxënësve.

## ***Pjesa përfundimtare e orës (5 min.)***

Në pjesën përfundimtare mësimitdhënësi i udhëzon nxënësit të mendojnë për sfida dhe mangësi që nxënësit i kanë në bashkësinë e tyre lokale, ndërsa janë në kompetencë të komunës në të cilën jetojnë. Këta shembuj nga jeta e tyre e përditshme në bashkësinë lokale duhet të prezantohen dhe diskutohen në orën e radhës.

Nëse ka nevojë, mësimitdhënësi mund të nxisë diskutim mes nxënësve përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Cilat aspekte të bashkësisë tuaj lokale (duke përfshirë edhe shkollën) mund të përmirësohen?
- ➔ Si do t'i përmirësonit kushtet?
- ➔ Cilat janë tri mangësitë më të mëdha në të cilat komuna duhet të përkushtojë vëmendje?
- ➔ Çfarë aktivitete do t'i propozonit komunës në mënyrë që t'i përmirësojë kushtet për jetesë të qytetarëve?

## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (3 min.)***

Mësimitdhënësi u parashtron nxënësve pyetjet si vijon për reflektim dhe vlerësim:

- ➔ Çfarë risie mësuat?
- ➔ Çfarë keni ende të paqartë?
- ➔ Çfarë do të ndodhte nëse nuk ekziston ndarja e pushtetit demokratik?
- ➔ Cili pushtet është më i fuqishëm? Pse mendoni ashtu?
- ➔ Në cilin lloj të pushtetit do të ishit përfshirë nëse do të kishit rastin për të zgjedhur?

## Fletë pune 4.4.

### Për çfarë kompetence bëhet fjalë?

Ndërlidhi shembujt e kompetencave me llojin përkatës të kompetencës së komunave. Kini kujdes, një lloj i kompetencës mund të përputhet me më shumë shembuj.

Shembull	Kompetencë
Në fshatin Kalishtë, në Ambulancën e fshatit është punësuar doktor i mjekësisë së përgjithshme	Planifikim urban dhe rural
Komuna e Dibrës miratoi masa për pyllëzimin e brigjeve të lumit Drin dhe Radikë për shkak të mbrojtjes nga erozioni.	Mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve
Në bul. Xhon Kenedi është vendosur ndriçim i ri rrugor.	Mbrojtje shëndetësore
Në planin e detajuar urbanistik për Muaxhir Mëhallën është planifikuar ndërtim i hotelit.	Arsim
Këshilli i Komunës së Gostivarit me vendim ndau mjete financiare nga buxheti i komunës së Gostivarit për ndërtimin e sallës sportive të SHMK "Gostivar".	Veprimtari komunale
Komuna e Shtipit në përputhje me planin dhe programin për menaxhimin e mbeturinave parashikon ndërtimin e qendrave për riciklim.	Kulturë
Komuna e Manastirit e organizon verën e sivjetme kulturore "Bit-fest".	Mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës
Komuna e Resnjës në programin për punë parashikoi edukimin e qytetarëve për prodhimin e mollave ekologjike.	Zhvillim lokal ekonomik
Këshilli i Komunës aprovoi fond të të hollave për mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.	
Komuna siguroi mjete për ndërtimin e shtëpisë për fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror.	

## ***Përmbajtja: Si është i organizuar pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut***



### ***Rezultate nga nxënia***

Nxënësi/nxënësjja është i/e aftë të sqarojë funksionimin e shtetit dhe t'i identifikojë mënyrat e pjesëmarrjes në pushtet dhe jetën publike.



### ***Standarde/tregues për arritje***

Nxënësi/nxënësjja mund të:

- ➔ Cekë mënyra konkrete të pjesëmarrjes qytetare në pushtet dhe në jetën publike.



### ***Materiale të nevojshme:***

letër, lapsa kimik, markerë, letër hamerë ose flipçart, fletë pune 4.5, fletë pune 4.6



### ***Metoda, teknika, forma:***

diskutim, demonstrim, stuhi e ideve, punë në grup.

## *Pjesa hyrëse e orës (5 min.)*

Mësimdhënësi e fillon orën me nxitjen e diskutimit për dituritë relevante për orën të përvetësuar paraprakisht, sipas pyetjeve si vijon:

- ➔ Çfarë paraqet qytetaria aktive? (Përgjigje të pritura: ndikim i qytetarëve në punën e institucioneve, vetiniciativë e qytetarëve në përmirësimin e kushteve për jetë në nivel lokal, kombëtar ose global, etj.)
- ➔ Pse njerëzit bashkohen në forma të ndryshme të organizimit? (Përgjigje të pritura: realizim të qëllimeve dhe interesave të përbashkët, ndikim në krijimin e politikave lokale dhe kombëtare, fitimin e pushtetit në shtet përmes rrugës demokratike, ndihmë për bashkësitë e marginalizuara, etj.)
- ➔ Çfarë mënyra të ndikimit qytetar mbi institucionet dini? (Përgjigje të pritura: parashtrim të iniciativës (nismës), grumbullim të nënshkrimeve për peticion, protestë, vetorganizim të qytetarëve në grupe formale ose joformale, etj.)

## *Pjesa kryesore e orës (35 min.)*

### *Pjesa teorike на часо̄ (10 min.)*

Në pjesën më të madhe të shoqërive bashkëkohore është respektuar ndarja e trefishtë e pushtetit (ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor) si një lloj garancie për zbatimin dhe ushtrimin e drejtë, korrekt dhe demokratik të pushtetit. Populli, gjegjësisht qytetarët i zgjedhin përfaqësuesit e tyre të cilëve ua besojnë udhëheqjen e institucioneve, gjegjësisht pushtetit. Megjithatë, një lloj i mbikëqyrjes dhe kontrollit qytetar mbi përfaqësuesit e zgjedhur janë gjithmonë të mirëseardhur dhe të dëshiruar në një shoqëri të lirë dhe demokratike. Në shoqëritë e sotme ku qytetarët janë gjithnjë e më shumë të prekur politikisht, ku politika dhe udhëheqja e shtetit bëhen pjesë thelbësore e përditshmërisë, qytetarët bëhen më të vetëdijshëm dhe më të pjekur në raport me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, kështu që u janë vënë në dispozicion disa mekanizma të caktuar për mbrojtje përkatëse, reagim dhe veprim atëherë kur konsiderojnë se është e nevojshme. Këtë e bëjnë përmes **vetorganizimit, nismave qytetare** dhe formave të tjera të veprimit. Qytetarët, në bazë të së drejtës qytetare apo lirisë së bashkimit dhe organizimit munden vetë në bazë të interesave të tyre, të vetorganizohen në **shoqata qytetare** të llojllojshme. Shoqatat paraqesin organizata joqeveritare, jopartiake dhe jofitimprurëse në të cilat qytetarët bashkohen për shkak të realizimit të interesave dhe bindjeve ekologjike, sociale, kulturore, shkencore, humanitare, arsimore, sportive, etj.

Edhe **sindikatat** ndikojnë seriozisht në vendimet e pushtetit. Sindikatat janë organizata të punëtorëve që angazhohen për ruajtjen dhe avancimin e kushteve për punë. Bashkimi i punëtorëve në sindikata u mundëson fuqi kolektive punëtorëve që të ndikojnë në avancimin e të drejtave punëtore.

Gjithashtu qytetari, grupi i qytetarëve ose shoqata të qytetarëve mund të nisn **iniciativë (nismë) qytetare** që rezulton nga nevojat dhe interesat e qytetarëve dhe t'ia dorëzojnë pushtetit lokal ose qendror.

### ***Çfarë është nisma qytetare?***

Me këtë term, në kuptimin më të gjerë, mund të përfshihen të gjitha llojet e aktiviteteve dhe veprimeve që qytetarët i ndërmarrin me qëllim që të bëjnë njëfarë ndryshimi shoqëror ose të arrijnë njëfarë qëllimi. Këto aktivitete dhe veprime u mundësojnë qytetarëve të bëhen pjesëmarrës aktiv në miratimin e politikave dhe krijimin e ndryshimeve shoqërore, si në bashkësitë e tyre lokale, ashtu edhe në nivel të shtetit.

Secili qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka të drejtë të parashtrojë parashtresa dhe propozime deri te organet shtetërore, shërbimet dhe institucionet publike, si dhe deri te ndërmarrjet me autorizime publike dhe për to të marrë përgjigje përkatëse. Parashtresa, gjegjësisht propozimi mund të ndërlidhet me cilëndo çështje ose problem që ka të bëjë me realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të qytetarit ose mbrojtjen e ndonjë interesi publik. Sa për formën, nuk ka ndonjë formë të veçantë të detyrueshme dhe për të nuk paguhet kurrfarë takse. Parashtrimi mund të jetë gojarisht ose me shkrim. Pas parashtresës ose propozimit të parashtruar, organi me të cilin ka të bëjë është i obliguar të japë përgjigje në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, gjegjësisht 30 ditë nga dita e pranimit nëse bëhet fjalë për ndonjë parashtresë ose propozim më të ndërlikuar.

Qytetari mund të parashtrojë propozim ose parashtresë deri te:

- Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- gjykatat;
- organet e administratës shtetërore;
- njësitë e vetëqeverisjes lokale (komunat);
- institucionet dhe shërbimet publike;
- organet dhe organizata të tjera që kanë autorizime publike.



## **Përfshirje në nivel të shkollës**

Në kuadër të shkollës, nxënësit në mënyrë individuale ose të organizuar – përmes organizimit shkollor mund të propozojnë nisma të nxënësve drejtuar drejtorisë së shkollës. Secili nxënës ka të drejtë të parashtrojë kërkesë përkatëse me propozim iniciativë (nismë) të aktiviteteve të ndryshme të nxënësve, përmirësim të kushteve në shkollë dhe ngjashëm. Secila shkollë duhet të synojë që nxënësit e tyre të kontribuojnë me shprehjen e mendimeve të tyre dhe të ndikojnë në marrjen e vendimeve. Nxënësit kanë të drejtë, në përputhje me Kushtetutën dhe *Ligjin për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik* të kërkojnë informacione publike për funksionimin e shkollës. Kështu që mund ta pyetni lirisht shkollën për ekzistimin e programit vjetor, rregulloreve për notim, rregulloreve për masa disiplinore, buxhetin e shkollës, etj.

Secila shkollë duhet të mbështesë dhe stimulojë përfshirjen e nxënësve në procesin e marrjes së vendimeve. Mënyra më e mirë për përfshirjen e nxënësve është përmes formës së organizimit shkollor (trup përfaqësues i nxënësve). Ekzistimi i organizatës shkollare varet nga vullneti i vetë nxënësve, por edhe vullneti i drejtorive të shkollave. Në vetë idenë e krijimit dhe nxitjes së qytetarëve aktiv duhet të stimulohet përfshirja e nxënësve në marrjen e vendimeve në nivel të shkollës.

### **Aktivitet:**

#### **Plani juaj për ndryshim (25 min.)**

Mësimdhënësi i përkujton nxënësit në pyetjet nga ora paraprake për sfidat dhe mangësitë e tyre në të cilat hasin në jetën e tyre të përditshme në bashkësinë lokale (duke përfshirë edhe shkollën). Përgjigjet e nxënësve i shënon në tabelë dhe i grupon në mënyrë përkatëse (për shembull: sfida ekologjike, sfida infrastrukturore, mangësi kulturore-argëtuese, etj.).

Varësisht nga kategoritë dhe prioritetet e vendosura, mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe (për shembull: 3 kategori – 3 grupe). Secili grup e merr fletën e punës 4.5 që duhet ta plotësojë në afat prej 15 minutave.

Mësimdhënësi në tabelë i shënon/projekton jep udhëzimet si vijon për përpilimin e kërkesës:

- ➔ Kush e parashton kërkesën? (për shembull: Një grup i nxënësve nga shkolla...);
- ➔ Deri te kusht e adresojnë kërkesën? (për shembull: Kryetari i Komunës, Këshilli i Komunës ose anëtar specifik i Këshillit...);

- ➔ Përmbajtja e kërkesës:
  - ▶ Përshkrim i shkurtër i sfidës/mangësisë me të cilin përballen
  - ▶ Propozim zgjidhje nga nxënësit
- ➔ Data dhe vendi;

Pasi që kërkesa do të përpunohet, parashtruesi i kërkesës ka për obligim ta fillojë procesin e përfaqësimit të kërkesës te bashkënxënësit e grupeve të tjera. Në këtë drejtim, *parashtruesi i kërkesës* në kohëzgjatje prej 5 minutave, duhet t'i vizitojë dhe bindë bashkënxënësit e grupeve të tjera që të japin nënshkrimin e tyre për kërkesën e tyre. Për mbledhjen e nënshkrimeve përdoret fleta e punës 4.6.

Secili nxënës mund ta japë nënshkrimin e tij për çdo kërkesë me të cilën është dakord dhe ka interes. Nëse në fund të aktivitetit, më shumë kërkesa kanë numër të barabartë të nënshkrimeve, mësimdhënësi i fton nxënësit në nivel të klasës të përzgjedhin kërkesën më të mirë. Kërkesa me mbështetje më të madhe nga nxënësit e klasës, me mbështetje të mësimdhënësit ose drejtorisë së shkollës, mund të parashtrohet në mënyrë të mirëfilltë deri te institucionet e pushtetit lokal ose qendror.

Në fund të aktivitetit, mësimdhënësi nxjerrë konstatim:

Në mënyrë që qytetarët të ndikojnë në mënyrë aktive në pushtet, duhet doemos të jenë të njoftuar me mekanizmat e pjesëmarrjes së drejtpërdrejt të qytetarëve në marrjen e vendimeve. Qytetarët aktiv janë pjesë e pandarë e shoqërisë qytetare demokratike që duhet të jenë vazhdimisht korrigjues të pushtetit qendror dhe lokal.

## ***Pjesë përfundimtare e orës dhe aktivitetet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)***

Mësimdhënësi parashtron pyetje të shkurtra për përcaktimin e informacioneve të përvetësuara nga ora:

- ➔ Pse është me rëndësi si qytetarë të marrim pjesë aktive në miratimin e politikave lokale dhe kombëtare?
- ➔ Cilët mekanizma i kemi si qytetarë që të ndikojmë në pushtetin qendror dhe lokal?
- ➔ Çfarë risie mësuat sot?

## ***Fletë pune 4.5.***

### ***Kërkesë drejtuar institucionit***

Parashtrues i kërkesës \_\_\_\_\_

Drejtuar \_\_\_\_\_

## **K Ë R K E S Ë**

Arsyetim i kërkesës

---

---

---

---

Nënshkrim i parashtruesit të kërkesës:

---

Në

---

Më datë

---

## ***Fletë pune 4.6.*** **Listë e nxënësve**

Data

---

Grupi

---

Nr.	Emri dhe mbiemri	Klasa	Nënshkrimi

Objekt i kërkesës:

---

# Përmbajtja: Sundimi i ligjit



## Rezultate nga nxënia

Nxënësi/nxënësja mundtë:

- dallojë karakteristikat e shtetit ligjor,
- sqarojë dukuritë negative që e rrënojnë sundimin e ligjit.



## Standarde/tregues për arritje

Nxënësi/nxënësja:

- përshkruan karakteristikat e shtetit ligjor
- përkufizon termet integritet/presion social, korrupsion dhe nepotizëm,
- përshkruan format në të cilat mund të paraqitet korrupsioni.



## Materiale të nevojshme:

tabelë, shkumës, hamer, fletë pune 4.7



## Metoda, teknika, forma:

Diskutim, punë në çifte dhe në grupe të vogla, formë frontale

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

### Aktivitet:

#### Çfarë nëse?

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe nga tre veta. Më pas i lexon situatat e poshtëshënuara dhe i udhëzon nxënësit të mendojnë dhe diskutojnë në grupet se çfarë do të ndodhte nëse situatat janë të lejuara.

Çfarë nëse:

- ➔ ju lejohet të vraponi ku të doni dhe kur të doni nëpër shkollë?
- ➔ ju lejohet të flisni në orë kur do të dëshironi, pa u paraqitur për fjalë?
- ➔ luani futboll dhe gjyqtari mund të vendosë në çdo moment ta ndërpresë lojën dhe të zgjedhë vetë se kush do të fitojë?
- ➔ ju lejohet të ngisni automobil që tani?
- ➔ guxonit të hidhni mbeturina ku të dëshironi?
- ➔ Mësimdhënësi nxitë diskutim përmes pyetjeve si vijon:
- ➔ A ndodhin këto situata sot? Nëse jo, pse? (Pritet nga nxënësit të tregojnë se çfarë situata nuk ndodhin për shkak se ekzistojnë rregulla dhe ligje).
- ➔ Në secilin prej shembujve të përmendur, kush i krijon rregullat? (Përgjigje të pritura: kuadri i shkollës, profesorët, rregulla të futbollit, ligji, etj.).
- ➔ Si vlerësojmë nëse një rregull është korrekte? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga nxënësit).
- ➔ A duhet të jetë një rregull, korrekte për të gjithë? Pse? (Priten përgjigje të ndryshme).
- ➔ Pse ndryshohen rregullat? (Pritet nga nxënësit që të tregojnë se me zhvillimin dhe ndryshimet në shoqëri, paraqitet nevoja për ndryshim të rregullave).

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve dhe nga diskutimi nxirret konstatimi si vijon:

Njerëzit jetojnë në bashkësi (kulturore, religjioze, gjeografike, etnike, politike, familjare, etj.), ndërsa secila bashkësi ka rregullat dhe normat e saj. Ato rregulla dhe norma që ne si bashkësi e qytetarëve kemi vendosur se janë të rëndësishme dhe të mira, ndërsa shteti i njej, bëhen pjesë e ligjeve të shtetit. Rregullat dhe normat tjera, ndonëse nuk janë ligj, e megjithatë janë të rëndësishme dhe të mira, vazhdojnë të vlejnjë në bashkësitë tona (p.sh. t'i liroshe vendin një personi më të moshuar në autobus, vënia e dorës në gojë gjatë kollitjes, të jesh i qetë në kinema dhe bibliotekë, etj.). Një shtet duhet doemos të ketë ligje që janë të drejta, gjegjësisht ligje që i garantojnë, mbrojnë dhe avancojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Elementi themelor në të cilin janë përfshirë rregullat dhe normat që shteti i njej është Kushtetuta jonë. Në të ka 134 rregulla që quhen nene, dhe në të cilat janë parashikuar të drejtat tona njerëzore, por edhe rregullat sipas të cilave është i organizuar shteti dhe pushteti.

Në shtetin tonë ka rreth 1900 ligje<sup>1</sup>, që "i rregullojnë ose modifikojnë marrëdhëniet më të ndryshme shoqërore dhe ndërnjerëzore (pronësi, trashëgimi, martesë, regjistrim në shkollë, blerje, shitje, qeverisje dhe relacione të tjera mes njerëzve)"<sup>2</sup>.

## ***Pjesa kryesore e orës (20 min.)***

Mësimdhënësi bën të ditur se, përveçse për t'i parashikuar rregullat dhe normat, shteti është i obliguar të sigurojë se **të gjithë** i respektojnë këto rregulla dhe norma, gjegjësisht ligjet e shtetit. Kjo do të thotë se jo vetëm qytetarët, por të gjithë, duke përfshirë edhe ata që janë pjesë e pushtetit dhe institucioneve shtetërore, si për shembull president/e, kryeministër/re, deputet/e, gjykatës/e, kryetar/e i/e komunës dhe këshilltar/e, drejtor/eshë, mjek/e, mësimdhënë/s/e, duhet doemos t'i respektojnë ligjet në shtet. Kur ligji arrin që të kufizojë me sukses keqpërdorimin e fuqisë dhe ligjet vlejnjë për të gjithë në mënyrë të barabartë, atëherë thuhet se në shtet ka **sundim të ligjit**.

1 Ministria e Drejtësisë, Bazë e ligjeve, akteve nënligjore dhe rregullave të tjera. E arritshme në: <https://ldbis.pravda.gov.mk/Prebaruvanje.aspx>

2 V. Gërçarevski, J. Bačovska, Baza të së drejtës: Viti IV Arsimit i mesëm profesional (2013).

## Aktivitet:

### **Veçori dhe shkathtësi të autoriteteve (10 min.)**

Mësimdhënësi në tabelë ose në hamer i shkruan tri pushtet, gjegjësisht kryeministër/re, deputet/e dhe gjykatës/e. Nxënësve u ndan stikerë në të cilët secili nxënës duhet të shkruajë nga një veçori ose shkathtësi kyçe të atyre që janë pjesë e secilit pushtet dhe më pas ta ngjisë nën pushtetin përkatës.

### **Përgjigje të mundshme nga nxënësit**

**Kryeministër/re:** lider/e, vizionar/e, aftësi për të marrë vendime, veçanërisht nën presion dhe në afate të shkurtra, aftësi për zgjidhjen e problemeve, aftësi për të bërë kompromise, lojtar ekipor, besueshmëri, etj.

**Deputet/e:** aftësi për t'u lidhur me qytetarët që i përfaqëson, shkathtësi debatuuese dhe oratore, silltet në përputhje me bindjet e tij, është i/e pakorruptuar, i/e motivuar për të përfaqësuar interesin e qytetarëve dhe ta bëjë pushtetin llogaridhënës, etj.

**Gjykatës/e:** i/e drejtë, i/e pakorruptuar, me durim, mirëkuptim, ndjeshmëri, me moral dhe etikë të lartë, aftësi për të marrë vendime, etj.

Pasi që nxënësit t'i ngjisin spikerët me karakteristika, mësimdhënësi nxitë diskutim:

- ➔ Cilat janë karakteristikat ose kompetencat kyçe personale për personat të cilët janë pjesë e pushteteve të ndryshme? Si dallojnë? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme, varësisht nga veçoritë dhe shkathtësitë që nxënësit i kanë shënuar në stikerët).
- ➔ Pse është me rëndësi që ata të cilët janë pjesë e pushteteve të ndryshme, t'i kenë këto karakteristika ose kompetenca personale? (Pritet nga nxënësit të sqarojnë se si karakteristikat që i kanë shkruar kontribuojnë drejt ushtrimit më të mirë të postit në pushtet).
- ➔ Çfarë do të ndodhë nëse kryeministri/ja, deputeti/ja, gjykatësi/ja ynë/jonë nuk i kanë këto karakteristika ose kompetenca personale? Përgjigje të mundshme: do të mund t'i korruptojnë, nuk do të jenë të drejtë, askush nuk do të dojë të bashkëpunojë me ta, qytetarët nuk do t'u besojnë, etj.).
- ➔ Në çfarë mënyre mund të sigurohemi se ata që janë pjesë e tri pushteteve, i kanë këto karakteristika ose kompetenca personale? (Pritet nga nxënësit që të ndajnë ide të ndryshme, varësisht nga veçoritë dhe shkathtësitë që i kanë shënuar në stikerët).



Mësimdhënësi nxjerr konstatim nga diskutimi në grup:

Ata që janë pjesë e pushtetit është me rëndësi të kenë karakteristika ose kompetenca personale si profesionalizëm, pavarësi dhe paanshmëri, ndjenjë për drejtësi dhe etikë, përgjegjësi. Ky është vetëm një element nga **sistemi për integritet** që nënkupton vendosje dhe përmbajtje ndaj vlerave, qëndrimeve dhe aktiviteteve qëllimi i të cilave është të pengojnë keqpërdorimin e pushtetit dhe shkeljen e ligjeve. Ndërtimi i sistemit të integritetit në fakt paraqet bazën për luftën kundër dukurive negative siç janë **korrupsioni dhe konflikti i interesave** etj.

**Korrupsioni** paraqet shfrytëzim të detyrës zyrtare për të përvetësuar dobi personale. Kjo do të thotë se një person që është pjesë e pushtetit ose punon në institucion shtetëror (president/e, kryeministër/re, gjykatës/e, kryetar/e i/e komunës dhe këshilltar/e, drejtor/eshë, mjek/e, mësimdhënës/e, nëpunës shtetërorë) e shfrytëzon pozicionin e tij për të marrë para, dhurata, ndikim, përparësi për familjen dhe miqtë e tij/e saj, e që përndryshe nuk do t'i kishte marrë ose nuk i takojnë.

Mirëpo korrupsioni nuk ekziston vetëm për shkak se atyre që janë në pushtet u mungon integritet ose duan që të pasurohen shpejtë dhe në mënyrë të paligjshme. Korrupsioni ekziston edhe për shkak se shpesh edhe qytetarët ushtrojnë presion ndaj atyre që janë në pozitë të fuqisë, të vazhdojnë korrupsioni, meqë edhe ata kanë leverdi nga i njëjti.

Për shembull, dikush ka interes të marrë leje nga komuna për të ndërtuar një kat shtesë të shtëpisë, por kjo nuk është e lejueshme pa ndryshimin e planit urbanistik, kështu që i korrupton këshilltarët për të votuar në interes të tij. Ose, nga ana tjetër, studenti në fakultet dëshiron notë më të madhe, kështu që profesorit i premtun se nëna e tij e cila është mjekë, do ta pranojë pa rend dhe nuk do t'ia arkëtojë shërbimin mjekësor. Ose kur polici do të ndalë dikë për vozitje të shpejtë, vozitësi dëshiron t'i japë ryshfet policit, në mënyrë që të mos e denoncojë se e ka shkelur ligjin, e me këtë edhe të mos paguajë dënim më të madh ose t'i merret patentat e shoferit.

## Pjesa përfundimtare e orës (10 min.)

### Aktivitet:

#### **Ndërlidhje e formave, përkufizimeve dhe shembujve për korrupsion**

Mësimdhënësi ua ndan fletën e punës 4.7 nxënësve, të cilët më pas vazhdojnë të punojnë në grupet e formuara paraprakisht me nga tre veta. Grupet duhet t'i ndërlidhin format e korrupsionit me përshkrimet e tyre dhe shembujt e dhënë, dhe për këtë kanë pesë minuta.

### Fletë pune e plotësuar – shembull për mësimdhënësin

Forma e korrupsionit	Përshkrim	Shembull
Konflikt i interesit	Kur dikush është i përballur me atë që të përzgjedhë mes detyrave në vendin e punës dhe interesit privat dhe personal, dhe në vend se të pengojë këtë dhe mos të arrij deri te një situatë e tillë, ose nëse nuk mund të pengoj, të vendosë që të përjashtohet nga marrja e vendimit, ai/ajo e përzgjedhë interesin privat dhe personal.	Mësimdhënësi i mban orë private nxënësit, për lëndën e njëjtë që ia ligjëron në shkollë. Nxënësit i jep notë më të lartë sesa ajo që realisht e meriton.
Ryshfet	Kur ndonjërit/ës, i jepet dhuratë, para ose leverdi tjetër, për të vepruar ose vendosur në favor të atij/asaj që e bën dhënien.	Vozitësi i autobusit i cili bën shkelje në komunikacion, gjysmën e shumës së parashikuar për dënim ia jep policit, ndërsa polici si kundërpërgjigje nuk e procedon kundërvajtjen.
Nepotizëm	Kur ndonjëri/a gjatë dhënies së vendit të punës, furnizimeve publike, lidhjes së marrëveshjeve, etj., i preferon anëtarët e familjes së tij/saj dhe miqtë e afërt, në vend të personit që është më i miri dhe më meritori.	Drejtoresha e spitalit vendosë të punësojë vëllanë e saj si jurist në spital.





Favorizim	Kur përzgjidhet një person, jo për shkak se është më i miri dhe me kualifikime më të mira, por për shkak të arsyeve subjektive, për shembull vjen nga qyteti i njëjtë, janë miq me zgjedhësin, janë anëtarë në parti të njëjtë, janë tifozë të klubit të njëjtë, ndajnë religjion të njëjtë, i pëlqen personalisht dhe etj.	Ministri vendosë të avancojë një polic në inspektor për shkak se vijnë nga një qytet i njëjtë.
Klientelizëm politik	Kur dikush është në pozicion më të fuqishëm se tjetri, ndaj i jep mallra, shërbime, privilegje si zëvendësim për lojalitetin politik të tij/të saj.	Një kandidat për deputet u premtonte studentëve të bashkësisë së tij se do t'u mundësojë vend në konviktin studentor, nëse votojnë për partinë e tij.

Pasi që secili grup do t'i ndërlihdë termet, mësimitdhënësi i nxitë grupet që t'i ndajnë përgjigjet e tyre. Nëse ka nevojë, mësimitdhënësi i sqaron në mënyrë plotësuese termet e dhëna dhe i ndan përgjigjet e sakta. Varësisht nga koha në dispozicion, mësimitdhënësi mund të nxisë edhe diskutim në nivel të klasës përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Në shembujt e dhënë, a bëhet sjellja korruptuese me kërkesë, dhënie, marrje, pranim ose premtim ose mund të paraqitet në të gjitha format?
- ➔ Kush e bën veprimin? A mund të paraqiten këto forma të korrupsionit edhe në sektorin publik edhe në atë privat?
- ➔ A mund të supozoni se sa është dëmi që është shkaktuar ose do të shkaktohet në periudhë afatgjate në secilin prej shembujve të dhënë?

## **Aktivitet për reflektim dhe vlerësim** **(5 min.)**

Mësimitdhënësi nxitë diskutim të shkurtër:

- ➔ Cila formë e korrupsionit konsideron se është më shpesh e përfaqësuar në shtetin tonë? Pse? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme nga nxënësit).
- ➔ Çfarë mendoni, pse njerëzit vendosin të bëjnë sjellje korruptuese? (Përgjigje të pritura: është më lehtë, është më shpejtë, nuk ka dënime, etj.).
- ➔ Sa juve, personalisht ju pengon korrupsioni? Pse po/jo? (Priten përgjigje të ndryshme nga nxënësit, varësisht nga qëndrimet e tyre personale).

## Fletë pune 4.7.

### ***Ndërlidhje e formave, përkufizimeve dhe shembujve për korrupsion***

Forma e korrupsionit	Përshkrim	Shembull
Ryshfet	Kur dikush është i përballur me atë që të përzgjedhë mes detyrave në vendin e punës dhe interesit privat dhe personal, dhe në vend se të pengoj këtë dhe mos të arrij deri te një situatë e tillë, ose nëse nuk mund të pengoj, të vendosë që të përjashtohet nga marrja e vendimit, ai/ajo e përzgjedhë interesin privat dhe personal.	Drejtoresha e spitalit vendosë të punësojë vëllanë e saj si jurist në spital.
Favorizim	Kur ndonjërit/ës, i jepet dhuratë, para ose leverdi tjetër, për të vepruar ose vendosur në favor të atij/asaj që e bën dhënien.	Një kandidat për deputet u premtonte studentëve të bashkësisë së tij se do t'u mundësojë vend në konviktin studentor, nëse votojnë për partinë e tij.
Konflikt i interesit	Kur dikush është në pozicion më të fuqishëm se tjetri, ndaj i jep mallra, shërbime, privilegje si zëvendësim për lojalitetin politik të tij/të saj.	Vozitësi i autobusit i cili bën shkelje në komunikacion, gjysmën e shumës së parashikuar për dënim ia jep policit, ndërsa polici si kundërpërgjigje nuk e procedon kundërvajtjen.





Nepotizëm	Kur përzgjidhet një person, jo për shkak se është më i miri dhe me kualifikime më të mira, por për shkak të arsyeve subjektive, për shembull vjen nga qyteti i njëjtë, janë miq me zgjedhësin, janë anëtarë në parti të njëjtë, janë tifoz të klubit të njëjtë, ndajnë religjion të njëjtë, i pëlqen personalisht dhe etj.	Mësimdhënësi i mban orë private nxënësit, për lëndën e njëjtë që ia ligjëron në shkollë. Nxënësit i jep notë më të lartë sesa ajo që realisht e meriton.
Klientelizëm politik	Kur ndonjëri/a gjatë dhënies së vendit të punës, furnizimeve publike, lidhjes së marrëveshjeve, etj., i preferon anëtarët e familjes së tij/saj dhe miqtë e afërt, në vend të personit që është më i miri dhe më meritori.	Ministri vendosë të avancojë një polic në inspektor për shkak se vijnë nga një qytet i njëjtë.

## *Përmbajtja: Sundimi i ligjit*



### **Rezultate nga nxënia**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ dallojë karakteristikat e shtetit ligjor,
- ➔ sqarojë dukuritë negative që e prishin sundimin e ligjit.



### **Standarde/tregues për arritje**

Nxënësi/nxënësja:

- ➔ vlerëson përfitimet për shoqërinë nga parandalimi dhe luftimi i korrupsionit,
- ➔ kritikon dhe dënon sundimin selektiv të ligjit.



### **Materiale të nevojshme:**

tabelë, shkumës, markerë, fletore, letër, fletë pune 4.8.



### **Metoda, teknika, forma:**

Diskutim, punë në grup, analizë e situatave, barometër i qëndrimeve

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

Para fillimit të aktivitetit, mësimitdhënësi përcakton dy pole në klasë mes të cilave nxënësit mund të lëvizin, me ç'rast njëri pol vendosë kartë në të cilën shkruan "Jam dakord", derisa në polin tjetër vendosë kartë në të cilën shkruan "Nuk jam dakord". U jep udhëzime nxënësve për mënyrën në të cilën mund të lëvizin në klasë, në përputhje me qëndrimet që do t'u lexohen.

**Shënim:** Si zgjidhje alternative për situata ku hapësira nuk lejon lëvizjen e nxënësve nëpër klasë, mësimitdhënësi mund t'u ndajë nxënësve karta të gjelbra dhe të kuqe. Mësimitdhënësi do të japë udhëzime, sipas të cilave nxënësit, nga vendi ku qëndrojnë, do të duhej të ngrenë një rënë prej kartave. Nëse janë dakord me qëndrimin e përmendur, duhet ta ngrenë kartën e gjelbër, e nëse nuk pajtohen me qëndrimin, kartën e kuqe.

### Aktivitet:

#### **Barometër i qëndrimeve për korrupsion**

Mësimitdhënësi u jep udhëzim nxënësve që të ndalen në midisin mes dy poleve në të cilat janë vendosur kartat "Jam dakord" dhe "Nuk jam dakord". Bashkëngjitur janë dhënë 10 deklaratat. Mësimitdhënësi në përputhje me kohën në dispozicion dhe dinamikën e diskutimit, mund të përzgjedhë se cilat nga deklaratat do t'i shfrytëzojë.

Propozim pohime:

1. Korrupsioni, thënë sinqerisht, edhe nuk është aq i keq për ata që marrin para, dhurata dhe shërbime, është i keq për ata që japin.
2. Dhënia e dhuratës në shenjë falënderimi të personit që është i detyruar ta mundësojë shërbimin mund të konsiderohet si sjellje korruptuese.
3. Korrupsioni është dukuri që ndodhë vetëm në institucionet shtetërore.
4. Sjellja korruptuese është pjesë e traditës sonë dhe nuk mund të ndryshohet me asgjë.
5. Në një shoqëri ku ka shumë korrupsion, nëse je me të vërtetë i mirë në diçka, kjo nuk do të pengojë që të përparosh.





6. Kapja e "lidhjeve" nuk është korrupsion.
7. Në mënyrë që procesi të paraqesë korrupsion, duhet doemos të përfshijë paratë.
8. Në një shoqëri në të cilën korrupsioni është në nivel shumë të lartë, përparimi është i kufizuar.
9. Edhe ai që ofron korrupsion, edhe ai që e pranon korrupsionin janë fajtorë në mënyrë të barabartë.
10. Nëse jam dëshmitar i korrupsionit, do ta denoncoja atë.

Pas leximit të secilës prej pohimeve, nxënësit duhet të marrin pozicion në barometër, me ç'rast pritët të formojnë dy grupe që (nuk) janë dakord me pohimin e lexuar. Mësimdhënësi fton vullnetarë nga të dyja palët të barometrit që t'i sqarojnë pozicionet e tyre, me ç'rast nxënësit kanë mundësinë që t'i argumentojnë qëndrimet e tyre dhe t'i dallojnë pikëpamjet e huaja. Pasi që nxënësit do t'i dëgjojnë argumentet e bashkënxënësve nga grupi i kundërt, kanë edhe mundësi për ta ndryshuar pozicionin e tyre nëse e kanë ndryshuar qëndrimin e tyre.

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e qëndrimeve të diskutuara dhe nxjerr konstatim të shkurtër:

Ndonëse korrupsioni paraqet shfrytëzimin e pozitës zyrtare për përvetësimin e dobisë personale, secili qytetar në shoqëri duhet të ketë zhvilluar nivel të lartë të vetëdijes për korrupsionin dhe të jetë i informuar se çfarë mund të bëjë nëse dëshmon veprim korruptues. Në RMV, korrupsioni mund të denoncohet tek Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në polici ose tek prokurori publik. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është institucion i obliguar për veprim lidhur me denoncimet për korrupsion dhe konflikt të interesave. Ndonjëherë ai mund të kërkojë nga prokurori publik që një rast i caktuar të arrijë në gjyq, ndërsa policia ka për obligim të hetojë nëse me të vërtetë ka ndodhur korrupsion dhe për dëshmitë e mbledhura ta informojë prokurorin publik. Prokurori publik më pas vendosë nëse rasti mund të dërgohet në gjyq, ku gjykatësi vendosë nëse me të vërtetë ka pasur korrupsion, kush është përgjegjës dhe çfarë dënimi vijon. Nga ana tjetër, nëse qytetarët nuk janë të informuar se ku mund ta denoncojnë korrupsionin ose nuk janë të sigurt se institucionet do t'i mbrojnë, ndihmë mund të kërkojnë nga organizatat qytetare ose përvojën e tyre ta ndajnë me mediat.



## ***Pjesa kryesore e orës (30 min.)***

Pasoja nga ekzistimi i korrupsionit janë si vijon: humbje të konsiderueshme ekonomike, rritje të varfërisë dhe pabarazisë, evitim të përgjegjësisë dhe drejtësi selektive, mosfunksionim i institucioneve publike, kuadër joprofesional, infrastrukturë e keqe dhe jociësore (rrugë, ndërtesa publike). Korrupsioni ndikon në aftësinë e shtetit për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për t'i përmbushur obligimet e tij, veçanërisht për sigurimin e gjyqësorit funksional dhe gjykimit korrekt, policisë, shëndetësisë, arsimit dhe shërbimeve sociale, etj. Nëse qytetarët shikojnë se ata që janë në pushtet marrin pjesë në korrupsion ose nuk e ndëshkojnë korrupsionin që e shohin, të gjithë qytetarët humbin besimin në shtetin.<sup>3</sup>

Lufta për parandalimin e korrupsionit është padyshim obligim i secilit shtet dhe pushtet, por edhe i të gjithë qytetarëve të shoqërisë. Secili ka të drejtë të denoncojë korrupsion pa pësuar kurfarë pasojash dhe duhet të jetë i mbrojtur.

### ***Aktivitet:***

#### ***Arsye të korrupsionit dhe pasoja nga korrupsioni (15 min.)***

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në 3-4 grupe dhe e marrin fletën e punës 4.8. Për secilin prej shembujve në fletën e punës, nxënësit marrin udhëzim që të përcaktojnë se në çfarë forme paraqitet korrupsioni (duke kujtuar format nga ora paraprake), çfarë është arsye, e çfarë është pasojë e korrupsionit.

### ***Fletë pune e plotësuar – shembull për mësimdhënësin***

#### ***Shembulli 1:***

- ➔ Forma të korrupsionit: nepotizëm, klientelizëm.
- ➔ Arsye: personi i njëjtë një kohë të gjatë në një post përvetëson fuqi të madhe, askush nga kandidatët tjerë nuk e ka kontestuar vendimin e kryetarit të komunës për të emëruar miken e tij për drejtoreshë, mediat nuk kanë informuar për këtë ngjarje, rregullat lejojnë korrupsion (nuk ka obligim për konkurs publik), menaxhim i keq i burimeve financiare (nuk ka kushte higjienike për shkak se paratë janë shpenzuar për një qëllim tjetër).
- ➔ Pasoja: përkeqësohet gjendja shëndetësore e nxënësve.

<sup>14</sup> <https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2020/08/MKUcenici.pdf>

## **Shembulli 2:**

- Formë e korrupsionit: ryshfet.
- Arsye: mekanizmat (inspektoratet) kontrollues nuk funksionojnë në mënyrë përkatëse.
- Pasoja: përkeqësohet cilësia e jetës dhe gjendjes shëndetësore të qytetarëve.

## **Shembulli 3**

- Forma të korrupsionit: klientelizëm politik.
- Arsye: shkelja e rregullave nuk është përcjellë me sanksion.
- Pasoja: ulet besimi në sistemin dhe institucionet, ulet efekti i largimit nga sjellja e ngjashme.

## **Aktivitet:**

### ***Aktivitet: Çfarë do të bënit nëse jeni në pushtet? (15 min.)***

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në tri grupe, prej të cilave secili merr nga një problem të shkruar në letër. Mësimdhënësi u jep udhëzime nxënësve që të imagjinojnë se ata janë pushteti në një shtet, kështu që për problemet e dhëna secili grup duhet të ofrojë mes një dhe tri zgjidhjeve. Mësimdhënësi u jep detyrë nxënësve edhe të mendojnë se si zgjidhjet e ofruara do ta zgjidhin problemin, kush duhet t'i realizojë këto zgjidhje, sa do të kushtojnë dhe sa kohë nevojitet të zbatohen në mënyrë që të japin rezultate. Pasi që nxënësit do ta përpunojnë detyrën, një përfaqësues nga secili grup e prezanton atë që është punuar.

Probleme:

1. Në shtetin tonë, qytetarët nuk marrin guximin që të denoncojnë korrupsion.
2. Në shtetin tonë, qytetarët nuk e dënojnë korrupsionin. Përkundrazi, konsiderojnë se në këtë mënyrë i zgjidhin më lehtë problemet e tyre.
3. Në shtetin tonë, më së shumti korrupsion ka në fushat e arsimit dhe shëndetësisë.

Përgjigje të mundshme të nxënësve:

- ➔ Duhet të vendosen dënime më rigorozë për ata që pranojnë para, dhurata, shërbime.
- ➔ Duhet të investohet në arsimim për dëmshmërinë e korrupsionit.
- ➔ Duhet të vendoset mundësia për denoncim anonim të korrupsionit.
- ➔ Duhet të rriten pagat e atyre që punojnë në institucione shtetërore.
- ➔ Duhet të informohen qytetarët ku mund të denoncojnë korrupsion.
- ➔ Nëse qytetarët shohin se ata që kanë bërë korrupsion janë të dënuar për korrupsion dhe vuajnë dënim me burg, atëherë edhe ata nuk do të duan të marrin pjesë në korrupsion.
- ➔ Ndalesa për korrupsion duhet të vlejë për të gjithë, edhe për politikanë, biznesmenë, mjek, profesorë, e jo vetëm për njerëzit e rëndomtë.

## ***Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)***

Mësimdhënësi nxitë diskutim në grup:

- ➔ Në çfarë mënyre mund ta shfrytëzoni në përditshmërinë tuaj atë që e keni mësuar në këtë orë?
- ➔ Sa është për ju e rëndësishme të kemi ardhmëri pa korrupsion në shtetin tonë?
- ➔ A do të denonconi korrupsion? Nëse jo, pse?

## Fletë pune 4.8.

### **Shembuj të korrupsionit, forma, arsye dhe pasoja**

**Shembulli 1:** Në një komunë, qytetarët tashmë 20 vite zgjedhin kryetarin e njëjtë. Disa vite më parë, kryetari i komunës për drejtoreshë të shkollës së mesme e emëroi miken e tij, ndonëse në konkursin u lajmëruan kandidatë të cilët kanë përvojë dhe dituri më të mirë për këtë post. Askush nga kandidatët nuk ankohet për vendimin, ndonëse e dinë se vendimi nuk është korrekt as në aspektin ligjor. Mediat nuk flasin publikisht për rastin, ndaj qytetarët nuk janë të njoftuar se çfarë ka ndodhur. Disa vite më vonë, shkolla vendos se duhet të blejnë kompjuterë. Drejtorja nuk shpall thirrje në mënyrë që kompanitë të japin oferta prej të cilave shkolla do të mund të përzgjedhë ofertën më të mirë, por vetëm e përzgjodhi kompaninë në të cilën kryetari i komunës ka aksione. Rregullat këtë e lejojnë. Kështu që, çmimi që shkolla tani do ta paguajë për një kompjuter është 30 për qind më i lartë sesa çmimi mesatar në treg. Në mënyrë që shkolla të mund t'i paguajë kompjuterët, drejtoresha vendosë se nuk do të bëjë furnizim të sapunit dhe letrës së tualetit. Për shkak të kushteve të këqija higjienike, përçindja e nxënësve të sëmurë me verdhëz është rritur për 10 për qind.

- ➔ Forma e korrupsionit: \_\_\_\_\_
- ➔ Arsye: \_\_\_\_\_
- ➔ Pasoja: \_\_\_\_\_

**Shembulli 2:** Një shtet ka problem të madh me ndotjen e ajrit. Nga njëra anë, çdo vit më shumë se 1.300 qytetarë të këtij shteti vdesin si rezultat i sëmundjeve të shkaktuara nga ndotja e ajrit. Si mënyrë për t'u përballur me problemin, shteti u ka urdhëruar të gjitha fabrikave se duhet doemos të vendosin filtra pastrimi në mënyrë që të mbrohet mjedisi jetësor. Mënyra në të cilën shteti kontrollon nëse fabrikat respektojnë urdhërin është me vizitë të paparajmëruar nga inspektori që duhet të kontrollojë nëse fabrikat kanë dhe i shfrytëzojnë filtrat. Ajo që për të gjithë është e paqartë është se gjithmonë kur ka kontroll, inspektorët shohin se filtrat e këtyre fabrikave punojnë pa problem, por ndotja nga viti në vit vetëm vazhdon të rritet. Gazeta lokale hulumton dhe mëson se disa fabrika ose u paguajnë ryshfet inspektorëve ose u kërcënohen se do t'u hakmerren, nëse nuk i informojnë fshehtëazi se kur do të ndodhi kontrolli. Në këtë mënyrë, fabrikat vetëm sipërfaqësisht u përmbahen rregullave, derisa zgjatë inspektimi.

- ➔ Forma e korrupsionit: \_\_\_\_\_
- ➔ Arsye: \_\_\_\_\_
- ➔ Pasoja: \_\_\_\_\_

**Shembulli 3:** Pas aksionit policor të koordinuar në mënyrë të shkëlqyeshme pas denoncimit të qytetarëve të cilët kanë qenë viktime të korrupsionit, fillon procedura gjyqësore për dy mjekë të cilët janë kapur duke marrë ryshfet. Njërit mjek i është shqiptuar dënim me burg për keqpërdorim, ndërsa tjetri është shpallur i pafajshëm. Arsyeja pse mjekut të dytë i shqiptohet vetëm dënim me kusht, është për shkak se partia në pushtet anëtar i së cilës është mjeku, i premtonte gjykatësit se nëse e liron mjekun, si kundërpërgjigje do ta përzgjedhë për gjykatës në Gjykatë të Lartë. Pasi që mëson opinionin, qytetarët komentojnë se është e evidente se rregullat nuk vlejnë në mënyrë të barabartë për të gjithë, se mund të mbijetohet vetëm me lidhje, se nuk ekziston shtet ligjor.

- ➔ Forma e korrupsionit: \_\_\_\_\_
- ➔ Arsye: \_\_\_\_\_
- ➔ Pasoja: \_\_\_\_\_

## **Përmbajtja: Zgjedhjet dhe proceset demokratike në shoqëri**



### **Rezultate nga nxënia**

Nxënësi/nxënësja i dallon mënyrat në të cilat qytetarët mund të marrin pjesë në proceset politike dhe e vlerëson rëndësinë e zgjedhjeve në zhvillimin e demokracisë.



### **Standarde/tregues për arritje**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ Numëron mënyra në të cilat qytetarët mund të marrin pjesë në proceset politike: votim, fushata, lobim, mitingje, peticione.



### **Materiale të nevojshme:**

fletë pune 4.9, laps/laps kimik



### **Metoda, teknika, forma:**

diskutim, punë në çifte, punë në grupe

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

Mësimdhënësi e fillon orën me kërkesë drejtuar nxënësve që të ndajnë përvojat e tyre personale lidhur me zgjedhjen e kryetarit të klasës dhe/ose kryetarit të parlamentit të nxënësve. Disa nxënës duhet ta përshkruajnë procesin e zgjedhjes dhe të vlerësojnë se sa ka qenë i njëjti demokratik, sipas parimeve si vijon:

- ➔ Sa ka pasur mundësi që secili nxënës në mënyrë të barabartë të kandidohet?
- ➔ A kanë pasur nxënësit-kandidatë mundësi për të prezantuar program personal ose qëllimet për të cilat do të angazhohen?
- ➔ Sa ka pasur mundësi secili nxënës të votojë në mënyrë të pavarur dhe sipas bindjes personale?
- ➔ A ka qenë votimi i fshehtë?
- ➔ Sa ka qenë publik dhe transparent procesi i numërimit të votave?
- ➔ Sa kanë qenë nxënësit të kënaqur me zgjedhjen në fund?

Përmes pyetjeve mësimdhënësi zhvillon diskutim për zgjedhjet si proces demokratik në të cilin mund të marrin pjesë të gjithë qytetarët, por vendimet merren në bazë të zgjedhjes së shumicës. Megjithatë, pjesëmarrja e qytetarëve në një shoqëri demokratike nuk është e kufizuar vetëm në mundësinë për të votuar në zgjedhje dhe referendum. Ekzistojnë mënyra të ndryshme në të cilat mund të marrin pjesë në proceset politike.

Mësimdhënësi mund të kërkojë nga nxënësit të përmendin disa nga mundësitë për pjesëmarrje dhe t'i sqarojnë përmes shembujve personal, dhe më pas kalon në aktivitetin e radhës.

## Pjesa kryesore e orës (30 min.)

### Aktivitet:

#### **Aktivitet: Mënyra të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset politike (15 min.)**

Nxënësit marrin dy lista (mund të jepen në formë të fletës së punës 4.9, të paraqitura përmes projektorit): Lista 1 me shembuj të pjesëmarrjes në proceset politike, dhe Lista 2 me mënyra të pjesëmarrjes. Në çifte nga dy vetë kanë për detyrë t'i ndërlidhin shembujt/situatat me mënyrat e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset politike.

**Shënim:** Për disa mënyra të caktuara të pjesëmarrjes nga Lista 2 janë dhënë më shumë se një shembull në Listën 1.

## Fletë pune e plotësuar – shembull për mësimdhënësin

Shembull për pjesëmarrje	Mënyrë e pjesëmarrjes
1. Marta ndjekë klipe reklamuese për zgjedhjet presidenciale dhe mendon për cilin kandidat ta japë votën e saj.	B
2. Kandidatët për këshilltarë në komunë organizojnë takime me qytetarët dy javë para zgjedhjeve.	B
3. Artani shkon në një shkollë lokale, ku ia kontrollojnë dokumentet personale dhe i japin fletë në të cilën duhet të rrethojë njërin prej kandidatëve.	A
4. Mia mbledhë nënshkrime nga banorët e mëhallës së saj për rindërtimin e këndit të lojërave për fëmijë në park.	D
5. Sanella shkoi të takohet me njërin prej anëtarëve të këshillit të komunës së saj për të biseduar për nevojën e vendosjes së shportave për seleksionimin e mbeturinave në lagje.	C
6. Mirkoja u takua me deputeten nga Kuvendi kur ajo ishte në një tribunë publike në qytetin e tij. Shfrytëzoi mundësinë që t'i thotë se kanë problem me mungesën e ujit gjatë periudhës së verës.	C
7. Mikja i bëri thirrje Linës që të shkojnë të dëgjojnë fjalimin e kandidatit për deputet nga komuna e tyre dhe të shikojnë se nëse zgjedhet, a do të angazhohet për t'i përfaqësuar interesat e tyre.	Ç
8. Rita shkoi në shkollën lokale ku ia kontrolluan dokumentet personale dhe i dhanë fletë në të cilën kishte dy opsione: PËR vendosje të transportit publik në qytet dhe KUNDËR vendosjes së transportit publik në qytet, ndërsa ajo duhej të rrethojë njërin prej opsioneve.	Ç

Pas zbatimit të ushtrimit dhe ndarjes së përgjigjeve në nivel të klasës, mësimdhënësi i fton nxënësit të tentojnë të sqarojnë secilin prej termeve, përmes asociacioneve, shembujve, përkufizimeve ose në ndonjë mënyrë tjetër. Përgjigjet e tyre i shënon, pas çka i jep përshkrimet si vijon. Nxënësit mund të shikojnë se sa është e ngjashme me këto përshkrime mënyra në të cilën ata e kanë kuptuar termin.



**Votimi** paraqet mënyrë të marrjes së vendimit grupor ose shprehjes së mendimit, që zakonisht rezulton pas diskutimeve, debateve ose fushatave zgjedhore. Zakonisht qytetarët votojnë në zgjedhje (lokale, parlamentare, presidenciale), por mund të votojnë edhe përmes shprehjes së qëndrimit të tyre për një çështje të caktuar në referendum.

**Fushata politike** është aktiviteti i organizuar qëllimi i të cilit është të ndikojë në mendimin publik dhe marrjen e vendimeve në mesin e votuesve. Në sisteme demokratike, fushatat politike në të shumtën e rasteve kanë të bëjnë me fushata zgjedhore qëllimi i të cilave është zgjedhja e përfaqësuesve politik. Shpeshherë, në kuadër të fushatave organizohen mitingje, gjegjësisht ngjarje në të cilat qytetarët kanë mundësi të dëgjojnë se për çfarë angazhohen kandidatët politik.

**Lobimi** paraqet tentim për të ndikuar në aktivitetet ose vendimet e faktorëve të ndryshëm (p.sh. përfaqësues të niveleve të ndryshme të pushtetit), në mënyrë ligjore.

**Peticioni** është dokument, zakonisht i nënshkruar nga një numër i madh i qytetarëve, me të cilin kërkohet marrja e një vendimi të caktuar ose zbatim i ndonjë aktiviteti të caktuar nga ana e autoriteteve ose faktorëve të tjerë.

### **Aktivitet:**

#### **Çfarë mund të bëjmë? (15 min.)**

Nxënësit duhet të rikthehen në ndonjërin prej orëve paraprake, kur përpilonin plan për nismë qytetare/të nxënësve për zgjidhjen e një problemi të caktuar lokal, dhe të propozojnë se përmes cilave nga format e përmendura të pjesëmarrjes qytetare (por edhe formave të tjera potenciale të pjesëmarrjes) do të mund të nxitnin zgjidhjen e të njëjtit. Gjatë përzgjedhjes së mënyrës së pjesëmarrjes duhet të kenë parasysh pyetjet si vijon:

- Sa aktivitet/angazhim kërkon nga qytetarët? Sa janë qytetarët të motivuar që të përfshihen në aktivitete të ndryshme (përpilim të peticionit, nënshkrim të peticionit, pjesëmarrje në miting, takime për lobim me përfaqësues të zgjedhur, etj.)?
- Sa mundëson mënyra e përzgjedhur që të dëgohen nevojat dhe interesat e qytetarëve?
- Sa do të depërtojë mënyra e përzgjedhur deri te ata që janë përgjegjës për zgjidhjen e problemit?

Pas miratimit të vendimit për metodën më përkatëse të pjesëmarrjes, nxënësit duhet të ndërmarrin hapa drejt realizimit të aktivitetit të planifikuar.

## *Aktivitet për reflektim (5 min.)*

- ➔ Sa i keni pasur të njohura tashmë gjërat për të cilat mësuam sot?
- ➔ Cilat informacione të reja i mësuat? A kishte diçka që ju befaso, habiti?
- ➔ Si do t'ju shërbejë më tutje në jetë kjo që e mësuam?

## Fletë pune 4.9.

# Mënyra të pjesëmarrje së qytetarëve në proceset politike

Lexoni shembujt për pjesëmarrje në proceset politike në kolonën e parë të tabelës dhe përfshijini në mënyrën përkatëse të pjesëmarrjes në kolonën e dytë.

### Lista 1. Shembujt të pjesëmarrjes në proceset politike

Shembull për pjesëmarrje	Mënyrë e pjesëmarrjes
1. Marta ndjekë klipe reklamuese për zgjedhjet presidenciale dhe mendon për cilin kandidat ta japë votën e saj.	
2. Kandidatët për këshilltarë në komunë organizojnë takime me qytetarët dy javë para zgjedhjeve.	
3. Artani shkon në një shkollë lokale, ku ia kontrollojnë dokumentet personale dhe i japin fletë në të cilën duhet të rrethojë njërin prej kandidatëve.	
4. Mia mbledhë nënshkrime nga banorët e mëhallës së saj për rindërtimin e këndit të lojërave për fëmijë në park.	
5. Sanella shkoi të takohet me njërin prej anëtarëve të këshillit të komunës së saj për të biseduar për nevojën e vendosjes së shportave për seleksionimin e mbeturinave në lagje.	
6. Mirkoja u takua me deputeten nga Kuvendi kur ajo ishte në një tribunë publike në qytetin e tij. Shfrytëzoi mundësinë që t'i thotë se kanë problem me mungesën e ujit në periudhën verore.	
7. Mikja i bëri thirrje Linës që të shkojnë të dëgjojnë fjalimin e kandidatit për deputet nga komuna e tyre dhe të shikojnë se nëse zgjidhet, a do të angazhohet për t'i përfaqësuar interesat e tyre.	
8. Rita shkoi në shkollën lokale ku ia kontrolluan dokumentet personale dhe i dhanë fletë në të cilën kishte dy opsione: PËR vendosje të transportit publik në qytet dhe KUNDËR vendosjes së transportit publik në qytet, ndërsa ajo duhej të rrethojë njërin prej opsioneve.	

### Lista 2. Mënyra të pjesëmarrjes

- A. Votim në zgjedhje
- B. Fushatë zgjedhore
- C. Lobim
- Ç. Miting
- D. Peticion
- DH. Votim në referendum

# **Përmbajtja: Zgjedhjet dhe proceset demokratike në shoqëri**



## **Rezultate nga nxënia**

Nxënësi/nxënësja:

- ➔ dallon mënyrat në të cilat qytetarët mund të marrin pjesë në proceset politike dhe vlerëson rëndësinë e zgjedhjeve në zhvillimin e demokracisë



## **Standarde/tregues për arritje**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ përshkruajë llojet e zgjedhjeve dhe modeleve zgjedhore,
- ➔ japë shembuj konkret se si partitë politike/kandidatët e pavarur duhet të jenë në funksion të interesave të qytetarëve.



## **Materiale të nevojshme:**

diskutim, formë frontale, punë në grupe



## **Metoda, teknika, forma:**

letër, laps/laps kimik, ueb faqe

## ***Pjesa hyrëse e orës (10 min.)***

Mësimdhënësi i përkujton nxënësit në përmbajtjet për organizimin e pushtetit, të mësuara në klasën e tetë dhe në kuadër të përmbajtjes „Si është organizuar pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut?” nga moduli mësimor rrjedhës. Në tabelë i shënon llojet e pushtetit në shtet:

**Pushtet ligjdhënës (Kuvend/Parlament)**

**Pushtet ekzekutiv (Qeveri)**

**Pushtet lokal (kryetari i komunës, Këshilli i Komunës)**

**President i shtetit**

Nxënësit duhet të tregojnë se me çfarë lloji të zgjedhjeve (lokale, parlamentare, presidenciale) zgjidhen përfaqësuesit e secilit pushtet dhe të arsyetojnë se cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet mes llojeve të ndryshme të zgjedhjeve.

## ***Pjesa kryesore e orës (25 min.)***

### ***Pjesa teorike: Sisteme zgjedhore dhe modele zgjedhore (10 min.)***

**Sistemi zgjedhor** është përmbledhje e rregullave që përcaktojnë se si mbahen zgjedhje ose referendume dhe si përcaktohen rezultatet nga të njëjtat. Rregullat përcaktojnë: kur mbahen zgjedhje, kush mund të votojë, kush mund të kandidohet, si zbatohet votimi, si numërohen votat, etj.

Dy modelet më të shpeshta zgjedhore janë modeli proporcional dhe modeli i shumicës.

Sipas **modelit zgjedhor proporcional**, secila parti është e përfaqësuar në Parlament në proporcion me pjesën e votave të fituara nga zgjedhësit. Me fjalë të tjera, secila parti merr numër të vendeve parlamentare në mënyrë proporcionale me përqindjen e votave që i ka fituar gjatë zgjedhjeve.

### **Shembull për modelin zgjedhor proporcional:**

Në zgjedhjet parlamentare, partitë i kanë marrë përqindjet e votave si vijon. Në Parlament ka 10 vende parlamentare. Në përputhje me modelin proporcional, renditja e vendeve parlamentare në Parlament është si vijon:

	Përqindje e votave të fituara (prej gjithsej 100%)	Numri i vendeve të fituara parlamentare (prej gjithsej 10 vendeve)
<b>Partia 1</b>	56 %	6
<b>Partia 2</b>	33 %	3
<b>Partia 3</b>	11 %	1

Karakteristika më e rëndësishme e sistemeve proporcionale zgjedhore me lista partiake është nxitja e formimit të sistemeve shumëpartiake, që shumë shpesh rezultojnë me formimin e koalicioneve dhe qeverive të koalicionit. Nga njëra anë, kjo konsiderohet si përparësi meqë sistemet shumëpartiake dhe formimi i qeverive të koalicioneve të gjera shpijnë drejt përfaqësimit të interesave të shumë grupeve të ndryshme në shoqëri në kuadër të Parlamentit dhe në Qeveri. Nga ana tjetër, kjo mund të konsiderohet edhe si mungesë e sistemit zgjedhor, duke marrë parasysh faktin se numri i madh i partive dhe koalicioneve të gjera qeveritare shpesh dinë të rezultojnë me paqëndrueshmëri të qeverisë dhe marrje më të vështirë të vendimeve të rëndësishme.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut modeli proporcional zbatohet në zgjedhjet parlamentare, gjatë zgjedhjes së deputetëve në Kuvendin kombëtar dhe në zgjedhjet lokale, gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të këshillave të komunave.

Gjatë zbatimit të **modelit zgjedhor të shumicës**, kandidati që do të fitojë më së shumti vota, e merr mandatin zgjedhor. Zakonisht, përcaktohet një prag minimal i votave që duhet të tejkalohet në mënyrë që kandidati të jetë i zgjedhur. Nëse në raundin e parë zgjedhor asnjëri prej kandidatëve të përcaktuar nuk e merr shumicën e nevojshme të votave, kalohet drejt mbajtjes së raundit të dytë zgjedhor, në të cilin marrin pjesë dy kandidatët që kanë fituar më së shumti vota. Në shtetin tonë, modeli zgjedhor i shumicës zbatohet gjatë zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjatë zgjedhjes së kryetarëve të komunave.

### **Shembull për modelin e shumicës zgjedhore:**

Në zgjedhjet presidenciale, tri partitë kanë pasur kandidatë të tyre, ndërsa ka pasur edhe një kandidat të pavarur. Në zgjedhjet mund të fitojë kandidati që do të kalojë pragun prej 50% të votave të fituara, gjegjësisht do të fitojë më shumë se 50% të votave. Meqë në raundin e parë zgjedhor asnjëri prej kandidatëve nuk e kaluar pragun e domosdoshëm të votave, dy kandidatët me më shumë vota kanë kaluar në raundin e dytë zgjedhor, pas çka njëri prej tyre ka marrë shumicën e votave dhe është zgjedhur president.

	Përqindja e votave të fituara në raundin e parë zgjedhor	Pragu minimal i votave	Përqindja e votave të fituara në raundin e dytë zgjedhor
Kandidat i partisë 1	38 %	50 %	48 %
Kandidat i partisë 2	7 %		
Kandidat i partisë 3	15 %		
Kandidat i pavarur 4	40 %		52 %

### **Aktivitet:**

#### ***Përfaqësuesit politik në funksion të qytetarëve (20 min.)***

Nxënësit ndahen në tri grupe.

Secili grup merr një pyetje (dilemë) për të cilën duhet të diskutojë.

1. Çfarë është më e rëndësishme: infrastrukturë e mirë urbane (rrugë, transport publik) ose ulje e ndotjes?
2. Çfarë është më e rëndësishme: mësimdhënës të trajnuar mirë ose punëtorë shëndetësor të trajnuar mirë?





3. Çfarë është më e rëndësishme: kujdesi për kafshët e rrugëve ose kujdesi për njerëz të pastrehë?

Grupet kanë rreth 10 minuta të diskutojnë për çështjet, me ç'rast inkurajohen që të lëvizin drejt konsensusit nëse është e mundshme.

Mësimdhënësi sqaron se në këtë mënyrë funksionon **demokracia direkte (e drejtpërdrejtë)**, përmes dhënies së mundësive që secili të shprehë mendimin e tij dhe të ndikojë drejtpërdrejtë në marrjen e vendimeve. Kjo është e mundur kur bëhet fjalë për grupe të vogla (p.sh. klasë, ndërmarrje e vogël, bashkësi banesore), por është shumë e komplikuar në grupe të mëdha. Prandaj, qytetarët përzgjedhin përfaqësues të cilët duhet t'i prezantojnë dhe përfaqësojnë interesat e tyre dhe veprojnë në emër të tyre. Këtë proces e quajmë **demokraci përfaqësuese**.

Në hapin e radhës, secili grup duhet të përzgjedhë një nxënës për të cilin konsiderojnë se do t'i përfaqësointe më së miri qëndrimet e grupit. Ata mund të zbatojnë edhe votim të fshehtë për zgjedhjen e përfaqësuesit, në atë mënyrë që secili do ta shkruajë emrin (ose numrin rendor) të nxënësit të cilin e propozon, e më pas bashkërisht do t'i numërojnë votat.

Përfaqësuesit e zgjedhur duhet të dalin në pjesën e parme të klasës dhe duhet të votojnë për secilën prej deklaratave si vijon, me ngritjen e dorës se janë dakord:

1. Infrastruktura e mirë urbane është më e rëndësishme sesa ulja e ndotjes.
2. Punëtorët shëndetësorë të trajnuar mirë janë më të rëndësishëm se mësimdhënësit e trajnuar mirë.
3. Kujdesi për kafshët e rrugës është më i rëndësishëm sesa njerëzit e pastrehë.

Mësimdhënësi i shënon votat e dhëna për secilin prej opsioneve. Sqaron se në këtë mënyrë funksionon demokracia përfaqësuese. Liderëve të zgjedhur u është besuar t'i përfaqësojnë votuesit e tyre (ose njerëzit që i përfaqësojnë) dhe të votojnë në emër të tyre.



## ***Pjesa përfundimtare e orës dhe aktivitetet për reflektim (10 min.)***

Mësimdhënësi nxitë diskutim sipas pyetjeve si vijon:

- ➔ A ishte ky proces korrekt?
- ➔ Sa mirë përfaqësuesit i njihnin interesat dhe qëndrimet e qytetarëve që i përfaqësonin?
- ➔ Sa vepronin në funksion të qytetarëve përfaqësuesit përmes votimit?
- ➔ Cilat janë disa nga problemet potenciale me këtë lloj të demokracisë? (Përgjigje të mundshme: Jo të gjithë qytetarët votojnë në zgjedhje, përfaqësuesit e zgjedhur mund të mos i dëgjojnë qytetarët, por të udhëhiqen nga interesat personale).
- ➔ Pse është e rëndësishme që të ekzistojnë mundësi për të dëgjuar zërin e secilit anëtar të grupit/bashkësisë? (Përgjigje të mundshme: Në mënyrë që të mundësohet secili anëtar i bashkësisë t'i realizojë interesat e tij dhe t'i kënaqë nevojat e tij, në mënyrë që të sigurohemi se askush nuk është i diskriminuar dhe secilit i janë dhënë mundësi të barabarta).
- ➔ Çfarë do të mund të bëni në mënyrë që të siguroheni se përfaqësuesi juaj me të vërtetë i kupton qëndrimet tuaja? (Përgjigje të mundshme: Të zbatohen takime të kohëpaskohshme mes qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre, deri te përfaqësuesit të dërgohen letra ku janë arsyetuar qëndrimet e qytetarëve, të zbatohen nisma qytetare me të cilat u ndihmohet përfaqësuesve në realizimin e disa qëllimeve të caktuara të përbashkëta).

## ***Përmbajtja: Administratë shtetërore dhe publike***



### ***Rezultate nga nxënia***

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ analizojë dhe vlerësojë rolin shoqëror të administratës shtetërore dhe publike.



### ***Standarde/tregues për arritje***

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ dallojë administratën shtetërore dhe publike,
- ➔ përshkruajë kompetenca të administratës shtetërore dhe publike,
- ➔ debatojë për përgjegjësinë e nëpunësve publik dhe shtetëror në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.



### ***Materiale të nevojshme:***

fletë pune 4.10, fletë pune 4.11, laps/laps kimik



### ***Metoda, teknika, forma:***

punë në grupe, diskutim

## Pjesa hyrëse e orës (5 min.)

Mësimdhënësi i nxitë nxënësit të ndajnë mendime për pyetjet si vijon:

- ➔ Ndani disa të mira dhe shërbime që të gjithë ose shumica prej tyre i përdorim çdo ditë? (Përgjigje të mundshme: shëndetësi publike, arsim publik, transport publik, rrugë, sistem komunal, mbrojtje policore, mbrojtje prej zjarreve, etj.).
- ➔ Kush na i mundëson këto të mira dhe shërbime të përbashkëta? (Pritet nga nxënësit të bëjnë të ditur se i mundësojnë shteti/institucionet shtetërore).
- ➔ Çfarë do të ndodhë nëse dikush tjetër, e jo shteti i mundëson këto të mira dhe shërbime? (Përgjigje të mundshme nga nxënësit: mund të rriten çmimet (kompanitë nuk kujdesen nëse çmimet janë mjaftueshëm të ulëta në mënyrë që të gjithë të kenë mundësi t'i mbulojnë), shërbimet dhe mallrat mund të mos jenë të arritshme për të gjithë qytetarët (për shkak të çmimeve, qasjes fizike) etj.

Mësimdhënësi bën përmbledhje të përgjigjeve të nxënësve dhe nxjerrë konstatim të shkurtër:

Shteti, gjegjësisht institucionet shtetërore, kujdesen që t'i mundësojnë të mirat dhe shërbimet e përbashkëta që u nevojiten qytetarëve. Është me rëndësi që këto të mira dhe shërbime të jenë të arritshme për të gjithë dhe të gjithë qytetarët të mund t'ua lejojnë vetes, pa ndikuar me këtë rast shoqëria e tregut (gjegjësisht konkurrenca) të ndikojë në çmimet.

## Pjesa kryesore e orës (25 min.)

**Administrata publike** është përmbledhje e institucioneve të themeluara nga shteti, që mundësojnë shërbime apo të mira që janë të domosdoshme për të gjithë qytetarët në shoqëri, pa të cilat nuk do të mund të imagjinohej përditshmëria e njerëzve në kushte bashkëkohore. Këtu bën pjesë: sigurimi i arsimit dhe zhvillimit të shkencës, mbrojtje shëndetësore dhe kujdes për shëndetin e popullatës, mbrojtje e mjedisit jetësor, qasje deri te rryma, uji, ngrohja, ndërtimi i rrugëve dhe strukturës komunikuese, mundësim të transportit, mundësim të mbrojtjes sociale dhe ndihmë për banim, mbështetje për kulturën dhe artin. Administrata është e obliguar të dijë se cilat janë problemet e qytetarëve, të përpilojë zgjidhje për problemet, të organizojë qasjen deri te shërbimet, të bashkëpunojë mes vete.

Administrata publike nga aspekti organizativ/formal i përfshin:

- ➔ **Administrata shtetërore:** ministritë, organe në përbërje të saj, organizata administrative
- ➔ **Vetëqeverisje lokale:** kryetarë komune, Këshill i Komunës/qytetit, administratë komunale

- **Institucione publike:** spitale, shkolla, fakultete, kopshte për fëmijë, shtëpi azili për pleq, teatro, kinema, qendra sociale
- **Fonde:** rrugore, pyje, ekologjike, invalidore, shëndetësore, pensionale
- **Ndërmarrje publike:** komunikacion, ujësjellës, higjienë komunale, pyje, ujëra
- Ka situata ku kompani private ose organizata joqeveritare (që nuk janë në pronësi të shtetit) marrin autorizime publike (të ushtrojnë punë që janë në interesin e të gjithëve):
- Shoqata tregtare me autorizime publike: SHA „Posta e Maqedonisë së Veriut“ - Shkup, EVN Maqedoni SHA
- Organizata joqeveritare me autorizime publike: Oda e mjekëve, Oda e noterëve, AMLM, Lidhja e vozitësve.

### **Aktivitet:**

#### **Çfarë bën pjesë në administratën publike? (15 min.)**

Mësimdhënësi u ndan nxënësve fletën e punës 4.10 ku nxënësit duhet të shënojnë nëse shembujt e dhënë janë pjesë e administratës publike. Pasi ta plotësojnë fletën e punës, mësimdhënësi fton vullnetarë që t'i ndajnë përgjigjet e tyre dhe të sqarojnë pse kanë bërë përzgjedhje të tillë. Mësimdhënësi nxitë diskutim mes nxënësve për përgjigjet e tyre.

## Fletë pune e plotësuar – shembull për mësimdhënësin

	Pjesë e administratës publike	Nuk është pjesë e administratës publike
Restoranti McDonald's		X
Agjencia e Rinisë dhe Sportit	X	
Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	X	
Komuna Çeshinovë – Obleshevë	X	
Marketi Kam		X
Shkolla e Mesme Komunale „Ibrahim Temo“ - Strugë	X	
Tutunska Banka		X
Spitali i Përgjithshëm – Ohër	X	
Teatri Popullor Maqedonas	X	
Biblioteka „Svetlina - Drita“, Komuna e Jegunocit	X	
Hoteli Kontinental		X
Muzeu i artit bashkëkohor	X	
Konvikti i nxënësve „Prof. Mijalkoviq“ – Kumanovë	X	
Fabrika e automobilave Teslla		X
Ansambl i valleve dhe këngëve popullore Tanec		X
Operatori mobil Telekom i Maqedonisë		X
Ndërmarrja publike Ujësjellës dhe kanalizim	X	
Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë	X	
Fondi për Sigurim Shëndetësor	X	
Kinemaja Cineplexx		X
Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale – Veles	X	
Shitore për pajisje sportive Nike		X
Klubi i futbollit Renova		X
Parku kombëtar „Pelister“ – Manastir	X	
Furra Zhitoluks		X

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve dhe nxjerrë konstatimin si vijon:

Administrata publike ka forma të ndryshme. Ministritë, komunat, agjencitë, quhen me një emër të përbashkët **organe të administratës shtetërore**. Shkollat, spitalet, teatrot, bibliotekat, muzetë quhen **institucione publike**. Institucionet të cilat janë pjesë e administratës publike themelohen për fusha të ndryshme: arsim, shëndetësi, mbrojtje të mjedisit jetësor, kulturë, mbrojtje sociale, etj. E përbashkët për të gjitha institucionet që janë pjesë e administratës publike është se janë themeluar nga shteti ose komuna dhe e mbrojnë interesin e të gjithë qytetarëve në shoqëri ose qytetarëve në bashkësinë lokale. Për dallim prej tyre, kompanitë ose bizneset private punojnë në interes të atyre që i kanë themeluar.

Në institucione të ndryshme shtetërore, për shembull shkollë, bibliotekë, ndërmarrje komunale, ata që i udhëheqin këto institucione, janë drejtorë dhe quhen **funksionarë të emëruar**. Qohen kështu meqë Qeveria, komuna ose ndonjë institucion tjetër që i ka themeluar, konsideron se janë më të përshtatshëm për të qenë përgjegjës për institucionin. Personat përgjegjës të institucioneve të cilët nga ana tjetër, i kanë zgjedhur drejtpërdrejt qytetarët, në zgjedhje të drejtpërdrejta quhen **funksionarë të zgjedhur**, siç janë për shembull kryetarët e komunave dhe anëtarë të Këshillit të Komunës. Detyrë e funksionarëve të zgjedhur dhe emëruar është të japin udhëzime se si institucionet të cilat i udhëheqin të përmirësohen, duke përfshirë edhe si të përmirësohen shërbimet që i ofrojnë dhe kujdesen për të punësuarit. Por, këta funksionarë janë përgjegjës për institucionin për një kohë të caktuar, prandaj për këtë arsye edhe shpesh ndërrohen.

Nga ana tjetër, të punësuarit, në këto institucione, të cilët quhen **të punësuar në sektorin publik ose administratë publike**, janë vazhdimisht të punësuar, dhe nuk ndryshohen aq shpesh si drejtorët dhe funksionarët tjerë të emëruar. Të punësuarit në administratën publike ndahen në më shumë grupe, të dhëna në foton 14.

Foto 14. Ndarja e administratës publike.



Administrata publike është eksperte, profesionale dhe jopartiake, që do të thotë se punësojnë persona të cilët kanë dituri dhe përvojë profesionale. Detyra e tyre është që t'i zgjidhin problemet e qytetarëve dhe t'u mundësojnë qasje deri te shërbimet publike, duke respektuar me këtë rast disa parime të caktuara të administratës publike:

- ➔ Administrata publike është e obliguar t'u shërbejë të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë dhe **të gjithë qytetarët t'i trajtojë në mënyrë korrekte.**
- ➔ Ajo duhet të dijë se cilat janë problemet e qytetarëve dhe të ofrojë zgjidhje me të cilat qytetarët janë dakord. Prandaj është me rëndësi që administrata publike t'i përfshijë qytetarët kur përcakton se cilat janë problemet parësore, por edhe së bashku me ta të krijojë zgjidhje. Kur qytetarët marrin pjesë në punën e administratës publike, themi se ajo është **inkluzive** dhe vendimet i merr në **mënyrë participuese.**
- ➔ Administrata publike për punën e saj ose për çështje që u interesojnë qytetarëve duhet doemos të japë qytetarëve informacione të sakta dhe në kohë. Ky quhet parim i **transparencës.**
- ➔ Administrata publike duhet doemos t'i respektojë ligjet dhe rregullat. Nëse administrata publike gabon dhe qytetarit i bën dëm ose ia pamundëson shfrytëzimin e një të drejte të caktuar, atëherë qytetari mund të kërkojë mbrojtje nga gjykatësit, Avokati i Popullit, ose nga ndonjë organ më i lartë, në mënyrë që t'i mundësohet shërbimi i nevojshëm ose e drejta. Nëpunësi ose institucioni mund të dënohen varësisht nga serioziteti i shkeljes. Në këtë mënyrë garantohet parimi i **përgjegjësisë.**

## Pjesa përfundimtare e orës (10 min.)

### Aktivitet:

#### Parimet e administratës publike

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në pesë grupe që në fletën e punës 4.11 duhet t'i ndërlidhin shembujt e dhënë me parimet përkatëse. Pasi që grupet do të bëjnë ndërlidhjen (për çfarë kanë 5 min.), secili grup prezanton nga një shembull/parim. Nëse grupet tjera nuk janë dakord me përzgjedhjen e grupit që prezanton, mësimdhënësi nxitë diskutim të shkurtër për të sqaruar me çfarë ka të bëjë qëndrimi i tyre i ndryshëm.

### Fletë pune e plotësuar – shembull për mësimdhënësin

Shembuj	Parime
Kandidati i pakënaqur mund të parashtrojë ankesë deri te <i>Komisioni për ndarjen e bursave për nxënësit dhe studentet e talentuar të Këshillit të Komunës</i> në afat prej tre ditëve nga shpallja e rezultateve.	Parimi i përgjegjësisë
Të gjithë banorët e komunës janë të ftuar të dorëzojnë propozime për përmirësimin e jetës kulturore në komunë.	Parimi i përfshirjes dhe participimit
Në faqen e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor janë publikuar të dhëna për nivelin e ndotjes së ajrit, në intervale kohore për çdo orë.	Parimi i transparencës
Të gjithë nxënësit kanë të drejtën e arsimit cilësor në gjuhën e tyre amtare.	Parimi i trajtimit të barabartë dhe të drejtë
Në shpalljen për punësim në administratën publike, nga kandidatët e lajmëruar, përzgjidhet ai që ka përvojë paraprake pune më përkatëse, njeh disa gjuhë, dhe në intervistë është vlerësuar më lartë se të gjithë kandidatët tjerë.	Parimi i profesionalizmit dhe ekspertizës



## ***Aktivitet për reflektim dhe vlerësim*** **(5 min.)**

Mësimdhënësi nxitë diskutim:

- ➔ Cila është puna më e dobishme që e mësuat në orën e sotme dhe pse?
- ➔ Çfarë nga ora e sotme ishte më e komplikuar ose e vështirë për ta kuptuar për ju?
- ➔ A ka ndonjë pyetje ose dilemë lidhur me orën e sotme që ju mbet e papërgjigjur?

## Fletë pune 4.10.

### Çfarë bën pjesë në administratën publike?

	Pjesë e administratës publike	Nuk është pjesë e administratës publike
Restoranti McDonald's		
Agjencia e Rinisë dhe Sportit		
Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor		
Komuna Çeshinovë – Obleshevë		
Marketi Kam		
Shkolla e Mesme Komunale „Ibrahim Temo” - Strugë		
Tutunska Banka		
Spitali i Përgjithshëm – Ohër		
Teatri Popullor Maqedonas		
Biblioteka „Svetlina - Drita”, Komuna e Jegunocit		
Hoteli Kontinental		
Muzeu i artit bashkëkohor		
Konvikti i nxënësve „Prof. Mijalkoviq” – Kumanovë		
Fabrika e automobilave Teslla		
Ansambli i valleve dhe këngëve popullore Tanec		
Operatori mobil Telekom i Maqedonisë		
Ndërmarrja publike Ujësjellës dhe kanalizim		
Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë		
Fondi për Sigurim Shëndetësor		
Kinemaja Cineplexx		
Qendra ndërkomunale për punë sociale – Veles		
Shitore për pajisje sportive Nike		
Klubi i futbollit Renova		
Parku kombëtar „Pelister” – Manastir		
Furra Zhitoluks		

## Fletë pune 4.11.

### Parimet e administratës publike

Shembuj	Parime
Kandidati i pakënaqur mund të parashtojë ankesë deri te Komisioni për ndarjen e bursave për nxënësit dhe studentet e talentuar të Këshillit të Komunës në afat prej tre ditëve nga shpallja e rezultateve.	Parimi i trajtimit të barabartë dhe të drejtë
Të gjithë banorët e komunës janë të ftuar të dorëzojnë propozime për përmirësimin e jetës kulturore në komunë.	Parimi i profesionalizmit dhe ekspertizës
Në faqen e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor janë publikuar të dhëna për nivelin e ndotjes së ajrit, në intervale kohore për çdo orë.	Parimi i përfshirjes dhe participimit
Të gjithë nxënësit kanë të drejtën e arsimit cilësor në gjuhën e tyre amtare.	Parimi i transparencës
Në shpalljen për punësim në administratën publike, nga kandidatët e lajmëruar, përzgjidhet ai që ka përvojë paraprake pune më përkatëse, njeh disa gjuhë, dhe në intervistën është vlerësuar më lartë se të gjithë kandidatët tjerë.	Parimi i përgjegjësisë

# ***Përmbajtja: Administrata shtetërore dhe publike***



## ***Rezultate nga nxënia***

Analizon dhe vlerëson rolin shoqëror të administratës shtetërore dhe publike.



## ***Standarde/tregues për arritje***

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ debaton për përgjegjësinë e nëpunësve publik dhe shtetëror në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve
- ➔ identifikon keqpërdorim të kompetencës së administratës shtetërore dhe publike



## ***Materiale të nevojshme:***

fleta, flomasterë, fletë pune 4.12



## ***Metoda, teknika, forma:***

simulim, diskutim

## Pjesa hyrëse e orës (5 min.)

Mësimdhënësi përkujton nxënësit se shteti, gjegjësisht administrata publike mundëson spektër të gjërë të shërbimeve dhe të mirave publike, por thekson se cilësia e tyre është e rëndësishme në mënyrë të barabartë. Më pas i nxitë nxënësit të përzgjedhin njërin nga shërbimet dhe të mirat publike të përmendura më poshtë për të cilin ata konsiderojnë se është më cilësor dhe një për të cilin konsiderojnë se i nevojitet përmirësim i konsiderueshëm.

Propozim shërbime dhe të mira publike:

- ➔ Arsimi publik
- ➔ Shëndetësia publike
- ➔ Mbrojtja e mjedisit jetësor
- ➔ Punësim
- ➔ Kulturë dhe art

Mësimdhënësi fton disa vullnetarë që ta sqarojnë përzgjedhjen e tyre.

**Argumente të mundshme në mënyrë që ndonjë nga shërbimet dhe të mirat publike të vlerësohet pozitivisht:** renditje e lartë në teste ndërkombëtare në fushë të caktuar, mënyrë tjetër e njohjes ndërkombëtare të cilësisë, janë investuar shumë para, nxënësit janë të pranuar shpesh në universitete botërore dhe më pas bëhen profesionistë të pranuar në fushat e tyre, prodhohet kuadër i mirë mjekësor që është atraktiv edhe për shtetet tjera, është evidentuar ulje e ndotjes së ajrit, artistët dhe punëtorët kulturor prodhojnë përmbajtje cilësore kulturore dhe artistike, prandaj rritet numri i atyre që i ndjekin ngjarjet kulturore, etj.

**Argumente të mundshme në mënyrë që ndonjë nga shërbimet dhe të mirat publike të vlerësohet negativisht:** kuadri i ri largohet, nuk investojmë sa duhet mjete në arsim dhe shëndetësi, kemi renditje të ulët në testimet ndërkombëtare, etj.

**Shënim:** Mësimdhënësi duhet të kujdeset për rrezikun nga pesimizmi i tepërt i nxënësve, gjegjësisht refuzimit që të japin notë pozitive.

## Pjesa kryesore e orës (25 min.)

### Aktivitet:

#### **Betejë për parkun „Solidaritet“**

Mësimdhënësi ndan fletën e punës 4.12 nxënësve ku është sqaruar historia për parkun “Solidaritet” dhe janë dhënë udhëzime për simulimin e debatit publik që do të vijojë. Më pas, mësimdhënësi, i ndan nxënësit në 8 grupe prej të cilave secili merr nga një prej roleve që janë dhënë në fletën e punës 4.13. Pas së paku 25 min. diskutim, kryetari i komunës dhe anëtarët e Këshillit duhet të vendosin dhe të njoftojnë publikisht vendimin rreth ardhmërisë së parkut.

## Pjesa përfundimtare e orës (10 min.)

Mësimdhënësi nxitë diskutim për aktivitetin paraprak:

- Cilët ishin aleatët tuaj natyror sipas qëndrimeve që i kishit?
- Si është e mundshme që dy sektorë në komunë, të kenë qëndrime krejtësisht të kundërta?
- Në çfarë mënyre komuna i trajtonte të gjitha palët e prekura? A ishte raporti korrekt dhe i barabartë ndaj të gjithëve?
- Vallë kryetari i komunës dhe këshilltarët, bënë kompromis në zgjidhjen përfundimtare, me qëllim që më shumë palë të prekura të jenë të kënaqura?
- Cili nga sektorët komunal ju dhanë mbështetje në mbrojtjen e qëndrimit dhe pse?
- Në çfarë mënyre tentuat ta bindni sektorin në komunë që nuk ishte dakord me ju, që t’ju mbështesë?
- Sa jeni të kënaqur me vendimin e kryetarit të komunës dhe anëtarëve të Këshillit?
- Në çfarë mënyre vendimi i kryetarit të komunave dhe anëtarëve të Këshillit e mbron interesin publik në këtë situatë?

## Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)

Mësimdhënësi u jep detyrë nxënësve që të mendojnë për pyetjet e dhëna dhe përgjigjet t’i shënojnë në ditarët e tyre reflektues:

- Cila është puna më e dobishme që e mësuat nga ora e sotme dhe pse?
- Çfarë nga ora e sotme ishte më e vështirë për ta kuptuar për ju?
- A ka ndonjë pyetje ose dilemë që është e ndërlikuar me orën e sotme, e që mbetie papërgjigjur?

## **Fletë pune 4.12.**

### **Beteja për parkun „Solidaritet“**

„Parku „Solidaritet“ është sipërfaqe e gjelbër prej 4.000 km<sup>2</sup>, në komunën Barazia. Parku ekziston më shumë se 50 vite dhe është në pronësi të komunës. Parku ka vegjetacion unik dhe të dendur, drunj të lartë, një liqen të vogël artificial dhe botë të llojlojshme shtazore. Parku ka shteg për këmbësorë, shteg për çiklistë dhe një terren loje për shumë dedikime. Parkingu në pjesën e prapme të parkut zë 20 automjete.

Në anën jugore të parkut, gjendet lagjja Vëllazërimi në të cilën jetojnë familje me shumë anëtarë, shumë gjenerata. Fëmijët e shfrytëzojnë parkun për lojë, nxënësit për aktivitete sportive, derisa qytetarët më të moshuar për shëtitje dhe relaksim.

Nga ana veriore e parkut, gjenden qendra afariste-administrative me një numër të madh të bankave, institucione shëndetësore dhe ndërmarrje private. Të punësuarit ndonjëherë e shfrytëzojnë parkun gjatë pauzës. Mirëpo, problem i madh për të gjitha ndërmarrjet, bizneset dhe institucionet është mungesa e parkingut për të punësuarit e tyre. Vetëm ¼ e të punësuarve të cilët përdorin automjete mund të parkojnë në afërsi të vendit të punës.

Nga ana lindore e parkut, ndërmarrja private “Ndërtuesi” dëshiron ta blejë këtë truall nga komuna dhe të ndërtojë tre rrokaqiej.

Viteve të fundit, janë plaçkitur disa persona në park për shkak të vegjetacionit të dendur dhe mungesës së ndriçimit përkatës . Përveç kësaj, në mbrëmje tubohen të rinj të cilët janë të zhurshëm, e ndonjëherë konsumojnë edhe alkool. Parkingu në pjesën e pasme është thuajse gjithmonë i okupuar nga të punësuarit në qendrën afariste-administrative që gjendet në veri të parkut.

#### **Cili është hapi i radhës?**

Kryetari i komunës dhe anëtarët e Këshillit duhet të vendosin çfarë të bëjnë me parkun Solidariteti, pasi që në Komunë kanë mbërritur disa kërkesa lidhur me parkun. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit, organizojnë debat publik për t’i dëgjuar të gjitha palët e interesuara. Pasi që kryetari i komunës dhe anëtarët e Këshillit, do të japin hyrje në temën e debatit publik, secila palë e prekur brenda 2 min. e arsyeton pozicionin e saj. Pasi që të gjithë do të përfundojnë kryetari i komunës do të japë 5 min. pauzë, ku palët e prekura mund të bëjnë bisedë mes vete, të llobojnë, të grupohen. Pas pauzës, secila palë e prekur ose koalicion i bashkuar mund të paraqitet për të marrë fjalën dhe për 2 min. të përgënjeshtroj fjalimet e të tjerëve. Kryetari i komunës dhe anëtarët e Këshillit pas çdo fjalimi mund të parashtrojnë pyetje.

## Fletë pune 4.13.

### Role në simulimin „Betejë për parkun“

1. Deri te **Kryetari dhe Këshilli i Komunës Barazia** kanë mbërritur disa propozime rreth të ardhmes së parkut. Ata duhet t'i dëgjojnë të gjitha palët dhe të vendosin se si do të veprojnë me parkun. Detyra e tyre është që ta mbrojnë interesin publik.
2. Ndërmarrja “Ndërtuesi” konsideron se afërsia e parkut është arsye e rëndësishme pse dikush do të vendoste të blejë banesë, por informacionet se parku është i pasigurt ndikojnë negativisht në çmimin e banesave. Ata kërkojnë që të priten një pjesë e drunjve, të vendoset ndriçim rrugor dhe gardian gjatë natës.
3. **Ndërmarrje, biznese dhe institucione të bashkuara nga qendra afariste-administrative** kërkojnë nga kryetari i komunës që ta rrënojë dhe ta ridedikojë në hapësirë parkingu. Ata kërcënohen se do të shpërngulen në lokacione të tjera, dhe me këtë do të ulen dukshëm të ardhurat e komunës.
4. **Banorët e lagjes Vëllazërimi** kundërshtojnë propozimet e këtilla. Për ta parku gjithmonë ka qenë pjesë e rëndësishme e jetës së tyre sociale dhe kulturore dhe njëra prej arsyeve për jetën cilësore që e kanë. Ata kërkojnë nga komuna që të mos e shesë truallin në anën lindore të parkut, por ta zgjerojnë parkun. Mirëpo, u pëlqen ideja për vendosjen e ndriçimit rrugor dhe gardianit gjatë natës, veçanërisht për shkak se u pengon zhurma që e bëjnë të rinjtë gjatë natës.
5. **Të rinjtë e lagjes Vëllazërimi** kërkojnë që të mos stigmatizohen të rinjtë në diskutimin rreth ardhmërisë së parkut. Duan që parku të zgjerohet, ndërsa më të moshuarit të kenë mirëkuptim për nevojën e tyre për hapësirë për shoqërim, si dhe besim se mund të sillen në mënyrë të përgjegjshme. Refuzojnë të pajtohen me vendosjen e gardianit gjatë natës.
6. **Shoqata lokale ekologjike Miq të natyrës**, jo vetëm që i kundërvihet prerjes ose ridedikimit të parkut, por kërkon edhe kufizim të konsiderueshëm të lëvizjes ditore të vizitorëve, për shkak se zhurma dhe mbeturinat i pengojnë botës së gjallë në parkun.
7. **Spektori për mbrojtjen e mjedisit jetësor** në komunë konsideron se parku është veçanërisht i rëndësishëm për avancimin e cilësisë së ajrit, si dhe për ruajtjen e diversitetit të vegjetacionit dhe botës së gjallë.
8. **Spektori për tatime dhe taksa komunale** në komunë konsideron se ridedikimi i parkut në parking ose ndërtim të rrokaqiejve, do t'i sjellë komunës të ardhura dukshëm më të mëdha.





*Moduli*



# **GLOBALIZIMI DHE SHOQËRIA**

## *Përmbajtja: Globalizimi dhe shoqëria*



### *Rezultate nga nxënia*

Nxënësi/nxënësja mund të::

- ➔ analizojë dhe ndjekë ndryshimet në shoqëri si rezultat i shkëmbimit të rritur kulturor.



### *Standarde/tregues*

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ përkufizon termin globalizim,
- ➔ numëron proceset në të cilat shfaqet globalizimi.



### *Materiale të nevojshme:*

fletë pune 5.1.



### *Metoda, teknika, forma:*

teknika, forma: diskutim, analizë e tekstit, punë frontale, punë individuale dhe punë në çiftë.

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

### Aktivitet:

#### **Historia e kompanisë Koka-Kola**

Mësimdhënësi e lexon shembullin për kompaninë Koka-Kola dhe i udhëzon nxënësit t'i shënojnë ato informacione për të cilat konsiderojnë se janë të rëndësishme.

„Koka-Kolën e ka shpikur farmacisti Xhon S. Pemberton, dhe dedikimi i parë i saj ka qenë për qëllime mjekësore. Kompania Koka-Kola është themeluar në SHBA në vitin 1886. Fabrikën e parë jashtë SHBA-së, kompania e ka hapur në Kanada, në vitin 1906. Lojërat e para olimpike në të cilat shitet Koka-Kola janë mbajtur në vitin 1928 në Amsterdam. Tashmë në vitin 1940, ajo i ka fabrikat e saj në shumë shtete të botës. Brendi Koka-Kola bëhet i njohur ndërkombëtarisht kur në vitin 1971 është lëshuar reklama ku njerëz të rinj nga gjithë bota janë tubuar dhe këndojnë në Itali. Në vitin 1978, kompania Koka-Kola është kompania e parë jokineze të cilës i është lejuar qasje në tregun kinez. Sot, kompania prodhon 400 brende të ndryshme në 191 shtete (të gjitha shtetet në botë, përveçse në Kubë dhe Korenë e Veriut). Më shumë se 70% e të ardhurave të kompanisë vijnë nga shitja jashtë SHBA-së. Thuajse dy dekada (1991-2012), Meksika është shteti që konsumon më së shumti koka-kola për kokë banori. Dy vite me radhë (viti 2018 dhe 2019), brendi Koka-Kola është shpallur brendi që kontribuon më së shumti drejt akumulimit të mbeturinave të plastikës në suaza botërore.“

Mësimdhënësi nxitë diskutim përmes pyetjeve si vijon:

- ➔ Cilat nga informacionet e përmendura në shembullin bëjnë të ditur se Koka-Kola është kompani globale /brend global? (Përgjigje të mundshme: është themeluar në SHBA, ndërsa shitet në mbarë botën, më së shumti të ardhura vijnë nga shitjet në Meksikë, etj.).
- ➔ A dini për ndonjë kompani tjetër që e shet produktin e saj në më shumë shtete në botë, duke përfshirë edhe Maqedoninë e Veriut? (Përgjigje të mundshme: Nike, Zara, IBM, Apple, Dell, HP, Samsung, Peugeot, Toyota, Nestle, Nikon, IKEA, Facebook...).
- ➔ Cilat janë përparësitë, e cilat mangësitë nga ajo që kjo kompani e shet produktin e saj në tregun e Maqedonisë së Veriut? (Përgjigje të mundshme: përparësi – çmime më të ulëta, përzgjedhje më e madhe, lidhshmëri më e madhe, mangësi – qytetarët nuk i blejnë produktet nga prodhuesit e Maqedonisë së Veriut, prodhuesit kontribuon drejt ndotjes).





- A dini për produkte që prodhohen në Maqedoninë e Veriut, ndërsa shiten në shtete të tjera? (Përgjigje të mundshme: verëra (Tikvesh, Stobi), autobusë (VanHoll), veshje (Tom Tejlor, Maks Mara, Guçi, Hugo Bos), duhan (Kombinati i Duhanit Prilep), mermer (Kombinati i mermerit Prilep), pjesë për automobila (Xhonsen Meti, Kromberg dhe Shubert, Drekselmaer), ilaçe (Alkaloid).

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve dhe nxjerrë konstatim të shkurtër nga diskutimi:

Të gjithë këta shembuj të shitjes së produkteve jashtë shtetit të vet u mundësuan për shkak të faktit se në shoqëritë bashkëkohore është ulur ndikimi i kufijve mes shteteve. Prandaj, kompanitë mund të importojnë dhe eksportojnë më lehtë produkte dhe shërbime, që me një fjalë quhet globalizim.

## *Pjesa kryesore e orës (20 min.)*

Globalizimi është proces në të cilin ekonomitë, shoqëritë dhe kulturat lokale, rajonale dhe kombëtare, bëhen gjithnjë e më të integruara dhe ndërlidhura. Termi globalizim në fakt ka të bëjë me uljen e barrierave dhe kufijve, me çka produkte, shërbime, fuqi punëtore, kapital dhe ide qarkullojnë shumë më lirshëm mes pjesëve të ndryshme të botës. Ky proces ndodhë me shekuj, kështu që tregtia me mëlmesa dhe rruga e mëndafshit janë shembuj historik për atë se si njerëzit kanë udhëtuar në distanca të mëdha për të bashkëpunuar me kultura dhe bashkësi të tjera. Mirëpo, dallimi mes globalizimit në 60 vitet e fundit dhe asaj më parë qëndron në rritjen e konsiderueshme të shpejtësisë me të cilën ndodhin ndryshimet. Prandaj:


- Nëse në vitin 1960 nuk ka ekzistuar telefoni celular, në vitin 2017 në botë ka 4,4 miliardë përdorues të telefonave celularë<sup>14</sup> (foto 15).

14 <https://ourworldindata.org/internet>, <https://www.bankmycell.com/blog/how-many-phones-are-in-the-world>

Foto 15. Numri i përdoruesve të telefonave celularë në botë në vitin 2017, është matur si proporcion në çdo 100 njerëz.

### Mobile cellular subscriptions, 2017

Mobile phone subscriptions, measured as the number per 100 people.



Source: International Telecommunication Union


OurWorldinData.org/technology-adoption/ + CC BY

→ Thuajse gjysma e popullatës në botë ka qasje onlajn (3.5 miliardë), derisa 2.4 miliardë përdorin media sociale<sup>15</sup> (foto 16).

Foto 16. Numri i përdoruesve të mediave sociale, në periudhën mes viteve 2004 dhe 2019.

### Number of people using social media platforms, 2004 to 2019

Estimates correspond to monthly active users (MAUs). Facebook, for example, measures MAUs as users that have logged in during the past 30 days. See source for more details.




Source: Statista and TNW (2019)

CC BY

15 <https://ourworldindata.org/internet>

- Nëse në vitin 1970, brenda vitit me aeroplan kanë udhëtuar 310 milionë udhëtarë, ky numër në vitin 2017 ngjitet në 4.2 miliardë udhëtarë<sup>13</sup> (Foto 17).

Foto 17. Numri i udhëtarëve të cilët kanë udhëtuar me aeroplan në periudhën mes vitit 1970 dhe 2018.



- Sipas jush, cilët janë faktorët , që e mundësojnë globalizimin?
  - Sipas jush, cili faktori është më i rëndësishëm, e cili më së paku i rëndësishëm?
- Nëse ka nevojë, mësimdhënësi i plotëson përgjigjet e nxënësve në raport me faktorët që e mundësojnë globalizimin:
- Komunikacion ajror,
  - Përdorim i gjuhës angleze si gjuhë botërore,
  - Teknologji informatike dhe rrjete sociale,
  - Tregti ndërkombëtare,
  - Lehtësim të rregullave të vizave dhe kontrolleve kufitare.

Mësimdhënësi bën të ditur se ekzistojnë më shumë lloje të globalizimit:

**Globalizimi politik** ka të bëjë me praqitjen e sundimit global përmes organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare. Organizatat ndërkombëtare qeveritare janë organizata të përbëra

16 <https://data.worldbank.org/indicator/IS.AIR.PSGR?end=2018&start=1970&view=chart>

prej shteteve anëtare, siç janë Organizata e Kombeve të Bashkuara, Organizata Botërore e Shëndetësisë ose Banka Botërore. Organizatat ndërkombëtare joqeveritare janë organizata që përbëhen prej organizatave të tjera joqeveritare, fondacioneve, individëve, bizneseve, etj. Shembull për organizata ndërkombëtare joqeveritare është Greenpeace, Mjekë pa kufij, Amnesty...

**Globalizimi kulturor** ka të bëjë me shkëmbimin e rritur të ideve, normave kulturore, vlerave dhe produkteve (ideologji, shkencë, muzikë, letërsi, art, film, gazeta). Prandaj, si rezultat i globalizimit kulturor rritet përdorimi i gjuhës angleze, qasjes deri te mediat masive dhe filmat, ndikimi i fushatave për të drejtat e njeriut, të drejtat e femrave, e fëmijëve, të drejtat e kafshëve dhe mjedisi jetësor.

**Globalizimi ekonomik** ka të bëjë me vendosjen e tregut global, që funksionon në bazë të lirisë së shkëmbimit të mallrave, shërbimeve, fuqisë punëtore dhe kapitalit. Globalizimin ekonomik mund ta ndajmë edhe në: *globalizim industrial* që ka të bëjë me zhvillimin e tregut global të prodhimit, që kërkon qarkullimin e materialit dhe të mirave jashtë kufijve kombëtarë; dhe *globalizimi financiar* që nënkupton zhvillimin e tregjeve botërore financiare dhe qasje më të mirë deri te borxhet e financuara nga jashtë.

**Globalizimi informatik** ka të bëjë me rritjen e zhvillimeve informatike ndërmjet pjesëve të ndryshme të botës. Ky ndryshim teknologjik është mundësuar me anë të komunikimit optik, satelitor, qasjes në internet dhe teknologjisë celulare.

## Aktivitet:

### Lloje të globalizimit (10 min.)

Mësimdhënësi e ndan fletën e punës 5.1. që nxënësit duhet ta plotësojnë në mënyrë të mëvetësishme dhe për këtë kanë pesë minuta. Derisa nxënësit punojnë individualisht, mësimdhënësi i shënon/projekton përgjigjet e sakta në tabelë. Më pas nxënësit kanë edhe pesë minuta për diskutim në çifte lidhur me përgjigjet e tyre dhe dallimet potenciale në qëndrime.

## Fletë pune e plotësuar Shembull për mësimdhënësin

1. Parku argëtues amerikan Diznilend ka hapur parqe në Hong Kong, Japoni dhe Francë. *(ekonomik)*
2. IBM Modeli 350 i njësisë së memories i vitit 1956 ka qenë 152 cm i gjatë, 173 cm i lartë dhe 74 cm i gjerë, me 5MB kapacitet të memories. MicroSD kartela e sotme është me dimensione 15 mm gjatësi, 11mm gjerësi, 1 mm lartësi dhe kapacitet të memories prej 128GB. *(informatik)*



3. Pjesë për automobil janë prodhuar në Gjermani, Japoni, Kore, Maqedoninë e Veriut, ndërsa automobili është kompletuar në Itali. *(ekonomik)*
4. Qendrat për mbështetje të përdoruesve në botë, në masë të madhe përdorin satelitë. Kështu që ai që kërkon informacion dhe i punësuar në qendrën për mbështetje të përdoruesve në të shumtën e rasteve janë në dy vende të ndryshme të botës. Për shembull, dikush nga Kanadaja lajmërohet për informacion për një produkt të caktuar, përgjigje merr nga një i punësuar në qendrën për mbështetje të përdoruesve që gjendet në Rumanë. *(informatike)*
5. Themelimi i forumeve rajonale si Bashkimi Evropian, Bashkëpunimi ekonomik mes Azisë dhe Paqësorit, Bashkimi Afrikan ose organizatave si Organizata Botërore e Tregtisë ose Komiteti Olimpik Ndërkombëtar. *(politik)*
6. BBC (British Broadcasting Service) mund të ndiqet në më shumë se 200 vende dhe territore në botë. *(kulturor)*
7. Shtetet mund të huazojnë para nga institucionet si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. *(ekonomik)*
8. 164 milionë njerëz në botë punojnë në një shtet të ndryshëm nga shteti i tyre. *(ekonomik)*
9. Në vitin 2020, videoja më e shikuar në YouTube ka 6.9 miliardë shikime (Despacito nga Luis Fonsi dhe Daddy Yankee). *(kulturor)*

## Pjesa përfundimtare e orës (10 min.)

Mësimdhënësi i nxitë nxënësit të mendojnë dhe të japin nga një shembull të tyre për të gjitha katër llojet e globalizimit. Pas disa minutave, mësimdhënësi nxitë vullnetarë që t'i ndajnë shembujt e tyre.

## Aktivite për reflektim dhe vlerësim (5 min.)

Mësimdhënësi nxitë diskutim me pyetjet si vijon:

- ➔ Si do të ishte bota nëse do të ndërpritej procesi i globalizimit?
- ➔ A është dikush përgjegjës për procesin e globalizimit ose globalizimi ndodhë spontanisht?

**Shënim:** Mësimdhënësi këto pyetje mund t'i japë edhe si pyetje për reflektim të asaj që është mësuar, të cilave nxënësit do t'u ishin përgjigjur me shkrim në ditarët e tyre për reflektim.

## **Fletë pune 5.1.**

### **Llojet të globalizimit**

Shikoji shembujt e dhënë më poshtë dhe përcakto për çfarë lloji të globalizimit bëhet fjalë (ekonomik, informatik, kulturor ose politik).

1. Parku argëtues amerikan Diznilend ka hapur parqe në Hong Kong, Japoni dhe Francë. \_\_\_\_\_
2. IBM Modeli 350 i njësisë së memories i vitit 1956 ka qenë 152 cm i gjatë, 173 cm i lartë dhe 74 cm i gjerë, me 5MB kapacitet të memories. MicroSD kartela e sotme është me dimensione 15 mm gjatësi, 11mm gjerësi, 1 mm lartësi dhe kapacitet të memories prej 128GB. \_\_\_\_\_
3. Pjesë për automobil janë prodhuar në Gjermani, Japoni, Kore, Maqedoninë e Veriut, ndërsa automobili është kompletuar në Itali. \_\_\_\_\_
4. Qendrat për mbështetje të përdoruesve në botë, në masë të madhe përdorin satelitë. Kështu që ai që kërkon informacion dhe i punësuar në qendrën për mbështetje të përdoruesve në të shumtën e rasteve janë në dy vende të ndryshme të botës. Për shembull, dikush nga Kanadaja lajmërohet për informacion për një produkt të caktuar, përgjigje merr nga një i punësuar në qendrën për mbështetje të përdoruesve që gjendet në Rumani. \_\_\_\_\_
5. Themelimi i forumeve rajonale si Bashkimi Evropian, Bashkëpunimi ekonomik mes Azisë dhe Paqësorit, Bashkimi Afrikan ose organizatave si Organizata Botërore e Tregtisë ose Komiteti Olimpik Ndërkombëtar. \_\_\_\_\_
6. BBC (British Broadcasting Service) mund të ndiqet në më shumë se 200 vende dhe territore në botë. \_\_\_\_\_
7. Shtetet mund të huazojnë para nga institucionet si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. \_\_\_\_\_
8. 164 milionë njerëz në botë punojnë në një shtet të ndryshëm nga shteti i tyre. \_\_\_\_\_
9. Në vitin 2020, videoja më e shikuar në YouTube ka 6.9 miliardë shikime (Despacito nga Luis Fonsi dhe Daddy Yankee). \_\_\_\_\_

# Përmbajtja: Globalizimi dhe shoqëria



## Rezultate nga nxënia

Nxënësi/nxënësja mund të::

- analizojë dhe të ndjekë ndryshimet në shoqëri si rezultat i shkëmbimit të rritur kulturor.



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësja mund të:

- veçon përfitimet dhe pasojat nga globalizimi dhe shkëmbimi kulturor,
- identifikon fushat e ndryshimeve nga globalizimi.



## Materiale të nevojshme:

рабочен лист 5.2.



## Metoda, teknika, forma:

analizë e rasteve, diskutim, punë në grup, tekst metoda.

## Pjesa hyrëse e orës (2 min.)

Mësimdhënësi e fillon orën me përkujtimin se orën e kaluar në fokus kanë qenë përfitimet dhe anët pozitive të globalizimit, derisa në këtë orë do t'i kushtohet vëmendje edhe pasojave të padëshiruara dhe negative nga globalizimi.

## Pjesa kryesore e orës (38 min.)

### Aktivitet:

#### **Sfida dhe pasoja nga globalizimi**

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në 6 grupe dhe secili grup merr nga një tekst (secilin tekst do ta punojnë dy grupe). Nxënësit kanë 5 minuta për ta lexuar tekstin dhe 10-15 minuta për diskutim në grup, në përputhje me pyetjet e dhëna. Gjatë diskutimeve në grup, mësimdhënësi e vëzhgon punën e nxënësve dhe ndihmon nëse ka nevojë. Pas diskutimeve në grup, mësimdhënësi nxitë diskutim në nivel të klasës (në kohëzgjatje prej 10-15 minutave) ku nxënësve u parashtrohen pyetje për shkëmbimin e shembujve dhe ideve.

- ➔ Çfarë sfidash dhe pasojash illustroi shembulli juaj? (Pritet nga nxënësit që shkurtimisht t'i përmbledhin shembujt që i diskutuan).
- ➔ Në çfarë mënyre globalizimi kontribuoi drejt pasojave në shembullin tuaj?
- ➔ Çfarë mund të ndërmarrin shtetet në të cilat ndodhin këta shembuj, në mënyrë që t'i parandalojnë pasojat negative?
- ➔ Në çfarë mënyre ju mund të ndihmoni që të pengohen ose të zvogëlohen sfidat dhe pasojat nga globalizimi?

Përgjigje të mundshme nga nxënësit

#### Shembulli 1. Sa është korrekte industria e tekstit?

- ➔ Sa është korrekte, sipas jush, që Mara paguhet më pak se 1 dollarë në orë dhe punon 10-12 orë? (Përgjigje të mundshme: nuk është korrekte për shkak se pagën që e merr është me të vërtetë e ulët dhe vështirë mund t'i plotësojë nevojat mujore të saj; nuk është korrekte për shkak se për punën e njëjtë, një punëtor në një shtet tjerët paguhet dukshëm më shumë; nuk është korrekte për





shkak se nuk kanë pauzë të mjaftueshme, punojnë gjatë festave, nuk guxojnë të organizohen në sindikata dhe të protestojnë për paga më të mëdha; është korrekte për shkak se kompania mund të zgjedhë të punojë në një shtet tjerët dhe atëherë Mara nuk do të kishte punë.)

- Pse këto kompani të mëdha vendosin që fabrikat e tyre t'i hapin në vende si Kamboxha, Bangladeshi, Maroko, Tajlanda, madje edhe Maqedonia e Veriut? (Pritet nga nxënësit që të tregojnë se disa shtete kanë ligje më pak të rrepta, e me këtë edhe mbrojtje më të vogël të punëtorëve dhe të drejtave të punëtorëve; disa shtete janë më të varfra dhe janë të gatshme të pranojnë çfarëdo kërkesash nga kompanitë, si zëvendësim për vende të punës).
- Në çfarë mënyre konsideroni se ju mund t'u ndihmoni njerëzve si Mara? (Përgjigje të mundshme: të informohemi se cilat kompani u paguajnë paga të vogla të punësuarve dhe të mos blejmë produktet e tyre; t'u shkruajmë kompanive se nuk na pëlqen ajo se çfarë trajtimi kanë ndaj të punësuarve; të bëhemi vullnetar në ndonjë organizatë që mundohet t'u ndihmojë këtyre punëtorëve që të luftojnë për të drejtat e tyre).

#### Shembulli 2. Delta e lumit Niger

- Si është e mundshme që Nigeria e cila është një ndër prodhuesit më të mëdhenj të naftës, njëherësh të jetë një ndër vendet më të varfra? (Pritet nga nxënësit të tregojnë se resurset e Nigerisë si nafta dhe gazi i shfrytëzojnë dhe përdorin kompani private ndërkombëtare, të cilat fitimin e marrin për vete, dhe nuk e investojnë në vetë shtetin; për shkak të korrupsionit, shteti i Nigerisë nuk ka arritur t'i rregullojë këto kompani; ligje të këqija që nuk i mbrojnë qytetarët ose të cilat nuk zbatohen...).
- Sa është, sipas jush, korrekte ajo që Nigeria është një ndër prodhuesit më të mëdhenj të naftës, e njëherësh të jetë një ndër vendet më të varfra? (Përgjigje të mundshme: nuk është korrekte, për shkak se: resurset janë të qytetarëve të Nigerisë; resurset janë të përbashkëta, duhet të ndahen dhe të gjithë të kenë leverdi prej tyre; kompanitë e shfrytëzojnë momentin që këto shtete janë të varfra dhe imponojnë rregullat e tyre; nuk është korrekte meqë kompanitë bëjnë fitim vetëm për vete, e jo për të gjithë. Është korrekte: shteti u ka lejuar kompanive që t'i shfrytëzojnë resurset; shteti ka miratuar ligje të tilla, kompanitë u përmbahen ligjeve, nuk janë kompanitë fajtores nëse ligjet janë të këqija; qytetarët e kanë zgjedhur pushtetin, pra janë dakord me mënyrën në të cilën udhëhiqen punët...).



- ➔ Në çfarë mënyre shkatërrimi i mjedisit jetësor në deltën e lumit Niger është pasojë e procesit të globalizimit? (Pritet nga nxënësit të përgjigjen se globalizimi do të thotë mënjanim të barrierave, kështu që me hapjen e tregut botëror, kompani të një shteti, mund të vijnë dhe të punojnë ose të shfrytëzojnë resurse të një shteti tjetër; kompanitë zgjedhin të punojnë në shtete në të cilat ka më së paku rregulla, ndërsa shtetet, nga ana tjetër, i ulin rregullat në mënyrë që të tërheqin kompani...).
- ➔ Sa është korrekte që të sakrifkohet mjedisi jetësor për interes ekonomik? (Përgjigje të mundshme: nuk është korrekte për shkak se shkatërrimi i mjedisit jetësor ka ndikim te të gjithë ne, ndërsa fitimi është vetëm për kompanitë; ska përfitim në botë që është aq i rëndësishëm nëse ne e shkatërrojmë mjedisin jetësor, për shkak se dëmi është i papërmirësueshëm; shkatërrimi i mjedisit jetësor do të thotë vetëshkatërrim. Është korrekte për shkak se disa vende janë me të vërtetë të varfra dhe përdorimi i resurseve natyrore mund t'i nxjerrë nga varfëria; natyra e bukur nuk paraqet asgjë, nëse nuk mund t'i plotësosh nevojat themelore; shtetet perëndimore përparimin e tyre e arritën duke shkatërruar mjedisin jetësor, nuk është korrekte që shteteve më pak të zhvilluara tani t'u kufizohet zhvillimi për shkak të dëmit që e kanë bërë shumë shtete të zhvilluara).

### Shembulli 3. Zhdukje e gjuhëve botërore

- ➔ Në çfarë mënyre globalizimi kontribuon në shuarjen e një pjese të gjuhëve botërore? (Përgjigje të mundshme: me rritjen e bashkëpunimit ekonomik, rritet nevoja për komunikim efikas, kështu që një ose disa gjuhë që i flasin të gjithë, në vend se shumë gjuhë që i flasin grupe më të vogla është metodë më efikase e komunikimit; shkrimtarët, punëtorët e filmit madje edhe muzikantët, për të pasur publik më të madh krijojnë në një ose në disa gjuhë që i përzgjedhë pjesa më e madhe e popullatës botërore, përballë krijimit në gjuhën e tij, që është e kuptueshme për një publik më të vogël).
- ➔ Pse nuk duhet të lejojmë shuarjen e gjuhëve të ndryshme që fliten nëpër botë? (Përgjigje të mundshme: gjuha është pjesë e rëndësishme e identitetit dhe kulturës së bashkësive të ndryshme, përmes gjuhës barten zhvillimet historike dhe politike të bashkësive të ndryshme, gjuha dëshmon për përvojat kolektive...).
- ➔ Në çfarë mënyre ju mund të ndihmoni që të ruhen gjuhët që janë të rrezikuara nga shuarja? Përgjigje të mundshme: duke mësuar gjuhën, duke ndihmuar që e njëjta të shkruhet, me mbështetjen për shkrimtarë dhe punëtorë kulturorë që krijojnë në gjuhë të ndryshme, etj.).

## *Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (5 min.)*

Nëse ka kohë në orë, mësimdhënësi nxitë diskutim. Pyetjet e njëjta mund t'u jepen nxënësve që të përpilojnë projekt për detyrë shtëpie.

- ➔ Sipas jush, a ka globalizimi më tepër përparësi ose mangësi? Sqaroni.
- ➔ Cilat sfida dhe pasoja nga globalizimi i ndejmë në Maqedoninë e Veriut?

## **Fletë pune 5.2.**

### **Sfida dhe pasoja nga globalizimi**

#### **Shembulli 1. Sa është korrekte industria e tekstit?**

Mara është një prej miliona punëtorëve të cilët punojnë në fabrika për veshje sportive nëpër botë. Fabrika në të cilën punon ajo gjenden në Pnom Pen, kryeqytetin e Kamboxhias. Puna e saj përbëhet prej qepjes së tutave sportive. Punëdhënësi i saj pret që Mara të qepë 120 palë tuta për një orë ose rreth 960 palë në ditë. Për punën e saj, Mara është e paguar 75 centë në orë, ndërsa punon për 10-12 orë në ditë, ndonjëherë edhe në ndërrim të natës. Brendet e mëdha sportive nuk çelin fabrika në shtetet e zhvilluara perëndimore për shkak se mudi për punën e bërë pagohet dukshëm më shtrenjtë. Sa për krahasim, në vitin 2012 paga mesatare e paguar për punëtor në industrinë e tekstit në Norvegji ka qenë 63 dollarë, në Suedi 58 dollarë, në SHBA 36 dollarë, në Britania e Madhe 31 dollarë<sup>4</sup>. Këto kompani për të kursyer në shpenzime për prodhimtari, vendosin t'i çelin fabrikat e tyre në shtete si Kamboxhia, Bangladeshi, Maroko, Tajlanda, madje edhe Maqedonia e Veriut.

Ndonëse është fakt pozitiv që këta punëtorë kanë mundësi të punojnë, megjithatë këta punëtorë pësojnë padrejtësi të mëdha dhe kushte johumane për punë.

Përveç asaj që Mara merr mes 3 dhe 6 herë pagë më të vogël në krahasim me një punëtor në shtetet perëndimore që e ushtron punën e njëjtë, paga Marës i shkurtohet në mënyrë plotësuese nëse nuk e arrin kuotën ditore, ajo ka pauza shumë të shkurtra për drekë dhe për nevojat fiziologjike, punon për festa, punon më shumë orë sesa dita jonë mesatare, nuk guxon të organizohet në sindikatë, e as të protestojë për të drejta më të mëdha.

#### **Pyetje për diskutim:**

- ➔ Sa është korrekte, sipas jush, që Mara është e paguar më pak se 1 dollar në orë dhe punon nga 10-12 orë?
- ➔ Pse këto kompani të mëdha vendosin që fabrikat e tyre t'i çelin në vende si Kamboxhia, Bangladeshi, Maroko, Tajlanda, madje edhe Maqedonia e Veriut?
- ➔ Në çfarë mënyre konsideroni se ju mund t'u ndihmoni njerëzve si Mara?

.....



## Shembulli 2. Delta në lumin Niger<sup>18</sup>

Kompania amerikane Shell punon në deltën e lumit Niger në Nigeri që nga vitet e 30-ta të shekullit të kaluar. Ndonëse tani Nigeria është demokraci, ky shtet ka një histori të gjatë brutale diktatoriale ushtarake. Më parë në rrethinën e deltës së lumit Niger tokat bujqësore kanë qenë më pjellore, ndërsa për shkak të vetë lumit ka pasur sasi të mëdha të peshqve në dispozicion të qytetarëve. Këtu ka qenë njëri prej ekosistemeve më të pasura, me florë dhe faunë unike. Në pjesën jugore të Deltës është zona Ogoniland, ku jetojnë gjysmë milionë ogonë.

Nigeria është prodhuesi më i madh i naftës në Afrikë dhe prodhuesi i 11-të më i madh në botë. Mirëpo, banorët e Nigerisë nuk kanë përfitim ekonomik nga shfrytëzimi i rezervave të naftës dhe Nigeria është njëri prej vendeve më të varfra të botës. Si është kjo e mundshme?

Gjysma e prodhimit të ditore të naftës në Nigeri është prodhuar nga Shell-i. Shell operon në Nigeri përmes kompanisë së përbashkët të formuar mes Shell-it dhe Qeverisë Nigeriane që quhet Shell Petroleum kompani zhvillimore. Kjo kompani posedon më shumë se 90 fusha të naftës, ose më shumë se 30 000 km<sup>2</sup> që gjendet në lumin Niger. Për nxjerrjen e naftës dhe gazit, ekziston rrjeti metuba i gjatë më shumë se 6 000 km, 7 platforma për gaz, 86 stacione lundruese dhe objekte të tjera.

Shell-i dhe kompanitë tjera e kanë shkretuar deltën e lumit Niger, për shkak të rrjedhjes së naftës dhe djegies së gazit. Popullata rreth lumit Niger vuan nga probleme të ndryshme shëndetësore, ndërsa toka është ndotur rëndë. Djegia e gazit ndërlidhet me probleme më të ndryshme shëndetësore si astma, kolli, frymëmarrje e rëndë dhe me dhimbje, bronkit kronik, etj. Jetëgjatësia e njerëzve të këtij rajoni është rreth 40 vjet.

Një nga pasojat ekologjike të djegies së gazit në deltën e Nigerit është "shiu acidik", i cili krijohet kur dioksidi i squfurit dhe oksidi i azotit i prodhuar nga djegia e gazit bien në kontakt me lagështinë e atmosferës. Ky lloj shiu "acidifikon" liqenet dhe burimet dhe shkatërron vegjetacionin. Përveç kësaj, e përshpejton dekompozimin e materialeve ndërtimore dhe në këtë mënyrë dëmton vendbanimet e qytetarëve.

### **Pyetje për diskutim:**

- ➔ Si është e mundshme që Nigeria, e cila është një nga prodhuesit më të mëdhenj të naftës, njëherësh të jetë një nga vendet më të varfra?
- ➔ Sa është korrekte, sipas jush, që Nigeria është një nga prodhuesit më të mëdhenj të naftës, e njëherësh është një nga vendet më të varfra?
- ➔ Sipas jush, si , shkatërrimi i mjedisit në deltën e lumit Niger është një pasojë e procesit të globalizimit?
- ➔ Sa është korrekte që të sakrifikosh mjedisin jetësor për përfitime ekonomike?

<sup>18</sup> [https://www.foeeurope.org/publications/2009/0verconsumption\\_Sep09.pdf](https://www.foeeurope.org/publications/2009/0verconsumption_Sep09.pdf)

### Shembull 3. Zhdukja e gjuhëve të botës

Njerëzimi sot po përballet me një humbje të madhe, gjuhët po zhduken me një shpejtësi të jashtëzakonshme. Prandaj, mbi 40% nga 7,000 gjuhë në botë që ne e dimë se ekzistojnë janë të kërcënuara me zhdukje, sipas Projektit të gjuhëve të rrezikuara<sup>19</sup>.

Sipas linguistëve, me çdo gjuhë që vdes ne humbasim një trashëgimi të madhe kulturore, gjuha shpjegon se në çfarë mënyre bashkësi të tëra komunikojnë, fshehtë njohuri shkencore, mjekësore, politike, mënyrën në të cilën bashkësitë shprehin humor dhe dashuri. Shkurtimisht, me zhdukjen e një gjuhe, ne e humbasim dëshminë e jetës nëpër shekuj.

Hulumtuesit së pari kanë përcaktuar listën e gjuhëve të rrezikuara, duke përdorur disa kritere si për shembull popullatën e vogël që e flet gjuhën, një rënie e madhe e popullsisë që flet gjuhën dhe një shtrirje e vogël gjeografike e popullsisë që flet gjuhën.

Hulumtimi<sup>20</sup> ka treguar se një numër i madh i gjuhëve të rrezikuara gjenden kryesisht në rajone të zhvilluara ekonomike, të tilla si Amerika Veriperëndimore, Evropa dhe Australia, si dhe rajone që shënojnë rritje të shpejtë ekonomike. Ata kanë shqyrtuar lidhshmërinë mes kërcënimit për zhdukjen e gjuhës dhe një numër të madh faktorësh, mes tjerash edhe ndikimin e mjedisit jetësor, por këta faktorë janë nën hijen e faktorëve social, politik dhe ekonomik. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)<sup>21</sup> për kokë banori është faktori nga i cili varet më së shumti se sa është rreziku i zhdukjes së një gjuhe, gjë që nga ana tjetër është rezultat i proceseve socio-ekonomike që shfaqen si pjesë e globalizimit.

Hulumtuesit shpjegojnë se me zhvillimin e ekonomisë, një gjuhë shpesh bëhet dominuese në sferën politike dhe arsimore të vendit. Njerëzit praktikisht janë të detyruar ta përdorin këtë gjuhë, në mënyrë që të mos anashkalojnë nga zhvillimet politike dhe ekonomike, në kurriz të gjuhëve të tyre.

Për shembull, kur kolonialistët evropianë mbërritën në vitet 1700, në territorin e Australisë fliteshin më shumë se 300 gjuhë. Sot, mendohet se kanë mbijetuar vetëm rreth 90 gjuhë, 60 prej të cilave konsiderohen të gjalla dhe janë në përdorim të përditshëm. Australia renditet në vendin e 11-të sa i përket PBB-së për kokë banori.

#### **Pyetje për diskutim:**

- ➔ Në çfarë mënyre globalizimi kontribuon në zhdukjen e një pjese të gjuhëve të botës?
- ➔ Pse nuk duhet të lejojmë zhdukjen e gjuhëve të ndryshme që fliten nëpër botë?
- ➔ Në çfarë mënyre mund të ndihmoni në ruajtjen e gjuhëve që janë të rrezikuara nga zhdukja?

19 Projekti për gjuhët e rrezikuara. I arritshëm në: <http://www.endangeredlanguages.com/about/>

20 Global distribution and drivers of language extinction risk <https://royalsocietypublishing.org/doi/full/10.1098/rspb.2014.1574#d3e718>

21 Produkti i brendshëm bruto është vlera totale e tregut e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të prodhuara në një vend për një periudhë kohore (zakonisht një vit).

# Përmbajtja: Republika e Maqedonisë së Veriut në organizatat ndërkombëtare



## Rezultate nga nxënia

Nxënësi/nxënësja mund të::

- ➔ Identifikon pozitën dhe dallon përfitimet e RMV-së në organizatat ndërkombëtare



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ numëron organizatat ndërkombëtare në të cilat RMV-ja është anëtare
- ➔ përshkruam rolin konkret të organizatave ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në zgjidhjen e problemeve globale në shoqëri



## Materiale të nevojshme:

fletë pune 5.3. (e prerë në kartonë më të vegjël), gërshërë, letër, ngjyra



## Metoda, teknika, forma:

diskutim, punë në grupe, punë në çifte, nxënie përmes lojës.

## Pjesa hyrëse e orës (15 min.)

### Aktivitet:

#### **Pse duhet të bashkëpunojmë?**

Nxënësit duhet të ulen në çifte nga dy vetë, në atë mënyrë që ia kthejnë shpinën njëri-tjetrit. Secili nxënës merr një simbol të një organizate ndërkombëtare (nga fleta e punës 5.3.) dhe duhet t'i japë udhëzime nxënësit tjetër se si të vizatojë simbolin. Nëse e di, nuk guxon të thotë emrin e organizatës simbolin e së cilës e përshkruan, ndërsa duhet të përpiqet të japë udhëzime të qarta dhe përshkrime të hollësishme. Pas pesë minutash, aktiviteti mbaron dhe mësuesi fton nxënësit të krahasojnë dhe ndajnë simbolin e vërtetë dhe atë të vizatuar dhe nxitë diskutim sipas pyetjeve si vijon:

- ➔ Çfarë ju ndihmoi më së shumti gjatë vizatimit?
- ➔ Në çfarë problemesh keni hasur?
- ➔ Si tentuat që t'i zgjidhni ato?

Qëllimi i diskutimit është të tregohet rëndësia e bashkëpunimit dhe komunikimit për një kuptim më të mirë të ndërsjellë dhe shkëmbim përkatës të informacionit. Sa më suksesshëm që komunikojnë nxënësit në çifti, përcjellin informacionin në mënyrë përkatëse, i dëgjojnë mirë ata, pyesin për detaje, etj., aq më i mirë do të jetë rezultati (fotografia e vizatuar). Parimi i njëjtë vlen edhe për bashkëpunimin mes vendeve në botë. Me globalizimin dhe shkëmbimin e informacioneve, mallrave dhe shërbimeve në një nivel global, nevojiten aftësi gjithnjë e më të mira të komunikimit të ndërsjellë mes shteteve, në mënyrë që të sigurohet bashkëpunim i suksesshëm, të zvogëlohen keqkuptimet dhe të parandalohen konfliktet.

Në botë ekzistojnë 193 shtete. Ashtu siç ne në vendin tonë bashkëpunojmë mes vete për të arritur përparim, ashtu edhe shtetet në të gjithë botën bashkëpunojnë në mënyrë që të përparojnë bashkësitë e tyre. Në mënyrë që të bashkëpunojnë më mirë me njëri-tjetrin, shtetet bashkohen në organizata ndërkombëtare.

## *Pjesa kryesore e orës (20 min.)*

Mësimdhënësi e fillon pjesën kryesore të orës me një diskutim të shkurtër, sipas pyetjeve si vijon:

- ➔ Pse është e nevojshme që shtetet të bashkohen në organizata ndërkombëtare?
- ➔ Çfarë ndodh me sovranitetin e shteteve, gjatë anëtarësimit të tyre në organizata ndërkombëtare?

Nxënësit përkujtohen për termin sovranitet dhe sqarohet se çfarë ndodhë me sovranitetin e shtetit kur anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare:

Pushteti sovran i shtetit në thelb do të thotë se ai është autoriteti më i lartë politik në një shtet që merr vendime në mënyrë të mëvetësishme. Në një shtet nuk mund të ketë më shumë autoritete sovrane, për shembull dy parlamente, dy qeveri, dy gjyqësorë, që kanë të drejtë të vendosin për të gjithë qytetarët. Shtetet sovrane nuk duhet të përzihen në punët e brendshme të shteteve të tjera sovrane.

Megjithatë, në mënyrë që organizatat ndërkombëtare të mund të funksionojnë, shtetet heqin dorë nga një pjesë e vogël e sovranitetit të tyre, gjegjësisht e drejta për të vendosur dhe i japin trupit të organizatës ndërkombëtare të vendosë në emrin e tyre të përbashkët. Për shembull, vendimet e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara janë të detyrueshme për vendet anëtare të kësaj organizate. Kjo do të thotë se kur Këshilli i Sigurimit vendos që një vend duhet të dënohet për shembull, për shkak të mosrespektimit të të drejtave të njeriut, të gjitha vendet duhet t'i binden. Meqë shtetet janë pajtuar që për këto çështje në emër të të gjithëve të vendosë Këshilli i Sigurimit, ato praktikisht kanë hequr dorë nga një pjesë e sovranitetit të tyre, gjegjësisht kanë hequr dorë nga e drejta që vetë të marrin vendime për këto çështje.

Mësimdhënësi thekson se ekzistojnë dy lloje të organizatave ndërkombëtare: organizata ndërkombëtare qeveritare dhe organizata ndërkombëtare joqeveritare, ndërsa ora që vijon u kushtohet organizatave qeveritare ndërkombëtare.

Dallimi kryesor është se organizatat qeveritare ndërkombëtare përbëhen prej shteteve që kanë vendosur të bashkëpunojnë. Organizatat ndërkombëtare joqeveritare, nga ana tjetër, përbëhen nga organizatat kombëtare joqeveritare ose nga grupe qytetarësh që kanë një qëllim të përbashkët, pa marrë parasysh se nga cila pjesë e botës vijnë. Shembuj për organizatat joqeveritare ndërkombëtare janë: Amnesty International, Human Rights Watch, World Wildlife Fund, PETA, Greenpeace, etj.

Ekzistojnë shumë arsye pse shtetet formojnë organizata ndërkombëtare:

- Në mënyrë që të zvogëlohen konfliktet dhe mosmarrëveshjet, e me këtë edhe luftërat dhe dhuna mes shteteve;
- Me forca të përbashkëta, të zgjidhin një problem që është i përbashkët, e që secili vend nuk mund ta zgjidhë vetë;
- Me resurse të përbashkëta të avancojnë një fushë të caktuar profesionale;
- Të fitohet më shumë fuqi ekonomike ose ushtarake;
- Shtetet e fuqishme formojnë dhe marrin pjesë në organizata ndërkombëtare në mënyrë që të ndikojnë në shtetet më pak të fuqishme për të miratuar politika ose marrëveshje që janë në interes të tyre;
- Shtetet më pak të fuqishme bëhen aleate me shtetet e tjera, dhe në këtë mënyrë, së bashku bëhen më të fuqishme, me ndikim dhe janë në gjendje t'u kundërvihen shteteve më të fuqishme.

### **Aktivitet:**

#### ***Ndërlidhja e organizatave ndërkombëtare (15 min.)***

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup i merr materialet nga fleta e punës 5.3. që përfshin simbolin/logon e organizatave ndërkombëtare, emrin e plotë, përshkrimin e organizatës. Printohen aq fletë pune, sa ka edhe grupe, priten në katrore individuale dhe bëhen aq pako sa ka edhe grupe. Secili grup merr një pako me materiale dhe duhet secilin përshkrim ta ndërlidhë me simbolin e organizatës përkatëse ndërkombëtare, dhe të thotë nëse Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e asaj organizate. Secili grup prezanton nga dy organizata ndërkombëtare, ndërsa mësimdhënësi konfirmon nëse ndërlidhja e simbolit, emrit dhe përshkrimit është e përshtatshme.

## *Pjesa përfundimtare e orës dhe aktivitet për reflektim (5 min.)*

- ➔ Çfarë është më mirë, nëse shtetet bashkëpunojnë mes vete përmes organizatave ndërkombëtare ose nëse secili kujdeset për interesat personal, jashtë organizatave ndërkombëtare? Pse konsideroni kështu? (Argumente të mundshme për bashkëpunim në kuadër të organizatave ndërkombëtare janë dhënë në hyrjen e pjesës kryesore. Argumentet e mundshme për veprim jashtë organizatave ndërkombëtare: interesat e shtetit dhe qytetarëve tuaj janë më të rëndësishëm sesa ato të vendeve ose organizatave të tjera; organizatat ndërkombëtare janë gjithnjë e më shumë nën ndikimin e shteteve të mëdha, etj.).
- ➔ Cilat janë përfitimet nëse Maqedonia e Veriut është anëtare e organizatave ndërkombëtare? (Përgjigje të mundshme: ka mundësinë të bashkëpunojë me vende të tjera për probleme të përbashkëta; do të mund të vendosë për çështje ndërkombëtare që e interesojnë; bashkëpunimi përmes organizatave ndërkombëtare do të avancojë ekonominë dhe demokracinë, etj.).

## Fletë pune 5.3.

### Ndërlidhje e organizatave ndërkombëtare

Simbol/Logo	Emër i organizatës/ A është RMV anëtare?	Përshkrim
	Këshilli i Evropës / Council of Europe (CoE)  RMV-ja është anëtare	Kjo organizatë ndërkombëtare është një organizatë udhëheqëse për të drejtat e njeriut, demokraci dhe sundimin e së drejtës në Evropë. Falë përpjekjeve të kësaj organizate, dënimi me vdekje më nuk zbatohet në asnjë nga 47 shtetet anëtare.
	Organizata Botërore e Shëndetësisë/World Health Organization (WHO)  RMV-ja është anëtare	Kjo organizatë ndërkombëtare punon në promovimin dhe avancimin e shëndetit të popullsisë në botë, angazhohet për mbrojtje universale shëndetësore dhe u shërben kategorive më të rrezikuara të qytetarëve. Me mbështetjen e programeve për imunizim nga ana e kësaj organizate, më shumë se 1 miliard fëmijë janë vaksinuar në dekadën e fundit. Prandaj, thujse janë eliminuar fruthi dhe paraliza fëmijërore në përmasa botërore, ndërsa në disa pjesë të botës është eliminuar malaria.
	Organizata e Kombeve të Bashkuara/United Nations (UN)  RMV-ja është anëtare	Kjo organizatë ndërkombëtare ka për qëllim të mirëmbajë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, të zhvillojë marrëdhënie miqësore midis shteteve, të zgjidhë probleme të përbashkëta përmes bashkëpunimit ndërshtetëror, të mbrojtë të drejtat e njeriut, të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm, të mundësojë qasje deri te ndihma humanitare dhe të promovojë të drejtën ndërkombëtare. Numëron 193 anëtarë dhe është themeluar në vitin 1945, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Nën kuadër të saj, janë realizuar 72 misione paqeruajtëse, nën patronazhin e saj janë lidhur 172 marrëveshje paqësore, me të cilat në të shumtën e rasteve i është dhënë fund luftës dhe janë lidhur më shumë se 300 marrëveshje ndërkombëtare për tema nga mbrojtja e mjedisit jetësor e deri te përdorimi i hapësirës (gjithësisë).





Organizata Botërore e Tregtisë / World Trade Organisation (WTO)

RMV-ja është anëtare

Kjo organizatë ndërkombëtare ka për qëllim të mundësojë që tregtia midis shteteve të zhvillohet në mënyrë të papenguar, të lirshme dhe të parashikueshme, përmes përcaktimit të rregullave për tregti. Që nga themelimi i saj në vitin 1995 e deri më sot, në kuadër të kësaj organizate janë zgjidhur më shumë se 500 konteste midis 164 shteteve anëtare të saj, në vend se shtetet të përfshihen në luftëra destruktive tregtare mes vete.



Fondi për fëmijë i Kombeve të Bashkuara / The United Nations International Children's Fund (UNICEF)

RMV-ja është anëtare

Kjo organizatë punon në shpëtimin e jetës së fëmijëve, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe realizimin e potencialit të fëmijëve. Me mbështetjen e kësaj organizate, më shumë se 40% e fëmijëve në botë janë vaksinuar, me çka janë shpëtuar më shumë se 3 milionë jetë të fëmijëve në vit. Kjo organizatë ka ndihmuar në uljen e përqindjes së fëmijëve të moshës shkollore që nuk vijojnë shkollën nga 18% në 8% në përmasa botërore.



United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization

Organizata e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kombeve të Bashkuara / The United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO)

RMV-ja është anëtare

Kjo organizatë ndërkombëtare është themeluar si përgjigje ndaj racizmit dhe dhunës antisemitike që ishte shumë e pranishme në Luftën e Dytë Botërore. Sipas kësaj organizate, bashkëpunimi ekonomik dhe politik midis shteteve nuk është i mjaftueshëm për paqe afatgjate midis shteteve, por nevojitet dialog dhe mirëkuptim midis qytetarëve të këtyre shteteve. Prandaj, organizata ka për qëllim të përmirësojë qasjen e çdo fëmije dhe qytetari në arsim cilësor, në veglat për të luftuar urrejtjen dhe jotolerancën, të promovojë trashëgiminë kulturore dhe barazinë mes të gjitha kulturave, të mbështesë shkencën si një platformë për bashkëpunim dhe zhvillim, të mbështesë qarkullimin e lirë të ideve dhe shkëmbimin e diturive, mbrojtjen e shprehjes. Nën mbrojtjen e kësaj organizate janë zona prej 10 milionë km<sup>2</sup>, ekuivalente me madhësinë e sipërfaqes së Kinës. Vetëm një zonë në Maqedoninë Veriore është në listën e zonave të mbrojtura të kësaj organizate ndërkombëtare, e ky është rajoni i Ohrit.



Organizata Evropiane  
për Hulumtim Bërthamor  
/ European Organization  
for Nuclear Research  
(CERN)

RMV-ja nuk është  
anëtare

Kjo organizatë në thelb është një laborator hulumtues. Hulumtuesit në këtë organizatë kanë zbuluar Grimcën e Higsit, në kuadër të saj funksionon Përplasësi i Madh i Hadronit, aty janë krijuar atomet e para antimateriale dhe Tim Berners-Li, një shkencëtar britanik i cili punoi në këtë organizatë në vitin 1989 e shpiku internetin.



Komiteti Ndërkombëtar  
i Kryqit të Kuq /  
International Committee  
of the Red Cross (ICRC)

RMV-ja është anëtare

Kjo organizatë ndërkombëtare ndihmon njerëzit që jetojnë në vende të përfshira në luftë ose në të cilat ka dhunë dhe angazhohet për respektimin e së drejtës që rregullon sjelljen midis palëve ndërluftuese në një luftë. Kjo organizatë ofron ndihmë mjekësore në kohë lufte, mbrojtje për robërit e luftës, kujdes për popullatën civile të prekur nga lufta, ndihmon në krijimin e lidhjeve familjare midis refugjatëve dhe personave të zhvendosur nga lufta. Kjo organizatë tre herë ka fituar Çmimin Nobel.



Organizata e Traktatit të  
Atlantikut të Veriut  
/ North Atlantic Treaty  
Organisation (NATO)

RMV-ja është anëtare

Kjo organizatë është në thelb një aleancë ushtarake. Në rast se një shtet anëtar sulmohet, shtetet e tjera janë të detyruara ta ndihmojnë atë. Ky quhet parimi i sigurisë kolektive. Qëllimi fillestar i kësaj organizate pas formimit të saj ishte bashkimi dhe forcimi i përgjigjes ushtarake të fuqive perëndimore ndaj invadimit të mundshëm të Evropës Perëndimore nga Bashkimi Sovjetik dhe partnerët e Traktatit të Varshavës.



Lidhja Postale Botërore  
/ Universal Postal Union  
(UPU)

RMV-ja është anëtare

Kjo organizatë është organizata e dytë më e vjetër ndërkombëtare në botë. Ajo u themelua në vitin e largët 1874, ndërsa ekziston edhe sot. Falë kësaj organizate, letra juaj shumë më shpejt dhe më lehtë mund të mbërrijë në skajin tjetër të botës.

# Përmbajtja: Republika e Maqedonisë së Veriut në organizatat ndërkombëtare



## Rezultate nga nxënia

Nxënësi/nxënësja mund të::

- Identifikon pozicionin dhe dallon përfitimet e RMV-së në organizatat ndërkombëtare



## Standarde/tregues

Nxënësi/nxënësja mund të:

- përshkruan rolin konkret të organizatave ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në zgjidhjen e problemeve globale në shoqëri
- sqaron procedurat për pjesëmarrje në projekte konkrete (p.sh. për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mjedisit jetësor, etj.)
- identifikon mekanizmat për sigurimin e mbështetjes së RMV-së nga organizatat ndërkombëtare.



## Materiale të nevojshme:

Fletë pune 5.4., fletë pune 5.5.



## Metoda, teknika, forma:

punë në grupe, analizë e rastit dhe simulim, diskutim në grup

## ***Pjesa hyrëse e orës (15 min.)***

Mësimdhënësi fillon orën, në atë mënyrë që i pyet nxënësit nëse kanë dëgjuar për Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Nëse dikush është i njoftuar, mësimdhënësi kërkon të sqarojë se çfarë di për qëllimet dhe për cilat prej qëllimeve ka njohuri.

Mësimdhënësi bën përmbledhjen se qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm janë vendosur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në vitin 2015 nga të gjitha 193 vendet anëtare, duke përfshirë edhe Maqedoninë e Veriut. Ato përmbajnë një listë të 17 fushave që duhet të avancohen deri në vitin 2030, me qëllim që t'i jepet fund varfërisë ekstreme, të sigurohet një ardhmëri e qëndrueshme dhe zhvillim i planetit tonë dhe të mundësohet që të gjithë njerëzit të gëzojnë paqe, drejtësi dhe prosperitet të barabartë. Në përputhje me fushat e ndryshme që i përfshijnë qëllimet, organizatat në kuadër të KB-së mbështesin projekte/programe që kontribuojnë drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara. Projektet zbatohen nga organizata të ndryshme civile, në bashkëpunim me institucionet shtetërore, si dhe sektorin e biznesit.

### ***Aktivitet:***

#### ***Roli i organizatave ndërkombëtare në zgjidhjen e problemeve globale në shoqëri***

Nxënësit ndahen në grupe, prej të cilave secili grup merr për detyrë të shqyrtojë dhe punojnë në një shembull të projekteve të dhëna në fletën e punës 5.4. Grupet duhet të shënojnë drejt cilit nga qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm synojnë projektet, e më pas para gjithë klasës t'i arsyetojnë përgjigjet. Mësimdhënësi ndan "çelësin" me përgjigje me secilin prej grupeve.

Për mësimdhënësin

#### ***qëllime për zhvillim të qëndrueshëm sipbujve***

**Shembulli 1.** Qëllime: 1, 4, 5

**Shembulli 2.** Qëllime: 3, 10

**Shembulli 3.** Qëllimi: 16

**Shembulli 4.** Qëllime: 6, 11

**Shembulli 5.** Qëllime: 5, 10, 16

**Shembulli 6.** Qëllime: 1, 7, 13

Mësimdhënësi thekson se organizatat e ndryshme në kuadër të OKB-së investojnë bashkërisht në arritjen e qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe në këtë mënyrë ndihmojnë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zgjidhjen e problemeve globale. Ai tregon se në pjesën tjetër të orës do të përqendrohen në një shqyrtim më të hollësishëm të institucioneve të OKB-së dhe mënyrave në të cilat ata mund të veprojnë në zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare dhe krijimin e kushteve për paqe globale.

## *Pjesa kryesore e orës (30 min.)*

Të gjithë 193 anëtarët e OKB-së janë pjesë e **Asamblesë së Përgjithshme** ku ata në esencë diskutojnë për çështje të ndryshme. Kjo Asamble është më e afërta që e kemi deri në Asamblenë botërore. Secili shtet, pavarësisht nëse është i madh apo i vogël, i pasur apo i varfër, nga veriu ose jugu, ka nga një votë. Ngjashëm si edhe anëtarët e Kuvendit tonë, ashtu edhe përfaqësuesit e vendeve anëtare në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së takohen dhe marrin vendime. Dallimi qëndron në atë se vendimet e Kuvendit tonë quhen ligje dhe janë të detyrueshme për qytetarët e shtetit tonë, ndërsa vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së quhen rezoluta dhe të njëjtat janë në nivelin e rekomandimeve për vendet anëtare.

**OKB-ja ka sekretar** të përgjithshëm të cilin e zgjedhin shtetet anëtare, e detyra e të cilit është të përfaqësojë organizatën, por edhe të mbrojë interesat e qytetarëve të botës, ndonjëherë çmimi është që t'i kundërshtojë shtetet anëtare.

Në kuadër të OKB-së, funksionon edhe **Këshilli i Sigurimit**, detyra kryesore e të cilit është ruajtja e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Ka 15 shtete anëtare, 5 prej të cilave janë anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit: Kina, Franca, Rusia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. 10 anëtarët e tjerë zgjidhen çdo dy vjet. Vendimet e Këshillit të Sigurimit janë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare. Kur ka konflikt midis dy ose më shumë vendeve, Këshilli i Sigurimit në të shumtën e rasteve së pari u bën thirrje palëve që të merren vesh në mënyrë paqësore mes vete se si të tejkalojnë konfliktin, në të shumtën e rasteve përmes bisedimeve. Nëse shpërthen lufta, atëherë Këshilli përpiqet të vendosë armëpushim midis palëve. Ndërkohë, derisa zgjatë lufta ose dhuna, Këshilli mund të vendosë që të dërgojë një mision paqeruajtës, në mënyrë që të rivendosë paqen dhe të mbrojë popullatën civile. Misionet paqësore duhet doemos të jenë neutrale ndaj të gjitha palëve ndërluftuese dhe ushtarët që janë pjesë e misioneve guxojnë të qëllonjë vetëm në vetëmbrojtje.

**Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë** është edhe një organ i OKB-së. Kur shtetet kanë mosmarrëveshje të ndërsjellë, ato mund të shkojnë para kësaj gjykate dhe ajo të vendosë se kush ka të drejtë.

## Aktivitet:

### **Hapa drejt paqes (25 min.)**

Nxënësit ndahen në 3 grupe, secili grup përfaqëson një shtet në Këshillin e Sigurimit: Franca, Kina dhe Afrika e Jugut. Secili grup ka nga 15 minuta për të lexuar situatën dhe për të plotësuar tabelën në fletën e punës 5.5. Grupeve u janë ofruar edhe zgjidhje të mundshme, nga të cilat ata mund të zgjedhin një ose më shumë, por duhet të dinë të arsyetojnë zgjedhjen e tyre.

Mënyra e prezantimit është si vijon: për problemin e parë, zgjidhje prezantojnë të gjitha grupet njëra pas tjetrës. Çdo prezantim individual zgjatë më së shumti 2 minuta. Pasi të prezantohen të gjitha zgjidhjet për problemin, vijon një diskutim prej 1 minute në grupet se për cilin propozim të votojnë, pas çka kalohet në votim. Secili grup (shtet) ka të drejtën e një vote dhe nuk mund të votojë për propozimin e vet.

## **Pjesa përfundimtare e orës dhe reflektim (5 min.)**

Mësimdhënësi i shkruan/projekton në tabelë pyetjet si vijon, të cilave nxënësit në çifte duhet të përpiqen t'u përgjigjen, pas çka i krahasojnë përgjigjet me çiftet tjera.

- ➔ Në çfarë mënyre OKB-ja ndihmon që të përfundohen luftërat dhe konfliktet në botë? (Përgjigjet e mundshme: Me ndërmjetësim në bisedime paqësore, me zbatimin e misioneve paqeruajtëse, me vendosjen e sanksioneve ndaj shteteve të caktuara).
- ➔ Cilat janë sfidat me të cilat përballet OKB-ja në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në botë? (Përgjigjet e mundshme: Shtete që nuk i përmbahen ndalesës për luftim, shtete që nuk respektojnë të drejtat e njeriut të qytetarëve të tyre, shtete që refuzojnë të bashkëpunojnë me OKB-në ose vendet tjera anëtare).
- ➔ A mendon se shtetet vetë mund të parandalojnë luftërat dhe konfliktet, apo megjithatë na duhen organizata ndërkombëtare siç është OKB-ja? Pse mendon ashtu? (Përgjigje të mundshme: shpesh palët ndërluftuese kanë nevojë për një anë neutrale që të përpiqet t'i pajtojë ato, dhe kjo është OKB-ja; nëse ekziston ndonjë problem, shtetet mund të diskutojnë problemin në OKB, e jo t'i qasen luftës; luftërat i prekin jo vetëm ata që janë në luftë por edhe vendet fqinje, rajonin, ndërsa shpesh edhe gjithë bashkësinë ndërkombëtare, etj.).
- ➔ Në çfarë mënyre, pas këtyre dy orëve, ka ndryshuar qëndrimi juaj për organizatat ndërkombëtare?

## *Fletë pune 5.4.* **Qëllime për zhvillim të qëndrueshëm dhe mënyra për arritje**

Shiko qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm dhe projektet e përshkruara më poshtë. Shëno drejt cilit/cilave qëllim/qëllime synohet me realizimin e secilit nga projektet.

### **Qëllime për zhvillim të qëndrueshëm**



## **Projekte të mbështetura nga organizatat në kuadër të OKB-së:**

### **Shembulli 1.**

Projekti, i mbështetur nga UNESCO, zbatohet në Kamboxhia, Indonezi dhe Nepal, ku jetojnë dy të tretat e personave të varfër në botë. Shumica e tyre janë gra dhe vajza dhe thuajse dy të tretat janë të moshës shkollore. Projekti ka për qëllim që të hetojë mënyra për aftësimin e vajzave të varfra të cilat nuk shkojnë në shkollë dhe t'u ndihmojë që të përvetësojnë dituri dhe shkathtësi që janë të ndërlidhura me teknologjinë, gjë që do t'ua çelë derën për më shumë mundësi për punë dhe në fund do ta rrisë statusin e tyre në shoqëri.

Qëllim/e për zhvillim të qëndrueshëm: \_\_\_\_\_

### **Shembulli 2.**

Republika e Maqedonisë së Veriut me ndihmën e UNICEF-it, UNDP-së dhe BE-së ia doli që të gjithë fëmijët të cilët ishin vendosur nëpër shtëpi të mëdha pa prindër, t'i zhvendosë të jetojnë në shtëpi të vogla, shtëpi grupore ku fëmijët kanë kushte për jetë të mirëfilltë familjare si në shtëpi.

Qëllim/e për zhvillim të qëndrueshëm: \_\_\_\_\_

### **Shembulli 3.**

Me mbështetje të UNDEF-it (Fondit për Demokraci të Kombeve të Bashkuara), në Armeni është zbatuar një projekt për forcimin e kapaciteteve të gazetarëve në mënyrë që të përfshihen në raportimin kundër korrupsionit, t'i ndjekin shpenzimet shtetërore të nëpunësve publik; avancim të transparencës qeveritare dhe vendosje të rrjetit për bashkëpunim mes mediave, shoqërisë qytetare dhe Qeverisë për aktiviteteve kundër korrupsionit.

Qëllim/e për zhvillim të qëndrueshëm: \_\_\_\_\_

### **Shembulli 4**

UNDP-ja ndihmoi Komunën e Resnjës që të vendosë sistem për menaxhimin dhe mbrojtjen e Liqenit të Prespës. Projekti përfshinte: ndërtimin e sistemit të kanalizimit, projekte të vogla infrastrukturore, mbështetje të ndërmarrjeve publike komunale dhe aktivitete të tjera në drejtim të menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit jetësor në Komunën e Resnjës. .

Qëllim/e për zhvillim të qëndrueshëm: \_\_\_\_\_



### **Shembulli 5.**

Për shkak të vetëdijes së pamjaftueshme demokratike dhe mosrespektimit të të drejtave të njeriut në Siera Leone, veçanërisht trajtimi i pabarabartë i grave në bashkësi, projekti (i mbështetur nga UNDEF-i) ka për qëllim të përmirësojë pjesëmarrjen e grave dhe të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe t'i aftësojë gratë që të luajnë rol të rëndësishëm në procesin e udhëheqjes në bashkësitë e tyre lokale.

Qëllim/e për zhvillim të qëndrueshëm: \_\_\_\_\_

### **Shembulli 6.**

Organizata „Let There Be Light International (LTBLI)“ shpërndan drita diellore për popullatën e Afrikës Subsahariane. Organizata është e orientuar drejt individëve dhe familjeve të kategorive të rrezikuara (të veja, persona të rritur, persona me nevoja të posaçme dhe fëmijë shkollorë). Deri në vitin 2018, kanë elektrifikuar me energji diellore 8 qendra rurale shëndetësore në zonat Gomba dhe Vakiso në Ugandë, duke shërbyer thuhetse 75,000 njerëz.

Qëllim/e për zhvillim të qëndrueshëm: \_\_\_\_\_

## **Fletë pune 5.5.**

### **Hapa drejt paqes**

Ju jeni përfaqësues në Këshillin e Sigurimit të shtetit të caktuar dhe keni për detyrë të përpiqeni të zgjidhni konfliktin në shtetin Arestan, të krijoni një paqe afatgjate dhe të mundësoni sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve të Arestanit. Konflikti ende nuk ka epilog, ndërsa qytetarët e Arestanit dhe vendeve përreth janë të ekspozuar ndaj vuajtjes së madhe. OKB-ja përpiqet të zgjidhë problemin, por i duhet ndihma dhe vendosmëria e Këshillit të Sigurimit për të gjetur një zgjidhje për paqe afatgjatë. Propozim-zgjidhjet do t'u prezantohen anëtarëve të tjerë të Këshillit të Sigurimit, të cilët do të përzgjedhin nga një zgjidhje për secilin problem.

Së pari t'ju njoftojmë me situatën në Arestan.

#### **KONFLIKTI NË ARESTAN**

Konflikti në Arestan, i cili filloi në vitin 2003, është një nga krizat më të mëdha humanitare që ka parë bota. Më shumë se 300,000 njerëz kanë humbur jetën në konflikt deri më tani, ndërsa më shumë se 3 milionë janë detyruar të braktisin shtëpitë e tyre për shkak të luftës.

#### **HISTORIKU I KONFLIKT**

Atena është një provincë në shtetin Arestan. Në Arestan ka dy kultura - Poseidonë dhe Apollonë. Qeveria në shtetin e Arestanit përbëhet kryesisht nga qytetarë apollonë, derisa shumica e qytetarëve në provincën e Atenës i përkasin kulturës poseidone. Konflikti fillon kur grupe kryengritësish fillojnë të sulmojnë qeverinë. Këto grupe konsiderojnë se qeveria i neglizhon dhe diskriminon qytetarët poseidonë. Si rezultat, provinca e Atenës është e pazhvilluar ekonomikisht dhe popullsia e saj është e varfër dhe e lënë pas dore. Si përgjigje ndaj sulmeve të kryengritësve, qeveria po sulmon provincën e Atenës, duke detyruar miliona qytetarë të shpërngulen nga shtëpitë e tyre në mënyrë që të shpëtojnë

#### **VËSHTIRËSITË E QYTETARËVE TË ATENËS**

Më shumë se 2 milionë qytetarë janë shpërngulur në Atenë, derisa 250,000 janë detyruar të kalojnë kufirin dhe të kërkojnë strehim nga dhuna në vendet fqinje. Si refugjatë, ata janë vendosur në kampe të improvizuara në shkretëtirë. Më shumë se 150,000 nga këta refugjatë janë fëmijë, gjysma e tyre nën moshën 14 vjeç. Në kampet e refugjatëve ka shumë pak resurse ushqimi, rroba, lodra, libra. Vetë kampet nuk ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme për fëmijët, që janë në rrezik të jenë të neglizhuar, të keqpërdorur, të rrëmbyer, të bëjnë punë të detyrueshme ose të jenë të rekrutuar si fëmijë-ushtarë.

## GJENDJA MOMENTALE

Përkundër përpjekjeve të OKB-së, rajoni është ende i paqëndrueshëm dhe i pasigurt. Qytetarët e pafajshëm dhe punëtorët humanitarë janë sulmuar nga grupet e armatosura. Dhuna dhe lufta e vazhdueshme pamundëson që OKB-ja të mbrojë qytetarët e ngujuar, por gjithashtu parandalon refugjatët që u larguan vite më parë të kthehen në shtëpi. Disa nga agjencitë që dërgojnë ndihmë humanitare duhet të ndalojnë aktivitetet e tyre në terren. Një nga pengesat më të mëdha për të arritur zgjidhje është fakti se kryengritësit dhe qeveria refuzojnë të takohen, të bisedojnë për problemin dhe të gjejnë një zgjidhje.

### *Detyra:*

Është koha, si anëtar i Këshillit të Sigurimit, të jepni propozim për aktivitetet me të cilat do të rikthehet paqja dhe siguria për qytetarët e Atenës.

Sfidë	Zgjidhje	Si do t'ju ndihmojë kjo zgjidhje qytetarëve të Atenës	Zgjidhje e mundshme
Luftim mes kryengritësve dhe Qeverisë			<ul style="list-style-type: none"><li>- OKB-ja të dërgojë një mision paqeruajtës që do t'i mbrojë qytetarët gjatë luftimeve midis qeverisë dhe kryengritësve;</li><li>- OKB-ja të vendosë sanksione në mënyrë që të bindë palët të fillojnë bisedime;</li><li>- Qeveria dhe kryengritësit të pajtohen që OKB-ja të marrë përsipër rolin e Qeverisë së përkohshme;</li><li>- OKB-ja të kërkojë që Qeveria të mbajë përgjegjësi para gjykatës ndërkombëtare për krimet që i ka bërë ndaj civilëve të Atenës;</li><li>- Shteti juaj t'u ndihmojë kryengritësve të fitojnë;</li><li>- Shteti juaj t'i ndihmojë Qeverisë të fitojë;</li></ul>
Miliona refugjatë të cilët jetojnë në kampe për refugjatë në Arestan dhe shtetet fqinje			<ul style="list-style-type: none"><li>- OKB-ja të mundësojë më shumë mbështetje financiare për kampet;</li><li>- Shteti juaj të ofrohet të pranojë një pjesë të refugjatëve;</li><li>- Shteti juaj të kushtëzojë mbështetjen për cilëndo prej palëve me kthimin e refugjatëve.</li></ul>

# *Përmbajtja: Republika e Maqedonisë së Veriut si pjesë e Evropës*



## **Rezultate nga nxënia**

Nxënësi/nxënësja mund të::

- ➔ analizojë pozicionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në raport me Bashkimin Evropian (BE),
- ➔ gjejë mënyra për bashkëpunim në fusha të ndryshme.



## **Standarde/tregues**

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ dallon përparësitë dhe sfidat nga anëtarësimi në BE, me referencë të veçantë në interesat e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe qytetarëve të saj;
- ➔ dallon vlera të përbashkëta evropiane dhe respekton diversitetin dhe identitetin kulturor.



## **Materiale të nevojshme:**

fletë pune 5.6., fletë pune 5.7., lapsa kimik/lapsa, projektor, hamer



## **Metoda, teknika, forma:**

unë individuale, punë në çifte, diskutim, teknika "Di, Dua të di, Mësova" -DDM

## *Pjesa hyrëse e orës (10 min.)*

Në fillim të orës së mësimi, mësimdhënësi vizaton tre kolona në tabelë “Di, Dua të di, Mësova” dhe i fton nxënësit të ndajnë ide dhe njohuri paraprake për Bashkimin Evropian si temë. Mësimdhënësi i nxitë nxënësit të ndajnë sa më shumë ide që të jetë e mundshme dhe të njëjtat i shkruan në tabelë.

Në fund të kohës së parashikuar për aktivitetin, mësimdhënësi nxjerr një konstatim të shkurtër: Për shkak të faktit se shtetet evropiane nuk kanë jetuar gjithmonë në paqe, Bashkimi Evropian është në thelb një përpjekje për të ndaluar luftimet e shpeshta midis shteteve në Evropë. BE-ja është themeluar në vitin 1951 dhe edhe sot e kësaj dite në territorin e tij ka paqe, ndonëse vendet anëtare jo gjithmonë pajtohen mes vete. Për shkak të përkushtimit dhe mbështetjes për paqe, demokraci dhe të drejtat e njeriut në vitin 2012, Bashkimi Evropian mori Çmimin Nobel për Paqe. Në vitin 2020, 28 vende janë anëtare të BE-së, ndërsa rreth 512 milionë qytetarë janë shtetas të tij.

## *Pjesa kryesore e orës (30 min.)*

### **Vlerat e BE-së**

Motoja e BE-së është “Të bashkuar në diversitetet”, ndërsa e gjithë puna e Bashkimit Evropian bazohet në vlerat e demokracisë, dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Prandaj secili shtet që dëshiron të bëhet anëtar i BE-së duhet doemos të tregojë se i respekton të njëjtat vlera. Prandaj, një nga mënyrat për të treguar se vlerëson me të vërtetë larminë e shumë kulturave që ekzistojnë në kuadër të shteteve të BE-së, por edhe se të gjithë janë të barabartë, BE-ja në punën e institucioneve të saj zbaton madje 24 gjuhë. Kjo do të thotë se kur Maqedonia e Veriut do të bëhet vend anëtar i BE-së edhe gjuha maqedonase do të bëhet gjuhë zyrtare e BE-së.

### **Aktivitet:**

#### **Vlera evropiane në RMV (10 min.)**

Mësimdhënësi ndan fletën e punës 5.6. që nxënësit duhet ta plotësojnë në çifte. Tabela mund të paraqitet edhe përmes projektorit ose në hamer, ndërsa nxënësit të plotësojnë në fletoret e tyre. Pasi të mbarojnë pesë minutat e parashikuara për punë në çifte, mësimdhënësi inkurajon nxënësit të ndajnë dhe argumentojnë përgjigjet e tyre.

## ***Përfitime nga anëtarësimi në BE***

**Qytetarët e BE-së mund të udhëtojnë dhe të jetojnë në çdo shtet tjetër të BE-së.** Për shembull, "Zbulojë BE-në" është një nismë me të cilën secili që do të arrijë moshën 18 vjeçe mund të udhëtojë nëpër BE, kryesisht me tren. Kjo është e mundshme meqë me vendosjen e Zonës së Shengenit nuk ka kufij dhe transporti është shumë më i lirë sesa më parë.

Gjithashtu, **qytetarët e BE-së mund të mësojnë në çdo shtet tjetër të BE-së.** Për këtë ekziston programi "Erasmus +" që u jep nxënësve dhe mësimdhënësve mundësinë për të mësuar ose për t'u përsosur jashtë shtetit të tyre. Të rinjtë madje mund të aplikojnë për praktikë në institucionet evropiane në Bruksel, Strasburg dhe Luksemburg. **Qytetarët janë të lirë të zgjedhin se ku duan të jetojnë, mësojnë ose punojnë,** falë lëvizjes së lirë të njerëzve dhe tregut të vetëm të punës që ekziston në BE. Në këtë moment, madje 17 milionë njerëz punojnë ose jetojnë në shtet tjetër të BE-së.

Qytetarët e BE-së **mund të punojnë në kompani ose institucion ose të fillojnë biznesin e tyre në cilindo shtet të BE-së.** Në mënyrë që t'u ndihmojë njerëzve të rinj që të gjejnë punë më lehtë, gjegjësisht të përfshihen në tregun e punës, BE-ja ka programin e vet të quajtur Garancia e Rinisë. Ky program u ndihmon të rinjve të gjejnë punë me të cilën do të jenë të kënaqur.

Po aq e rëndësishme është që **qytetarët e BE-së të kenë të drejtën të marrin pjesë në marrjen e vendimeve në nivelin evropian.** Prandaj, ata marrin pjesë në zgjedhjet për deputetë në Parlamentin Evropian. Qytetarët mund, së bashku me një milion qytetarë të tjerë nga 7 vende, të parashtrojnë nisma në Komisionin Evropian duke propozuar miratimin e ndonjë ligji, ose të marrin pjesë në dialog me përfaqësuesit e BE-së, ku ata mund t'ua shprehin pritjet dhe qëndrimet e tyre<sup>1</sup>.

BE-ja gjithashtu **ndihmon mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe biodiversitetin dhe lufton në mënyrë aktive ndryshimet klimatike.** Qytetarët pinë ujë dukshëm më të pastër për shkak të standardeve që BE-ja i ka vendosur në raport me cilësinë e ajrit dhe ujit.

BE-ja kujdeset edhe për të drejtat e qytetarëve si konsumatorë. Pra, kudo në BE qytetarët paguajnë të njëjtin çmim për të folur në telefon, pa shpenzime për roaming ose nga ana tjetër, nëse ua anulojnë ose vonojnë ndjeshëm fluturimin e tyre, BE-ja do të kujdeset që paratë e tyre t'u kthehen. Gjithashtu, nëse një qytetar i BE-së blen në internet nga ofertuesit e regjistruar në BE dhe nuk është i kënaqur me produktin e blerë, mund ta kthejë atë, duke iu falënderuar ligjeve që i miraton BE-ja. Nëse një shtetas i BE-së sëmuret në një shtet që nuk është i tij, pa problem, në kushte të njëjta, do të mund të kurohet në institucionet shëndetësore lokale, publike.

### **Aktivitet:**

#### ***Përfitimet më të rëndësishme nga anëtarësimi i RMV-së në BE (10 min.)***

Mësimdhënësi u ndan nxënësve fletën e punës 5.7. në të cilën ata duhet të përzgjedhin, sipas tyre, tri përfitimet më të rëndësishme nga anëtarësimi i RMV-s në BE. Përndryshe, nëntë pohimet mund të shfaqen përmes projektorit ose në hamer, ndërsa nxënësit t'i shikojnë ato derisa bëjnë përzgjedhjen e tyre. Për plotësimin e mëvetësishëm të fletës së punës janë parashikuar 5 minuta. Pasi të mbarojë koha e parashikuar, mësimdhënësi nxitë nxënësit të ndajnë dhe argumentojnë përzgjedhjen e tyre.

#### ***Pjesa përfundimtare e orës dhe aktivitet për reflektim (10 min.)***

Mësimdhënësi inkurajon nxënësit të ndajnë atë që e kanë mësuar gjatë orës së mësimit dhe ai i shënon në kolonën Mësova të teknikës DDM në pjesën hyrëse të orës.

## *Fletë pune 5.6.*

### **Vlerat evropiane në RMV**

Sipas mendimit tuaj, sa respektohen këto vlera evropiane në shtetin tonë? Shënoni përgjigjet në tabelë.

Vlera	Pamjaftueshëm	Pjesërisht	Tërësisht
Dinjiteti njerëzor dhe të drejtat e njeriut			
Liria			
Demokracia			
Sundimi i së drejtës			
Barazia			



## ***Fletë pune 5.7.*** ***Përfitimet më të rëndësishme nga anëtarësimi i RMV-së në BE***

Shqyrtoi pohimet e dhëna dhe përzgjidhi ato tri që konsideron se janë përfitimet më të rëndësishme nga anëtarësimi i vendit tonë në BE.

1. Anëtarësimi në BE do të thotë ndërtim të një shoqërie evropiane dhe një shteti sipas rregullave evropiane.	2. Anëtarësimi në BE do të thotë mundësi të pakufizuara për udhëtim, arsim dhe praktikë cilësore, si dhe vende pune me pagesë më të mirë.	3. Anëtarësimi në BE do të thotë më shumë mjete financiare për rrugë, ujësjellës, kanalizime, shkolla dhe kopshte për fëmijë.
4. Anëtarësimi në BE do të thotë standard më të lartë jetësor , PBB (Prodhim i Brendshëm Bruto ) më të lartë, më shumë vende të punës.	5. Anëtarësimi në BE do të thotë të investosh në shkencë, teknologji dhe në inovacione.	6. Anëtarësimi në BE do të thotë institucione që u shërbejnë në mënyrë cilësore të gjithë qytetarëve.
7. Anëtarësimi në BE do të thotë shfrytëzim të fondeve të BE-së për të mbrojtur dhe përmirësuar mjedisin përmes projekteve për tokë, ujë dhe ajër më të pastër	8. Anëtarësimi në BE do të thotë kufij më të sigurt dhe ruajtje të paqes në vend.	9. Anëtarësimi në BE do të thotë eksport të lehtë dhe të rritur, plasman më të mirë jashtë vendit dhe çmim më të lartë të blerjes së produkteve të maqedonisë

# *Përmbajtja: Republika e Maqedonisë së Veriut si pjesë e Evropës*



## *Rezultate nga nxënia*

Nxënësi/nxënësja mund të::

- ➔ analizojë pozitën e Republikës së Maqedonisë së Veriut në raport me Bashkimin Evropian (BE) dhe të gjejë mënyra për bashkëpunim në fusha të ndryshme.



## *Standarde/tregues*

Nxënësi/nxënësja mund të:

- ➔ identifikon shembuj të bashkëpunimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me vende të tjera evropiane në fusha të ndryshme nga aspekti individual, familjar dhe aspekt tjetër;
- ➔ identifikon mënyra për shkëmbim dhe bashkëpunim të të rinjve të Republikës së Maqedonisë së Veriut me të rinjtë e shteteve tjera evropiane.



## *Materiale të nevojshme:*

kompjuter, projektor



## *Metoda, teknika, forma:*

diskutim

## Pjesa hyrëse e orës (10 min.)

Mësimdhënësi nxitë diskutimin me pyetjet si vijon:

- ➔ A e dini cilat shtete dëshirojnë të bëhen anëtare të BE-së? (Pritet që nxënësit të ndajnë informacione për shtete të Ballkanit).
- ➔ Pse thuajse të gjitha shtetet që dëshirojnë të bëhen anëtare të BE-së janë nga Ballkani? (Përgjigje të mundshme: për shkak se shtetet e Ballkanit janë pjesë e Evropës, për shkak se ndajnë vlera të ngjashme me shtetet anëtare të BE, për shkak se kanë interes të jenë pjesë e tregut të BE-së).
- ➔ Cilat janë ngjashmëritë, e cilat janë dallimet midis shteteve që janë anëtare të BE-së dhe shteteve të Ballkanit që duan të bëhen anëtare? (Përgjigje të mundshme: ato që duan të bëhen anëtarë nuk janë ende në të njëjtin nivel demokratik me anëtarët e BE-së, nuk kanë treg plotësisht të lirë funksional që të mund të bëhen pjesë e tregut të BE-së, vendet e Ballkanit në vitet '90 kishin një konflikt që pamundësoi funksionimin demokratik dhe zhvillimin ekonomik).
- ➔ Sipas teje, sa i respekton Maqedonia e Veriut këto vlera dhe a është e gatshme të bëhet një vend anëtar i BE-së? (Janë të mundshme përgjigje të ndryshme në varësi nga karakteristikat personale dhe përvojat e deritanishme të nxënësve).
- ➔ Cilat do të ishin përfitimet për ty, nëse Maqedonia e Veriut bëhet anëtare e BE-së? (Përgjigje të mundshme: qasja në një treg më të madh, qytetarët do të mund të punojnë atje ku duan në BE ose të themelojnë kompani, mundësi për përdorimin e programeve për arsim dhe vullnetarizëm, mundësi për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore në shtete të tjera të BE-së).
- ➔ Në cilat pyetje konsideron se BE duhet të përqendrohet në të ardhmen dhe pse? (Përgjigje të mundshme: mbrojtje e të drejtave të njeriut, për shembull të drejtat LGBTQ, mbrojtje e mjedisit jetësor, punësimi, çështjet e të rinjve, gjithëpërfshirja sociale, arsimit, etj.).

Mësimdhënësi bën përmbledhjen e përgjigjeve të nxënësve dhe nxjerr një konstatim të shkurtër nga diskutimi:

Bashkimi Evropian dhe anëtarët e saj zhvillohen vazhdimisht në përputhje me nevojat dhe interesat e qytetarëve të tyre, por edhe në përputhje me qëllimet e përbashkëta të shteteve anëtare. Anëtarësimi i RMV-së në BE jo vetëm që do të nxisë përparim të madh shoqëror në shtet, por do të ketë edhe ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së përditshme të të gjithë qytetarëve në Maqedoni.

## Pjesa kryesore e orës (25 min.)

### Aktivitet:

#### **Diskutim për mënyra të bashkëpunimit në nivel të BE-së**

Mësimdhënësi lexon një deklaratë, pas së cilës fton nxënësit të mendojnë dhe diskutojnë për pyetjet e propozuara. Varësisht nga koha në dispozicion, fusha në të cilën janë orientuar nxënësit dhe interesat e tyre, mësimdhënësi mund të bëjë përzgjedhje nga deklaratat e propozuara që t'i përpunojë në orë dhe/ose t'i zëvendësojë me të tjera.

**Deklarata 1:** Gjatë 3 dekadave, më shumë se 10 milion nxënës, mësimdhënës, profesorë, njerëz të rinj kanë marrë pjesë në programin Erasmus+. Në periudhën prej vitit 2015-2018, 47 nxënës dhe mësimdhënës nga Maqedonia e Veriut ishin në shkëmbim përmes Erasmus +.<sup>22</sup>

➔ **Cilat janë përfitimet për nxënësit dhe mësimdhënësit nga Maqedonia e Veriut që kanë marrë pjesë në këto shkëmbime?**

**Deklarata 2:** Në vitin 2018, 31% e qytetarëve të Bashkimit Evropian kanë qenë vullnetarë vitin e kaluar. Të rinjtë në BE mund të paraqiten vullnetarë në një vend tjetër evropian përmes Korpusit<sup>23</sup> Solidar Evropian dhe Shërbimit Vullnetar Evropian. Të rinjtë nga Maqedonia e Veriut kanë të drejtë të marrin pjesë në këto dy programe.

➔ **Sa shpesh paraqiten vullnetarë qytetarët e Maqedonisë së Veriut? A janë të rinjtë më shumë vullnetarë sesa qytetarët tjerë të Maqedonisë së Veriut?**

**Deklarata 3:** Dialogu Rinor Evropian është një mekanizëm përmes të cilit njerëzit e rinj, organizatat rinore dhe vendimmarrësit në Bashkimin Evropian debatojnë për çështje me rëndësi për të rinjtë. Në këtë mënyrë, BE-ja sigurohet se mendimet, qëndrimet dhe nevojat e të rinjve janë marrë parasysh gjatë përcaktimit të prioriteteve të politikave rinore që i miraton BE-ja. BE-ja ka miratuar Strategji për të rinjtë për periudhën 2019-2027 që ka për qëllim t'i lidhë, përfshijë dhe inkurajojë të rinjtë.

➔ **Në çfarë mënyre të rinjtë nga Maqedonia e Veriut janë konsultuar nga ata që marrin vendime?**

22 [https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/sites/erasmusplus2/files/erasmusplus\\_northmacedonia\\_2018.pdf](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/sites/erasmusplus2/files/erasmusplus_northmacedonia_2018.pdf)

23 <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/d8989d5f-c2cb-11e8-9424-01aa75ed71a1/language-mk/format-PDF>

**Deklarata 4:** “Zbuloni BE-në” është nismë me të cilën secili që mbush 18 vjeç mund të udhëtojë nëpër BE. Qëllimi i kësaj nisme është që njerëzit e rinj të zhvillojnë aftësi të tilla si pavarësi, vetëbesim dhe të jenë të hapur ndaj kulturave të tjera. Deri më tani më shumë se 70,000 njerëz të rinj nga BE-ja e kanë shfrytëzuar këtë mundësi.

➔ **Sa janë të rinjtë në Maqedoninë e Veriut të pavarur, me vetëbesim dhe të hapur ndaj kulturave të tjera?**

**Deklarata 5:** Në mënyrë që t’u ndihmojë njerëzve të rinj të gjejnë punë më lehtë, gjegjësisht të përfshihen në tregun e punës, BE-ja ka programin e vet të quajtur Garancia Rinore. Çdo vit, më shumë se 5 milion të rinj aplikojnë për shfrytëzimin e Garancisë Rinore, nga të cilët më shumë se 3.5 milion të rinj punësohen, vazhdojnë shkollimin ose shkojnë në praktikë. Maqedonia e Veriut vendosi një instrument të ngjashëm, kështu që në vitin 2018 në garancinë rinore u përfshinë 8,850 persona.<sup>24</sup>

➔ **Papunësia e të rinjve (për qytetarët midis 20-34 vjeç) në Maqedoninë e Veriut është 36.3% që është më shumë se dyfishi i mesatares së Bashkimit Evropian (16.5%)<sup>25</sup>. Pse kemi një papunësi kaq të lartë të të rinjve në Maqedoninë e Veriut? Në çfarë mënyre mund të ulët papunësia e të rinjve, nëse bëhemi anëtare të BE-së?**

**Deklarata 6:** Në vitin 2019, në një takim mes ministrave të bujqësisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës Çeke, u nënshkrua një Deklaratë për bashkëpunim të ndërsjellë të dy vendeve në pjesën e shkëmbimit tregtar të produkteve bujqësore-ushqimore, shkëmbimit të përvojave në fushën e proceseve eurointegruese në sektorët e bujqësisë dhe atyre rural, si dhe pylltarinë, peshkimin dhe akuakulturën, vreshtarinë, prodhimin e verës, etj. Republika Çeke, si anëtare e BE-së, shfrytëzon 1 miliard euro, mjete të dedikuara për modernizimin e bujqësisë dhe përmirësimin e kushteve në mjediset rurale. Republika Çeke është në krye të BE-së në ruajtjen e bagëtive, ndërsa shërbimet e inspektimit janë një nga më të rreptat në Evropë.

➔ **Cilat janë përfitimet nga vendosja e bashkëpunimit ndërkombëtar mes shtetit tonë dhe shteteve të tjera evropiane?**

24 <https://vlada.mk/node/18570>

25 <https://faktor.mk/lideri-sme-po-mladinska-nevrabotenost--kolku-e-teshko-da-se-najde-rabota>

## *Pjesa përfundimtare e orës / Aktivitet për reflektim dhe vlerësim (10 min.)*

Mësimdhënësi nxitë diskutim me nxënësit:

- ➔ Sa prej përmbajtjeve të përpunuara në këtë orë ishin tashmë të njohura për ty, e me çfarë u njoftove për herë të parë?
- ➔ Në çfarë mënyre atë që e mësuam sot, mund ta shfrytëzojmë në përditshmërinë tonë?
- ➔ Cilat nga mundësitë për shkëmbim dhe bashkëpunim me të rinjtë nga vendet e BE-së do të dëshironit t'i shfrytëzoni? Pse?



# **BIBLIOGRAFIA**



- Amano, T., Sandel, B., Eager, H., Bulteau, E., Svenning, J. C., Dalsgaard, B., ... & Sutherland, W. J. (2014). Global distribution and drivers of language extinction risk. *Proceedings of the Royal Society B: Biological Sciences*, 281(1793), 20141574.
- Aronson, E., Wilson T.D. Akert, R.M., Sommers, S.M. (2013) *Social Psychology*. Pearson.
- Boulding, K. (1962). *Conflict and defense*. Harpers, New York.
- Brennan, K., Bryant, D.S., Kaman, C. Empathy as a Foundation of Civic Engagement: Using Technology and Storytelling to Cultivate Perspective Taking, 2008. Në dispozicion në: <https://llk.media.mit.edu/courses/readings/civic-media/idc-proposal.pdf>
- British Council. (2017). *Active Citizens Facilitator's Kit*. Në dispozicion në: [https://www.britishcouncil.mk/sites/default/files/active\\_citizens\\_global\\_toolkit\\_2017-18.pdf](https://www.britishcouncil.mk/sites/default/files/active_citizens_global_toolkit_2017-18.pdf)
- Bureau of Labor Statistics. (2013). *International Labor Comparisons of Hourly Compensation Costs in Manufacturing, 2012*. Në dispozicion në: <https://www.bls.gov/fls/ichcc.pdf>
- Civix. (n.d.) *Citizenship Education Resources – Secondary Lessons*. Në dispozicion në: <http://civix.ca/resources/category/secondary-lessons/>
- Collaborative for Academic, Social and Emotional Learning. (2017). *Sample Teaching Activities to Support Core Competencies of Social and Emotional Learning*. Chicago: Collaborative for Academic, Social, and Emotional Learning. Në dispozicion në: <https://www.casel.org/wp-content/uploads/2017/08/Sample-Teaching-ies-8-20-17.pdf>
- College & Career Competency Framework. (2017). *Self-Regulation Lessons*. Kansas: CCC Framework. Në dispozicion në: <https://apps.esc1.net/ProfessionalDevelopment/uploads/WKDocs/71257/Self-Regulation%20Lessons.pdf>
- Community Engagement and Education Unit. (2010). *Learning & Teaching Resources*. Melbourne: Parliament of Victoria. Në dispozicion në: <https://www.parliament.vic.gov.au/education/learning-a-teaching-resources>
- Department of Education and Early Childhood Development. (2007). *Developing, monitoring and reporting on personal learning goals*. Melbourne: State of Victoria. Në dispozicion në: <https://www.education.vic.gov.au/Documents/school/teachers/teachingresources/social/personal/devperslearngoal.pdf>
- Encyclopædia Britannica. (2020). *Sovereignty*. Në dispozicion në: <https://www.britannica.com/topic/sovereignty>
- Endangered Languages Project. Në dispozicion në: <http://www.endangeredlanguages.com/about/>
- Equality and Human Rights Commission. (n.d.) *Lesson plan ideas*. Në dispozicion në: <https://www.equalityhumanrights.com/en/lesson-plan-ideas>
- Everyday Democracy. (2016). *Resources for Teaching Civics and Government*. Në dispozicion në: <https://www.everyday-democracy.org/resources/resources-teaching-civics-and-government>
- Galtung, J. (1996). *Peace by peaceful means: Peace and conflict, development and civilization* (Vol. 14). Sage.
- Gysbers, N. C., Stanley, J. B., Kosteck-Bunch, L., Magnuson, C. S., & Starr, M. F. (2011). *Missouri comprehensive guidance and counseling program: A manual for program development, implementation, evaluation and enhancement*. Jefferson City, MO: Department of Elementary and Secondary Education. Në dispozicion në: [https://dese.mo.gov/sites/default/files/cnsl-missouri-comprehensive-school-counseling-manual-2017\\_0.pdf](https://dese.mo.gov/sites/default/files/cnsl-missouri-comprehensive-school-counseling-manual-2017_0.pdf)
- Howard, J. A. (2000). *Social Psychology of Identities*. *Annual Review in Sociology*, 26:367–93.
- International Institute for Democracy and Electoral Assistance. (n.d.) *Global State of Democracy Indices*. Në dispozicion në: <https://www.idea.int/data-tools/tools/global-state-democracy-indices>
- Krauss, R.M., Fussell, S.R., (1996) *Social Psychological Models of Interpersonal Communication* in Higgins & A. Kruglanski (Eds.), *Social Psychology: Handbook of Basic Principles*. New York: Guilford Press.

- Lannegrand-Willems, L., Chevrier, B., Perchec, C., & Carrizales, A. (2018). How is Civic Engagement Related to Personal Identity and Social Identity in Late Adolescents and Emerging Adults? A Person-Oriented Approach. *Journal of Youth Adolescence*.
- Milivojevic, Z. (2000). *Emocije – Psihoterapija i razumevanje emocija*. Novi Sad: Prometej.
- Milofsky, A. (Ed.) (2011). *Peacebuilding Toolkit for Educators – High School Lessons*. Washington: United States Institute of Peace Press. Në dispozicion në: [https://www.usip.org/sites/default/files/GPC\\_EducatorToolkit-\(HighSchool\)\\_combined.pdf](https://www.usip.org/sites/default/files/GPC_EducatorToolkit-(HighSchool)_combined.pdf)
- Musliu, A., & Simonovski, I. (2019). *Handbook for Teachers in Secondary Schools and Tools for Early Detection and Action*. Skopje: Center for Research and Policy Making.
- Oxfam, G. B. (2015). *Global Citizenship in the Classroom: A Guide for Teachers*. Në dispozicion në: <https://oxfamilibrary.openrepository.com/handle/10546/620105>
- Petrovska, I. (2019) *Civic Identity Development: Ontogenetic Aspect*. *Social Welfare Interdisciplinary Approach*, 9 (2).
- Practical Money Skills. (n.d.) *Lesson Plans: Grades 9-12*. Në dispozicion në: [https://www.practicalmoneyskills.com/teach/lesson\\_plans/grades\\_9\\_12](https://www.practicalmoneyskills.com/teach/lesson_plans/grades_9_12)
- Price, J. (2003). *Get Global! : A Skills-based Approach to Active Global Citizenship; Key Stages Three & Four*. ActionAid. Në dispozicion në: <https://resourcecentre.savethechildren.net/library/get-global-skills-based-approach-active-global-citizenship-key-stages-three-four>
- Roser, M., Ritchie, H. & Ortiz-Ospina, E. (2015). "Internet". Published online at OurWorldInData.org. Në dispozicion në: <https://ourworldindata.org/internet>
- Sassenberg, K., Vliek, M., W. (Eds.) (2019). *Social Psychology in Action*. Springer.
- Sen, R. (2003). *Stir it up: Lessons in community organizing and advocacy (Vol. 16)*. John Wiley & Sons.
- UNESCO. (2016). *A Teacher's Guide to Prevention from Violent Extremism*. Në dispozicion në: [https://en.unesco.org/sites/default/files/lala\\_0.pdf](https://en.unesco.org/sites/default/files/lala_0.pdf)
- University of Houston Center for Diversity and Inclusion. (n.d.) *Diversity Activities Resource Guide*. Në dispozicion në: [https://www.uh.edu/cdi/diversity\\_education/resources/\\_files/\\_activities/diversity-activities-resource-guide.pdf](https://www.uh.edu/cdi/diversity_education/resources/_files/_activities/diversity-activities-resource-guide.pdf)
- United States Institute of Peace. (n.d.) *Activities*. Në dispozicion në: <https://www.usip.org/public-education/educators/lessons-and-activities>
- World Bank Data. (2019). *Air transport, passengers carried*. Në dispozicion në: <https://data.worldbank.org/indicator/IS.AIR.PSGR?end=2018&start=1970&view=chart>
- World's Largest Lesson. (n.d.) *Human Rights and the Global Goals*. Në dispozicion në: [https://www.biomatiko.gr/\\_downloads/goal\\_4/Amnesty-WLL-lesson-plan-English.pdf](https://www.biomatiko.gr/_downloads/goal_4/Amnesty-WLL-lesson-plan-English.pdf)
- Алушевски, С. и Тркуља, А. (2011). *Ние сме визуелни! Образование и аудиовизуелизација на човекови права*. Скопје: МакеДокс и ЦРИС „Студиорум“. Në dispozicion në: <https://issuu.com/makedox/docs/we-are-visual-mkd-web-bez-mkd>
- Грнчаревски, В. и Бачовска, Ј. (2013). *Основи на правото: IV година Средно стручно образование*.
- Лахтов, М. и Трајкоска, Ж. (Уред.) (2018). *Прирачник за медиумска писменост за млади, за медиуми и за граѓански организации*. Скопје: Висока школа за новинарство и за односи со јавноста, Институт за комуникациски студии.
- МакеДокс. (б.д.) *МакеДокс во училница 1*. Në dispozicion në: [https://issuu.com/makedox/docs/makedox\\_in\\_classroom\\_mkd\\_3mm\\_bleed\\_final](https://issuu.com/makedox/docs/makedox_in_classroom_mkd_3mm_bleed_final)
- МакеДокс. (б.д.) *МакеДокс во училница 2: Креативни документарни филмови во образованието*. Në dispozicion në: [https://issuu.com/makedox/docs/md\\_vo\\_ucilnica\\_mk](https://issuu.com/makedox/docs/md_vo_ucilnica_mk)
- Пецова Илиеска, Л., Бабаноски, К. и Јаневска Делева, А. (2020). *Прирачник за работа на час наменет за ученици во средно образование за изучување на темата „Борба против корупција“*. Скопје: Институт за демократија „Социетас Цивилис“ - Скопје.

## Video

- Ta vizatoj: Bartës të ndryshimeve. Masa kritike,  
Produksioni: Ballkoni 3, Në dispozicion  
në: [https://www.youtube.com/  
watch?v=zFibL1gbnNs](https://www.youtube.com/watch?v=zFibL1gbnNs), 6 Shkurt, 2021
- Ta vizatoj: Bartës të ndryshimeve. Programuesi  
i ajrit. Produksioni: Ballkoni 3, Në  
dispozicion në: [https://www.youtube.com/  
watch?v=f4FyvoKFE4Y](https://www.youtube.com/watch?v=f4FyvoKFE4Y), 6 Shkurt, 2021
- Gra në biçikleta për të drejta të njeriut në Pakistan.  
Në dispozicion në: [https://www.youtube.com/  
watch?v=zc0VzAi5ERQ](https://www.youtube.com/watch?v=zc0VzAi5ERQ), 14 Janar, 2021
- Humanity. Change yourself to a better person. Në  
dispozicion në: [https://www.youtube.com/  
watch?v=0Cl280pJf0gSt=2s](https://www.youtube.com/watch?v=0Cl280pJf0gSt=2s), 19 qershor, 2014
- Tregim për të drejta të njeriut, Në dispozicion  
në: [https://www.youtube.com/  
watch?v=zc0VzAi5ERQ](https://www.youtube.com/watch?v=zc0VzAi5ERQ), 14 Janar, 2021
- © 2009 United for Human Rights. Të gjitha të drejtat  
janë të rezervuara.
- AP Archives, F.I.L.M Archives, Journeyman Pictures,  
ABC News Video Source, National Archives, WPA  
Library, Footage Bank. Dr. King footage license  
granted by Intellectual Management, Atlanta  
Georgia as exclusive licensor of the King Estate
- Полио Плус – движење против хендикеп ги доби  
правата на филмот “Приказна за човековите  
права” од United for Human Rights да го  
преведе и да го дистрибуира за едукативни  
цели.
- Polio Plus – lëvizja kundër handikapit i fitoi të drejtat  
e filmit “Tregimi për të drejtat e njeriut” nga  
United for Human Rights ta përkthejë dhe ta  
distribuojë për qëllime edukative.





